

## GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Numri i lëndës 410/13

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jetë i formës së prerë dhe mund të jetë objekt i ankesës në bazë të ligjit të aplikueshëm.

**(HYRJE)**

Ky aktgjykim është i datës 14 prill 2016

### AKTGJYKIM NË EMËR TË POPULLIT

Në bazë të neneve 359 *et seq.* të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm KPPRK) *ex vi* neni 541, paragrafi (në tekstin e mëtejshëm, par.) 1, të KPPRK-së. KPPRK i ri që ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013, do të zbatohet në këtë lëndë si aktakuza, e datës 11 dhjetor 2013 në Prishtinë (PSRK PPS Nr: 50/2011), që është ngritur në të njëjtën ditë, kjo sipas neni 541, paragrafi 1, të KPPRK-së.

**Seanca dëgjimore fillestare** është mbajtur në disa seanca, për shkak jo vetëm të vëllimit të lëndës por edhe për shkak të numrit të çështjeve, dhe kompleksitetit të saj, që duheshin adresuar; seanca të tilla janë mbajtur më 30 dhjetor 2013, 29 janar 2014 dhe 23 prill 2014.

Përkthimi i aktakuzës në turqisht është urdhëruar gjithashtu më 30 dhjetor 2013.

Duke pasur parasysh edhe nevojën për përkthimin e disa provave në gjuhë të ndryshme (për shembull nga kroate, angleze në shqip dhe turqisht), në seancën e 29 janarit 2014, të gjithë pjesëmarrësit u pajtuan që të mbahet seanca e radhës vetëm pas 31 marsit 2014, në mënyrë që të mundësohen përkthimet e nevojshme.

Në seancën e mbajtur më 23 prill 2014 është konfirmuar se aktakuza e përthyer është dorëzuar, gjithashtu është konsideruar se provat ishin shpalosur dhe përthyer dhe se raportet tjera të mbetura do të dorëzohen së shpejti si dhe është konsideruar se provat janë shpalosur.

Gjithashtu më 23 prill 2014, pas marrëveshjes së pjesëmarrësve, vetëm dispozitivi i aktakuzës është lexuar dhe pasi që është siguruar se e kanë kuptuar aktakuzën dhe pikat e akuzës gjykata mori deklaratimet e tyre mbi fajësinë.

Të gjithë të pandehurit janë deklaruar të pafajshëm për të gjitha akuzat, përveç i pandehuri A.M., i cili ka thënë se është i gatshëm të nënshkruaj marrëveshje me prokurorinë por vetëm lidhur me akuzën e kontrabandimit me migrantë (pika numër 2); një marrëveshje e tillë nuk u arrit asnjëherë.

Në të njëjtën seancë dëgjimore fillestare, përsëri është diskutuar që provat e shpalosura mund të jenë në format digjital, jo të shtypura, dhe një afat prej 20 ditësh është caktuar (në pajtim me nenin 245 paragrafi 6 të KPPK-së) për të paraqitur ndonjë kundërshtim ndaj provave të cekura në aktakuzë në pajtim me nenin 249 të KPPK-së, për të paraqitur ndonjë kërkesë për hedhjen poshtë të aktakuzës si e ndaluar ligjrisht apo që nuk kishte asnjë provë në aktakuzë sipas neneve 250 dhe 253 të KPPK-së.

Gjithashtu është vendosur, duke pasur parasysh llojin e madh të subjekteve që mund të diskutohen gjatë seancës së dytë, sipas nevojës për të caktuar, një afat prej 30 ditësh, ju është dhënë avokatëve mbrojtës për të paraqitur materialet e tyre, kundërshtimet dhe kërkesat për hedhjen poshtë të aktakuzës.

**Seanca e dytë dëgjimore**, në pajtim me nenin 254 të KPPK-së, është mbajtur më 30 maj 2014. Në seancën e dytë dëgjimore, askush nuk ka ofruar materiale tjera për mbrojtjen e tyre, që mund të ishte e pranueshme në pajtim me nenin 256 të KPPK-së.

Kur është mbajtur seanca e dytë dëgjimore, rreth kundërshtimeve në prova dhe kërkesave për të hedhur poshtë aktakuzën, veçse ishte vendosur me aktvendimin e datës 27 maj 2014, aktvendim i cili është vërtetuar nga Gjykata e Apelit. Pasi që aktvendimi u bë i plotfuqishëm, ishte e mundur të vazhdohet me shqyrtim gjyqësor, që ka filluar më 10 shtator 2014.

**Gjykata Themelore në Prizren** në këtë lëndë ka një trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Jorge Martins Ribeiro (EULEX, si kryetar i trupit gjykues) dhe Jennifer Seel (EULEX), së bashku me gjyqtarin e Kosovës Artan Sejrani, me Labinot Jetishin si këshilltar ligjor.

Disa seanca u desh të anulohen në mes të shtatorit 2015 dhe nëntorit 2015, pasi aranzhime të reja është dashur të bëhen, për shkak të faktit se gjyqtari i Kosovës Artan Sejrani ishte caktuar që nga seanca e mbajtur më 20 nëntor 2015 për ta zëvendësuar gjyqtarin vendor të mëparshëm, Zejnullah A.G. – i cili ishte anëtar i trupit gjykues deri kur është emëruar si prokuror.

Në pajtim me nenin 311, paragrafi 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme KKRK), pas dëgjimit të palëve, është pajtuar nga secili të konsiderohen si të lexuara, administruara dhe të ekzaminuara, provat që janë paraqitur përgjatë seancave të mëparshme.

Siç është konstatuar më parë, kjo gjykatë është kompetente për të gjykuar këtë lëndë, në pajtim me nenet 1, 2, paragrafi 1.2, 9 paragrafi 2.1, 15 paragrafi 1.20 dhe 15, paragrafi 2, të Ligjit për gjykatat (L. 03/L-199 në fuqi në kohën kur ka filluar procedura) dhe sipas neneve 3,

paragrafët 1 dhe 7 (ky i fundit lidhur me shumicën e gjyqtarëve të EULEX-it) të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (L. 03/L-053 siç ishte në fuqi në atë kohë) *ex vi neni* 442 i KPRK-së.

Kjo lëndë penale është kundër të pandehurve **A.Ç.**, [pseudonimi i mbajtësit të pasaportës turke nr.], **M.B.**, [mbajtës i pasaportës së Kosovës me nr.] [me numër personal të identifikimit nr.], **A.M.**, [mbajtës i letërnjoftimit me numër (i lëshuar nga Republika e Serbisë)], **M.A.**, [mbajtës i identifikimit sipas lejes së vozitjes nga Turqia me numër e datës], **A.B.**, mbajtës [i pasaportës së ish-RJ të Maqedonisë, me numër], **I.P.**, [mbajtës i letërnjoftimit me numër], **A.G.**, [mbajtës i letërnjoftimit me numër] dhe **T.Y.**, [mbajtës i letërnjoftimit me numër]<sup>1</sup>.

Fillimisht kjo lëndë ka qenë edhe kundër S.S.t. Procedura lidhur me të pandehurin S.S. (pika 7 e aktakuzës) është veçuar në seancën e parë dëgjimore fillestare, më 30 dhjetor 2013. Kjo gjykatë ka pranuar një memorandum zyrtar nga drejtoria rajonale e policisë – Prishtinë, stacioni policor veri – Prishtinë, duke informuar që i pandehuri S.S. nuk është paraqitur në Stacion Policor Veri dhe duke vepruar kështu nuk e ka respektuar aktvendimin e kësaj gjykate dhe më 27 dhjetor 2013, gjykata, në pajtim me nenin 307, paragrafi 1, dhe neni 175 të KPPK-së lëshoi një urdhër për arrestimin e S.S.t. Që nga 30 dhjetor 2013, i pandehuri nuk është paraqitur në gjykatë dhe sipas raportit të policisë është vërtetuar se vendndodhja e atij të pandehuri nuk ka mundur ende të përcaktohet, dhe sipas dispozitave të nenit 36 të KPPK-së, është vendosur veçimi i procedurës lidhur me të, gjithashtu edhe sepse të konsideruarit e kompleksiteti të lëndës ka kërkuar që nuk do të jetë e përshtatshme të zbatohet dispozita e përcaktuar në nenin 285, paragrafi 4 të KPPK-së, që do të thotë të pezullohet seanca në lidhje me të.

Të pandehurit janë akuzuar me një aktakuzë (PSRK PPS Nr: 50/2011, HEP Nr. 108/2011), e datës 11/12/2012, e ngritur në gjykatë nga prokurori i EULEX-it, Martin Hackett, në bazë të nenit 240, paragrafi 1, 241 dhe 242 të KPPK-së dhe Ligjit 04/L-123.

Secili prej të akuzuarve ende<sup>2</sup> ngarkohet me veprat penale në vijim<sup>3</sup>:

#### **1 - A.Ç.:**

- kontrabandim me migrantë, sipas nenit 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të KPPK-së (aktualisht siç parashihet me nenin 170, paragrafët 1 deri 6 të KPRK-së);
- krim i organizuar, sipas nenit 274, paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK-së, (aktualisht e parashikuar me nenin 283, paragrafët 1 dhe 2, të KPRK-së) dhe
- për shpërlarje të parave, në shkelje të nenit 32 të Ligjit 03/L-196 për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit i datës 3 shtator 2010, që ka hyrë në fuqi më

<sup>1</sup> Identifikimi më i detajuar i të pandehurve do të ofrohet në rastin e duhur.

<sup>2</sup> Pavarësisht nga fakti se në fjalën përmbyllëse, prokuroria ka pranuar që nuk ka ofruar prova për pikën 9, për shpërlarjen e parave, asnjë akuzë nuk është tërhequr (që ka mundur, në pajtim me nenin 363, paragrafi 1. 1.1., të KPPK-së., që do të çonte në refuzimin e akuzës në pajtim me nenin 363, paragrafi 1.1, të KPPK-së, dhe jo në shfajësim, në pajtim me nenin 364, paragrafi 1.3, të KPPK-së).

<sup>3</sup> Këtu pa ju referuar në mënyrë specifike pikave të ndryshme.

18.10.2010, dhe gjersa është e zbatueshme, neni 10.2 i Rregullores se UNMIK-ut nr. 2004/2 mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të ngjashme Penale.

## **2 - M.B.:**

- kontrabandim me migrantë, sipas neni 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të KPPK-së (aktualisht siç parashihet me neni 170, paragrafët 1 deri 6 të KPRK-së);

- krim i organizuar, sipas neni 274, paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK-së, (aktualisht e parashikuar me neni 283, paragrafët 1 dhe 2, të KPRK-së) dhe

- për shpërlarje të parave, në shkelje të neni 32 të Ligjit 03/L-196 për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit i datës 3 shtator 2010, që ka hyrë në fuqi më 18.10.2010, dhe gjersa është e zbatueshme, neni 10.2 i Rregullores se UNMIK-ut nr. 2004/2 mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të ngjashme Penale.

## **3 - A.M.:**

- kontrabandim me migrantë, sipas neni 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të KPPK-së (aktualisht e parashikuar me neni 170, paragrafët 1 deri 6 të KPRK-së);

- krim i organizuar, sipas neni 274, paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK-së, (aktualisht e parashikuar me neni 283, paragrafët 1 dhe 2, të KPRK-së) dhe

- për shpërlarje të parave, në shkelje të neni 32 të Ligjit 03/L-196 për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit i datës 3 shtator 2010, që ka hyrë në fuqi më 18.10.2010, dhe gjersa është e zbatueshme, neni 10.2 i Rregullores se UNMIK-ut nr. 2004/2 mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të ngjashme Penale.

## **4 - M.A.:**

- kontrabandim me migrantë, sipas neni 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të KPPK-së (aktualisht e parashikuar me neni 170, paragrafët 1 deri 6 të KPRK-së);

- krim i organizuar, sipas neni 274, paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK-së, (aktualisht e parashikuar me neni 283, paragrafët 1 dhe 2, të KPRK-së).

## **5- A.B.:**

- kontrabandim me migrantë, sipas neni 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të KPPK-së (aktualisht siç parashihet me neni 170, paragrafët 1 deri 6 të KPRK-së);

- krim i organizuar, sipas neni 274, paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK-së, (aktualisht e parashikuar me neni 283, paragrafët 1 dhe 2, të KPRK-së) dhe

- për shpërlarje të parave, në shkelje të nenit 32 të Ligjit 03/L-196 për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit i datës 3 shtator 2010, që ka hyrë në fuqi më 18.10.2010, dhe gjersa është e zbatueshme, neni 10.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2 mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të ngjashme Penale.

#### **6 - I.P.:**

- kontrabandim me migrantë, sipas nenit 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të KPPK-së (aktualisht siç parashihet me nenin 170, paragrafët 1 deri 6 të KPRK-së);

- krim i organizuar, sipas nenit 274, paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK-së, (aktualisht e parashikuar me nenin 283, paragrafët 1 dhe 2, të KPRK-së).

#### **7 - A.G.:**

- kontrabandimi me migrantë, sipas nenit 138 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK-së (aktualisht e parashikuar me nenin 170, paragrafët 1 deri 3 të K.P.R.K) dhe

- pjesëmarrja në krim të organizuar (neni 274, paragrafët 1 dhe 2, të KPPK-së, aktualisht e parashikuar me nenin 283, paragrafi 1, të KPRK-së).

#### **8 - T.Y.:**

- kontrabandimi me migrantë, sipas nenit 138 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK-së (aktualisht e parashikuar me nenin 170, paragrafët 1 deri 3 të K.P.R.K) dhe

- pjesëmarrja në krim të organizuar (neni 274, paragrafët 1 dhe 2, të KPPK-së, aktualisht e parashikuar me nenin 283, paragrafi 1, të KPRK-së).

Seanca dëgjimore fillestare është mbajtur më 30 dhjetor 2013, 29 janar 2014 dhe 23 prill 2014, dhe seanca dëgjimore e dytë është mbajtur më 30 maj 2014, ndërsa seancat e shqyrtimit gjyqësor, të hapura për publikun janë mbajtur më 10 shtator 2014, 11 shtator 2014, 24 shtator 2014, 25 shtator 2014, 15 tetor 2014, 31 tetor 2014, 3 nëntor 2014, 10 nëntor 2014, 24 nëntor 2014, 2 dhjetor 2014, 3 dhjetor 2014, 9 dhjetor 2014, 10 dhjetor 2014, 16 dhjetor 2014, 22 janar 2015, 28 janar 2015, 9 shkurt 2015, 10 shkurt 2015, 16 mars 2015, 19 mars 2015, 15 prill 2015, 20 prill 2015, 28 prill 2015, 6 maj 2015, 8 maj 2015, 12 maj 2015, 13 maj 2015, 18 maj 2015, 20 maj 2015, 16 qershor 2015, 17 qershor 2015, 14 korrik 2015, 15 korrik 2015, 1 shtator 2015, 22 shtator 2015, 23 shtator 2015, 20 nëntor 2015, 23 nëntor 2015, 30 nëntor 2015, 1 dhjetor 2015, 17 dhjetor 2015, 18 dhjetor 2015, 5 janar 2016, 14 janar 2016, 16 dhe 18 shkurt, 9, 15, 16, 21 mars 2016, 7 dhe 12 prill 2016, në prani të prokurorisë<sup>4</sup>, të pandehurve dhe të avokatëve mbrojtës<sup>5</sup>.

---

<sup>4</sup> Prokuroria fillimisht është përfaqësuar nga z. Martin Hackett dhe znj. Diane Wilson, më vonë nga z. Robert Kucharski (më 23 prill 2014), e ndihmuar nga zyrtarja ligjore znj. Claire Morris, dhe më pas (qysh nga 30

Trupi gjykues e shqyrtoi lëndën dhe votoi më 12 prill 2016.

Shqyrtimi dhe votimi është bërë në pajtim me dispozitat e përcaktuara në nenin 365 dhe nenet 470 deri te neni 473, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK).

Aktgjykimi është (duke u) shpallur me gojë më 14 prill 2016, në pajtim me dispozitat e përcaktuara me nenin 366 të KPPRK-së, në prani, pra, të prokurorit të EULEX-it, të pandehurve dhe të avokatëve të tyre mbrojtës, në pajtim me dispozitat e lartpërmendura, lidhur me nenin 470 *et seq.* të KPPRK-së.

### **(DISPOZITIVI)**

Më 14 prill 2016, Gjykata Themelore e Prizrenit, me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Jorge Martins Ribeiro (EULEX), si kryetar i trupit gjykues, gjyqtarja Jennifer Seel (EULEX) dhe gjyqtari Artan Sejrani, si anëtarë të trupit gjykues, në lëndën penale P.no. 410/13, që ndiqet penalisht nga Prokurorët e PSRK-së, z. Rómulo Mateus dhe znj. Tiffany-Corrine Moise (EULEX)<sup>6</sup>, shpall publikisht si në vijim:

---

maj 2014) nga z. Rómulo Mateus dhe znj. Tiffany-Corinne Moise (z. Danilo Ceccarelli ishte prokuror për seancën e mbajtur më 1 dhjetor 2015, z. Paul Flynn, më 21 mars 2016 dhe z. Tomas Meskauskas, më 12 prill 2016), të dy të ndihmuar nga znj. Laura Gheorghe, si këshilltare ligjore.

<sup>5</sup> Avokatët mbrojtës fillimisht të caktuar për të pandehurit ish-in (në seancën e parë të seancës dëgjimore fillestare, të mbajtur më 30 janar 2013): O.R. për A.Ç., O.Z. për M.B., E.G. për A.M. [që nga 10 shkurti 2015 ishte zëvendësuar përherë nga znj. N.H., me vendimin e të pandehurit (f. 3 e procesverbalit)], H.C. për M.A., R.H. për I.P. [me kërkesë të avokatit mbrojtës R.H., bazuar në atmosferën e tensionuar në sallën e gjyqimit, në seancën e mbajtur më 19 mars 2015 (f. 8 në procesverbal) ai është zëvendësuar nga V.O.], A.K. për A.B., G.D. për T.Y., R.K. për S.S. dhe B.N. (I zëvendësuar nga A.A.) për A.G.. Në seanca të shumta, gjatë seancës dëgjimore fillestare, seancës së dytë dhe shqyrtimit gjyqësor, shumë herë edhe në mëngjes edhe në mbrëmje, avokatët mbrojtës kanë bashkuar autorizimet për tu zëvendësuar nga avokatë tjerë. Në secilin zëvendësimi ishte pëlqimi i të pandehurit përkatës.

<sup>6</sup> Dhe të tjetër, siç janë përmendur më parë.

## NË EMËR TË POPULLIT

Të akuzuarit janë:

**1 – A.Ç.**, nofka “Sa.” (“pijanec”), i biri i..., mashkull, i pamartuar, me numër personal të identifikimit (pasaportë turke)...me numër serik..., me kombësi dhe nënshtetësi turke, i lindur më... në..., krahina..., Republika e Turqisë, më parë me banim në..., Republika e Turqisë, me adresë në Kosovë...

Ai është në paraburgim që nga 3 shkurt 2013.

**2 – M.B.**, i biri i..., mashkull, i martuar, me pasaportë të Kosovës me nr..., me numër personal të identifikimit..., me kombësi shqiptar i Kosovës dhe nënshtetësi të Kosovës, i lindur më..., në..., më parë me banim në...

Ai është në paraburgim që nga 13 dhjetori 2012.

**3 – A.M.**, i biri i..., mashkull, i pamartuar, me numër personal të identifikimit (i lëshuar nga Republika e Serbisë)..., me kombësi turke dhe nënshtetësi të Kosovës, i lindur më..., në..., më parë me banim në...

Ai është në paraburgim që nga 13 dhjetori 2012.

**4 – M.A.**, i biri i..., mashkull, i pamartuar, me numër personal të identifikimit (lejen e vozitje të Turqisë)..., me kombësi dhe nënshtetësi turke, i lindur më...në qytetin..., më parë me banim në..., dhe më pas në...

Ai ishte në paraburgim prej 24 janar 2013 deri më 12 prill 2016. Tani ai i nënshtrohet masës së paraqitjes në stacion policor dy herë në javë, bashkë me premtimin për të mos u fshehur.

**5 – A.B.**, i biri i..., mashkull, i martuar, me numër personal të identifikimit (pasaportë të ish-RF të Maqedonisë)..., me kombësi shqiptar i Maqedonisë dhe nënshtetësi të ish-RF të Maqedonisë; i lindur më...në..., ish RF e Maqedonisë, dhe më parë ka banuar në...

Ai është në paraburgim që nga 13 dhjetori 2012.

**6 – I.P.**, i biri i..., mashkull, i martuar, me numër personal të identifikimit..., me kombësi shqiptar i Kosovës dhe me nënshtetësi të Kosovës, i lindur më...në...me banim në fshatin...

Ai ishte në paraburgim prej 13 dhjetor 2012 deri më 12 qershor 2014. Që nga 11 qershor 2014, ai i nënshtrohet masës së paraqitjes në stacion policor dy herë në javë, bashkë me premtimin për të mos u fshehur.

**7 – A.G.**, i biri i..., mashkull, i martuar, me numër personal të identifikimit..., me kombësi shqiptar i Kosovës dhe me nënshtetësi të Kosovës, i lindur më...në..., me banim në...

I pandehuri i nënshtrohet masës së paraqitjes në stacion policor një herë në javë, bashkë me premtimin për të mos u fshehur.

**8 – T.Y.**, i biri i..., mashkull, i martuar, me numër personal të identifikimit...(T.Y. është bërë qytetar i Republikës së Kosovës, nr..., MPB – Prishtinë; Pasaportë të Kosovës...), me kombësi turke dhe nënshtetësi të Kosovës dhe të Turqisë, i lindur më...në..., me banim në...

I pandehuri i nënshtrohet masës së paraqitjes në stacion policor një herë në javë, bashkë me premtimin për të mos u fshehur.

Të pandehurit janë akuzuar me aktakuzë (PSRK PPS nr. 50/2011, HEP nr. 108/2011) me datë 11/12/2012, e ngritur në gjykatë nga prokurori i EULEX-it, Martin Hackett, në bazë të nenit 240, paragrafi 1, 241 dhe 242 të KPPRK-së dhe Ligjit 04/L-123.

Secili prej të akuzuarve<sup>7</sup> ngarkohet me veprat penale në vijim<sup>8</sup>:

**1 - A.Ç.:**

- kontrabandim me migrantë, sipas nenit 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të KPPK-së (aktualisht siç parashihet me nenin 170, paragrafët 1 deri 6 të KPRK-së);

- krim i organizuar, sipas nenit 274, paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK-së, (aktualisht e parashikuar me nenin 283, paragrafët 1 dhe 2, të KPRK-së) dhe

- për shpërlarje të parave, në shkelje të nenit 32 të Ligjit 03/L-196 për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit i datës 3 shtator 2010, që ka hyrë në fuqi më 18.10.2010, dhe gjersa është e zbatueshme, neni 10.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2 mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të ngjashme Penale.

**2 - M.B.:**

- kontrabandim me migrantë, sipas nenit 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të KPPK-së (aktualisht siç parashihet me nenin 170, paragrafët 1 deri 6 të KPRK-së);

- krim i organizuar, sipas nenit 274, paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK-së, (aktualisht e parashikuar me nenin 283, paragrafët 1 dhe 2, të KPRK-së) dhe

---

<sup>7</sup> Siç është thënë, Prokuroria nuk ka tërhequr asnjë akuzë.

<sup>8</sup> Përsëri, në këtë moment, pa ju referuar pikave.



- për shpërlarje të parave, në shkelje të nenit 32 të Ligjit 03/L-196 për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit i datës 3 shtator 2010, që ka hyrë në fuqi më 18.10.2010, dhe gjersa është e zbatueshme, neni 10.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2 mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të ngjashme Penale.

### **3 - A.M.:**

- kontrabandim me migrantë, sipas nenit 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të KPPK-së (aktualisht e parashikuar me nenin 170, paragrafët 1 deri 6 të KPRK-së);;

- krim i organizuar, sipas nenit 274, paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK-së, (aktualisht e parashikuar me nenin 283, paragrafët 1 dhe 2, të KPRK-së) dhe

- për shpërlarje të parave, në shkelje të nenit 32 të Ligjit 03/L-196 për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit i datës 3 shtator 2010, që ka hyrë në fuqi më 18.10.2010, dhe gjersa është e zbatueshme, neni 10.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2 mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të ngjashme Penale.

### **4 - M.A.:**

- kontrabandim me migrantë, sipas nenit 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të KPPK-së (aktualisht e parashikuar me nenin 170, paragrafët 1 deri 6 të KPRK-së);;

- krim i organizuar, sipas nenit 274, paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK-së, (aktualisht e parashikuar me nenin 283, paragrafët 1 dhe 2, të KPRK-së).

### **5- A.B.:**

- kontrabandim me migrantë, sipas nenit 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të KPPK-së (aktualisht siç parashihet me nenin 170, paragrafët 1 deri 6 të KPRK-së);;

- krim i organizuar, sipas nenit 274, paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK-së, (aktualisht e parashikuar me nenin 283, paragrafët 1 dhe 2, të KPRK-së) dhe

- për shpërlarje të parave, në shkelje të nenit 32 të Ligjit 03/L-196 për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit i datës 3 shtator 2010, që ka hyrë në fuqi më 18.10.2010, dhe gjersa është e zbatueshme, neni 10.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2 mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të ngjashme Penale.

### **6 - I.P.:**

- kontrabandim me migrantë, sipas nenit 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të KPPK-së (aktualisht siç parashihet me nenin 170, paragrafët 1 deri 6 të KPRK-së);;

- krim i organizuar, sipas nenit 274, paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK-së, (aktualisht e parashikuar me nenin 283, paragrafët 1 dhe 2, të KPRK-së).

## **7 - A.G.:**

- kontrabandimi me migrantë, sipas nenit 138 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK-së (aktualisht e parashikuar me nenin 170, paragrafët 1 deri 3 të K.P.R.K) dhe

- pjesëmarrja në krim të organizuar (neni 274, paragrafët 1 dhe 2, të KPPK-së, aktualisht e parashikuar me nenin 283, paragrafi 1, të KPRK-së).

## **8 - T.Y.:**

- kontrabandimi me migrantë, sipas nenit 138 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK-së (aktualisht e parashikuar me nenin 170, paragrafët 1 deri 3 të K.P.R.K) dhe

- pjesëmarrja në krim të organizuar (neni 274, paragrafët 1 dhe 2, të KPPK-së, aktualisht e parashikuar me nenin 283, paragrafi 1, të KPRK-së).

Seanca dëgjimore fillestare është mbajtur më 30 dhjetor 2013, 29 janar 2014 dhe 23 prill 2014, dhe seanca dëgjimore e dytë është mbajtur më 30 maj 2014, ndërsa seancat e shqyrtimit gjyqësor, të hapura për publikun janë mbajtur më 10 shtator 2014, 11 shtator 2014, 24 shtator 2014, 25 shtator 2014, 15 tetor 2014, 31 tetor 2014, 3 nëntor 2014, 10 nëntor 2014, 24 nëntor 2014, 2 dhjetor 2014, 3 dhjetor 2014, 9 dhjetor 2014, 10 dhjetor 2014, 16 dhjetor 2014, 22 janar 2015, 28 janar 2015, 9 shkurt 2015, 10 shkurt 2015, 16 mars 2015, 19 mars 2015, 15 prill 2015, 20 prill 2015, 28 prill 2015, 6 maj 2015, 8 maj 2015, 12 maj 2015, 13 maj 2015, 18 maj 2015, 20 maj 2015, 16 qershor 2015, 17 qershor 2015, 14 korrik 2015, 15 korrik 2015, 1 shtator 2015, 22 shtator 2015, 23 shtator 2015, 20 nëntor 2015, 23 nëntor 2015, 30 nëntor 2015, 1 dhjetor 2015, 17 dhjetor 2015, 18 dhjetor 2015, 5 janar 2016, 14 janar 2016, 16 dhe 18 shkurt, 9, 15, 16, 21 mars 2016, 7 dhe 12 prill 2016, në prani të prokurorisë, të pandehurve të përmendur<sup>9</sup> dhe avokatëve të tyre mbrojtës, dhe pas shqyrtimit të lëndës dhe votimit nga trupi gjykues më 12 prill 2016.

Dhe në pajtim me nenet 359 deri 366 dhe 370 të Kodit të Procedurës të Republikës së Kosovës, më 14 prill 2016, në një gjykim të hapur dhe në prani të të pandehurve, avokatët mbrojtës dhe prokurorit të PSRK-së, lëshon këtë

---

<sup>9</sup> Përveç kur mungonin në sallë të gjyqimit, në pajtim me ligjin, gjersa bashkë- të pandehurit po deklarorin për rastin, por gjithmonë të përfaqësuar nga avokatë mbrojtës përkatës (dhe janë njoftuar për atë çfarë është thënë gjatë mungesës në sallën e gjyqimit).

## AKTGJYKIM

**Pika 1: “A.Ç., M.B., A.M., A.B., I.P. dhe M.A. për krim të organizuar, në shkelje të nenit 274 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK-së, e dënueshme me gjobë deri në 500.000 EURO dhe me burgim deri në njëzet e pesë vjet (në përputhje me nenin 283 paragrafët 1 dhe 2 të Kodit Penal të Kosovës, Ligji 04/L-082 të vitit 2012 (kodi i ri)”**

(1) **Lidhur me pikën 1**, në pajtim me nenet 359, 361, 362, paragrafi 1, 364, paragrafi 1.1.3, dhe 370, paragrafi 3, të KPPK-së, gjykata shpall të pandehurit **A.Ç., M.B., A.M., A.B., I.P. dhe M.A. të pafajshëm** për veprën penale të krimi i organizuar, në kundërshtim me nenin 274 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK-së, e dënueshme me gjobë deri në 500.000 EURO dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet (në përputhje me nenin 283 paragrafët 1 dhe 2 të Kodit Penal të Kosovës, Ligji 04/L-082 i vitit 2012 (kodi i ri), sepse nuk është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të akuzuarit e përmendur kanë kryer veprat me të cilat janë akuzuar, pra, nuk është vërtetuar se të pandehurit (tani citohet aktakuza): “Në periudhën në mes 1 Tetorit 2010 dhe 3 Shkurtit 2013 A.Ç.; në periudhën në mes të 6 prillit 2011 dhe 13 dhjetorit 2012 M.B.; në mes të 28 qershorit 2011 dhe 13 dhjetorit 2012 A.M.; në mes të 4 Nëntorit 2010 dhe 13 dhjetorit 2013 A.B.; në mes të 5 Tetorit 2012 dhe 13 dhjetorit 2013 I.P.; dhe në mes të 21 qershorit 2012 dhe 24 Janarit 2013 M.A.; në territorin e Kosovës kanë kryer veprën penale krim të organizuar duke: (1) Organizuar, mbikëqyrur, menaxhuar apo drejtuar aktivitetet e një grupi të organizuar kriminal të përbërë nga O.K., C.K., E.K., L.K., O.Y., B.F., F.A., A.Ç., M.B., A.M., A.B., I.P., M.A., S.S., A.G., T.Y., N.N., “N.”, S.M., M.M., S.I., M.C., S.P-M., M.Me., I.H., M.H. (“B.”), T.H., S.B., N.P., Z.G., M.Ca., Z.M., G.N., A.V., K.V., N.H., H.M., K.H., A.By., S.A., R.V., G.B., A.Al., A.Br., B.E., D.M., T.Ha., M.Br., D.S., A.S., E.S., M.Ma., R.A., O.S., A.C., H.Y., M.O., O.Sa., I.B., M.T., M.G., H.G., M.I., H.H., H.Ha., J.Z. [llagap I.], N.K., “I.?” (mbiemri i panjohur), “E.?” (mbiemri i panjohur), “A.?” (mbiemri i panjohur), “B.?” (mbiemri i panjohur), personin me nofkën “K.”, personi me nofkën “A.P.”, personi me nofkën “T.”, personi me nofkën “L.”, personi me nofkën “Ar.”, personi me nofkën “D.” dhe kryerës të tjerë të paidentifikuar; (2) Kanë kryer një vepër të rëndë penale, përkatësisht kontrabandim me migrantë, duke qenë pjesë e një grupi të organizuar kriminal të përbërë nga O.Y., B.F., F.A., A.Ç., M.B., A.M., A.B., I.P., M.A., S.S., A.G., T.Y., N.N., “N.”, S.M., M.M., S.I., M.C., S.P-M., M.Me., I.H., M.H. (“B.”), T.H., S.B., N.P., Z.G., M.Ca., Z.M., G.N., A.V., K.V., N.H., H.M., K.H., A.By., S.A., R.V., G.B., A.Al., A.Br., B.E., D.M., T.Ha., M.Br., D.S., A.S., E.S., M.Ma., R.A., O.S., A.C., H.Y., M.O., O.Sa., I.B., M.T., M.G., H.G., M.I., H.H., H.Ha., J.Z. [llagap I.], N.K., “I.?” (mbiemri i panjohur), “E.?” (mbiemri i panjohur), “A.?” (mbiemri i panjohur), “B.?” (mbiemri i panjohur), personin me nofkën “K.”, personi me nofkën “A.P.”, personi me nofkën “T.”, personi me nofkën “L.”, personi me nofkën “Ar.”, personi me nofkën “D.” dhe kryerës të tjerë të paidentifikuar; dhe/ose kanë marrë pjesë aktive në aktivitete kriminale apo të tjera të grupit të përmendur të organizuar kriminal duke e ditur se pjesëmarrja e tyre do të

kontribuonte në kryerjen e veprave të përmendura të rënda penale nga grupi; me qëllim të përfitimit direkt apo indirekt financiar apo tjetër material”.

**Pika 2: “A.G. dhe T.Y. për pjesëmarrje në krim të organizuar, në shkelje të nenit 274 paragrafët 1 dhe 2 të KPPK-së, e dënueshme me burgim prej më së paku shtatë vjet (në përputhje me nenet 283 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës, Ligji 04/L-082 i vitit 2012 (kodi i ri)<sup>10</sup>”**

(1) **Lidhur me pikën 2**, në pajtim me nenet 359, 361, 362, paragrafi 1, 364, paragrafi 1.1.3, dhe 370, paragrafi 3, të KPPK-së, gjykata shpall të pandehurit **A.G. dhe T.Y. të pafajshëm** për veprën penale të pjesëmarrje në krim të organizuar, në shkelje të nenit 274 paragrafët 1 dhe 2 të KPPK-së, e dënueshme me burgim prej më së paku shtatë vjet (në përputhje me nenet 283 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës, Ligji 04/L-082 i vitit 2012 (kodi i ri), sepse nuk është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm që të akuzuarit në fjalë kanë kryer veprat për të cilat janë akuzuar, pra, nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm që të pandehurit (dhe tani citimi i aktakuzës): “në mes të 17 gushtit 2012 dhe 13 dhjetorit 2012, A.G.; dhe në mes të 7 nëntorit 2012 dhe 13 dhjetorit 2012, T.Y.; në territorin e Kosovës, kanë kryer veprën e Pjesëmarrjes në Krim të Organizuar duke: (1) Kryer krim të rëndë kryesisht duke Kontrabanduar me migrant, si pjesë e një grupi kriminal të organizuar e që përbëhej nga: O.Y., B.F., F.A., A.Ç., M.B., A.M., A.B., I.P., M.A., S.S., A.G., T.Y., N.N., “N.”, S.M., M.M., S.I., M.C., S.P-M., M.Me., I.H., M.H. (“B.”), T.H., S.B., N.P., Z.G., M.Ca., Z.M., G.N., A.V., K.V., N.H., H.M., K.H., A.By., S.A., R.V., G.B., A.Al., A.Br., B.E., D.M., T.Ha., M.Br., D.S., A.S., E.S., M.Ma., R.A., O.S., A.C., H.Y., M.O., O.Sa., I.B., M.T., M.G., H.G., M.I., H.H., H.Ha., J.Z. [llagap I.], N.K., “I.” (mbiemri i panjohur), “E.” (mbiemri i panjohur), “A.” (mbiemri i panjohur), “B.” (mbiemri i panjohur), personin me nofkën “K.”, personi me nofkën “A.P.”, personi me nofkën “T.”, personi me nofkën “L.”, personi me nofkën “Ar.”, personi me nofkën “D.” dhe kryerës të tjerë të paidentifikuar; dhe/ose (2) Duke qenë pjesë aktive e veprimeve kriminale të grupit kriminal të organizuar e që përbëhej nga: O.Y., B.F., F.A., A.Ç., M.B., A.M., A.B., I.P., M.A., S.S., A.G., T.Y., N.N., “N.”, S.M., M.M., S.I., M.C., S.P-M., M.Me., I.H., M.H. (“B.”), T.H., S.B., N.P., Z.G., M.Ca., Z.M., G.N., A.V., K.V., N.H., H.M., K.H., A.By., S.A., R.V., G.B., A.Al., A.Br., B.E., D.M., T.Ha., M.Br., D.S., A.S., E.S., M.Ma., R.A., O.S., A.C., H.Y., M.O., O.Sa., I.B., M.T., M.G., H.G., M.I., H.H., H.Ha., J.Z. [llagap I.], N.K., “I.” (mbiemri i panjohur), “E.” (mbiemri i panjohur), “A.” (mbiemri i panjohur), “B.” (mbiemri i panjohur), personin me nofkën “K.”, personi me nofkën “A.P.”, personi me nofkën “T.”, personi me nofkën “L.”, personi me nofkën “Ar.”, personi me nofkën “D.” dhe kryerës të tjerë të paidentifikuar duke e ditur që pjesëmarrja e tyre do kontribuoj në kryerjen e veprës së rëndë penale nga grupi; me qëllim të përfitimeve direkte apo indirekte financiare apo përfitime tjera materiale”.

---

<sup>10</sup> Referimet e S.S.t do të hiqen.

**Pika 3: “A.Ç. dhe A.B. për kontrabandim me migrantë, në shkelje të nenit 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të Kodit Penal të Kosovës (KPPK)”**

**Lidhur me pikën 3**, në pajtim me nenet 359, 361, 362, paragrafi 1, 364, paragrafi 1.1.3, dhe 370, paragrafi 3, të KPPK-së, gjykata shpall të pandehurit **A.Ç. dhe A.B. të pafajshëm** për veprën penale të kontrabandim me migrantë, në shkelje të nenit 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), sepse nuk është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm që të akuzuarit në fjalë kanë kryer veprat për të cilat janë akuzuar, pra, nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm që të pandehurit (dhe tani citimi i aktakuzës): “në mes të 25 qershorit 2011 dhe 14 dhjetorit 2011 A.Ç. dhe A.B. në territorin e Kosovës, Serbisë, ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi, Kroacisë, Sllovenisë, Italisë, Austrisë, Gjermanisë dhe/ose shteteve të tjera kanë kryer veprën penale të kontrabandimit me migrantë duke bërë kontrabandimin; sigurimin dhe ofrimin e dokumenteve të rreme të udhëtimit apo letërnjoftime të rreme për të mundësuar kontrabandim për përfitim financiar apo të një dobie tjetër pasurore; dhe mundësimin e personave që nuk janë qytetarë të Kosovës të hyjnë apo të qëndrojnë në Kosovë, apo persona që nuk janë vendorë apo qytetarë të përhershëm të kalojnë kufirin pa respektuar rregullat për hyrje të ligjshme, dhe të qëndrojnë në shtetin në fjalë pa përmbushur kërkesat e nevojshme ligjore për të qëndruar me anë të mjeteve të përmendura më parë apo me mjete të tjera të paligjshme; dhe mbi të gjitha, me organizimin dhe drejtimin e personave të tjerë për të kryer të njëjtat veprime për migrantët si në vijim:

(1) -H.D., F.Y., A.S.Z. (prej 25/6/2011 deri 06/07/2011).

(2) -S.Ar. dhe Personi me nofkën T.T. (prej 19/10/2011 deri 23/10/2011).

(3) -M.S., R.S. dhe A.Sa. (prej 01/10/2011 deri 07/10/2011).

(4)- Z.A. dhe O.Y. (prej 01/10/2011 deri 17/11/2011).

(5)- Kontrabandimi i 4 migrantëve ilegal turk të paidentifikuar nga Turqia përmes Malit të Zi dhe Serbisë për në Gjermani (prej 17/11/2011 deri 20/11/2011).

(6)-Y.D., B.H.O. (prej 20/11/2011 deri 28/11/2011) dhe H.Da. dhe M.So. (prej 20/11/2011 deri 28/11/2011).

(7) -”Il.” [dhe një familje e përbërë nga një nënë dhe 5 fëmijë dhe një migrant turk me emrin U. (prej 28/11/2011 deri 06/12/2011)].

(8) - M.Bu., A.K., B.B., “S.” ose “Se.”, F.T., “M.” (mbiemri i panjohur), “Sel.” (mbiemri i panjohur), E.U., M.E., familje prej 3 personave, M.Ar., E.A., M.Y., A.U., R.T., S.D. dhe një person tjetër i paidentifikuar (prej 18 gushtit 2011 deri 3 dhjetorit 2011)”.

**Pika 4: “A.Ç. për kontrabandim me migrantë, në shkelje të nenit 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të Kodit Penal të Kosovës (KPPK)”**

**Lidhur me pikën 4**, në pajtim me nenet 359, 361, 362, paragrafi 1, 364, paragrafi 1.1.3, dhe 370, paragrafi 3, të KPPK-së, gjykata shpall të pandehurin **A.Ç. të pafajshëm** për veprën penale të kontrabandim me migrantë, në shkelje të nenit 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), sepse nuk është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm që i akuzuari në fjalë kanë kryer veprat për të cilat është akuzuar, pra, nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm që i pandehuri (dhe tani citimi i aktakuzës): “Në mes të datave 5 tetor 2011 dhe 9 tetor 2011, A.Ç., në territorin e Kosovës, ka kryer veprën penale të kontrabandim me migrantë duke bërë kontrabandimin, sigurimin dhe ofrimin e dokumenteve të rreme të udhëtimit apo letërnjoftime të rreme për të mundësuar kontrabandim për përfitim financiar ose të një dobie tjetër pasurore dhe mundësimin e personave që nuk janë qytetarë të Kosovës të hyjnë apo të qëndrojnë në Kosovë apo persona që nuk janë vendorë apo qytetarë të përherëshëm të kalojnë kufirin pa respektuar rregullat për hyrje të ligjshme dhe të qëndrojnë në shtetin në fjalë pa përmbushur kërkesat e nevojshme ligjore për të qëndruar me anë të mjeteve të përmendura më parë apo me mjete të tjera të paligjshme dhe mbi të gjitha, me organizimin dhe drejtimin e personave të tjerë për të kryer të njëjtat veprime për migrantët si në vijim:

(1) Tre që gjoja po udhëtonin në mes të 5 tetorit 2011 dhe 9 tetorit 2011: A.E.it, M.Er.it dhe A.Er.it”.

**Pika 5: “A.Ç., M.B., A.M., A.B., I.P. dhe M.A. për kontrabandim me migrantë, në shkelje të nenit 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), në veçanti me organizimin dhe drejtimin e të tjerëve për të kryer veprën penale, të dënueshme me gjobë deri në 500.000 EUR dhe dënim me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet me rrethanën rënduese të veprimit si anëtar të një grupi ose në mënyrë që ka gjasa të rrezikoj jetët apo sigurinë e migrantëve apo që ngërthen trajtim jo-njerëzor apo degradues përfshirë eksploatimin e atyre migrantëve (në përputhje me nenin 170 të Kodit Penal të Kosovës, Ligji 04/L-082 i vitit 2012 (kodi i ri)”**

**Lidhur me pikën 5**, në pajtim me nenet 359, 361, 362, paragrafi 1, 365, dhe 366, dhe 370, paragrafi 3, të KPPK-së, gjykata shpall të pandehurit **A.Ç., M.B., A.M., A.B., I.P. dhe M.A., fajtorë** për kontrabandim me migrantë, në kushtet saktë siç do të përmendet më poshtë, e kryer në bashkë-kryerje:

-A.Ç. sipas neneve 3, 31, 81 dhe 170, paragrafët 1, 5, 6 dhe 8, të KPPK-së, është përfshirë në kontrabandim me migrantë, duke organizuar dhe drejtuar të tjerët dhe si pjesëtar i një grupi, në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi;

- M.B., A.M., M.A. dhe A.B. sipas neneve 23, 71 dhe 138, paragrafët 1, 6 dhe 7, të KPPK-së, janë përfshirë në vepra penale të njëkohshme të kontrabandimit me migrantë si pjesëtarë të një grupi dhe në bashkëkryerje;

- I.P. sipas neneve 3, 31 dhe 170, paragrafët 1 dhe 8, të KPRK-së, është përfshirë në kontrabandim me migrantë (duke u liruar nga rrethanat rënduese pasi faktet që janë përbërës të tyre nuk janë vërtetuar përtej dyshimi të arsyeshëm) dhe në bashkëkryerje.

Është vendosur kështu sepse<sup>11</sup> është vërtetuar se këta të akuzuar kanë kryer veprat me të cilat janë ngarkuar, pra, është vërtetuar kontrabandimi me migrantë përtej dyshimit të arsyeshëm.

Në këtë pikë do ta adresojmë secilin paragraf të pikës veç e veç, do t'i përmendim emrat e secilit migrantë të kontrabanduar, bashkë me emrat e të pandehurve të përfshirë në secilin rast<sup>12</sup>:

(1)- Në periudhën në mes të 23 qershorit dhe 27 qershorit 2012, kontrabandimi me migrantët turk në vijim, duke organizuar udhëtimin e tyre dhe hyrjen e tyre në Kosovë si vend transit drejt shteteve tjera si destinacion i tyre i fundit:

M.Oc.: A.Ç.,  
T.O.: A.Ç. dhe  
M.K.: A.Ç.

(2)- Në periudhën korrik 2012, kontrabandimi me migrantët në vijim duke organizuar udhëtimin e tyre dhe hyrjen në Kosovë si vend transit për në shtetet tjera si destinacion i tyre i fundit:

I.Y.: A.Ç.,  
F.K.: A.Ç. dhe  
M.Sol.: A.Ç..

(3)- Për periudhën gusht 2012, kontrabandimi me migrantët në vijim duke organizuar udhëtimin e tyre dhe hyrjen në Kosovë si vend transit për në shtetet tjera si destinacion i tyre i fundit:

O.Yl.: A.Ç.,  
I.K.<sup>13</sup>: A.Ç. / A.G.,  
M.S.B.: A.Ç. dhe  
M.Ha.: A.Ç..

---

<sup>11</sup> Faktet në dispozitiv janë vetëm një pasqyrë për të mundësuar kuptimin e vendimit.

<sup>12</sup> Në këtë pikë vetëm emrat do të përmenden, roli i secilit të pandehur në secilin fakt të vërtetuar të veçantë të kontrabandimit me migrantë do të shpjegohet në arsyetim.

<sup>13</sup> Për arsye sistematike, ky individ do të përmendet përsëri në akuzën 6, në lidhje me të pandehurin A.G.

(4)- Për periudhën shtator 2012, kontrabandimi me migrantët në vijim duke organizuar udhëtimin e tyre dhe hyrjen në Kosovë si vend transit për në shtetet tjera si destinacion i tyre i fundit:

M.Go.: A.Ç.,

R.K.G.: A.Ç.,

T.Ya.: A.Ç.,

D.E.: A.Ç.,

S.E.: A.Ç.,

E.E.: A.Ç.,

H.Ce.: A.Ç.,

K.C.: A.Ç.,

B.C.: A.Ç.,

L.D.: A.Ç.,

S.K.: A.Ç.,

H.K.: A.Ç.,

A.Ak.: A.Ç.,

G.K.: A.Ç.,

M.P.: A.Ç.,

E.P.: A.Ç.,

M.S.D.: A.Ç.,

F.U.: A.Ç. / A.M.,

H.E.: A.Ç. / A.M.,

U.K.: A.Ç.,

I.T.: A.Ç.,

E.Si.: A.Ç. / A.M.,

V.Oz.: A.Ç. / A.M.,



S.C.: A.Ç. / A.M.,

A.Akd.: A.Ç.,

C.D.: A.Ç.,

D.B.: A.Ç.,

S.Al.: A.Ç. and

M.Ka.: A.Ç..

(5)- Në periudhën tetor 2012, kontrabandimi me migrantët në vijim duke organizuar udhëtimin e tyre dhe hyrjen në Kosovë si vend transit për në shtetet tjera si destinacion i tyre i fundit:

I.Yl.: A.Ç.,

C.C.: A.Ç.,

E.B.: A.Ç.,

N.S.: A.Ç.,

V.A.: A.Ç. / A.M.,

H.Yu.: A.Ç.,

D.K.: A.Ç.,

A.D.: A.Ç.,

L.B.: A.Ç.,

I.Pol.: A.Ç.,

S.Sa.: A.Ç.,

S.Ba.: A.Ç.,

A.Bi.: A.Ç. / M.B.,

I.D.: A.Ç. / A.M./ A.B.,

A.O.: A.Ç. / A.M.,

A.H.Y.: A.Ç.,

T.E.: A.Ç.,

H.S.: A.Ç.,

H.A.: A.Ç.,

A.Ar.: A.Ç. / A.M.,

F.G.: A.Ç.,

A.Di.: A.Ç. / I.P.,

H.M.K.: A.Ç. / I.P.,

O.G.: A.Ç.,

O.K.: A.Ç. / I.P. dhe

A.Uz.: A.Ç..

(6)- Për periudhën nëntor 2012, kontrabandimi me migrantët në vijim duke organizuar udhëtimin e tyre dhe hyrjen në Kosovë si vend transit për në shtetet tjera si destinacion i tyre i fundit:

B.G.: A.Ç. / M.B. / M.A.,

H.T.: A.Ç. / A.M. / M.B.,

M.P.: A.Ç. / A.M. / M.B.,

R.B.<sup>14</sup>: A.Ç. / T.Y. / M.B. / A.B.,

E.Ba.<sup>15</sup>: A.Ç. / T.Y.,

Akr.A.: A.Ç. / M.B.,

S.Az.: A.Ç. / M.B.,

N.A.: A.Ç. / M.B.,

Y.A.: A.Ç. / M.B.,

D.A.: A.Ç. / M.B.,

C.Ko.: A.Ç.,

N.C.: A.Ç.,

---

<sup>14</sup> Për arsye sistematike, ky individ do të përmendet përsëri në pikën 8, në lidhje me të pandehurin T.Y.

<sup>15</sup> Për arsye sistematike, ky individ do të përmendet përsëri në pikën 8, në lidhje me të pandehurin T.Y.

M.M.B.:<sup>16</sup> A.Ç. / M.A. / A.B./ M.B.<sup>17</sup>,

A.Gi.: A.Ç.

Në përputhje me rrethanat: i pandehuri A.Ç. është përfshirë në kontrabandim me migrantë, duke vepruar si pjesëtar i një grupi dhe duke organizuar dhe drejtuar aktivitetet e tjerëve dhe ishte i përfshirë në disa momente të kontrabandimit me 79 migrantë; i pandehuri M.B. është përfshirë në kontrabandim me migrantë duke vepruar si pjesëtar i një grupi dhe ishte përfshirë në 6 momente të kontrabandimit me 11 migrantë; i pandehuri A.M.u është përfshirë në kontrabandim me migrantë duke vepruar si pjesëtar i një grupi dhe është përfshirë në 7 momente të kontrabandimit me 11 migrantë; i pandehuri A.B. është përfshirë në kontrabandim me migrantë duke vepruar si pjesëtar i një grupi dhe ishte përfshirë në 3 momente të kontrabandimit me 3 migrantë; i pandehuri M.A. është përfshirë në kontrabandim me migrantë duke vepruar si pjesëtar i një grupi dhe ishte përfshirë në 2 momente të kontrabandimit me 2<sup>18</sup> migrantë dhe i pandehuri I.P. është përfshirë në kontrabandim me migrantë dhe është përfshirë në 1 moment të kontrabandimit me 3 migrantë<sup>19</sup>.

Të pandehurit kanë vepruar në atë mënyrë me qëllim të përfitimit të një dobie financiare ose të një dobie tjetër pasurore nga hyrja e paligjshme e personit në Republikën e Kosovës, i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës ose i një personi qoftë shtetas i Republikës së Kosovës apo shtetas i huaj në shtetin në të cilin personi i tillë nuk është banor i përhershëm ose shtetas i atij shteti dhe e ka ditur që dokumenti do të ose së paku që mund të përdoret për të hyrë në Kosovë, ose në disa raste, me vetëdije dhe me bashkëpunimin aktiv me këta të fundit, të gjithë me qëllim të mundësisimit për individët e kontrabanduar një udhëtim të mëtejshëm drejt shteteve tjera, përkatësisht, të Bashkimit Evropian.

Në atë kohë të pandehurit janë sjellë në mënyrën e përshkruar më sipër, ata ishin në gjendje t'i kuptonin dhe kontrollonin veprimet e tyre, të cilat i kanë dëshiruar, duke e ditur se veprimet e tyre ishin të ndaluara dhe të dënueshme me ligj.

Në këtë pikën 5, nuk është vërtetuar se nëse përveç migrantëve të sipërpërmendur, gjithashtu edhe individët e mëposhtëm janë kontrabanduar: në paragrafin (3) A.Se. dhe S.Baj. dhe, në paragrafin (5) G.Ba.. Gjithashtu, nuk është vërtetuar përmbajtja e paragrafit (7): “Në mes të 21 qershorit 2012 dhe 2 dhjetorit 2012, tentimi për të kontrabanduar apo për t’iu mundësuar 59 personave që nuk janë vendorë apo qytetarë të përhershëm apo që ndryshe nuk lejohen në mënyrë ligjore të qëndrojnë në shtete tjera respektivisht personave me origjinë turke apo siriane

---

<sup>16</sup> Ka të dhëna lidhur me një individ tjetër (bashkëshortja e M.M.B.) A.Bu., për shembull në raportin e SMK-së, referimeve në sms mesazhe dhe përgjime. Megjithatë, ky individ nuk përmendet në aktakuzë.

<sup>17</sup> M.B. lidhur me përprjekjen e parë nga qifti i përmendur më 13/11/2012, kur kanë ateruar në Aeroportin Ndërkombëtarë të Prishtinës, në ora 7.49. pasdite (shih faqen 275 të raportit të SMK-së).

<sup>18</sup> Pasi A.Bu. nuk përmendet në aktakuzë, përndryshe do të ishte A.Ç. 80, M.B. 12, A.B. 4, M.A. 3.

<sup>19</sup> Pavarësisht se nuk është përmendur në aktakuzë, i pandehuri A.G. ishte përfshirë në kontrabandimin me 1 migrant dhe i pandehuri T.Y. ishte përfshirë në kontrabandimin me 2 migrantë (në 2 momente të ndryshme).

që nga Turqia nëpërmes Serbisë, Kosovës, IRJ të Maqedonisë, Malit të Zi, Kroacisë dhe/apo Bosnje Hercegovinës të hyjnë në Slloveni, Itali, Hungari, Gjermani dhe/ose Austri”.

**Pika 6: “A.G., kontrabandim me migrantë, sipas nenit 138 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK-së (aktualisht siç parashihet me nenin 170, paragrafët 1 deri 3, të KPRK-së)”**

**Lidhur me pikën 6**, në pajtim me nenet 359, 361, 362, paragrafët 1, 365, dhe 366, dhe 370, paragrafi 3, të KPPK-së, gjykata shpall të pandehurin **A.G. fajtor** për përfshirje në kontrabandim me migrantë, e kryer në bashkëkryerje me A.Ç., në shkelje të neneve 170, paragrafët 1 dhe 8, të KPRK-së, lidhur me nenin 3, paragrafi 2, dhe nenin 31 të KPRK-së, sepse në periudhën në mes të 17 gushtit dhe 22 gushtit 2012, i pandehuri A.G. është përfshirë në kontrabandim me migrantë duke ju ofruar një letër garantuese përmbajtja e të cilës ishte e rreme që nuk korrespondonte me të vërtetën (e cila mund të çojë në veprën penale të legalizimit të përmbajtjes së rreme – në bazë të nenit 334, të KPPK-së, ose nenit 403 të KPRK-së), e lëshuar më 17/8/2012 dhe e nënshkruar nga ai pas kërkesës dhe asistencës së A.Ç.s, letra për I.K., i cili ka udhëtuar dhe ka zbritur në Kosovë me qëllim të shfrytëzimit si vend transit për në shtete tjera si destinacion përfundimtar, duke qenë se i pandehuri ka shkuar në aeroport më 22/8/2012, me qëllim që ta merr atë, pasi ai kishte garantuar për të më 17/8/2012. I.K., në fakt erdhi në Kosovë në Aeroportin e Prishtinës më 22/08/2012, në ora 6.43 pasdite.

I pandehuri A.G. (i përfshirë në kontrabandim me migrantë) është përfshirë në një moment të kontrabandimit me 1 migrant.

I pandehuri ka vepruar në atë mënyrë me qëllim të përfitimit të një dobie financiare ose të një dobie tjetër pasurore nga hyrja e paligjshme e personit në Republikën e Kosovës, i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës ose i një personi qoftë shtetas i Republikës së Kosovës apo shtetas i huaj në shtetin në të cilin personi i tillë nuk është banor i përhershëm ose shtetas i atij shteti dhe e ka ditur që dokumenti do të ose së paku që mund të përdoret për të hyrë në Kosovë, prandaj, hyrja në bazë të deklaratave mashtruese dhe të rreme tek oficerët e kufirit, përkatësisht në bazë të letrës garantuese të nënshkruar nga ai, të gjithë me qëllimin e mundësimit të individit të kontrabanduar një udhëtim të mëtejshëm për në shtetet tjera, përkatësisht të Bashkimit Evropian.

Në atë kohë i pandehuri është sjellë në mënyrën e përshkruar më sipër, ai ishte në gjendje t’i kuptonte dhe t’i kontrollonte veprimet e veta, të cilat i ka dëshiruar, edhe nëse nuk e ka ditur se veprimet e tij ishin të ndaluara dhe të dënueshme me ligj, së paku ai ishte në dijeni se pasoja e ndaluar mund të ndodhë si rezultat i veprimeve të tij dhe se ai e ka shkaktuar atë.

**Pika 7:** Objekt i veçimit të procedurës.

**Pika 8: “T.Y., kontrabandim me migrantë, sipas nenit 138 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK-së (aktualisht siç parashihet me nenin 170, paragrafët 1 deri 3, të KPRK-së)”**

**Lidhur me pikën 8**, në pajtim me nenet 359, 361, 362, paragrafët 1, 365, dhe 366, dhe 370, paragrafi 3, i KPPK-së, gjykata shpall të pandehurin **T.Y. fajtor** për përfshirje në kontrabandim me migrantë, e kryer në bashkëkryerje me A.Ç., në shkelje të neneve 170, paragrafët 1 dhe 8, të KPRK-së, lidhur me nenin 3, paragrafi 2, nenin 31 dhe 81 të KPRK-së, sepse në periudhën në mes të 7 nëntorit 2012 dhe 7<sup>20</sup> dhjetor 2012, i pandehuri T.Y., është përfshirë në kontrabandim me migrantë duke marrë pjesë në përgatitje dhe aranzhime të udhëtimeve të tyre, të cilët kanë udhëtuar dhe hyrë në Kosovë, në ditë të ndryshme, si vend transit për në vendet tjera si destinacion përfundimtar: R.B. dhe E.Ba.

I pandehuri T.Y. i pandehuri A.G. (i përfshirë në kontrabandim me migrantë) është përfshirë në një moment të kontrabandimit me 2 migrantë.

I pandehuri ka vepruar në atë mënyrë me qëllim të përfitimit të një dobie financiare ose të një dobie tjetër pasurore nga hyrja e paligjshme e personit në Republikën e Kosovës, i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës ose i një personi qoftë shtetas i Republikës së Kosovës apo shtetas i huaj në shtetin në të cilin personi i tillë nuk është banor i përhershëm ose shtetas i atij shteti dhe e kanë ditur hyrjen ilegale të bazuar në deklaratata mashtruese dhe të rreme tek oficerët e kufirit, të gjithë me qëllimin e mundësisimit të individëve të kontrabanduar një udhëtim të mëtejshëm për në shtetet tjera, përkatësisht të Bashkimit Evropian.

Në atë kohë i pandehuri është sjellë në mënyrën e përshkruar më sipër, ai ishte në gjendje t'i kuptonte dhe t'i kontrollonte veprimet e veta, të cilat i ka dëshiruar, duke e ditur se veprimet e tij ishin të ndaluara dhe të dënueshme me ligj.

Në këtë pikën 8 nuk është vërtetuar: nëse përveç prokurimit dhe përfshirjes, pra duke kontaktuar me pasagjerët dhe duke ofruar informacione lidhur me aranzhimet e udhëtimit i pandehuri gjithashtu ka përgatitur letra garancioni.

**Pika 9: “A.Ç., M.B., A.M. dhe A.B. për shpërlarje të parave, në shkelje të nenit 32 të Ligjit 03/L-196 për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit i datës 3.09.2010”**

**Në lidhje me pikën 9**, në bazë të neneve 359, 361, 362, paragrafi 1, 364, paragrafi 1.1.3, dhe 370, paragrafi 3, të KPPK-së, gjykata shpall të pandehurit **A.Ç., M.B., A.M. dhe A.B. të pafajshëm** për veprën penale të shpërlarjes së parave, në shkelje të nenit 32 të Ligjit 03/L-196 për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit i datës 3.09.2010, që ka hyrë në fuqi më 18.10.2010, dhe gjersa është e zbatueshme, neni 10.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2 mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të ngjashme Penale, e miratuar më 5 shkurt 2004, sepse nuk është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të akuzuarit e përmendur kanë kryer veprat me të cilat janë akuzuar, pra, nuk është vërtetuar se të pandehurit (tani citohet aktakuza): “në mes të 01 tetorit 2010 dhe 3 shkurtit 2013 A.Ç., në mes të 6 prillit

---

<sup>20</sup> Jo 4.

2011 dhe 13 dhjetorit 2012 M.B., në mes të 28 qershorit 2011 dhe 13 dhjetorit 2012 A.M., në mes të 4 nëntorit 2010 dhe 13 dhjetorit 2013 A.B. - në territorin e Kosovës dhe shteteve të tjera kanë kryer veprën penale të pastrimit të parave duke e ditur apo duke pasur shkak për të ditur se disa prona, respektivisht para të gatshme apo mjete të tjera monetare kanë origjinë të aktiviteteve kriminale dhe se në fakt burojnë nga vepra penale (kontrabandim me migrantë nga ana e anëtarëve të grupit kriminal)”.

### **Për sa më sipër gjykata shqipton këto**

#### **Dënime:**

**A.Ç.** (Pika 5): Për veprën penale të kontrabandim me migrantë në formë të rëndë, duke vepruar jo vetëm si anëtar i një grupi, por edhe duke organizuar dhe drejtuar të tjetër në veprimtarinë e kontrabandimit me migrantë, në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi, në përputhje me nenin 170, paragrafët 1, 5,6 dhe 8.1 dhe 8.2 të KPRK-së, lidhur me nenet 3, 31, 41, 45, 46, 62, 71, 72, 73 dhe 81 të KPRK-së, dënohet me 7 vjet dhe 3 muaj burgim dhe të paguajë një gjobë prej 1000 Euro.

**M.B.** (Pika 5): Për veprën penale të kontrabandim me migrantë në formë të rëndë, duke vepruar si anëtar i një grupi, në bashkëkryerje dhe njëkohësisht 6 vepra penale të kontrabandim me migrantë në formën në fjalë, në përputhje me nenin 138, paragrafët 1, 6 dhe 7, lidhur me nenet 23, 34, 39, 54, 62, 63, 64 dhe 71 të KPPK-së, dënohet me dënim unik prej 5 vjet dhe 3 muaj burgim.

**A.M.** (Pika 5): Për veprën penale të kontrabandim me migrantë në formë të rëndë, duke vepruar si anëtar i një grupi, në bashkëkryerje dhe njëkohësisht 7 vepra penale të kontrabandim me migrantë në formën në fjalë, në përputhje me nenin 138, paragrafët 1, 6 dhe 7, lidhur me nenet 23, 34, 39, 54, 62, 63, 64 dhe 71 të KPPK-së, dënohet me dënim unik prej 5 vjet burgim.

**A.B.** (Pika 5): Për veprën penale të kontrabandim me migrantë në formë të rëndë, duke vepruar si anëtar i një grupi, në bashkëkryerje dhe njëkohësisht 3 vepra penale të kontrabandim me migrantë në formën në fjalë, në përputhje me nenin 138, paragrafët 1, 6 dhe 7, lidhur me nenet 23, 34, 39, 54, 62, 63, 64 dhe 71 të KPPK-së, dënohet me dënim unik prej 4 vjet burgim.

**M.A.** (Pika 5): Për veprën penale të kontrabandim me migrantë në formë të rëndë, duke vepruar si anëtar i një grupi, në bashkëkryerje dhe njëkohësisht 2 vepra penale të kontrabandim me migrantë në formën në fjalë, në përputhje me nenin 138, paragrafët 1, 6 dhe 7, lidhur me nenet 23, 34, 39, 54, 62, 63, 64 dhe 71 të KPPK-së, dënohet me dënim unik prej 3 vjet dhe 6 muaj burgim.

**I.P.** (Pika 5): Për veprën penale të përfshirjes në kontrabandim me migrantë, në bashkëkryerje, në përputhje me nenin 170, paragrafët 1 dhe 8.1 dhe 8.2, të KPRK-së, lidhur me

nenet 3, 31, 41, 45, 46, 73 dhe KPRK-së, dënohet me 2 vjet dhe 3 muaj burgim dhe të paguajë një gjobë prej 400 euro.

**A.G.** (Pika 6): Për veprën penale të përfshirjes në kontrabandim me migrantë, në bashkëkryerje, në përputhje me nenin 170, paragrafët 1 dhe 8.1 dhe 8.2, të KPRK-së, lidhur me nenet 3, 31, 41, 45, 46, 73 dhe KPRK-së, dënohet me 1 vit dhe 3 muaj burgim dhe të paguajë një gjobë prej 200 euro.

**T.Y.** (Pika 8): Për 2 vepra penale të përfshirjes në kontrabandim me migrantë, në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi, në formën në fjalë, në përputhje me nenin 170, paragrafët 1 dhe 8.1 dhe 8.2, të KPRK-së, lidhur me nenet 3, 31, 41, 45, 46, 73, 75, dhe 81 të KPRK-së, dënohet me dënim prej 2 vjet burgim dhe të paguajë një gjobë prej 400 euro.

### **Llogaritja e kohës së kaluar në paraburgim**

Në pajtim me nenin 73, paragrafi 1, të KPPK-së ose nenit 83, paragrafi 1, të KPRK-së, koha e kaluar në paraburgim do të llogaritet në zbatimin e dënimeve me burgim.

### **Periudha për pagesën e gjobave**

Në pajtim me nenin 365, paragrafi 2, të KPPK-së dhe nenin 46, paragrafi 2, të KPRK-së, i pandehuri A.G. duhet të paguajë gjobën brenda periudhës prej 1 muaj dhe i pandehuri T.Y. brenda periudhës prej 3 muaj. Në rast se gjobat duhet të zëvendësohen, mënyra do të jetë në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 46, paragrafët 3 deri 5, të KPRK-së.

### **Pezullimi i dënimeve me burgim, të shqiptuara ndaj të pandehurve A.G. dhe T.Y.:**

Gjykata vendos, në pajtim me nenet 3, 50, 51, paragrafët 1, 2, 4, dhe 52, paragrafët 2 (ky në lidhje me 170 paragrafi 1), 3 deri 5, të K.P.R.K, ta pezullojë ekzekutimin e dënimit me burgim të A.G.t nëse ai nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit prej 2 viteve dhe të T.Y., nëse ai nuk e kryen ndonjë vepër tjetër penale për periudhën e verifikimit prej 3 viteve. Dënimet e gjobës nuk janë pezulluar.

Në pajtim me nenet 52, paragrafi 3, dhe 59 të KPRK-së, pezullimi gjithashtu përfshinë obligimin për përmbajtjen e mos ndryshimit të vendbanimit pa e njoftuar shërbimin sprovues.

### **Mos zbatimi i nenit 82 të KPRK-së nga gjykata**

Gjykata vendosi të mos e zbatojë normën e tillë në këtë moment, për shkak se në mesin e faktorëve tjerë, nuk ka të dhëna të mjaftueshme lidhur me fazën e ekzekutimit të dënimit të shqiptuar ndaj të pandehurit I.P., në procedurë pranë Gjykatës Themelore të Gjilanit, me numër PKR. nr. 56/2013 dhe Gjykatës së Apelit (PAKR 259/14), të datës 22 maj 2015, në të cilën ai u dënua për “kontrabandim me migrantë në tentativë”, në përputhje me nenin 170, paragrafi 1, neni 28, paragrafi 3 dhe neni 76, paragrafi 1, nën-paragrafi 4, të KPRK-së, me 1 (një) vit dhe 6 (gjashtë) muaj burgim dhe një gjobë në shumën prej 200 € (dyqind Euro).

### **Dënimi(et) plotësuese:**

Në lidhje me dënimin plotësues ndaj të pandehurve, gjykata vendos të shqiptojë ndaj dy të pandehurve të cilët janë shtetas të huaj, me asnjë lidhje të drejtpërdrejt familjare me Kosovë (A.Ç. dhe A.B.) dënimin plotësues të “dëbimit nga territori i Republikës së Kosovës” i parashikuar me nenin 62, paragrafi 2.9, lidhur me nenet 3, 71, paragrafi 1 të KPRK-së, për periudhën prej 7 viteve për A.Ç.n dhe për periudhën prej 4 viteve për A.B., duke filluar nga dita kur ky vendim merr formën e prerë (neni 71, paragrafi 4, të KPRK-së).

Në rastin e dy shtetasve tjerë të huaj, të pandehurit M.A. dhe T.Y. (me shtetësi të dyfishtë, duke përfshirë atë Kosovare), gjykata nuk do të, dhe nuk mundet respektivisht, të shqiptojë dënim të tillë plotësues.

**Konfiskimi i sendeve:** Sendet që ndodhen në aktakuzë të propozuara për sekuestrim, shpallen të sekuestruara<sup>21</sup> nëse ende nuk janë subjekt i ndonjë vendimi identik në ndonjë procedurë tjetër<sup>22</sup> pasi ato janë përdorur për kryerjen e veprimeve që përbëjnë vepra penale, në pajtim me nenin 60 të KPPK-së (aktualisht neni 69 i KKRK-së):

Nga A.Ç.:

- 1 - Telefon celular, Nokia, modeli 6300 IC: 661U-RM217 me SIM kartelë, IPKO, nr. 109011355198;
- 2 - Telefon celular, Nokia, modeli 6230i, IMEI Nr. 353233/01421796/2 me SIM kartelë MTS, [Tel. nr.];
- 3 - SIM kartelë, IPKO, nr. 109011298946;
- 4 - SIM kartelë, VALA, nr. 8937701010020489791;
- 5 - SIM kartelë, IPKO, nr. 109011301108;
- 6 - SIM kartelë, djuice, [Tel. nr.];
- 7 - Telefon celular, Nokia, modeli 2310, IMEI nr. 354819/01/015797/7;
- 8 - SIM kartelë, VIP, nr. 8938105209070703180;
- 9 - SIM kartelë, IPKO, nr. 108010741091;

---

<sup>21</sup> Për arsye se procedura është veçuar në lidhje me S.S.n, sendet e referuar për të nuk do të përmenden këtu.

<sup>22</sup> Si për shembull, në rastin e të pandehurit M.B., në këtë rast vetëm [telefoni me numrin] është përdorur, por të tjerat janë sekuestruar pas një urdhri të lëshuar në një procedurë tjetër penale. Në fakt, vetëm numri [telefoni me numrin], do të përmendet bashkë m arsyetimin që do të vijoj tek faktet e vërtetuara, dhe gjykata e përmenden këtë sepse jo vetëm përgjatë gjykimit por gjithashtu edhe gjatë fjalës përmbyllëse (më 16/03/2016), i pandehuri M.B. ka insistuar se telefoni bashkë [telefoni me numrin] veçse janë sekuestruar në një procedurë tjetër, më 25/09/2011.



- 10 - Telefon celular, Nokia, modeli 6300 IC: 661U-RM217, IMEI: 358051012922556;
- 11 - SIM kartelë, IPKO, nr. 109011867774, [Tel. Nr.];
- 12 - SIM kartelë, IPKO, 109011389055;
- 13 - SIM kartelë, Mobi, [Tel. Nr.];
- 14 - SIM kartelë, Mobi, [Tel. Nr.];

**Nga M.B.:**

- 1 - Desktop kompjuter, HP COMPAQ, HP DC7600, MT, CEL 3066/512/40, nr. serik 1059262;
- 2 - Telefon celular, Vodafone, GSM 900/1800 Mhz, IMEI nr. 868955000980611, me SIM kartelë [me numerin];
- 3 - SIM kartelë, IPKO, nr. 109011727207 [me numerin];
- 4 - Telefon celular, NOKIA, modeli 2310, lloji RM-189, IMEI nr. 358960/01/546112/5 me SIM kartelë [Tel. Nr.] numër serik 0553626;
- 5 - SIM kartelë, Z-mobile, nr. 101005288898 [nr. i telefonit];

**Nga A.M.:**

- 1 - Telefon celular, SAMSUNG, modeli GT-E1170, IMEI nr. 358688/03/348592/3, me SIM kartelë, IPKO, nr. 109011732744 [nr. i telefonit];
- 2 - SIM kartelë, VALA, nr. 8937701010013414525;
- 3 - Telefon celular, NOKIA, modeli 1650, lloji RM 305, IMEI nr. 359565/01/710615/3;
- 4 - Telefon celular, SIEMENS C35i, nr. 449191546517141;
- 5 - Telefon celular, SAMSUNG, modeli GT-E1080Ë, IMEI nr. 359779/04/506133/6;
- 6 - DELL laptop, LBL P/N Ë1495 A00;
- 7 - Telefon celular, NOKIA, modeli N73-1, lloji RM-133, IMEI nr. 359568019767451;
- 8 - Telefon celular, NOKIA, modeli 6230i, lloji RM-72, IMEI nr. 357097/00/936104/4;
- 9 - San Disk Micro Chip, Micro SD;

**Nga M.A.:**

- 1 - SIM kartelë, IPKO, nr. 108010802656;
- 2 - Telefon celular Samsung, modeli SGH-C130, IMEI: 359345/00/290793/5;

**Nga A.B.:**

- 1 - Telefon NOKIA 1112, nr. serik IMEI 358067/01/197640/1;
- 2 - IPKO SIM kartelë, ne nr. serik 109011863241;
- 3 - Telefon SAMSUNG SGH D900I, me IMEI nr. 354890/01/275088/7;
- 4 - T-Mobile SIM kartelë, nr. 893890109022551969732.GI;

**Nga I.P.:**

- 1 - Telefon celular, NOKIA, modeli 101, lloji RM-769, me dy SIM kartela dhe IMEI nr. 359739/04/689510/8 dhe IMEI nr. 359739/04/689511/8;
- 2 - SIM kartelë, VALA, nr. 8937701010020426413;
- 3 - SIM kartelë, IPKO, nr. 109011276344;

**Nga A.G.:**

- 1 - Telefon celular, NOKIA, modeli 6300, IMEI nr. 353933/01/340506/8;
- 2 - Telefon celular, Samsung, modeli SGH-E900, IMEI nr. 356030/01/325515/0;
- 3 - Telefon celular, Samsung, modeli GT- C 3010, IMEI nr. 353373/03/898337/9;
- 4 - Telefon celular, Samsung, modeli GT-E 1170, IMEI nr. 355049/04/406513/2;
- 5 - Telefon celular, Samsung, modeli SGH-C 260, IMEI nr. 358210/01/064416/2;
- 6 - Telefon celular, Samsung, modeli C 3050, IMEI nr. 358553/03/840340/4;
- 7 - SIM kartelë, VALA, nr. 8937701010016818185;

**Nga T.Y.:**

- 1 - Telefon celular, NOKIA, modeli 6303ci, lloji RM-638, IMEI nr. 352682/04/167543/9;
- 2 - SIM kartelë, VALA, nr. 8937701010016959260 [nr. i telefonit], pin kodi:0000;
- 3 - SIM kartelë, VALA, nr. 8937701010007220789;

4 - Desktop kompjuter COMPAQ, 8110FR4Z1957.

**Kërkesë pronësore:**

Nuk ka asnjë kërkesë pronësore.

**Shpenzimet e procedurës:**

Në bazë të nenit 450 të KPPK-së, shpenzimet e procedurës do të paguhen nga të pandehurit. Në pajtim me nenin 450, paragrafi 2.6, shuma paushalle është 200 Euro për secilin të pandehur, në vlerën e përgjithshme prej 1600 Euro.

Në bazë të nenit 450, paragrafët 5 deri 7, të KPPK-së, shpenzimet për përkthimin në gjuhët e të pandehurve dhe pagesat dhe shpenzimet e nevojshme për avokatët mbrojtës të caktuar, nuk përfshihen.

Gjykata, *ex officio*, nuk sheh ndonjë nevojë për shpallje të këtij aktgjykimi (dispozitivi) në shtyp, në radio apo televizion, neni 365, paragrafi 1.1.6, të KPPK-së, për të mbrojtur vlerat e drejtësisë dhe të Interesit Publik.

**Këshillë juridike:** Në pajtim me nenet 374, paragrafi 1.1, dhe 380, paragrafi 1, kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë brenda 15 ditëve nga dita e dorëzimit të një kopjeje të tij tek palët. Ankesa duhet të dorëzohet në Gjykatë të Apelit përmes Gjykatës Themelore të Prizrenit.

**(SQARIMI I BAZËS SË AKTAKUZËS)**

**ARSYETIMI**

**A) Trupi gjykues dhe kompetenca:**

Asnjë kundërshtim nuk është ngritur nga palët lidhur me përbërjen e trupit gjykues. Pas ndryshimit të një anëtari të trupit gjykues, të gjitha palët janë pajtuar t'i konsiderojnë "si të lexuara dhe administruara" të gjitha provat që janë paraqitur deri tani, në pajtim me nenin 311, paragrafi 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, KPRK-së.

Kjo gjykatë është kompetente për të gjykuar lëndën, në pajtim me nenet 1, 2 nën-paragrafi 1.2, 9 nën-paragrafi 2.1, 15 paragrafi 1.20 dhe 15, paragrafi 2, të Ligjit për Gjykatat - L. 03/L-199, në fuqi në kohën kur ka filluar procedura [Gjykata Themelore do të jetë gjykata e shkallës së parë në Republikën e Kosovës, në këtë lëndë (paragrafi 2) Gjykata Themelore e Prizrenit është ajo që ka juridiksion territorial dhe në pajtim me nenin 11, paragrafi 1, e të njëjtit ligj, Gjykata Themelore është kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha lëndët,

përveç nëse parashihet ndryshe me ligj] – dhe sipas nenit 3, paragrafëve 1 dhe 7 (kjo e fundit në lidhje me shumicën e gjyqtarëve të EULEX-it) të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (L. 03/L-053 në fuqi në atë kohë), *ex vi* neni 442 i KPK-së.

## **B) Çështje procedurale:**

**B.1-** Më 10 maj 2011, PSRK-ja pranoi një kërkesë për Ndihmë Ligjore Ndërkombëtare nga Prokurori Publik i Qarkut në Lubjanë të Republikës së Sllovenisë me numrin e referencës TPP-S-1 27/2010 – DŠ, datuar 21 prill 2011, lidhur me të dyshuarin e identifikuar O.A.

**B.2-** Bashkë me të përmendurin O.A. janë individ të tjerë të ndërlidhur me hetimin në fjalë dhe më 11 korrik 2011, prokurori lëshoi aktvendimin për inicimin ndaj O.A., më 14 dhjetor 2011, prokurori lëshoi aktvendimin për zgjerimin e hetimeve edhe ndaj B.F.t, më 20 janar 2012, prokurori lëshoi aktvendimin e tretë për zgjerimin e hetimeve edhe ndaj F.A., më 20 janar 2012, A.Ma. (i cili më vonë është ri-identifikuar si A.By.) ishte subjekt i një urdhri identik (dhe më 21 mars 2012, prokurori lëshoi një aktvendim për zgjerimin e hetimeve lidhur me A.By.), më 17 gusht 2012, prokurori lëshoi një aktvendim për zgjerimin e hetimeve kundër A.Ç., më 3 dhjetor 2012 M.B., ishte subjekt i një urdhri identik, më 5 dhjetor 2012, një tjetër aktvendim është lëshuar nga prokurori për zgjerimin e hetimeve ndaj M.A., A.M., A.G., I.P., T.Y., S.S., B.Be., M.Bo. dhe E.Y. dhe më 14 dhjetor 2012, prokurori lëshoi një aktvendim për zgjerimin e hetimeve ndaj A.B.. Aktvendimi në fjalë lidhur me hetimet e veprave penale të kontrabandim me migrantë, krim i organizuar dhe shpërlarje e parave, sipas legjislacionit në fuqi [kontrabandim me migrantë, sipas nenit 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të KPPK-së (aktualisht e parashikuar me nenin 170, paragrafët 1 deri 6 të KPRK-së); krim i organizuar, sipas nenit 274, paragrafët 1, 2 dhe 3, të KPPK-së, (aktualisht e parashikuar me nenin 283, paragrafët 1 dhe 2, të KPRK-së) dhe shpërlarje e parave, në pajtim me nenin 32 të Ligjit 03/L-196 për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit i datës 3 shtator 2010, që ka hyrë në fuqi më 18.10.2010, dhe gjersa është e zbatueshme, neni 10.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2 mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të ngjashme Penale].

**B.3-** Një pjesë e hetimeve është ende në vazhdim dhe individ të tjerë përveç të pandehurve në këtë lëndë veçse janë gjykuar, të tjerët janë duke u gjykuar ose rigjykuar.

**B.4-** Ndaj kësaj lënde penale (fillimisht SPRK PPS nr: 50/2011, HEP nr. 108/2011) është ngritur aktakuzë më 11/12/2012, pranë gjykatës në pajtim me nenet 240, paragrafi 1, 241 dhe 242 të KPPRK-së dhe Ligjit 04/L-123.

**B.5-** Kjo procedurë tani është ndaj të pandehurve A.Ç., [pseudonimi] i mbajtësit të pasaportës turke nr...me numër serik..., M.B., mbajtës i pasaportës së Kosovës me nr...me numër personal të identifikimit..., A.M., mbajtës i letërnjoftimit me numër (i lëshuar nga Republika e Serbisë)..., M.A., mbajtës i identifikimit sipas lejes së vozitjes nga Turqia me

numër..., **A.B.**, mbajtës i pasaportës së ish-RJ të Maqedonisë, me numër..., **I.P.**, mbajtës i letërnjoftimit me numër..., **A.G.**, mbajtës i letërnjoftimit me numër... dhe **T.Y.**, mbajtës i letërnjoftimit me numër... Fillimisht kjo lëndë ka qenë edhe kundër S.S.t. Procedura lidhur me të pandehurin S.S. (pika 7 e aktakuzës) është veçuar në seancën dëgjimore fillestare, më 30 dhjetor 2013, duke pasur parasysh se vendndodhja e tij u bë e panjohur.

**B.6-** Seanca dëgjimore fillestare është mbajtur më 30 dhjetor 2013, 29 janar 2014 dhe 23 prill 2014, dhe seanca dëgjimore e dytë është mbajtur më 30 maj 2014.

**B.7-** seancat e shqyrtimit gjyqësor, të hapura për publikun janë mbajtur më 10 shtator 2014, 11 shtator 2014, 24 shtator 2014, 25 shtator 2014, 15 tetor 2014, 31 tetor 2014, 3 nëntor 2014, 10 nëntor 2014, 24 nëntor 2014, 2 dhjetor 2014, 3 dhjetor 2014, 9 dhjetor 2014, 10 dhjetor 2014, 16 dhjetor 2014, 22 janar 2015, 28 janar 2015, 9 shkurt 2015, 10 shkurt 2015, 16 mars 2015, 19 mars 2015, 15 prill 2015, 20 prill 2015, 28 prill 2015, 6 maj 2015, 8 maj 2015, 12 maj 2015, 13 maj 2015, 18 maj 2015, 20 maj 2015, 16 qershor 2015, 17 qershor 2015, 14 korrik 2015, 15 korrik 2015, 1 shtator 2015, 22 shtator 2015, 23 shtator 2015, 20 nëntor 2015, 23 nëntor 2015, 30 nëntor 2015, 1 dhjetor 2015, 17 dhjetor 2015, 18 dhjetor 2015, 5 janar 2016, 14 janar 2016, 16 dhe 18 shkurt, 9, 15, 16, 21 mars 2016, 7 dhe 12 prill 2016, në prani të prokurorisë, të pandehurve në fjalë dhe avokatëve të tyre mbrojtës, dhe pas shqyrtimit dhe votimit të trupit gjykues më 12 prill 2016.

**B.8-** Disa seanca u desh të anulohen në mes të shtatorit 2015 dhe nëntorit 2015, pasi aranzhime të reja është dashur të bëhen, për shkak të faktit se gjyqtari i Kosovës Artan Sejrani ishte caktuar që nga seanca e mbajtur më 20 nëntor 2015 për ta zëvendësuar gjyqtarin vendor të mëparshëm, Zejnullah A.G. – i cili ishte anëtarë i trupit gjykues deri kur është emëruar si prokuror – dhe në seancën e mbajtur në po këtë datë (siç është futur në procesverbal), në pajtim me nenin 311, paragrafi 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme KKRK), pas dëgjimit të palëve, është pajtuar nga secili të konsiderohen si të lexuara, administruara dhe të ekzaminuara, provat që janë paraqitur përgjatë seancave të mëparshme. Gjithashtu seancat e caktuara për 23 dhe 25 shkurt u desh të anulohen pasi që një anëtar i trupit gjykues nuk ka mundur të jetë i pranishëm.

**B.9-** Sipas kërkesës nga avokatët mbrojtës, të gjitha seancat ishin të incizuara audio dhe video.

**B.10-** Të gjitha seancat u mbajtën me përkthim nga gjuha angleze në shqipe (dhe anasjelltas) dhe nga gjuha shqipe në turke (dhe anasjelltas), siç është në procesverbal.

**B.11-** Të gjitha seancat janë mbajtur në prani të Prokurorisë, të gjithë të pandehurve<sup>23</sup> dhe avokatëve të tyre mbrojtës. Prokuroria fillimisht është përfaqësuar nga z. Martin Hackett dhe znj.

---

<sup>23</sup> Siç u tha më parë, përveç kur mungonin në sallë të gjykimit, në pajtim me ligjin, gjersa bashkë-të pandehurit po deklarorin për rastin, por gjithmonë të përfaqësuar nga avokatë mbrojtës përkatës (dhe janë njoftuar për atë çfarë është thënë gjatë mungesës në sallën e gjykimit).

Diane Wilson, më vonë nga z. Robert Kucharski (më 23 prill 2014), ndihmuar nga zyrtarja ligjore znj. Claire Morris, dhe më pas (qysh nga 30 maj 2014) nga z. Rómulo Mateus dhe znj. Tiffany-Corinne Moise (z. Danilo Ceccarelli ishte prokuror për seancën e mbajtur më 1 dhjetor 2015, z. Paul Flynn, më 21 mars 2016 dhe z. Tomas Meskauskas, më 12 prill 2016). Avokatët mbrojtës fillimisht të caktuar për të pandehurit ishin (në seancën dëgjimore fillestare, të mbajtur më 30 janar 2013): O.R. për A.Ç., O.Z. për M.B., E.G. për A.M. [që nga 10 shkurti 2015, ishte zëvendësuar përherë nga znj. N.H., me vendimin e të pandehurit (f. 3 e procesverbalit)], H.C. për M.A., Rexhep H.Ce. për I.P. [me kërkesë të avokatit mbrojtës Rexhep H.Ce., bazuar në atmosferën e tensionuar në sallën e gjyqimit, në seancën e mbajtur më 19 mars 2015 (f. 8 në procesverbal) ai është zëvendësuar nga Visar Ostrozubi], A.K. për A.B., G.D. për T.Y., R.K. për S.S. dhe B.N. (I zëvendësuar nga A.A.) për A.G.. Në seanca të shumta, gjatë seancës dëgjimore fillestare, seancës së dytë dhe shqyrtimit gjyqësor, shumë herë edhe në mëngjes edhe në mbrëmje, avokatët mbrojtës kanë bashkuar autorizimet për tu zëvendësuar nga avokatë tjerë. Në secilin zëvendësimi ishte pëlqimi i të pandehurit përkatës.

**B.12-** Nuk ka asnjë kërkesë pronësore.

**B.13-** Nënshtetësia aktuale e të pandehurve është si në vijim: **A.Ç.n** është turk (pasaportë turke nr...), **M.B.** është kosovar, **A.M.** është kosovar, **M.A.** është turk (leje të vozitjes turke me numër...), **A.B.** është maqedonas, qytetar i ish-RJ të Maqedonisë (pasaportë të ish-RJ të Maqedonisë...) **I.P.** është kosovar, **A.G.** është kosovar dhe **T.Y.** është turk dhe kosovar, me numër personal të identifikimit...(T.Y. është bërë qytetar i Republikës së Kosovës, nr..., MPB – Prishtinë; pasaportë të Kosovës...).

**B.14-** Informatat e azhurnuara rreth dosjeve potenciale penale të të pandehurve janë kërkuar nga Gjykatat Themelore të Kosovës dhe nga Ministria e Drejtësisë në IRJM (përmes BJK përmes Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës).

**B.15-** Situata e të pandehurve në lidhje me masat për sigurimin e pranisë së tyre në procedurë është si në vijim:

**A.Ç.:** Ai është në paraburgim që nga 3 shkurti 2013.

**M.B.:** Ai është në paraburgim që nga 13 dhjetori 2012.

**A.M.:** Ai është në paraburgim që nga 13 dhjetori 2012.

**M.A.:** Ai ka qenë në paraburgim që nga 24 janari 2013 deri më 12 prill 2016.

Tani ai i është nënshtruar masës së paraqitjes në stacion policor, së bashku me premtimin e mos fshehjes.

**A.B.:** Ai është në paraburgim që nga 13 dhjetori 2012.

**I.P.:** Ai ka qenë në paraburgim që nga 13 dhjetori 2012 deri më 12 qershor 2014.

Që nga 11 qershori 2014, ai i është nënshtruar masës së paraqitjes në stacion policor dy herë në javë, së bashku me premtimin e mos fshehjes.

**A.G.:** I pandehuri i është nënshtruar masës së paraqitjes në stacion policor një herë në javë, së bashku me premtimin e mos fshehjes, që nga 13 dhjetori 2012.

dhe

**T.Y.:** I pandehuri i është nënshtruar masës së paraqitjes në stacion policor një herë në javë, së bashku me premtimin e mos fshehjes, që nga 13 dhjetori 2012.

**B.16-** Trupi gjykues diskutoi dhe votoi më 12 prill 2016.

### **C) Arsyetimi sipas neneve 364, 365 dhe 370 të KPPK-së:**

#### **C 1) – Faktet e dëshmuara që janë relevante për vendimin:**

##### **Pika 5 (dhe tani duke shfrytëzuar formulimin e saktë të përmendur në Aktakuzë):**

“A.Ç., M.B., A.M., A.B., I.P. dhe M.A.

Kontrabandimi me Migrantë, në kundërshtim me Nenin 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6, Kodi Penal i Kosovës (KPK), në veçanti me organizimin dhe drejtimin e të tjerëve për të kryer veprën penale, të dënueshme me gjobë deri në 500.000 EUR dhe dënim me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet me rrethanën rënduese të veprimit si anëtarë të një grupi ose në mënyrë që ka gjasa të rrezikoj jetët apo sigurinë e migrantëve apo që ngërthen trajtim jo-njerëzor apo degradues përfshirë eksploatimin e atyre migrantëve (që korrespondon me Nenin 170 të Kodit Penal të Kosovës, Ligji 04/L-082 i 2012-ës (kodi i ri) sipas të cilit dënimi bëhet në pajtueshmëri me Nenin 3), sepse: ndërmjet 23 qershorit 2012 dhe 2 dhjetorit 2012, A.Ç., M.B., A.M., A.B. dhe M.A., në territorin e Kosovës, Serbisë, ish republikës jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi, Kroacisë, Sllovenisë, Italisë, Austrisë, Gjermanisë dhe/ose shteteve të tjera kanë kryer veprën penale të kontrabandimit me migrantë duke bërë kontrabandimin; sigurimin dhe ofrimin e dokumenteve të rreme të udhëtimit apo letërnjoftime të rreme për të mundësuar kontrabandim për përfitim financiar apo tjetër material; dhe mundësimin e personave që nuk janë qytetarë të Kosovës të hyjnë apo të qëndrojnë në Kosovë, apo persona që nuk janë vendorë apo qytetarë të përherëshëm të kalojnë kufirin pa respektuar rregullat për hyrje të ligjshme, dhe të qëndrojnë në shtetin në fjalë pa përmbushur kërkesat e nevojshme ligjore për të qëndruar me anë të mjeteve të përmendura më parë apo me mjete të tjera të paligjshme; dhe mbi të gjitha, me organizimin dhe drejtimin e personave të tjerë për të kryer të njëjtat veprime për migrantët si në vijim”:

**Kjo pikë do të shqyrtohet paragraf pas paragrafi të pikës së aktakuzës, individ pas individ (të kontrabanduar), të pandehurit drejtpërdrejtë të përfshirë (emri i të pandehurve në këtë lëndë do të jepet në kllapa pas emrit të secilit migrant<sup>24</sup>):**

### C.1.1

(1)- Në periudhën ndërmjet 23 qershorit dhe 27 qershorit 2012, kontrabandimi i këtyre migrantëve Turq duke e organizuar udhëtimin e tyre dhe hyrjen në Kosovë si shtet tranzit për në shtete tjera si destinacion i tyre i fundit:

M.Oc.: A.Ç.,  
T.O.: A.Ç. dhe  
M.K.: A.Ç..

(2)- Në periudhën korrik 2012, kontrabandimi i këtyre migrantëve duke e organizuar udhëtimin e tyre dhe hyrjen në Kosovë si shtet transit për në shtete tjera si destinacion i tyre i fundit:

I.Y.: A.Ç.,  
F.K.: A.Ç. dhe  
M.Sol.: A.Ç..

(3)- Në periudhën gusht 2012, kontrabandimi i këtyre migrantëve duke e organizuar udhëtimin e tyre dhe hyrjen në Kosovë si shtet transit për në shtete tjera si destinacion i tyre i fundit:

O.Yl.: A.Ç.,  
I.K.<sup>25</sup>: A.Ç. / A.G.,  
M.S.B.: A.Ç. dhe  
M.Ha.: A.Ç..

(4)- Në periudhën shtator 2012, kontrabandimi i këtyre migrantëve duke e organizuar udhëtimin e tyre dhe hyrjen në Kosovë si shtet transit për në shtete tjera si destinacion i tyre i fundit:

M.Go.: A.Ç.,  
R.K.G.: A.Ç.,

---

<sup>24</sup> Në këtë fazë do të përmenden vetëm emrat, roli i secilit të pandehur në çdo fakt specifik të vërtetuar do të shpjegohet në arsyetim.

<sup>25</sup> Për arsye sistematike, ky individ do të përmendet përsëri në pikën 6, në lidhje me të pandehurin A.G.



T.Ya.: A.Ç.,  
D.E.: A.Ç.,  
S.E.: A.Ç.,  
E.E.: A.Ç.,  
H.Ce.: A.Ç.,  
K.C.: A.Ç.,  
B.C.: A.Ç.,  
L.D.: A.Ç.,  
S.K.: A.Ç.,  
H.K.: A.Ç.,  
A.Ak.: A.Ç.,  
G.K.: A.Ç.,  
M.P.: A.Ç.,  
E.P.: A.Ç.,  
M.S.D.: A.Ç.,  
F.U.: A.Ç. / A.M.,  
H.E.: A.Ç. / A.M.,  
U.K.: A.Ç.,  
I.T.: A.Ç.,  
E.Si.: A.Ç. / A.M.,  
V.Oz.: A.Ç. / A.M.,  
S.C.: A.Ç. / A.M.,  
A.Akd.: A.Ç.,  
C.D.: A.Ç.,  
D.B.: A.Ç.,

S.Al.: A.Ç. dhe

M.Ka.: A.Ç..

(5)- Në periudhën tetor 2012, kontrabandimi i këtyre migrantëve duke e organizuar udhëtimin e tyre dhe hyrjen në Kosovë si shtet transit për në shtete tjera si destinacion i tyre i fundit:

I.Yl.: A.Ç.,

C.C.: A.Ç.,

E.B.: A.Ç.,

N.S.: A.Ç.,

V.A.: A.Ç. / A.M.,

H.Yu.: A.Ç.,

D.K.: A.Ç.,

A.D.: A.Ç.,

L.B.: A.Ç.,

I.Pol.: A.Ç.,

S.Sa.: A.Ç.,

S.Ba.: A.Ç.,

A.Bi.: A.Ç. / M.B.,

I.D.: A.Ç. / A.M. / A.B.,

A.O.: A.Ç. / A.M.,

A.H.Y.: A.Ç.,

T.E.: A.Ç.,

H.S.: A.Ç.,

H.A.: A.Ç.,

A.Ar.: A.Ç. / A.M.,

F.G.: A.Ç.,

A.Di.: A.Ç. / I.P.,

H.M.K.: A.Ç. / I.P.,

O.G.: A.Ç.,

O.K.: A.Ç. / I.P. dhe

A.Uz.: (A.Ç.).

(6)- Në periudhën nëntor 2012 kontrabandimi i këtyre migrantëve duke e organizuar udhëtimin e tyre dhe hyrjen në Kosovë si shtet transit për në shtete tjera si destinacion i tyre i fundit:

B.G.: A.Ç. / M.B. dhe M.A.

H.T.: A.Ç. / A.M. / M.B.,

M.P.: A.Ç. / A.M. / M.B.,

R.B.<sup>26</sup>: A.Ç. / T.Y. / M.B. / A.B.,

E.Ba.<sup>27</sup>: A.Ç. / T.Y.,

Akr.A.: A.Ç. / M.B.,

S.Az.: A.Ç. / M.B.,

N.A.: A.Ç. / M.B.,

Y.A.: A.Ç. / M.B.,

D.A.: A.Ç. / M.B.,

C.Ko.: A.Ç.,

N.C.: A.Ç.,

M.M.B.:<sup>28</sup> A.Ç. / M.A. / A.B. / M.B.<sup>29</sup>,

A.Gi.: A.Ç.

---

<sup>26</sup> Për arsye sistematike, ky individ do të përmendet përsëri në pikën 8, në lidhje më të pandehurin T.Y.

<sup>27</sup> Për arsye sistematike, ky individ do të përmendet përsëri në pikën 8, në lidhje më të pandehurin T.Y.

<sup>28</sup> Ka të dhëna sa i përket një individ tjetër (bashkëshortja) A.Bu., për shembull në raportin SMK, referencat, mesazhet SMS dhe përgjimet. Megjithatë, ky individ nuk përmendet në aktakuzë.

<sup>29</sup> Vetëm për tentimin e parë për hyrje të çiftit më 13/11/2012, me aeroplan në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, në orën 7.49 në mbrëmje. (shih faqen 275 të raportit SMK).

## **Pika 6**

**Në periudhën ndërmjet 17 gusht dhe 22 gusht 2012, i pandehuri A.G. i angazhuar në kontrabandimin e migrantëve duke ia dhënë një letër garancioni, përmbajtja e të cilit nuk përkonte me të vërtetën, I.K.it, i cili udhëtoi dhe arriti në Kosovë me qëllim që ta përdorë si shtet tranzit për në shtete tjera si destinacion të fundit:**

**C.1.2** – I pandehuri ia lëshoi një letër garancioni I.K.it më 17/8/2012, të nënshkruar nga ai, pas kërkesës dhe ndihmës nga A.Ç., përmbajtja e së cilës nuk përkonte me të vërtetën, pasi që i pandehuri shkoi në aeroport më 22/8/2012 që ta marrë atë, meqë ai kishte garantuar për të më 17/8/2012. I.K. në të vërtetë mbërriti në Kosovë dhe ateroi në Aeroportin e Prishtinë më 22/08/2012, në orën 6.43 pasdite.

## **Pika 8**

**Në periudhën ndërmjet 7 nëntorit 2012 dhe 7<sup>30</sup> dhjetorit 2012, i pandehuri T.Y. u angazhuar në kontrabandimin e këtyre migrantëve duke marrë pjesë në përgatitjen dhe aranzhimin e udhëtimeve të tyre, për migrantët që udhëtuan dhe hynë në Kosovë, në ditë të ndryshme, si shtet transit për në shtetet tjera si destinacion i tyre i fundit:**

**C.1.3** – R.B.<sup>31</sup>: A.Ç. / T.Y. / M.B. / A.B. dhe

- E.Ba.<sup>32</sup>: A.Ç. / T.Y.,

**C.1.4** – A.Ç. gjithashtu ndërhynte në pasaporta kur nevojitej, në disa raste i fshinte vulat e refuzimit të hyrjes në ndonjë kufi me qëllim që të mos krijohen dyshime te zyrtarët kufitar në kontrollet pasuese kufitare.

**C.1.5** – Individët e përmendur si migrantë (të kontrabanduar) në të gjitha pikat ishin individë që vinin në Kosovë për ta shfrytëzuar si shtet transit, pavarësisht se nuk ia kanë deklaruar këtë zyrtarëve kufitar apo madje t'ua deklarojnë të kundërtën autoriteteve, pasi që qëllimi ishte arritja te shtetet e treta, gjegjësisht shtetet e Bashkimit Europian, dhe të mos qëndrojnë për qëllimin e deklaruar, për vizitë apo punë në Kosovë, për periudhë kohore më të shkurtë apo më të gjatë.

**C.1.6.1** – Në disa raste, zyrtarët kufitar mashtroheshin rreth letrave të garancionit apo të ftesave, përmbajtja e të cilave ishte e rrejshme meqë nuk përkonte me faktet dhe përdorshin për t'i dhënë më shumë besueshmëri gënjeshtres që i është thënë zyrtarit kufitar, rreth qëllimit të hyrjes në Kosovë; në rastet tjera, dikush priste në aeroport me një tregim paraprakisht të dakorduar me migrantin që do t'i tregohej zyrtarit nëse do të pyetej për të konfirmuar ndonjë gjë.

---

<sup>30</sup> Jo 4.

<sup>31</sup> Për arsye sistematike, ky individ do të përmendet përsëri në pikën 8, në lidhje më të pandehurin T.Y.

<sup>32</sup> Për arsye sistematike, ky individ do të përmendet përsëri në pikën 8, në lidhje më të pandehurin T.Y.

**C.1.6.2** – Në rastet tjera zyrtarët, si në Kosovë dhe në shtetet tjera, gjegjësisht në IRJM dhe në Serbi, ishin të korruptuar dhe e dinin për paligjshmërinë në kalimet kufitare nga disa individë që kontrabandoheshin dhe i lejoheshin kalimet e paligjshme në përputhje me marrëveshjet që i kishin bërë me kontrabanduesit: çmimin, shumën e ryshfetit për migrantin e kontrabanduar – emrat e të cilëve ndonjëherë jepeshin paraprakisht. Së paku të pandehurit A.Ç., M.B., A.M., M.A. dhe A.B. ishin, në disa ngjarje specifike të kontrabandimit të migrantëve, jo vetëm në dijeni për këtë situatë por gjithashtu llogaritnin në të si pjesë të ekzekutimit të kontrabandimit.

**C.1.7** – Në përputhje me të lartcekurat: i pandehuri A.Ç. u angazhua në kontrabandimin e migrantëve duke vepruar si pjesëtar i një grupi duke organizuar dhe drejtuar aktivitetet e të tjerëve, dhe ai ishte i përfshirë në disa momente në kontrabandimin e 79 migrantëve<sup>33</sup>; i pandehuri M.B. u angazhua në kontrabandimin e migrantëve duke vepruar si pjesëtar i një grupi dhe ai ishte i përfshirë në 6<sup>34</sup> momente në kontrabandimin e 11 migrantëve; i pandehuri A.M. u angazhua në kontrabandimin e migrantëve duke vepruar si pjesëtar i një grupi dhe ai ishte i përfshirë në 7 momente në kontrabandimin e 11 migrantëve; i pandehuri A.B. u angazhua në kontrabandimin e migrantëve duke vepruar si pjesëtar i një grupi dhe ai ishte i përfshirë në 3 momente në kontrabandimin e 3 migrantëve; i pandehuri M.A. u angazhua në kontrabandimin e migrantëve duke vepruar si pjesëtar i një grupi dhe ai ishte i përfshirë në 2 momente në kontrabandimin e 2<sup>35</sup> migrantëve dhe i pandehuri I.P. u angazhua në kontrabandimin e migrantëve dhe ai ishte i përfshirë në 1 moment të kontrabandimit të 3 migrantëve<sup>36</sup>.

**C.1.8** – Pas veprimeve të përshkruara më lartë, të pandehurit kishin qëllimin e arritjes së dobisë financiare apo dobisë tjetër materiale nga hyrja e paligjshme e një personi në Republikën e Kosovës, ku personi i tillë nuk është Shtetas i Republikës së Kosovës, apo person i cili është shtetas i huaj në një Shtet ku personi i tillë nuk është banor i përhershëm apo shtetas i atij shteti dhe e ka ditur për paligjshmërinë e hyrjeve që ishin të bazuara në deklarata të rrejshme të dhëna zyrtarëve kufitar apo / dhe në disa raste me dijeni dhe bashkëkryerje aktive të të fundit, të gjithë

---

<sup>33</sup> Numri i momenteve (apo ngjarjeve, ose zgjidhjeve kriminale – që mund të jenë të ndryshëm nga numri i individëve të kontrabanduar, nëse në një ngjarje është më shumë se një migrant i kontrabanduar) lidhur me ata të pandehur që është relevant për njëkohshmërinë e veprave penale është konstatuar duke i pasur parasysh datat e veprimeve (gjegjësisht të vlerësuara nga datat e arritjes në Kosovë), itinerarin e përcjellë për t'u larguar nga Kosova dhe nëse ishin bërë aranzhime për një apo më shumë se një individ në atë kohë.

<sup>34</sup> Bazuar në *kriteret* posa të shpjeguara dhe në datat e shpjeguara në arsyetimin e fakteve të vërtetuara, ngjarjet që ndërlidhen me M.B.n ishin më 22/10/2012 (1 migrant), 29/11/2012 (1 migrant), 8/11/2012 (2 migrantë), 11/11/2012 (1 migrant), 16/11/2012 (5 migrantë) dhed 24/11/2012 (1 migrant); në lidhje me A.M.un ishin më 25/9/2012 (2 migrantë), 25/9/2012 (3 migrantë), 17/10/2012 (1 migrant), 23/10/2012 (1 migrant), 23/10/2012 (1 migrant), 27/10/2012 (1 migrant) dhe më 8/11/2012 (2 migrantë); në lidhje me M.A.in ishin më 24/11/2012 (1 migrant) dhe më 29/11/2012 (1 migrant) dhe në lidhje me A.B. ishin më 24/10/2012 (1 migrant), 13/11/2012 (1 migrant) dhe më 25/11/2012 (1 migrant).

<sup>35</sup> Meqë A.Bu. nuk përmendet në aktakuzë, përndryshe do të ishte A.Ç. 80, M.B. 12, A.B. 4, M.A. 3.

<sup>36</sup> Ndonëse nuk është përmendur në këtë pikë, i pandehuri A.G. ishte përfshirë në kontrabandimin e 1 migranti dhe i pandehuri T.Y. ishte përfshirë në kontrabandimin e 2 migrantëve (në 2 momente të ndryshme).

duke u përpjekur për t'iu mundësuar individëve të kontrabanduar një udhëtip për në shtetet tjera, gjegjësisht në Bashkimin Europian.

**C.1.9** – Të gjithë të bashkë-pandehurit tjerë në këtë lëndë e njihnin të pandehurin A.Ç., i pandehuri A.Ç. dhe të tjerët si M.B., A.M. dhe A.B. i njohnin të pandehurit të rasteve të ndërlidhura (si, për shembull, N.N. dhe O.Y.) dhe disa të pandehur të kësaj lëndë kishin kontakte ndërmjet tyre dhe bashkëpunonin në ngjarje të ndryshme të kontrabandimit të migrantëve. Në të vërtetë, nëse A.Ç. i njihnte të gjithë të bashkë-pandehurit, është e vërtetë se të pandehurit M.B., A.M., M.A. dhe A.B. ose po vepronin vetëm në bashkë-kryerje me individë të tjerë (përfshirë zyrtarë policor apo zyrtarë kufitar), por ndonjëherë vepronin së bashku, në ngjarje të ndryshme, duke qenë se është e mundshme të vërtetohet se të pandehurit e cekur e dinin rreth angazhimit në kontrabandimin e migrantëve dhe ishin në kontakt me së paku edhe 2 të pandehur, nga ta, edhe nëse në momente të ndryshme në kohë sa i përket ngjarjeve specifike të kontrabandimit të migrantëve.

**C.1.10** – Në ngjarjet e kontrabandimeve të përshkruara më lartë, i pandehuri A.Ç. kishte rol kyç në vendosjen se bashkëpunimi i kujt i nevojitet për një veprim të caktuar në një rast të caktuar, dhe rrjedhimisht për këtë qëllim ai kontaktonte me një apo më shumë të bashkë-pandehur, të cilët kryesisht angazhoheshin duke marrë pjesë në ngjarjet e cekura të kontrabandimit ose jo, nëse tashmë ishin të angazhuar në diçka tjetër apo nga një person tjetër. Përveç kontaktimit të bashkë-pandehurve të kësaj lënde, dhe organizimit të angazhimit përkatës, ai po ashtu kontaktonte individë që janë të pandehur në procedura të përafërta, si N.N., O.Y. dhe O.K., për shembull.

**C.10.1** – Të pandehurit A.Ç., M.B., A.M., M.A. dhe A.B. janë angazhuar në mënyra dhe detyra të ndryshme në ngjarje specifike, si për shembull i pandehuri A.Ç. kujdesej për rezervimet, letrat e garancive, ndërhyrjet në pasaporta kur nevojitej, por po ashtu shkante për t'i marrë migrantët dhe ndonjëherë i përcillte në nisjen e radhës, i pandehuri M.B. ndonjëherë organizonte udhëtime të migrantëve të tij (në të cilat ai po ashtu angazhonte anëtarë të familjes, gjegjësisht e dërgonte nënë e tij që të shkojë në aeroport për ta pritur një migrant), por njëkohësisht shkante për t'i marrë të tjerët. I pandehuri A.M. merrte pjesë në lëshimin e letrave të garancive por edhe për t'i marrë të migrantët. I pandehuri M.A. i kalonte informata A.Ç. për zyrtarët e korruptuar që do të ishin në detyrë por edhe shkante në aeroport për t'i marrë migrantët, dhe A.B. ose kalonte informata gjithashtu për policët e korruptuar por edhe planifikonte udhëtime, gjegjësisht në kontakt direkt me policët e korruptuar që t'ia jep emrin e migrantit që do të lejohet për ta kaluar kufirin.

**C.1.11** – Në kohën e fakteve, dhe sa i përket aktiviteteve profesionale të të pandehurve dhe të ardhurave mujore nga puna, mund të konstatohet si në vijim: i pandehuri A.M. punonte për një [kompani të quajtur] dhe kishte të ardhura mesatare prej 400/500 Eurove; i pandehuri M.A. punonte në rindërtimin e një xhamie në...dhe ka deklaruar të ardhura mesatare prej 200/1500 eurove, i pandehuri I.P. punonte si taksist he ka deklaruar të ardhura mesatare prej

250/300 eurove, T.Y. punonte në [restorantin] me rrogë prej 800 eurove dhe i pandehuri A.G. punonte si taksist, ai nuk ka deklaruar të ardhura mesatare.

**C.1.12** – Përveç se nuk ishte e mundshme të vërtetohet ndonjë aktivitet profesional në lidhje me të pandehurit A.Ç., M.B. dhe A.B., për gjykatën është po ashtu e njohur se:

**C.1.12.1** – Të pandehurit A.Ç., M.B., A.M., M.A., A.B., A.G. dhe T.Y. nuk kishin importuar asnjë mall në Kosovë<sup>37</sup>;

**C.1.12.2** – Të pandehurit A.Ç. (i cili nuk ka pasur as numër fiskal), M.B., A.M., M.A., A.B. dhe T.Y. nuk kishin biznes të regjistruar në Kosovë, pasi që vetëm të pandehurit I.P. dhe A.G. ishin të regjistruar si taksistë<sup>38</sup>.

**C.1.13** – Në lidhje me llogaritë bankare dhe transaksionet financiare<sup>39</sup>:

**C.1.13.1** – Të pandehurit A.Ç., A.B. dhe M.A. nuk kishin llogari bankare, nuk kishin kryer transaksione financiare (as në emrin e tyre, as me autorizim) në asnjë institucion financiar që operon në Kosovë si në vijim: RBKO – Raiffeisen Bank, PCB, ProCredit Bank, BpB Banka për Biznes, NLB Prishtina, BE – Banka Ekonomike, TEB – Turkish Economic Bank, BKT – Banka Kombetare Tregtare dhe DMTH LLC Money Gram.

**C.1.13.2** – I pandehuri M.B. e kishte një llogari në TEB – Turkish Economic Bank [nr], A.M. kishte një llogari në RBKO – Raiffeisen Bank [nr], I.P. kishte një llogari në RBKO – Raiffeisen Bank [nr] dhe e kishte edhe një llogari në ProCredit Bank [nr], A.G. kishte një llogari private në RBKO – Raiffeisen Bank [nr] dhe një llogari tjetër afariste [nr], ai po ashtu kishte një tjetër në BE Banka Ekonomike (74972 pa transaksione që nga [date]), një tjetër në TEB – Turkish Economic Bank [nr] dhe T.Y. e kishte një llogari në ProCredit Bank [nr] dhe një tjetër në TEB – Turkish Economic Bank [nr].

**C.1.13.3** – Të pandehurit në vijim kishin transaksione financiare përmes Unionit Financiar Prishtinë (Western Union): A.Ç., M.B., A.M., A.B., A.G. dhe T.Y..

**C.1.14** – Në atë kohë të pandehurit silleshin në mënyrën e përshtuar më lartë. Ata ishin në gjendje t'i kuptojnë dhe kontrollojnë veprimet e tyre, të cilat i dëshironin, duke e ditur se veprimet e tyre ishin të ndaluara dhe të ndëshkueshme me ligj. Në lidhje me të pandehurin A.G., dhe nëse nuk e ka ditur se veprimet e tij ishin të ndaluara dhe të ndëshkueshme me ligj, ai së paku ka qenë i vetëdijshëm se ka mund të ndodh një pasojë e ndaluar si rezultat i veprimeve të

---

<sup>37</sup> Sipas informatave nga Doganat e Kosovës / Ministria e Financave, të datës 28/02/2013, vetëm i pandehuri I.P. kishte importuar një veturë, Ford Fiesta (- shih raportin e Doganave të Kosovës / Ministrisë së Financave, të datës 28/02/2013 për 15 regjistratorët policor, regjistratori 11, fashikulli 10, f. 134/135).

<sup>38</sup> Sipas informatave nga Ministria për Tregti dhe Industri e Kosovës, të datës 20/02/2013, vetëm të pandehurit I.P. dhe A.G. kishin aktivitete të regjistruara [ ] dhe [ ] – shih raportin e MTI-së, të datës 20/02/2013 për 15 regjistratorët policor, regjistratori 11, fashikulli 11, f. 141/142).

<sup>39</sup> Sipas Raportit Përmbledhës të Hetimit Financiar Ref. Nr. 2011-DHKO-027/2013, të datës 11/04/2013, që gjendet në 15 regjistratorët policor, regjistratori 10, f. 1 deri 59).

veta dhe ai është pajtuar që ato të ndodhin. Ky i pandehur, megjithatë, më vonë i deklaroi të bashkë-pandehurit A.Ç. se nuk donte të kishte asgjë tjetër me të, pra ai nuk dëshironte të kryente ndonjë detyrë apo punë për të.

**C.1.15** – Përveç asaj që është thënë në lidhje me të A.G., të pandehurit tjerë gjithnjë i refuzonin akuzat, pretendonin se ishin viktima të kësaj procedure, asnjëherë nuk i pranonin faktet apo ndonjë paligjshmëri në veprimet e tyre dhe nuk shprehnin asnjë keqardhje.

**C.1.15.1** – Gjësendet e shënuara në aktakuzë që duhen konfiskuar janë përdorur në kryerjen e veprimeve të konstatuara më lartë.

#### **Faktet tjera të vërtetuara:**

#### **C.1.16 – Gjendjet personale të të pandehurve<sup>40</sup>**

**C.1.16.1 - A.Ç.:** Deklaroi se kishte një bashkë-partner në Turqi dhe një tjetër në Bosnjë dhe Hercegovinë; i ka 3 fëmijë (30 dhe 28 vjeç, që jetojnë në Turqi, dhe një tjetër 15 vjeç që jeton në Bosnjë dhe Hercegovinë). Deklaroi se ishte shitës dhe kishte të ardhura ndërmjet 2000 dhe 2500 eurove; ka 8 vite shkollim (shkolla e mesme) dhe gjendje mesatare financiare. Qëndrimi i A.Ç. në Kosovë në momentin e paraburgimit nuk ishte më në përputhje me ligjin në fuqi për të huajt, pasi që ai qëndroi në vend pas 90 ditëve fillestare.

**C.1.16.2 - M.B.:** I pandehuri është i martuar me... dhe ka dy fëmijë...e lindur më..., dhe..., i lindur më... Deklaroi se e ka kryer shkollën fillore (9 vite) dhe flet Shqip dhe Turqisht. Ai deklaroi se kurrë nuk ka pasur ndonjë profesion, se është i papunë dhe jeton nga mirëqenia sociale dhe ka gjendje të dobët ekonomike.

**C.1.16.3 - A.M.:** Deklaroi se është beqar dhe nuk ka fëmijë. Ai deklaroi se ka punuar në prodhimin e dyerve dhe dritareve ndërmjet viteve 2011 dhe 2012 në [fshatin], se e ka kryer shkollën fillore (8 vite) dhe se ka gjendje të dobët ekonomike. Ai flet Shqip dhe Turqisht.

**C.1.16.4 - M.A.:** Deklaroi se bashkëjeton me një partnere (qytetare e Kosovës) që nga viti 2008 dhe ka 1 fëmijë... Deklaroi se punon në ndërtimtari, ka kryer shkollën fillore (5 vite) dhe ka gjendje të dobët ekonomike. Ai jeton në Kosovë që nga viti... dhe nuk ka të afërm që jetojnë në Kosovë. Ai flet Turqisht.

**C.1.16.5 - A.B.:** Ai është i martuar me... që nga viti... dhe ka 3 fëmijë..., lindur përkatësisht më.... Deklaroi se ka punuar në ndërtimtari, ka kryer shkollën fillore dhe është i varfër. Ai flet Maqedonisht (dhe Serbo-Kroatisht), Turqisht, si dhe Anglisht dhe Gjermanisht në nivelin fillestar.

---

<sup>40</sup> Referenca fakteve të “deklaruara” është sepse provat e mirëfillta të dokumentuara asnjëherë nuk i janë bashkuar shkresave të lëndës (për shembull çertifikata martesore për gjendjen martesore, çertifikatat e lindjes për fëmijët, etj).



**C.1.16.6 - I.P.:** Ai është i martuar me...që nga viti...dhe ka 9 fëmijë..., të lindur përkatësisht më..., duke qenë se 3 të fundit janë fëmijë nën moshën 18 vjeçare. Ai tashmë nuk është taksist por bujk në tokën e vet; deklaroi se e ka kryer shkollën e mesme (12 vite shkollim) dhe ka gjendje të mesme ekonomike (sipas tij ai ka të ardhura mesatare prej 200 apo 300 eurove si bujk). Ai flet Shqip, Serbo-Kroatisht rrjedhshëm, dhe pak Anglisht e Gjermanisht.

**C.1.16.7 - A.G.:** Ai është i martuar me... dhe ka 3 fëmijë..., të lindur përkatësisht më... Ai është taksist, ka kryer shkollën fillore dhe ka gjendje të dobët ekonomike.

dhe

**C.1.16.8 - T.Y.:** Ai është i martuar dhe ka 1 fëmijë, Tamer T.Y., i lindur më 11/09/2011. Deklaroi se ka punuar në një qebaptore dhe aktualisht punon në restorantin “Extreme Pizza” me një rrogë prej 800 eurove (sipas kontratës të datës mars 2011); ka kryer shkollën fillore dhe ka gjendje të mesme ekonomike. Gjuha e tij amtarë është Turke, ndonëse ka disa vite që ai jeton në Kosovë.

#### **Më shumë fakte të vërtetuara:**

#### **C.1.17 – Dosjet penale**

Ka pasur kërkesa shtesë drejtuar IRJM-së (Kërkesa për BNJ dërguar Ministrisë së Drejtësisë në IRJ të Maqedonisë), lidhur me të pandehurin A.B., përmes Ministrisë së Drejtësisë, përfshirë më 9 nëntor 2015. Përgjigja, e datës 12/2/2016, është pranuar nga autoritetet e IRJM-së më 3/3/2016. Për shkak të disa paqartësive lidhur me përmbajtje janë kërkuar informata shtesë por ato nuk janë ofruar asnjëherë, prandaj nuk është e mundshme të vërtetohet dosja penale e të pandehurit A.B.<sup>41</sup>.

Ndërkaq në Kosovë, përgjigjet janë dhënë nga Gjykatat Themelore në Nëntor 2015:

Gjykata Themelore në Prishtinë ka ofruar informata lidhur me një dënim të mëparshëm të të pandehurit T.Y. (por në deklaratën e tij ai pretendoi se nuk ka pasur denime të mëparshme).

Gjykata Themelore në Gjilan ka ofruar informata lidhur me një dënim të mëparshëm të të pandehurit I.P..

Gjykata Themelore në Peja ka ofruar informata lidhur me një dënim të mëparshëm të të pandehurit I.P..

---

<sup>41</sup> Versioni në Anglisht i informatave të dhëna thotë si në vijim: “-Përmes Aktgjykimit K nr. 17/91 të datës 20/02/1991 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Kërçovës për shkak të veprës penale në kundërshtim me nenin 239 f. 3 në lidhje me nenin 243, e lexuar me paragrafin 4 nën Kodin Penal të Maqedonisë, gjoba: 5000. – përmes Aktgjykimit K nr. 873 /83 (jo 17/91 sikurse në përkthimin e parë në Anglisht) të datës 15/07/1983 të lëshuar nga Gjykata Komunale II G.S. Shkup për shkak të veprës penale në kundërshtim me nenin 239 f.3, në lidhje me nenin 243, e lexuar me paragrafin 4 nën Kodin Penal të Maqedonisë, gjoba: 13000”.

Gjykata Themelore në Mitrovicë ka ofruar informata lidhur me një rast të mëparshëm të të pandehurit M.B.<sup>42</sup>.

Gjykatat Themelore në Prizren<sup>43</sup>, Ferizaj dhe Gjakovë, kanë ofruar informata se asnjëri nga të pandehurit nuk ka qenë paraprakisht i dënuar në gjykata.

**C.1.17.1 - A.Ç.:** I pandehuri A.Ç. deklaroi se kurrë nuk është dënuar nga ndonjë gjykatë. Në Kosovë ai nuk ka dënime të mëparshme.

**C.1.17.2 - M.B.:** I pandehuri M.B. deklaroi se kurrë nuk është dënuar nga ndonjë gjykatë<sup>44</sup>. Në Kosovë ai nuk ka dënime të mëparshme.

**C.1.17.3 - A.M.:** I pandehuri A.M. deklaroi se kurrë nuk është dënuar nga ndonjë gjykatë. Në Kosovë ai nuk ka dënime të mëparshme.

**C.1.17.4 - M.A.:** I pandehuri M.A. deklaroi se kurrë nuk është dënuar nga ndonjë gjykatë. Në Kosovë ai nuk ka dënime të mëparshme.

**C.1.17.5 - A.B.:** I pandehuri A.B. deklaroi se kurrë nuk është dënuar nga ndonjë gjykatë përveç një gjobe për aksident trafiku para shumë viteve. Në Kosovë ai nuk ka dënime të mëparshme.

dhe

**C.1.17.6 - I.P.:** I pandehuri I.P.:

- Në Gjykatën Themelore të Gjilanit në lëndën me numër, PKR. nr. 56/2013, ai është dënuar për “kontrabandimin e migrantëve në tentativë”, në përputhje me nenin 170, paragrafi 1, neni 28, paragrafi 3 dhe neni 76, paragrafi 1, nën-paragrafi 4, i KPRK-së, me 1 (një) vit dhe 6 (gjashtë) muaj burgim dhe gjobë në shumën prej 200 € (dyqind euro); Akgjykimi i plotfuqishëm i Gjykatës së Apelit (PAKR 259/14) i datës 22 maj 2015.

---

<sup>42</sup> Lënda numër 21/07 Gjykata Themelore Mitrovicë, lidhur me veprën penale të falsifikimit të parave: nga të gjitha informatat e marrë nuk është e mundshme të konstatohet se lënda është përmbyllur me dënim të formës së prerë. Më 17/12/2015 Gjykata Themelore Mitrovicë më tej shpjegoi (pas kërkesës) se në atë kohë i pandehuri ishte i mitur dhe “kjo lëndë ndodhet në objektin e Prokurorisë Themelore të Mitrovicës – në pjesën veriore të qytetit dhe përveç kësaj, pas transferimit të lëndës, mund të kërkohet nga Prokuroria e cekur në lidhje me fazën dhe nëse është marrë ndonjë vendim lidhur me këtë lëndë” – më vonë, më 24 mars 2016, kjo gjykatë mori informatën se lënda ende po vazhdon.

<sup>43</sup> Lënda numër PKR 466/14 për veprën penale sipas nenit 138, paragrafi. 1, të KPRK-së, kundër të pandehurit M.B., është në pritje në Departamentin e Krimeve të Rënda në Prizren dhe ende nuk ka përfunduar.

<sup>44</sup> Sipas informatave lidhur me M.B.n të ofruara nga Gjykata Themelore në Prishtinë (“M.G.P. nga []), PKR. Nr. 466/14, kundër këtij personi është zhvilluar procedurë penale për veprën penale nga neni 138/1 i KPRK-së, dhe procedura po vazhdon në këtë lëndë që i është caktuar gjyqtarit Faik Hoxha”, kjo lëndë nuk po konsiderohet si dosje penale për shkak të prezumimit të pafajësisë, siç është shpjeguar më herët.

- Sipas Gjykatës Themelore të Pejës, P.nr. 10/2005, për veprën penale nga neni 328/2 (Pronësia, kontrolli, posedimi apo përdorimi i paautorizuar i armëve) ai është dënuar me gjobë prej 100 eurove; ky vendim u bo i plotfuqishëm më 15/02/2005.

Në P.nr. 119/2009, për veprën penale nga neni 328/2 (Pronësia, kontrolli, posedimi apo përdorimi i paautorizuar i armëve), ai është dënuar me një gjobë prej 225 eurove; vendimi u bë i formës së prerë më 27/03/2009<sup>45</sup>.

**C.1.17.7 - A.G.:** I pandehuri A.G. deklaroi se kurrë nuk është dënuar nga ndonjë gjykatë dhe

**C.1.17.8 - T.Y.:** I pandehuri pretendoi se nuk ka pasur dënime të mëparshme. Megjithatë, T.Y. në lëndën penale P. nr. 1345/11 (Gj.Th. Prishtinë), për veprën penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 153, par. 4.4, KPK, lidhur me nenin 24 të KPRK-së, është dënuar që të paguajë gjobë në shumë prej 200€, me aktgjykimin e plotfuqishëm të datës 08/01/2013. Me aktvendimin e datës 19/05/2015 për shkak të parashkrimit absolut, procedura është ndërprerë; ky aktvendim u bo i plotfuqishëm më 11/06/2015<sup>46</sup>.

**C.1.18 –** Situata e të pandehurve në lidhje me masat për sigurimin e pranisë së tyre në procedurë është si në vijim:

**C.1.18.1 - A.Ç.:** Ai është në paraburgim që nga 3 shkurti 2013.

**C.1.18.2 - M.B.:** Ai është në paraburgim që nga 13 dhjetori 2012.

**C.1.18.3 - A.M.:** Ai është në paraburgim që nga 13 dhjetori 2012.

**C.1.18.4 - M.A.:** Ai ka qenë në paraburgim që nga 24 janari 2013 deri më 12 prill 2016. Tani ai i është nënshtuar masës së paraqitjes në stacion policor dy herë në javë, së bashku me premtimin e mos fshehjes.

**C.1.18.5 - A.B.:** Ai është në paraburgim që nga 13 dhjetori 2012.

**C.1.18.6 - I.P.:** Ai ka qenë në paraburgim që nga 13 dhjetori 2012 deri më 12 qershor 2014.

Që nga 11 qershori ai është nën masën e paraqitjes në stacion policor dy herë në javë, së bashku me premtimin e mos fshehjes.

---

<sup>45</sup> Një pjesë e informatave për I.P.n e ofruar nga Gjykata Themelore e Pejës (“DKR.P.nr. 17/2014 për veprën penale nga neni 180/1 ku lënda është në procedurë (duke vazhduar)”) nuk po konsiderohet si vepër penale për shkak të prezumimit të pafajësisë.

<sup>46</sup> Në përputhje me përgjigjen e marrë nga Gjykata Themelore e Prishtinës më 17/12/2015 për qartësimin e kërkuar më 01/11/2015. Sa i përket të pandehurve tjerë, nuk ka të dhëna nga gjykatat themelore të Kosovës që vërtetojnë dënimet e mëparshme të të pandehurve. Nuk ka qenë e mundur të përcaktohet nëse ai ka qenë i dënuar më përpara apo pas fakteve që ndodhën në këtë lëndë.

**C.1.18.7 - A.G.:** I pandehuri është nën masën e paraqitjes në stacion policor një herë në javë, së bashku me premtimin e mos fshehjes, që nga 13 dhjetori 2012.

dhe

**C.1.18.8 - T.Y.:** I pandehuri është nën masën e paraqitjes në stacion policor një herë në javë, së bashku me premtimin e mos-fshehjes, që nga 13 dhjetori 2012.

**C.1.19** – Shtetësia e tanishme e të pandehurve është si në vijim: **A.Ç.n** është Turk [Pasaportë Turke nr.], **M.B.** është Kosovar, **A.M.** është Kosovar, **M.A.** është Turk [Patent shoferi Turk me numër], **A.B.** është Maqedon, shtetas e IRJ të Maqedonisë [Pasaportë e IRJ të Maqedonisë] dhe [letërnjoftimi nr.] **I.P.** është Kosovar, **A.G.** është Kosovar dhe **T.Y.** është Turk dhe Kosovar, [numri personal] (T.Y. është bërë shtetas i Republikës së Kosovës, [nr.], MPB–Prishtinë; pasaporta e Kosovës [nr.]).

## **C.2 Faktet që nuk janë vërtetuar<sup>47</sup>**

### **Pika 1 (duke përdorur formulimin e saktë të përmendur në aktakuzë):**

**C.2.1** –Nuk është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit<sup>48</sup> **A.Ç., M.B., A.M., A.B., I.P. dhe M.A.** i kanë kryer veprat për të cilat janë akuzuar, gjegjësisht, nuk është vërtetuar se ata (dhe tani duke e cituar aktakuzën) “Në periudhën në mes 1 Tetorit 2010 dhe 3 Shkurtit 2013 A.Ç.; në periudhën në mes të 6 Prillit 2011 dhe 13 Dhjetorit 2012 M.B.; në mes të 28 qershorit 2011 dhe 13 dhjetorit 2012 A.M.; në mes të 4 Nëntorit 2010 dhe 13 Dhjetorit 2013 A.B.; në mes të 5 Tetorit 2012 dhe 13 Dhjetorit 2013 I.P.; dhe në mes të 21 Qershorit 2012 dhe 24 Janarit 2013 M.A.; në territorin e Kosovës kanë kryer veprën penale krim të organizuar duke

(1) Organizuar, mbikëqyrur, menaxhuar apo drejtuar aktivitetet e një grupi të organizuar kriminal të përbërë nga O.K., C.K., E.K., L.K., O.Y., B.F., F.A., A.Ç., M.B., A.M., A.B., I.P., M.A., S.S., A.G., T.Y., N.N., “N.”, S.M., M.M., S.I., M.C., S.P-M., M.Me., I.H., M.H. (“B.”), T.H., S.B., N.P., Z.G., M.Ca., Z.M., G.N., A.V., K.V., N.H., H.M., K.H., A.By., S.A., R.V., G.B., A.Al., A.Br., B.E., D.M., T.Ha., M.Br., D.S., A.S., E.S., M.Ma., R.A., O.S., A.C., H.Y., M.O., O.Sa., I.B., M.T., M.G., H.G., M.I., H.H., H.Ha., J.Z. [llagap I.]N.K., “I.?” (mbiemri i panjohur), “E.?” (mbiemri i panjohur), “A.?” (mbiemri i panjohur), “B.?” (mbiemri i panjohur), personin me nofkën “K.”, personi me nofkën “A.P.”, personi me nofkën “T.” personi me nofkën “L.”, personi me nofkën “Ar.”, personi me nofkën “D.” dhe kryerës të tjerë të pidentifikuar; (2) Kanë kryer një vepër të rëndë penale, përkatësisht kontrabandim me migrantë, duke qenë pjesë e një grupi të organizuar kriminal të përbërë nga O.Y., B.F., F.A., A.Ç., M.B., A.M., A.B., I.P., M.A., S.S., A.G., T.Y., N.N., “N.”, S.M., M.M., S.I., M.C., S.P-

<sup>47</sup> Në lidhje me pikat 1 dhe 2 të kopjuara në tërësi nga aktakuza, ky njoftim bëhet sepse një pjesë e fakteve të përmendura në ato pika po ashtu janë pjesë e pikave tjera dhe janë vërtetuar në kontekste të tilla, sikurse u cek më lartë.

<sup>48</sup> Sikurse u tha, pa paragjykim ndaj fakteve tjera të vërtetuara në pikat tjera dhe pa paragjykim ndaj faktit se as nuk është vërtetuar që I.P. po vepronte si pjesëtari i një grupi.

M., M.Me., I.H., M.H. ("B."), T.H., S.B., N.P., Z.G., M.Ca., Z.M., G.N., A.V., K.V., N.H., H.M., K.H., A.By., S.A., R.V., G.B., A.Al., A.Br., B.E., D.M., T.Ha., M.Br., D.S., A.S., E.S., M.Ma., R.A., O.S., A.C., H.Y., M.O., O.Sa., I.B., M.T., M.G., H.G., M.I., H.H., H.Ha., J.Z. [llagap I.], N.K., "I.?" (mbiemri i panjohur), "E.?" (mbiemri i panjohur), "A.?" (mbiemri i panjohur), "B.?" (mbiemri i panjohur), personin me nofkën "K.", personi me nofkën "A.P.", personi me nofkën "T.", personi me nofkën "L.", personi me nofkën "Ar.", personi me nofkën "D." dhe kryerës të tjerë të pidentifikuar dhe ose; dhe/ose (3) Kanë marrë pjesë aktive në aktivitete kriminale apo të tjera të grupit të përmendur të organizuar kriminal duke e ditur se pjesëmarrja e tyre do të kontribuonte në kryerjen e veprave të përmendura të rënda penale nga grupi; me qëllim të përfitimit direkt apo indirekt financiar apo tjetër material".

## **Pika 2 (duke përdorur formulimin e saktë të përmendur në aktakuzë):**

**C.2.2** – Nuk është dëshmuar se të pandehurit<sup>49</sup> **A.G. dhe T.Y.** i kanë kryer veprat për të cilat janë akuzuar, gjegjësisht, nuk është vërtetuar se ata "ndërmjet 17 gushtit 2012 dhe 13 dhjetorit 2012, A.G.; dhe ndërmjet 7 nëntorit 2012 dhe 13 dhjetorit 2012, T.Y.; në territorin e Kosovës, kanë kryer veprën e Pjesëmarrjes në Krim të Organizuar duke : (1) Kryer krim të rëndë kryesisht duke Kontrabanduar me migrant, si pjesë e një grupi kriminal të organizuar e që përbëhej nga: O.A., B.F., F.A., A.Ç., M.B., A.M., A.B., I.P., M.A., S.S., A.G., T.Y., N.N., "N.", S.M., M.M., S.I., M.C., S.P-M., M.Me., I.H., M.H. ("B."), T.H., S.B., N.P., Z.G., M.Ca., Z.M., G.N., A.V., K.V., N.H., H.M., K.H., A.By., S.A., R.V., G.B., A.Al., A.Br., B.E., D.M., T.Ha., M.Br., D.S., A.S., E.S., M.Ma., R.A., O.S., A.C., H.Y., M.O., O.Sa., I.B., M.T., M.G., H.G., M.I., H.H., H.Ha., J.Z. [llagap I.], N.K., "I.?" (mbiemri i panjohur), "E.?" (mbiemri i panjohur), "A.?" (mbiemri i panjohur), "B.?" (mbiemri i panjohur), personin me nofkën "K.", personi me nofkën "A.P.", personi me nofkën "T.", personi me nofkën "L.", personi me nofkën "Ar.", personi me nofkën "D." dhe kryerës të tjerë të pidentifikuar dhe ose; dhe/ose (2) Duke qenë pjesë aktive e veprimeve kriminale të grupit kriminal të organizuar e që përbëhej nga: O.Y., B.F., F.A., A.Ç., M.B., A.M., A.B., I.P., M.A., S.S., A.G., T.Y., N.N., "N.", S.M., M.M., S.I., M.C., S.P-M., M.Me., I.H., M.H. ("B."), T.H., S.B., N.P., Z.G., M.Ca., Z.M., G.N., A.V., K.V., N.H., H.M., K.H., A.By., S.A., R.V., G.B., A.Al., A.Br., B.E., D.M., T.Ha., M.Br., D.S., A.S., E.S., M.Ma., R.A., O.S., A.C., H.Y., M.O., O.Sa., I.B., M.T., M.G., H.G., M.I., H.H., H.Ha., J.Z. [llagap I.], N.K., "I.?" (mbiemri i panjohur), "E.?" (mbiemri i panjohur), "A.?" (mbiemri i panjohur), "B.?" (mbiemri i panjohur), personin me nofkën "K.", personi me nofkën "A.P.", personi me nofkën "T.", personi me nofkën "L.", personi me nofkën "Ar.", personi me nofkën "D." dhe kryerës të tjerë të pidentifikuar duke e ditur që pjesëmarrja e tyre do kontribuoj në kryerjen e veprës së rëndë penale dhe; me qëllim të përfitimeve direkte apo indirekte financiare, apo përfitime tjera materiale".

---

<sup>49</sup> Pa paragjykim ndaj fakteve tjera të vërtetuara dhe që ndërlidhen me pikat tjera, gjegjësisht fakti se nuk është vërtetuar së pari se këta dy të pandehur po vepronin si pjesëtarë të një grupi dhe *a fortiori* si pjesëtarë të një grupi të organizuar kriminal.

### **Pika 3 (duke përdorur formulimin e saktë të përmednur në Aktakuzë):**

**C.2.3** Nuk është vërtetuar se “A.Ç. dhe A.B. (...) ndërmjet 25 qershorit 2011 dhe 14 dhjetorit 2011, A.Ç. dhe A.B. në territorin e Kosovës, Serbisë, Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të zi, Kroacisë, Sllovenisë, Italisë, Austrisë, Gjermanisë, dhe/ose shteteve tjera, kanë kryer veprën penale të kontrabandimit me migrantë duke bërë kontrabandimin; sigurimin dhe ofrimin e dokumenteve të rreme të udhëtimit apo letërnjoftime të rreme për të mundësuar kontrabandim për përfitim financiar apo tjetër material; dhe mundësimin e personave që nuk janë qytetarë të Kosovës të hyjnë apo të qëndrojnë në Kosovë, apo persona që nuk janë vendorë apo qytetarë të përhershëm të kalojnë kufirin pa respektuar rregullat për hyrje të ligjshme, dhe të qëndrojnë në shtetin në fjalë pa përmbushur kërkesat e nevojshme ligjore për të qëndruar me anë të mjeteve të përmendura më parë apo me mjete të tjera të paligjshme; dhe mbi të gjitha, me organizimin dhe drejtimin e personave të tjerë për të kryer të njëjtat veprime për migrantët si në vijim:

(1) -H.D., F.Y., A.S.Z. (prej 25/6/2011 deri më 06/07/2011).

(2) -S.Ar. dhe Personi me nofkën T.T. (prej 19/10/2011 deri më 23/10/2011).

(3) -M.S., R.S. dhe A.Sa. (prej 01/10/2011 deri më 07/10/2011).

(4) - Z.A. dhe O.Y. (prej 01/10/2011 deri më 17/11/2011).

(5) - Kontrabandimin e 4 migrantëve të paligjshëm Turk, të paidentifikuar nga Turqia nëpërmjet Malit të Zi dhe Serbisë në Gjermani (prej 17/11/2011 deri më 20/11/2011).

(6) -Y.D., B.H.O. (prej 20/11/2011 deri më 28/11/2011) dhe H.Da. dhe M.So. (prej 20/11/2011 deri më 28/11/2011).

(7) -”Il.” [dhe një familje të përbërë nga një nënë dhe 5 fëmijë, dhe një migrant Turk të quajtur F.U. (prej 28/11/2011 deri më 06/12/2011)].

(8) - M.Bu., A.K., B.B., Serhat or Serkan, F.T., “M.” (mbiemri i panjohur), “Sel.” (mbiemri i panjohur), E.U., M.E., familje prej 3 anëtarësh, M.Ar., E.A., M.Y., A.U., R.T., S.D. dhe një person tjetër i paidentifikuar (prej 18 gushtit 2011 deri më 3 dhjetor 2011)”.

### **Pikat 4 (duke përdorur formulimin e saktë të përmednur në Aktakuzë):**

**C.2.4** – Nuk është vërtetuar se “A.Ç. (...) Në mes të datave 5 tetor 2011 dhe 9 tetor 2011, A.Ç., në territorin e Kosovës, ka kryer veprën penale të kontrabandimit me migrantë duke bërë kontrabandimin, sigurimin dhe ofrimin e dokumenteve të rreme të udhëtimit apo letërnjoftime të rreme për të mundësuar kontrabandim për përfitim financiar apo tjetër material dhe mundësimin e personave që nuk janë qytetarë të Kosovës të hyjnë apo të qëndrojnë në Kosovë apo persona që nuk janë vendorë apo qytetarë të përhershëm të kalojnë kufirin pa respektuar rregullat për hyrje të ligjshme dhe të qëndrojnë në shtetin në fjalë pa përmbushur kërkesat e nevojshme ligjore për

të qëndruar me anë të mjeteve të përmendura më parë apo me mjete të tjera të paligjshme dhe mbi të gjitha, me organizimin dhe drejtimin e personave të tjerë për të kryer të njëjtat veprime për migrantët si në vijim:

(1) Tre migrantë që pretendohet se kanë udhëtuar ndërmjet 5 tetorit 2011 dhe 9 tetorit 2011: A.E., M.Er. dhe A.Er.”.

#### **Pika 5:**

**C.2.5** – Nuk është vërtetuar kontrabandimi i këtyre migrantëve: në paragrafin (3) A.Se. dhe S.Baj., në paragrafin (5) G.Ba. dhe në paragrafin (7) nuk është vërtetuar se (tani duke kopjuar nga aktakuza): “Në mes të 21 qershorit 2012 dhe 2 dhjetorit 2012 tentim për të kontrabanduar apo për t’iu mundësuar 59 personave që nuk janë vendorë apo qytetarë të përhershëm apo që ndryshe nuk lejohen në mënyrë ligjore të qëndrojnë në shtete tjera respektivisht personave me origjinë turke apo siriane që nga Turqia nëpërmes Serbisë, Kosovës, IRJ të Maqedonisë, Malit të Zi, Kroacisë dhe/apo Bosnje Hercegovinës të hyjnë në Slloveni, Itali, Hungari, Gjermani dhe/ose Austri”.

#### **Pika 8:**

**C.2.6** –Në pikën 8 nuk është vërtetuar nëse përveç prokurimit dhe angazhimit, gjegjësisht duke i kontaktuar udhëtarët dhe duke iu dhënë informata lidhur me aranzhimet e udhëtimit, nëse i pandehuri ka siguruar dhe letra të garancive.

#### **Pika 9 (duke përdorur formulimin e saktë të përmednur në Aktakuzë):**

**C.2.7** – “A.Ç., M.B., A.M. dhe A.B. (...) ndërmjet 6 prillit 2011 dhe 13 dhjetorit 2012, M.B.; ndërmjet 28 qershorit 2011 dhe 13 dhjetorit 2012, A.M.; ndërmjet 4 nëntor 2010 dhe 13 dhjetorit 2013, A.B.; në territorin e Kosovës dhe Shteteve tjera ka kryer veprën penale të pastrimit të parave, duke e ditur apo duke pasur shkak për të ditur se disa prona, respektivisht para të gatshme apo mjete të tjera monetare kanë origjinë të aktiviteteve kriminale dhe se në fakt burojnë nga vepra penale (kontrabandim me migrantë nga ana e anëtarëve të grupit kriminal)”.

#### **C.3 – Arsyetimi i vendimit mbi faktet e vërtetuara dhe jo të vërtetuara:**

Arsyetimi nuk ka për qëllim të jetë përsëritje e materialit të provave, funksioni i tij është ta mundësojë të kuptuarit e vendimit lidhur me vërtetimin ose jo të fakteve.

Fillimisht, ne do t’i bëjmë disa vërejtje të përgjithshme mbi secilin lloj të provës dhe pastaj do të bëhen edhe disa referime specifike për secilin fakt, apo së paku për grumbuj faktesh.

Rreth sferës së arsytimit, ne e citojmë këtu nenin për të Drejtën në Gjykim të Drejtë të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (Neni 6 GjEDN)<sup>50</sup> “ ‘Arsyetimi i vendimeve gjyqësore’ – Sipas praktikës juridike që reflekton një parim të lidhur me ndarjen e duhur të drejtësisë, aktgjykimet e gjykatave dhe tribunaleve duhet t’i shpalosin qartë arsyet mbi të cilat ato bazohen (*Papon kundër Francës*). Vendimet e arsyetuara i shërbejnë qëllimit të demonstrimit palëve se ata janë dëgjuar, duke kontribuar kështu në një pranim më të gatshëm të vendimit nga ana e tyre. Përveç kësaj, ato i obligojnë gjyqtarët që ta bazojnë arsyetimin e tyre në argumentet objektive si dhe t’i ruajnë të drejtat e mbrojtjes. Megjithatë, shkalla e detyrës për të dhënë arsyetim ndryshon sipas natyrës së vendimit dhe duhet të përcaktohet në aspektin e rrethanave të rastit (*Ruiz Torija kundër Spanjës*, § 29). **Ndonëse gjykatat nuk janë të obliguara të japin përgjigje të hollësishme për secilin argument të ngritur** (*Van de Hurk kundër Holandës*, § 61), **duhet të jetë e qartë nga vendimi se janë trajtuar çështjet thelbësore të rastit** (shih *Boldea kundër Rumunisë*, § 30). Gjykatat kombëtare duhet t’i cekin me **qartësi të mjaftueshme bazat në të cilat i bazojnë vendimet e tyre** me qëllim që t’i mundësohet një palë ndërgjyqëse që t’i ushtrojë të drejtat për ankesë (*Hadjianastassiou kundër Greqisë*; dhe *Boldea kundër Rumunisë*) [**theksi i shtuar**]<sup>51</sup>.

E “vërteta”, cilado që është, mund të mos përputhet me të “vërtetën gjyqësore”, “me fjalë tjera, e vërteta gjyqësore bazohet në vërtetimin e saktë të fakteve relevante dhe vërtetimi i saktë qëndron në *prova* dhe *dëshmi*; për të pasur një vendim të mirë gjyqësor, çdo gjykatë duhet ta ketë një mënyrë të mirë të përdorimit të provave me qëllim të gjetjes dhe provimit të fakteve të vërteta”<sup>52</sup>. Të gjitha faktet e vërtetuara duhet të dëshmojnë përtej dyshimit të arsyeshëm<sup>53</sup>, nëse jo, *non liquet* në kuptim të provave dhe dëshmive do të jetë e dobishme për të pandehurin, *in dubio pro reo*, sepse i pandehuri prezumohet si i pafajshëm.

Në lidhje me deklaratat e personave që janë marrë në pyetje si dëshmitarë, dhe kanë mbetur të tillë gjatë gjykimit, atëherë ligji parasheh rastet kur deklaratat e mëparshme të dëshmitarit mund të shqyrtohen për shkak se, si rregull, të gjitha provat duhet të paraqiten gjatë shqyrtimit gjyqësor, si pasojë e nenit 361 të KPPK-së, par. 1. “As deklaratat e mëparshme të dëshmitarit nuk mund të përdoren si provë e drejtpërdrejtë, ato mund të përdorur vetëm për të konfrontuar (Neni 123, par. 2, KPPK) dhe për të marrë në pyetje të tërthortë (par. 3). Ky është rregulli. Përrjashtimet janë nëse dëshmitari ka vdekur, është i sëmurë apo e përdor privilegjin e mungesës së pranisë në Kosovë (par. 3, in fine) apo nëse është mundësi e veçantë hetimore (par.

<sup>50</sup> Në dispozicion në [http://www.echr.coe.int/Documents/Guide\\_Art\\_6\\_criminal\\_ENG.pdf](http://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_criminal_ENG.pdf), p.21.

<sup>51</sup> Po ashtu për arsyetimin e vendimeve shih faqen. 21 të Udhëzimit “E Drejta për Gjykim të Drejtë, Neni 6 i GjEDN-së”. Neni është në dispozicion në [http://www.echr.coe.int/Documents/Guide\\_Art\\_6\\_criminal\\_ENG.pdf](http://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_criminal_ENG.pdf)

<sup>52</sup> Artikulli nga Rrjeti Europian për Trajnim Gjyqësor, në <http://ëëë.ejtn.eu/Documents/Themis/Ërritten%20paper%20Italia/Themis%20ëritten%20paper%20Romania%202.pdf> p.1.

<sup>53</sup> “Kur i analizon provat në anën substanciale të nenit 2 dhe 3, Gjykata e Strasburgut udhëhiqet nga parimi i provimit “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”. Megjithatë, konkludimi i fajësisë mund të burojë nga bashkë-ekzistimi i konkluzioneve mjaftueshëm të forta, të qarta dhe të përputhshme apo të prezumimeve të ngjashme jo të refuzuara të fakteve, si në nenin 2, dhe në nenin 3, gjegjësisht rezultat i provave të tërthorta”. *Ibidem*, f. 16 dhe 17.



4)”. Një situatë e paqartë mund të ndodh nëse gjatë gjykimit dëshmitari pretendon se ai qëndron prapa deklaratave të mëparshme që i ka dhënë ... Edhe në atë rast, kjo duhet të shmanget, gjykata ende duhet t'i ndjek kriteret ligjore të posa përmendura dhe duhet ta përdor shqyrtimin gjyqësor që ta pyes dëshmitarin çka mund të jetë relevante dhe çdo mospërputhje do të vlerësohet lirshëm nga trupi gjyqësor.

Në lidhje me deklaratat paraprake të dhëna nga të pandehurit, të gjitha janë dhënë në atë cilësi, që në atë kohë<sup>54</sup>. Në çdo lloj deklaratë duhet të kontrollohet nëse janë zbatuar obligimet formale gjatë kohës që është dhënë deklarata, për të siguruar që të merret parasysh nga gjykata në mënyrë ligjore nëse janë plotësuar obligimet tjera (p.sh. neni 261, par. 2, lexuar së bashku me nenin 123, par. 2, KPPK); në qoftë se gjykata i përdor deklaratat e mëparshme për ta arsyetuar vendimin e saj, gjykata duhet gjithnjë të kontrollojë nëse në çdo kohë kur është dhënë deklarata janë zbatuar dispozitat procedurale në fuqi.

Formalitetet që duhen zbatuar janë ato në fuqi në kohën kur personi merret në pyetje, sikurse parashihet me ligjin në fuqi në atë kohë (kjo si pasojë e parimit *tempus regit actum* – dhe po ashtu e cekur nga Gjykata e Apelit në aktvendimin e datës 10/12/2013 në lëndën PN 577/2013, f. 14, “ligjshmëria e një veprimi hetimor gjithnjë duhet të përcaktohet kundrejt rregullave procedurale në fuqi në kohën kur është kryer veprimi hetimor”).

Në këtë rast të veçantë, nuk ka deklarata nga të pandehurit që janë dhënë në cilësi tjetër, të gjitha deklaratat janë dhënë në cilësi të të pandehurit, janë zbatuar dispozitat ligjore në fuqi për të pandehurit, neni 231, par. 2, pika 2, gjegjësisht “para marrjes në pyetje të të pandehurit, qoftë i paraburgosur apo në liri, ai duhet të informohet për (...) të drejtën e heshtjes dhe mos dhënies së përgjigjeve ndaj pyetjeve, përveç për të dhënë informata rreth identitetit të tij”; për më tepër, par. 4 thotë se (i pandehuri ka) “të drejtë që të merr ndihmën e një avokati mbrojtës dhe të konsultohet me të para dhe gjatë marrjes në pyetje”.

Në lëndën e tanishme, ku janë zbatuar të gjitha formalitetet, duhet të vlerësohet nëse dëshmia është e pranueshme kundër vet atyre si të pandehur dhe po ashtu për të

---

<sup>54</sup> Sikurse ndodh ndonjëherë, dikush që është bërë i pandehur i referohet deklaratave të mëparshme (“deklarata e të pandehurit”), pavarësisht faktit se vet deklarata në atë kohë ishte dhënë në një cilësi tjetër, p.sh si dëshmitar. Në lidhje me deklaratat e dhëna në cilësinë e dëshmitarit i cili më vonë u bo i pandehur, ato nuk mund të konsiderohen prova të pranueshme pasi si “deklaratat e mëparshme të një dëshmitari”, sepse ai person nuk është më dëshmitar, dhe nuk mund të konsiderohet si “deklarata e mëparshme të të pandehurit” – pasi që në atë kohë personi nuk është marrë në pyetje në atë cilësi dhe, prandaj, të drejtat e parapara me ligj, dhe të respektuara, kanë qenë të ndryshme. Kjo nuk kundërshtohet me dispozitën e nenit 123, par.5, KPPK.: “Deklaratat e dhëna nga i pandehuri në çfarëdo konteksti, nëse janë dhënë në mënyrë vullnetare dhe pa shtrëngim, janë prova të pranueshme gjatë shqyrtimit kryesor kundër të pandehurit, por jo edhe kundër të bashkëpandehurve. Deklaratat e tilla nuk mund të shërbejnë si provë e vetme fajësuese apo vendimtare për dënimin e të pandehurit”. Në këtë dispozitë është e palogjikshme të kuptohet se hera e parë që fjala “i pandehur” përdoret ka të bëjë jo me vet individin, por me cilësinë në të cilën individi ka deklaruar. Kjo dispozitë e fundit, ku thotë “po jo të bashkëpandehurit” përkon me arsyetimin prapa normës së dhënë në nenin 126, par. 1.1.3, KPPK., “(...) mund të mos merren në pyetje si dëshmitares (...) bashkëpandehur ndërsa zhvillohen procedura të përbashkëta” – a fortiori, do të thoshim, nëse procedurat janë të njëjta (megjithatë është jurisprudenca e mbrojtjes në Gjykatën e Apelit që mund të përdoret edhe lidhur me të bashkëpandehurit).

bashkëpandehurit, dhe kjo duhet të bëhet në përputhje me rregullat e provave që janë përfshirë në Kodin (e ri) të Procedurës Penale të Kosovës, në përputhje me nenin 541, par. 1, KPPK. Në rast të tillë, nenet 261, 262 dhe 123 së bashku me nenet 125 (dhe 151 deri 155) dhe 132 KPPK i caktojnë rregullat.

Një gjë që duhet të merret parasysh në procesin e vendim-marrjes është grumbulli i provave që janë pranuar, administruar, dhe që nuk janë refuzuar *ab initio* apo përjashtuar me ndonjë aktvendim, por është gjë tjetër se deri në çfarë shkallë gjykata to ta shqyrtojë, diskutojë dhe vlerësojë secilën provë; deri në çfarë mase do ta vlerësojë gjykata vlerën e saj provuese; deri në çfarë mase do ta konsiderojë gjykata si formë e pranueshme e provës për të vërtetuar ose jo një fakt të caktuar. Duke lexuar nenin 361, par. 1, të KPPK-së, ne shohim se “Gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor”, që do të thotë në njërin anë provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor dhe, në anën tjetër, provat që nuk janë refuzuar apo përjashtuar. Paragrafi i dytë i nenit të njëjtë jo vetëm që e qartëson kuptimin e paragrafit 1 por po ashtu konfirmon atë që jemi duke e thënë, duke cekur se “Gjykata detyrohet që me ndërgjegje të vlerësojë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar”.

Rreth vlerësimit të deklaratave të mëparshme, është po ashtu me rëndësi të merret në konsideratë neni 123, par. 5, i KPPK-së., ku ligjvënësi e i ka zgjedhur fjalët “deklaratat nga i pandehuri” (pa thënë që kur...*ab initio*, nga fillimi i hetimeve apo vetën në një fazë të mëvonshme) dhe po ashtu ka theksuar se këto deklarata mund të jenë dhënë në “çdo kontekst”. Sa i përket fjalisë së dytë të paragrafit, po ashtu mund të themi se njëra nga parimet themelore të interpretimit juridik është se ligjvënësi ka ditur si të shpreh; në fakt, ligjvënësi ka thënë “(...) janë të pranueshme gjatë shqyrtimit kryesor kundër të pandehurit, **por jo edhe kundër të bashkëpandehurve**”, **dhe nuk ka thënë** “(...) janë të pranueshme gjatë shqyrtimit gjyqësor kundër të **pandehurit dhe të bashkëpandehurit**” [**theksi i shtuar**]. Fjalja e fundit mund të lexohet si kriter, një udhëzim që duhet të ndiqet nga gjykata në vlerësimin e provave (duke konsideruar madje edhe parimin e mbrojtjes kundër vet-inkriminit) në lidhje me atë të pandehur konkret, “*Deklaratat e tilla nuk mund të shërbejnë si provë e vetme fajësuese apo vendimtare për dënimin e të pandehurit*”.

Sa i përket deklaratave të mëparshme të dhëna nga një i pandehur tashmë në atë cilësi, atëherë ne duhet t’i shqyrtojmë situatat e ndryshme që mund të ndodhin.

Megjithatë, para kësaj, është po ashtu me rëndësi të bëhet dallimi ndërmjet provave që janë pranuar, administruar dhe si janë vlerësuar si prova, vlera e tyre provuese, si pasojë e nenit 260, para. 2 dhe 3, KPPK.

Deklaratat e mëparshme nga një i pandehur, siç e kupton trupi gjykues, do të varen përfundimisht në atë nëse i pandehuri, gjatë shqyrtimit gjyqësor, ku paraqiten të gjitha provat, siç u tha tashmë, vendos ta deklarojë rastin e tij, pra nëse i pandehuri vendos të heshtë ose jo<sup>55</sup>.

Sidoqoftë, dhe në lidhje me të bashkëpandehurit, vlera provuese e deklaratave të tilla tashmë është përmendu, përgjigja ishte se ajo nuk mund të shqyrtohet.

Pavarësisht referencave që tashmë i janë bërë kësaj çështjeje, tani është koha të adresohet vet deklaratat e të pandehurit, natyrisht duke supozuar se është marrë në përputhje me ligjin (sipas nenit 261, par. 1, KPPK.).

Sipas kësaj norme të fundit, neni 261, par. 1, KPPK, “*Deklarimi i të pandehurit dhënë policisë ose prokurorit të shtetit mund të jetë provë e pranueshme në gjykatë vetëm kur është marrë në pajtim me dispozitat e nenit (...). Deklaratat e tilla mund të përdoren për ta kundërshtuar deklarin e të pandehurit në gjyq ose si provë e drejtpërdrejtë në pajtim me nenin 262 paragrafi 2. të këtij Kodi*” [theksi i shtuar]. Në anën tjetër, neni 262, par. 2, KPPK, thotë “*Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare deklaramit të dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit të shtetit*”. Në fund, neni 346, par. 1, KPPK, thekson “*I akuzuari ka të drejtë që të mos deklarojë. Nëse ai zgjedh që të deklarojë (...)*”.

Kjo na sjell te thelbi, te vlera provuese (për arsyetimin e fakteve të vërtetuara) e deklaratave të mëparshme nga një i pandehur: varet në atë nëse i akuzuari deklarohe ose jo në shqyrtim gjyqësor, ku paraqiten të gjitha provat, neni 361. par. 1, KPPK.

Nëse i pandehuri në shqyrtimet gjyqësore zgjedh të deklarojë, të dëshmojë, deklaratat e tij të mëparshme mund të përdoren për ta konfrontuar dëshminë e tij dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Nëse ai zgjedh të mos dëshmojë, të mos deklarojë, atëherë deklaratat e mëparshme nuk mund të përdoren, së paku nuk mund të përdoren në dëm të të pandehurit<sup>56</sup>.

Trupi gjykues vëren se neni 261, par. 1, KPPK., thotë “*për ta kundërshtuar deklarin e të pandehurit në gjyq ose si provë e drejtpërdrejtë në pajtim me nenin 262 paragrafi 2*” (“Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë ose duke i

---

<sup>55</sup> “Sa i përket “të drejtës për heshtje” ajo mund të kuptohet në kontekst të gjerë apo të ngushtë. Kuptimi i gjerë i referohet të drejtës së të akuzuarit që të mos dëmtohet në bazë të heshtjes së tij; në këtë koncept, e drejta përmban disa pasoja ndër të cilat është e drejta për mos-inkriminim të vetes. Sipas kuptimit të ngushtë, e drejta e heshtjes i referohet të drejtës së personit që heshtja e tij të mos merret parasysh në mënyrë të pafavorshme nga gjykata gjatë vlerësimit të akuzave kundër tij apo në caktimin e dënimit të tij”. Artikull nga Rrjeti Europian për Trajnim Gjyqësor, në <http://www.ejtn.eu/Documents/Themis/Written%20paper%20Italie/Themis%20ëritten%20paper%20Romania%20.pdf> p.9.

<sup>56</sup> Ku kuptim nuk është unanim në jurisprudencë, kryesisht për shkak të faktit se norma i referohet “ose si provë e drejtpërdrejtë”, siç do të shohim – por kësaj mund t’i shtohet se në asnjë rrethanë paqartësia e ligjit nuk mund të interpretohet në dëm të të pandehurit.

dhënë rëndësi vendimtare deklarimit të dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit të shtetit”) por kjo na çon te thelbi i problemit.

Ndonëse ligjvënësi ka theksuar se si “provë e drejtpërdrejtë” (që përputhet me nenin 123, par. 5, KPPK) ajo nuk mund të përdoret për ta shpallur të akuzuarin fajtor vetëm apo në shkallë vendimtare, ligjvënësi nuk ka thënë shprehimisht se kjo nuk vlen për rastet ku i pandehuri vendos që të mos dëshmojë gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Ky trup gjykues është i mendimit se nëse i pandehuri nuk dëshmon në shqyrtimin gjyqësor, deklaratat e tij të mëparshme nuk mund të përdoren, e aq më pak në dëm të tij.

Është më rëndësi të theksohen këto:

- Madje as deklaratat e mëparshme të dëshmitarëve nuk mund të përdoren si provë e drejtpërdrejtë; ato vetëm mund të përdoren për të konfrontuar (neni 123, par. 2) dhe për të marrë në pyetje të tërthortë (par. 3). Ky është rregulli. Përjashtimet janë nëse dëshmitari ka vdekur, është i sëmundjes apo shfrytëzon privilegjin e mungesës së pranisë përbrenda Kosovës (par. 3, *in fine*) apo nëse është mundësi e veçantë hetimore (par. 4).

Prandaj, nuk do të ishte e arsyeshme të kuptohet se ligjvënësi ka dashur t’i jep vlerë më të lartë provuese (dhe me më të “lartë” nënkuptohet “me më pak obligime për t’u përdorur ligjërisht”) deklaratave të mëparshme të një të pandehuri (sipas përkufizimit, i prezumuar i pafajshëm), sesa deklaratave të dhëna nga një dëshmitar.

Pavarësisht respektit për opinionet e ndryshme, një interpretim apo konkludim tjetër në këtë drejtim mund ta zbraz vlerën e vendosjes për të qëndruar në heshtje vetëm në shqyrtimin gjyqësor; për këtë arsye të gjitha provat duhet të paraqiten në shqyrtimin gjyqësor dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të pandehurit janë të fundit kur vjen të paraqitja e provave, gjegjësisht të dëshmojnë ose jo (dhe “jo” është duke qëndruar në heshtje).

- Njëra ndër parimet kryesore të së drejtës penale është se në rast të paqartësisë, interpretimi duhet të bëhet në dobi të të pandehurit; ndonëse ne nuk po e diskutojmë të drejtën penale materiale. Është më rëndësi të konsiderohet njëra nga dimensionet e parimit të ligjshmërisë (neni 2, par. 3, i KPK-së thotë “Përkufizimi i një veprë penale duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi sipas analogjisë. **Në rast paqartësie, përkufizimi i veprës penale interpretohet në favor të personit i cili hetohet,**”) [theksi i shtuar]; nuk shohim arsye që të marrim qëndrim tjetër apo qasje kur të diskutojmë të drejtën procedurale, një normë procedurale.

Nëse ka dyshime, atëherë neni 3, par. 2, KPPK, i qartëson ato: “(...) **mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës**” [theksi i shtuar]. Paqartësia e përmendur e

ligjvënësit, mos-adresimi shprehimisht i rastit kur i pandehuri vendos që të mos dëshmojë në shqyrtim gjyqësor<sup>57</sup>, dhe duke e futur në dispozitë që fillon me “deklaratat e tilla mund të përdoren për ta konfrontuar dëshminë e të pandehurit në gjykatë” e çuan trupin gjykues që ta qartësojë interpretimin e saj të ligjit në mënyrën e cekur: deklaratat e mëparshme të nga një i pandehur nuk janë të pranueshme në qoftë se i pandehuri shfrytëzon të drejtën që të qëndrojë në heshtje gjatë shqyrtimit gjyqësor – dhe i pandehuri prezumohet i pafajshëm deri kur shpallja e dënimit nga gjykata bëhet i formës së prerë<sup>58</sup>.

Në rastin tonë konkret, të gjithë të pandehurit megjithatë vendosën të deklarojnë, të japin dëshmi, gjë që e përjashton çështjen që sapo u trajtua pasi që deklaratat e cekura janë përdorur ligjërisht gjatë marrjes në pyetje të tërthortë të të pandehurve. Këto deklarata janë prova shtesë që do të përdoren në vlerësimin e përgjithshëm të të gjitha provave (“gjykata e bazon aktgjykimin e saj vetëm në faktet dhe provat e proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor” – neni 361, par. 1, KPPK), provat që janë përmbledhur për ta formuar bindjen e gjykatës, në përputhje me nenin 361 KPPK (baza e aktgjykimit), par. 2: “gjykata detyrohet që me ndërjegje të vlerësojë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar”.

### **Dokumentet:**

Të gjitha dokumentet relevante për procesin e marrjes së vendimit janë konsideruar së bashku me diskutimin, gjykata nuk do t'i trajtojë një nga një pasi që nuk nevojitet, por disa do t'i bëhen referenca ndonjë dokumenti specifik apo disa dokumenteve kur konsiderohet e domosdoshme, vetëm deri në atë masë.

Po ashtu, disa nga faktet e provuara janë vet-shpjeguese dhe disa fakte i shpjegojnë tjera.

Gjendja martesore dhe fëmijët e të pandehurve janë konstatuar bazuar vetëm në provat e dokumentuara dhe e njëjta ka ndodhur me të kaluarën e tyre penale. Në rastet ku nuk ka qenë e

---

<sup>57</sup> Sikurse ndodh në shtetet tjera, për shembull, në Portugali [(ku deklaratat e mëparshme mund të merren parasysh vetëm nëse i pandehuri është paralajmëruar paraprakisht se nëse ai apo jo deklarohet gjatë fazës hetimore, ai deklarim mund të përdoret kundër tij ose saj përfshirë në rastin e shfrytëzimit të së drejtës për të qëndruar në heshtje gjatë shqyrtimit gjyqësor); për shembull dispozita e nenit 141, par.4, pika b, e Kodit të Procedurës Penale, sipas së cilës i pandehuri njoftohet se në qoftë se ai apo ajo deklarohet, deklaratat e tij/saj mund të përdoren në shqyrtim gjyqësor edhe nëse ai apo ajo vendos të qëndrojë në heshtje].

<sup>58</sup> “Sa i përket prezumimit të pafajësisë, siç ceket në nenin 6 § 2 të Konventës, është parim i *shenjtë* i secilit sistem juridik të bazuar në parimin e sundimit të ligjit dhe përkthehet në idenë se një person i akuzuar për kryerje të një akti të natyrës penale konsiderohet i pafajshëm deri në momentin e shpallje së fajësisë. Ky prezumim obligon, *inter alia*, që kur i kryen detyrat, gjykata nuk duhet të fillojë me idenë e para-formuar se i akuzuar i ka kryer veprat për të cilat është akuzuar. **Në atë mënyrë, barra e provës është mbi prokurorinë dhe çdo dyshim duhet të shkojë në dobi të të akuzuarit [theksi i shtuar].** Artikulli nga Rrjeti i Europian i Trajnimit Juridike, në <http://www.ejtn.eu/Documents/Themis/Written%20paper%20Italie/Themis%20written%20paper%20Romania%2020.pdf> p.10.

mundur t'i kemi dokumentet relevante të paraqitura, atëherë gjykata ka bërë qartësimin se ka qenë përmbajtja që ata kishin thënë<sup>59</sup>.

Në këtë fazë, ne do t'i përmendim disa nga dokumentet të cilave gjykata i jep rëndësi më të madhe: raporti i bazuar në sistemin e menaxhimit të kufirit (shpesh i përmendur si raporti i SMK-së) ku janë futur të dhënat lidhur me individët (përkatësisht ata të përmendur në aktakuzë si migrantë) që hyjnë dhe dalin nga Kosova, përfshirë referencat se cila pikë kufitare është përdorur, data dhe koha, emri, lloji i dokumentit të udhëtimit që është paraqitur, etj. Raportet e vëzhgimeve, raportet për bastisjet e kryera dhe gjërat e sekuestruara gjatë bastisjeve në shtëpi, raportet për analizat e përgjimeve (telefonatat dhe mesazhet tekstuale) dhe regjistri i transaksioneve monetare lidhur me të pandehurit (dhe individët tjerë); pa i përjashtuar të tjerat, këto ishin provat e dokumentuara që meritojnë theks të veçantë për vlerësimin e gjykatës.

Referencat specifike fragmenteve të të gjitha këtyre raporteve janë bërë hollësisht në seancat e shqyrtimit gjyqësor, së bashku me marrjen në pyetje edhe të dëshmitarëve edhe marrjen në pyetje (të ndërthurtë) të të pandehurve; nëse është e vërtetë se një praktikë e tillë në një rënë anë mund të konsiderohet se merr shumë kohë<sup>60</sup>, është po ashtu e vërtetë se në një rënë anë siguron që gjykimi është zhvilluar në përputhje me rregullat, gjegjësisht se provat janë vlerësuar gjatë shqyrtimit gjyqësor<sup>61</sup>. Kjo, së bashku me përkthimin simultan, gjithashtu iu mundëson të pandehurve që t'i vlerësojnë provat vet kur ato paraqiten dhe iu lejon që ta përgatitin qëndrimin e tyre në lidhje me to<sup>62</sup>.

Çështja e përkthimit me shkrim dhe me gojë po ashtu meriton disa fjalë. Të pandehurit nuk e kanë të drejtën e zgjedhjes së përkthyesve. Deri në masën që ka qenë e mundur, gjykata është përpjekur t'ua përmbush kërkesën e tyre për përkthyesin e gjuhës Turke që ata e preferonin, kjo pavarësisht faktit se njëri që përkthente më shpesh është i akredituar në gjykatën e Prizreni si përkthyes me gojë. Po ashtu, të pandehurit, A.Ç. më shumë se dy herë, theksuan se nuk kuptonin si dëshmitarët që nuk flasin Turqish (për shembull, M.J. dhe V.I.) kanë mundur ta thonë atë që e kanë thënë gjatë gjyqimit, pasi që ata nuk kanë mundur t'i kuptojnë bisedat e përgjuara... Ndonëse është e kontestueshme, ky lloj argumenti meriton të trajtohet. Gjykata përsëri thekson se ekzistojnë transkriptet e përgjimeve dhe këtë transkripte janë përkthyer dhe shpesh ka pasur përkthime të drejtpërdrejta të përgjimeve me qëllim që hetuesit të mund të

---

<sup>59</sup> Që mund të përkojë me realitetin ose jo.

<sup>60</sup> Në kohën e arsyeshme për ndërprerjen e procedurës dhe kompleksiteti i procedurës, shih f. 32 të Udhëzimit "E drejta për një gjykim të drejtë, neni 6 i GjEDN-së". Artikulli është në [http://www.echr.coe.int/Documents/Guide\\_Art\\_6\\_criminal\\_ENG.pdf](http://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_criminal_ENG.pdf)

<sup>61</sup> Në këtë drejtim, shih f. 20 of the Udhëzimit "E drejta për një gjykim të drejtë, neni 6 i GjEDN-së", për dëgjimin kundërshtues kundrejt kohëzgjatjes së procedurës, në kuptimin që prova duhet të trajtohet dhe ekzaminohet gjatë gjyqimit. Ky artikull është në [http://www.echr.coe.int/Documents/Guide\\_Art\\_6\\_criminal\\_ENG.pdf](http://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_criminal_ENG.pdf)

<sup>62</sup> Dhe kjo është kyçe, sepse sikurse ka theksuar i pandehuri A.Ç., ka pasur raste kur përkthimet e procesverbaleve ishin gati vetëm pas përfundimit të ekzaminimit të një dëshmitari të veçantë, duke pretenduar se nuk ka mundur të përgatitet si duhet për marrje në pyetje të tërthortë. Megjithatë, meqë në atë kohë iu shpjegua dëshmitarëve se ata kishin përkthim simultan dhe prandaj ai argument nuk ishte valid.

veprojnë në mënyrë adekuate, pra të vendosin nëse duhet të caktohet një ekip vëzhgues. Kjo është e qartë, por përsëri, është shpjeguar disa herë.

Po ashtu, provat janë përkthyer deri në atë masë sa që GJEDN-ja mund ta konsiderojë të panevojshme, megjithatë, gjykata ka vendosur në këtë drejtim në atë mënyrë që është më e drejtë nga aspekti i parimit të barazisë së palëve<sup>63</sup>.

Në fakt, duke pasur parasysh mënyrën që provat janë paraqitur gjatë shqyrtimit gjyqësor<sup>64</sup> ne mund të themi se të gjitha provat relevante janë trajtuar gjatë seancave, gjegjësisht përgjimet (disa prej tyre *fjalë për fjalë*, disa tjera të përmbledhura), dhe e njëjta me transkriptet e mesazheve tekstuale.

Në këtë rast, po ashtu vlen të ceket se **të gjithë të pandehurit janë deklaruar rreth çështjes dhe kanë konfirmuar përdorimin e telefonave, numrave të telefonave, dhe emailat që sipas prokurorisë ishin të tyre**<sup>65</sup>; përveç kësaj, duke vlerësuar përputhjen ndërmjet provave qartëson çdo dyshim të mundshëm, për shembull, nëse në raportin e analizës së bisedave nga një telefon disa biseda i janë caktuar të pandehurve specifik dhe pas këtyre bisedave ata takoheshin diku, dhe më vonë në raportin e vëzhgimit të aktiviteteve (në disa raste të dokumentuara me foto) theksohet se këta individë janë parë te vendi i përmendur në bisedën e mëhershme, kështu që është e logjikshme të konkludohet përtej dyshimit të arsyeshëm se këta individë ishin ata që e kishin pasur bisedën e cekur.

E njëjta logjikë vlen për situatat/faktet tjera, kur bëhen aranzhimet për udhëtimin e dikujt dhe pastaj një person me emrin e njëjtë apo dokumentin e njëjtë të identifikimit (apo edhe me të dhëna tjera, si data e lindjes) në të vërtetë udhëton, hynë, apo del nga kufijtë e Kosovës.

Siç u tha, të pandehurit konfirmuan përdorimin e numrave të telefonit dhe emailave të përmendur në aktakuzë dhe të gjitha provat e lexuara së bashku, në mënyrën e shpjeguar, i kanë mundësuar gjykatës që të vendos rreth fakteve që duhen vërtetuar. Kjo po përmendet si pjesë substanciale e provave në këtë rast dhe raste të ngjashme meqë përbëhet nga regjistrat e përgjimeve dhe ato vetëm mund të paraqesin vështirësi për ta argumentuar një vendim, pasi që dikush mund të thotë që bisedat rreth fakteve kriminale nuk janë vepra penale në vetvete, dhe se ajo duhet të argumentohet me diçka tjetër.

---

<sup>63</sup> Për më shumë shënime jurisprudente në lidhje me përkthimet me shkrim dhe ato me gojë, shih f. 38 *et seq.* (pikat 232, 247, 251, 252 deri 254, 256) dhe f. 51 *et seq.* (pikat 335, 339 deri 341) të Udhëzimit të cekur, Udhëzimi “E drejta për një gjykim të drejtë, neni 6 i GjEDN-së”. Artikulli mund të shikohet në [http://www.echr.coe.int/Documents/Guide\\_Art\\_6\\_criminal\\_ENG.pdf](http://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_criminal_ENG.pdf)

<sup>64</sup> Sikurse u tha në arsyetimin e aktvendimit të lëshuar në kohën e dëgjimit fillestar, rreth “kërkesave” që të gjitha provat të shtypen dhe të dërgohen, dhe të mos dorëzohen në format elektronik, ligji vetëm obligon që të gjitha provat të zbulohen por nuk thotë se ato duhet të shtypen, prandaj ato mund të jenë edhe në format elektronik.

<sup>65</sup> Përrjashtim i bërë njërit prej numrave të telefonit të cekur si ende në përdorim për M.B., sikurse u shpjegua.

Në fund, është thelbësore të përmendet se askush nuk i ka kontestuar në asnjë kohë (prandaj edhe në kohën e duhur për t'i kundërshtuar provat) as përgjimet as transkriptet e tyre – siç theksoi prokuroria në deklaratat e veta përmbyllëse dhe gjykata kurrë nuk ka refuzuar ndonjë kërkesë që të lëshohet ndonjë incizim specifik, dhe gjykata e thotë këtë sepse avokati mbrojtës i të pandehurit A.G. deklaroi në deklaratat e tij përmbyllëse se provë janë incizimet, jo transkriptet.

### **Dëshmitarët:**

Dispozitat e nenit 330 KPPK kryesisht trajtojnë marrjen në pyetje të dëshmitarëve. Asnjëri nga të pandehurit nuk ka propozuar dëshmitarë dhe marrja në pyetje e dëshmitarëve të propozuar nga prokuroria është zhvilluar në përputhje me dispozitat në fuqi, gjegjësisht sipas nenit 332 *et seq.* KPPK.

Dëshmitarët e ekzaminuar janë<sup>66</sup>:

- M.J. (Zyrtare Policore e EULEX-it), “udhëheqëse e rastit për këtë lëndë, të quajtur PINK, në vitin 2011, kur filluan hetimet. Unë jam emëruar në këtë lëndë në maj të vitit 2011 May dhe qëndrova si udhëheqëse e rastit deri në maj të vitit 2013. Ne e hetuam këtë rast në formë të ekipit të përbashkët hetimor dhe udhëheqës i rastit për Policinë e Kosovës ishte K.G.” – faqe 4 oe procesverbalit të datës 11/09/2014).

- V.C. (Zyrtar Policor i EULEX-it në IPCU – zyra për bashkëpunim ndërkombëtar - “udhëheqës i ekipit të Njësisë për Hetimin e Krimit të Organizuar), “Unë jam informuar nga secili udhëheqës i rastit rreth përmbajtjes së secilit hetim. Pra, udhëheqësja e rastit M.J. ma tregoi një kërkesë për NJN, është shkurtësë për Ndhimë Juridike Ndërkombëtare që i është drejtuar PSRK-së nga autoritetet Sllovene. Ky NJN erdhi në Njësinë për Hetimin e Krimit të Organizuar në korrik të vitit 2011; më këtë NJN, prokuroria Sllovene kërkoi që PSRK-ja të hap një lëndë dhe t’iu ndihmojë autoriteteve Sllovene në një rast të kontrabandimit të migrantëve nga Kosova për në Slloveni. (...) Ka qenë një Ekip i Përbashkët Hetimor me Policinë e Kosovës, në veçanti me departamentin e Krimit të Organizuar të Policisë së Kosovës” – faqe 8 të procesverbalit të datës 31 tetor 2014).

- V.I.<sup>67</sup> (Inspektor Policor – Aktualisht punon në EULEX – Zyra për Hetimin e Krimeve të Rënda), “Unë jam caktuar në këtë lëndë të quajtur PINK në vitin 2011, si hetues. Në të njëjtin

---

<sup>66</sup> Në kllapa ne do ta citojmë përgjigjen kryesore të dhënë nga secili dëshmitar në lidhje me atë se si ata kishin njohuri për faktet e diskutuara në gjykim, si ata kishin marrë pjesë në hetimin që çoi në aktakuzë.

<sup>67</sup> Aktvendimi për pranimin e propozimit të paraqitur nga PSRK-ja më 2/2/2014, që i kërkon gjykatës që ky dëshmitar të merret në pyetje, është lëshuar më 19/6/2014, bazuar në faktin se dëshmitari në ndërkohë ishte kthyer në Kosovë dhe sipas prokurorisë ky dëshmitar ishte i vetmi i cili ka mundur që më hollësisht ta trajtojë analizën e rezultateve të regjistrimit dhe analizën e telefonave dhe kompjuterëve të sekuestruar gjatë bastisjeve. Propozimi është aprovuar në bazë të nenit 288 paragrafi 2 i KPPK-së, duke i lejuar dëshmitarit V.I. që të jep dëshmi në shqyrtimin gjyqësor pasi që dëshmitari kishte qenë jashtë vendit dhe nuk ishte në dispozicion deri në atë datë, dhe nuk do ta dyfishonte një dëshmitar tjetër në mënyrë të konsiderueshme. Është konsideruar fakti se ai është hetues



vit, unë jam emëruar si zëvendës udhëheqës i rastit dhe më vonë kur kolegja ime – M.J. – nga Sllovenia u largua, unë u bërë udhëheqës i rastit. Kontributi im në këtë hetim është mjaft heterogjen. Ne vazhdimisht jemi në kontakt me homologët, Policinë e Kosovës, meqë ky ishte operacion i përbashkët. Detyra ime ishte të jem në kontakt me ta në baza ditore dhe t'i analizojë telefonatat që i kishim në hetim. Në hetim, ndër strategjitë që i kishim, ne kemi pasur masa të fshehta si përgjimi i telefonatave. Pra në këtë fazë të hetimeve, njëra ndër detyrat e mia ishte t'i analizojë dhe t'i paraqes në zyrën e prokurorisë raportet 15 ditore, së bashku me zyrtarët e policisë së Kosovës” – faqe 5 të procesverbalit të datës 24/11/2014.

- K.G. (Policia e Kosovës, Drejtoria kundër Krimit të Organizuar, Prishtinë, “në vitin 2010 u zhvillua një hetim për krim të organizuar lidhur me kontrabandimin e migrantëve, kryesisht nga Turqia dhe Siria, ndërsa njëri nga të dyshuarit në këtë rast, i quajtur O.Y., dyshohej se jetonte në Kosove i angazuar në vepra kriminale, kryesisht në kontrabandimin e migrantëve. (...) Ishte formuar një ekip i përbashkët me Policinë e Kosovës dhe Policinë e EULEX-it, dhe unë u emërova si hetues nga Policia e Kosovës dhe M.J. fillimisht ishte emëruar nga Policia e EULEX-it. Në atë letër shkruante se O.Y. duhej të identifikohet dhe të gjendej vendbanimi i tij. Ne i filluam hetimit kundër këtij personi dhe e gjetëm përmes metodave operacionale policore (...) Unë jam mbikëqyrës i një ekipi i përbërë nga 6 - 7 hetues policor” – faqe 4 e procesverbalit të datës 6 maj 2015).

- A.R. (në kohën e hetimeve): “ushtrues detyre i Udhëheqësit të Ekipit në Njësinë e Hetimit të Krimit të Organizuar” – faqe 4 e procesverbalit të datës 16 qershor 2015.

- Y.J. (Policë hetues në Njësinë e Hetimit të Krimit të Organizuar në Pristinë), “roli im ishte përgjimi i telefonatave dhe vrojtimi në disa raste kur ekipi vëzhgues nuk ka qenë në dispozicion (...) Kam marrë pjesë në vëzhgime (...) në disa raste (...). Gjatë përgjimeve (...) ato që janë relevante për rastin, ne e morëm transkriptin. (...) Ne ishim pesë polic hetues që merremi me hetim dhe ne të gjithë i kemi bërë transkriptet e përgjimeve” – faqet 3 dhe 4 të procesverbalit të datës 15 korrik 2015.

Dëshmitarja M.J. është ekzaminuar më 11 shtator 2014, 24 shtator 2014, 25 shtator 2014, 15 tetor 2014 dhe më 10 nëntor 2014; dëshmitari V.C. është ekzaminuar më 31 tetor 2014 dhe më 03 nëntor 2014; dëshmitari V.I. më 24 nëntor 2014, 02 dhjetor 2014, 03 dhjetor 2014, 09 dhjetor 2014, 10 dhjetor 2014, 16 dhjetor 2014, 22 janar 2015, 28 janar 2015, 09 shkurt 2015, 10 shkurt 2015, 16 mars 2015, 19 mars 2015, 15 prill 2015, 20 prill 2015, 28 prill 2015, 1 shtator 2015 dhe më 22 shtator 2015; dëshmitari K.G. është ekzaminuar më 06 maj 2015, 08 maj 2015, 12 maj 2015, 13 maj 2015, 18 maj 2015 dhe më 20 maj 2015; dëshmitari A.R. është ekzaminuar

---

policor me përvojë dhe ka mundur t'i jep gjykatës prova dhe opinione lidhur me çështjet për të cilat ai ka njohuri dhe përvojë. Mundësia e dhënies së një dëshmie të tillë në shqyrtim gjyqësor është konsideruar relevante meqë do të jepte një shpjegim të dobishëm për provat voluminoze të dokumentuara në shkresat e lëndës sa i përket roleve të të pandehurve në faktet që diskutohen në shqyrtim gjyqësor.

më 16 qershor 2015, 17 qershor 2015 dhe më 14 korrik 2015; në fund, dëshmitari Y.J. është ekzaminuar më 15 korrik 2015.

Siç u përmend më herët, shumë dokumente dhe fragmente të raporteve të ndryshme vazhdimisht paraqiteshin nga prokuroria dëshmitarëve; kjo është bërë në përputhje me nenet 333, par. 3, dhe 336 KPPK.

Është thelbësore të tërhiqet vëmendja në faktin se edhe hetimi edhe shkresat e lëndës janë voluminoze, jo vetëm për shkak të numrit të të dyshuarve, të pandehurve të mëvonshëm, por edhe për shkak të periudhës kohore që hetimi ka zgjatur dhe aktivitetet e kryera nga të hetuarit – që ndikon në shumë individë dhe përfshinë mbledhjen e të dhënave të llojeve të ndryshme. Në këtë kontekst, dëshmitarët janë marrë në pyetje rreth të dhënave në raportet e ndryshme: SMK (sistemi i menaxhimit të kufijve), raporti për përgjimin e komunikimeve me rrjet kompjuterik (për shembull analiza e emailave të A.Ç. dhe A.M.ut), raportet për vëzhgimin e fshehtë fotografik dhe video (për shembull për A.Ç., A.M., M.B., M.A., A.G.), raportet për përgjimin e komunikimeve (të gjithë të pandehurit dhe të tjerët, edhe telefonatat dhe mesazhet tekstuale), raportet për regjistrimin e telefonatave dhe zbulimin e të dhënave financiare. Dëshmitarët po ashtu janë pyetur, ndër tjera, rreth operacionet e tyre të përgjithshme, metodologjinë e përdorur, rreth zhvillimit të hetimeve, si janë bashkërenduar veprimet hetimore dhe rreth relevancës së përgjimeve të drejtpërdrejta me përkthim – meqë do të mundësonte përcjelljen e aktiviteteve në kohë reale dhe dërgimin e ekipeve vëzhguese në pikë takimi në aeroport, për shembull, kur konsiderohet e domosdoshme.

Nëse metodologjia e përdorur dhe e lejuar nga gjykata (që parashihet me ligj, nuk ka nevojë të thuhet) mund të konsiderohet, siç u tha më parë, që merr kohë, përveç përparësive që janë përmendur më herët dhe e theksojmë tani se kjo vijë e procedimit po ashtu mundësoi shpjegimin se si u zhvillua hetimi dhe si dhe pse janë krijuar provat e ndryshme (në përputhje me nenin 336, par. 3, KPPK), sikurse në rastin e raporteve të vëzhguese pas përgjimeve të drejta dhe vërtetimit reciprok të të dhënave që ndodhen në raportin e përpiluar të SMK-së dhe të dhënave të shkëmbyera me mesazhe tekstuale, për shembull, si emrat dhe datat e lindjeve gjegjëse.

Tani është koha për disa fjalë në lidhje me faktet që nuk janë vërtetuar.

Faktet e pavërtetuara janë vetëm “të pavërtetuara” dhe “të pavërtetuara” do të thotë se nuk ka qenë e mundur të vërtetohen, pasi që nga aspekti juridik nuk do të thotë se ato nuk kanë ndodhur. Të gjitha faktet e përmendura në aktakuzë dhe që nuk konsiderohen të vërtetuara nuk janë të vërtetuara (edhe pse shumica e tyre do të trajtohen individualisht).

Përveç kritereve, parimeve dhe shpjegimeve të dhëna më lartë, gjykata tani do të ofrojë arsyetime lidhur me secilin emër të përmendur në **pikat e akuzës 3, 4, 5, 6 dhe 8** si migrantë të kontrabanduar nga të pandehurit.

Pikat **1, 2** dhe **9** do të trajtohen më vonë<sup>68</sup>.

Në secilën prej pikave me numër **3, 4, 5, 6** dhe **8** gjykata do të jep më shumë hollësi për secilin emër dhe pse kontrabandimi i secilit individit është vërtetuar ose jo, duke pasur parasysh gjithçka tashmë të deklaruar në lidhje me vlerësimin e provave të ndryshme.

### **Pika 3:**

Nuk është e mundur të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit në këtë lëndë kanë kryer kontrabandimin e (pretenduar) të migrantëve të identifikuar (dhe të paidentifikuar) në këtë pikë të akuzës.

Arsyetimi i kësaj pikë shkon nga faqe 29 deri në faqen 37 të aktakuzës; arsyetimi i cekur pothuajse ekskluzivisht i trajton të pandehurit në procedurat tjera, gjegjësisht O.Y., B.F., F.A. dhe N.N.

Janë disa referenca për individët që janë të pandehur në këtë lëndë, gjegjësisht për A.Ç. dhe A.B., për shembull në lidhje me personat që pretendohet se janë kontrabanduar në nëntor 2011: B.H.O., Y.D., H.Da., M.So., “Il.” dhe F.U. (paragrafët 5 deri 7 të pikës 3).

Asnjëri nga këta individë nuk është përmendur në raportin e SMK-së (është një individ me mbiemrin “U.” por këtij i referohet në periudhën shtator 2012, jo 2011 – periudha kohore që përmendet në pikën e akuzës).

Po ashtu, raporti financiar për të pandehurit nuk jep prova relevante për qëllimin nën konsiderim dhe që ndërlidhet me individët e përmendur më lartë: në lidhje me A.B., duke i shikuar transaksionet në vitin 2011 (f. 15 të raportit financiar të datës 11/4/2013) asnjëra nuk mundëson që të konsiderohet se mund të ndërlidhen me akuzën, sa i përket A.Ç., në f. 4 të raportit të njëjtë është një depozitë prej 900 Eurove, të dërguara nga një “U.” (F.U.A.) por, përveç se që nuk dihet nëse është F.U.i që e përmend Prokuoria, data e transaksionit ishte 4 shkurt 2011 ndërkaq akuza e përmend nëntorin 2011. Po ashtu, për shkak të referimit letrave të pretenduara të ftesave nga A.Ç. për individët “Il.” dhe “U.”, trupi gjykues thotë se nuk ka qenë në gjendje t’i gjejë ato dokumente.

Në lidhje me individët e përmendur në këtë pikë, trupi gjykues nuk ka gjetur prova, siç u tha, që t’i mundësojë trupit gjykues t’i vërtetojë faktet relevante, përtej dyshimit të arsyeshëm, për të mos përmendur se në lidhje me shumë emra nuk ka pasur asnjë provë që ka mundur të konsiderohet (lidhur me të pandehurit në këtë lëndë).

---

<sup>68</sup> Gjithashtu për shkak se në disa raste ka dallim të qartë ndërmjet fakteve dhe ligjit, në raste tjerë dallimi nuk është aq i qartë, meqë faktet janë të përfshira me vet “*aktgjykimet me vlerë juridike*” – që deri në një masë të madhe, është rasti me shumicën e “fakteve” relevante për pikat 1, 2 (për veprat penale të krimit të organizuar dhe pjesëmarrjes në krim të organizuar) dhe 9 (për veprën penale të pastrimit të parave).

Për 2 bisedat e përgjuara ndërmjet A.B. dhe O.A. më 17/11/2012, në orën 16.03 dhe 16.10., përmbajtjet e atyre bisedave rreth “pagesave që duhen bërë nga djemtë” nuk i mundëson këtij trupi gjykues të konkludojë përtej dyshimit të arsyeshëm se ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e fakteve që përbëjnë një veprë penale, dhe e njëjta vlen për bisedën e A.Ç. (duke përdorur telefonin që mbaron me 818 por ende i paidentifikuar atëherë) kur atë e thirri O.A. më 20/11/2012 në orën 14.55, pasi që për këtë trup gjykues vet biseda, edhe pse është për këshilla se si të kryhet një veprë penale, një bisedë për një aktivitet të supozuar kriminal, nuk mund të konsiderohet në vete si përbërëse e veprës penale, pasi që nuk është e mjaftueshme për ta konsideruar se bie nën konceptet e ndihmës apo bashkë-kryerjes...

Megjithatë, trupi gjykues tani i trajton paragraf pas paragrafi emrat në këtë pikë:

(1) - **H.D., F.Y., A.S.Z.** (prej 25/6/2011 deri më 06/07/2011): nuk është paraqitur asnjë provë në këtë gjykim në lidhje me këta individë, edhe nëse arsyetimi i aktakuzës i referohet të dyshuarve tjerë, dhe jo atyre që janë të pandehur në këtë procedurë – siç u cek më lartë.

(2) - **S.Ar. dhe Personi me nofkën T.T.** (prej 19/10/2011 deri më 23/10/2011): Përsëri, nuk është paraqitur asnjë provë në këtë gjykim në lidhje me këta individë, edhe nëse arsyetimi i aktakuzës i referohet të dyshuarve tjerë, dhe jo atyre që janë të pandehur në këtë procedurë.

(3) - **M.S., R.S. dhe A.Sa.** (from 01/10/2011 to 07/10/2011): nuk është paraqitur asnjë provë në këtë gjykim në lidhje me këta individë, edhe nëse arsyetimi i aktakuzës i referohet të dyshuarve tjerë, dhe jo atyre që janë të pandehur në këtë procedurë.

(4)- **Z.A. and O.Y.** (from 01/10/2011 to 17/11/2011): nuk është paraqitur asnjë provë në këtë gjykim në lidhje me këta individë, edhe nëse arsyetimi i aktakuzës i referohet të dyshuarve tjerë, dhe jo atyre që janë të pandehur në këtë procedurë (edhe pse në këtë lëndë përmendet se A.Ç. i ka përgatitur ftesat po kjo, sikurse shumë aspekte tjera, tashmë janë trajtuar më lartë).

(5)- Kontrabandimi i **4 turqve të paidentifikuar** migrant të paligjshëm nga Turqia përmes Malit të Zi dhe Serbisë për në Gjermani (nga data 17/11/2011 deri me datën 20/11/2011): asnjë provë nuk është paraqitur.

(6)- **Y.D., B.H.O.** (nga 20/11/2011 deri me datë 28/11/2011): Në këtë rast e vetmja provë e dhënë ishte ajo që lidhej me 2 sms të dërguara nga [numrit të telefonit] që gjoja i përkisnin O.A. për A.B. në [numrit të telefonit] me datë 24/11/2011 me emrat dhe datat e lindjes “Y.D. [datë], dhe B.H.O. [datë]” në orën 18.18 minuta, dhe trupi gjykues tashmë ka sqaruar se nuk e gjen këtë të jetë si provë e mjaftueshme; asnjë provë tjetër e rëndësishme nuk u paraqit gjatë gjithë shqyrtimit kryesor. Përmbajtja e bisedave në këtë periudhë mes datës 20/11/2011 dhe datës 28/11/2011 ku përfshihet A.Ç. nuk mjafton për të lidhur atë apo vetë bisedat me këta migrantë të caktuar.

- **H.Da.** dhe **M.So.** (nga data 20/11/2011 deri me datën 28/11/2011): Si dhe në paragrafin e fundit, vetëm një sms me përmbajtjen, “H.Da. [datë]” në orën 18.18.37 i është dërguar A.B. nga numri i njëjtë, [numrit të telefonit] që i përket O.Y. (siç është konfirmuar në faqen 3 nga dëshmitari K.G. në procesverbalin e datës 13/05/2015), e që përsëri nuk është provë e mjaftueshme. Në rastin e M.So.it nuk pati ndonjë sms identik të dërguar ndonjë personi të panjohur. Përmbajtjet e bisedave në periudhën kohore mes datës 20/11/2011 dhe 28/11/2011 duke përfshirë A.Ç. nuk është e mjaftueshme për të lidhur atë ose vetë bisedat me këta migrantë të caktuar, në kuptim të asaj që tashmë u sqarua.

Madje edhe në seancën e mbajtur me datë 10/12/2014 kur prokurori pyeti dëshmitarin V.I. se a i mbante mend këta emra, ai tha jo (shih faqen 12 të procesverbalit në fjalë) dhe po ashtu (në faqen 13), ne mund të dëgjojmë, përgjigjen e dëshmitarit për pyetjen tjetër të prokurorisë: “V.I.: Po. O.A., A.Ç., F.A., B.F. janë të mirë njohur për hetimet PINK I. Me sa mbaj unë mend, B.F. është arrestuar me A.By.n me datë 17 prill 2012. F.A. ishte po ashtu i përfshirë në këtë veprimtari penale. Mbaj mend se ai ishte vozitës taksie”.

(7) - “Il.” [dhe një **familje që përbëhej nga një nënë dhe 5 fëmijë** dhe një migrantë turk që quhej **F.U.** (nga data 28/11/2011 deri me datën 06/12/2011)]: Me datë 8 dhjetor 2011 në orën 11.28.20 sekonda ka referime për një person “Il.” ose “Ik.” në një bisedë pretendohet mes O.A. dhe A.B., por përsëri përmbajtjet e bisedës në fjalë, siç u përmend më sipër, nuk janë të mjaftueshme për periudhën kohore të përmendur në akuzë (se O.A. është duke i thënë A.B. se ai, A.B., e kishte transportuar atë shumë kohë përpara, kjo përkundër faktit se përmbajtja e bisedës është, sipas pikëpamjes së një vëzhguesi objektiv, inkriminuese kur është fjala për vlerësimin e veprimtarive të këtyre individëve, që do të thotë të përmendur [emri i parë i N.N.] dhe O.A.in në fjalë). Po ashtu me datë 11 dhjetor 2011 në orën 11.56.30 sekonda ishte një bisedë telefonike nga një person i panjohur në Turqi me O.A.in (në [numrit të telefonit]) duke i përmendur personat e tillë përsëri (F.U. dhe “Il.”): “Kjo është e pabesueshme. Ai iu dha emrin tim në polici, ata po ia tregojnë fotografimin time çdokujt. Ata po i thonë atyre se [emri i parë i N.N.] është diku afër këtu. Është i gjithi faji i “Il.” it dhe i F.U.it” (– shih faqen 224, dosja 4 e përgjimeve të Pink I) por, përsëri, nuk përmban dëshmi substanciale lidhur me të pandehurit e kësaj procedure penale gjyqësore, madje as sa i përket A.B., sepse më nuk ka asnjë dëshmi e cila do i mundësonte gjykatës që të vërtetoj faktet përtej dyshimit të arsyeshëm, duke përfshi bisedën që u zhvillua me datë 4 dhjetor 2011, në orën 12.30.15 sekonda, kur A.B. thirri O.A. dhe përkundër asaj që ata flasin për para dhe bileta, thelbi i bisedës është A.B. duke thënë “ata janë dallaveraxhi, a ke folur ti me “Il.”? Edhe [emri i parë i N.N.] më thirri, ajo ka familje me pesë fëmijë, unë i thash asaj që të kontaktoj me ty, unë iu thash që O.A. mund ta bëjë këtë” – kjo me kuptimin që kjo mund të jetë dëshmi substanciale sa i përket individëve të tjerë, jo të pandehurve të këtij rasti – shih faqen 53/54, dosja e 4 e përgjimeve Pink I. Gjatë shqyrtimit kryesor nuk u dha asnjë provë mbi faktin e pretenduar që A.Ç. kishte përgatitur letra garancie për familjen në fjalë, edhe pse emri i asaj familje nuk përmendet, dhe se asnjë provë nuk është paraqitur që ai

apo ndonjëri i pandehur tjetër në këtë procedurë penale ka marr shumë në siç përmendet në aktakuzë (1.700 Euro dhe 5.500 Euro).

(8) - **M.Bu., A.K., B.B., “S.” ose “Se.”, F.T., “M.” (mbiemri i panjohur), “Sel.” (mbiemri i panjohur), E.U., M.E., familja prej 3 vetave, M.Ar., E.A., M.Y., A.U., R.T., S.D.** dhe **persona të tjerë të paidentifikuar** (nga 18 gushti 2011 deri me 3 dhjetor 2011): Asnjë provë nuk u paraqit lidhur me këta persona dhe lidhur me të pandehurit në fjalë, A.Ç. dhe A.B.. Vetëm sa i përket migrantit të pretenduar M.Y. mund të ngrit mëdyshje se mos mesazhi i dërguar me datë 25/10/2012 nga A.Ç. tek A.M. kishte të bënte me këtë individ, siç i është referuar me “M.Y.” – drejtshkrimi ndryshe; edhe pse, kjo ndodhi me datë 25/10/2012 dhe faktet supozohet që ndodhen mes 18 gushtit 2011 deri me datë 3 dhjetor 2011, që na shpie në përfundimin se mund të ketë qenë një tjetër individ.

#### **Akuza 4:**

Nuk është e mundur që të vërtetohen të pandehurit në këtë rast që kryen kontrabandë me migrantë (të pretenduar) të identifikuar (dhe të përmendur si raste në tentativë<sup>69</sup>) në këtë akuzë.

Arsyetimi i kësaj akuze është në faqen 37 të aktakuzës; arsyetimi në fjalë pothuajse ekskluzivisht i adresohet të pandehurve në procedura tjera gjyqësore, që do të thotë O.Y. dhe F.A..

(1)- **A.E., M.Er. dhe A.Er.** (gjoja udhëtuan mes datës 5 tetor 2011 dhe 9 tetor 2011): Asnjë provë nuk është paraqitur gjatë shqyrtimit kryesor, përpos kësaj, referimet lidhur me bisedat në arsyetimin e kësaj akuze në aktakuzë, ku përmendet A.Ç. – biseda telefonike mes O.Y. dhe tij, nga [numri i telefonit] dhe [numri i telefonit], me datë 09/10/2011 në orën 19.39.34 sekonda – nuk ka fare të bëjë me grupin prej 3 personave, aq më pak të quajtur [emri i fundit i M.Er.] ose diçka ngjashëm; gjykata po ashtu vlerësoi bisedat paraprake ditën e njëjtë por të orës 19.33.22 sekonda, ku A.Ç. është thirrur përsëri nga O.A. dhe përsëri me atë rast nuk u gjet asnjë e dhënë e rëndësishme. Prandaj, trupi gjykues po ashtu gjen se nuk ka zgjidhje tjetër përpos të mos vërtetimit të fakteve.

#### **Akuza 5:**

Në këtë akuzë është e mundur të vërtetohet se të pandehurit e këtij rasti kryen kontrabandë me migrantë siç është përshkruar më përpara.

Me sa duket, rrethanat e përgjithshme të thëna më herët duhet të kihen parasysh, sepse kjo është më specifike, pothuajse “një nga një”, dhe arsyetim më i hollësishëm, që mundëson që të përcaktohet roli që secili i akuzuar ka pasur lidhur me secilin migrantë apo grup të migrantëve.

Arsyetimi i kësaj akuze është nga faqja 37 deri në faqen 103<sup>70</sup> të kësaj aktakuze.

---

<sup>69</sup> Por ky klasifikim si “tentativë” është një pyetje juridike së cilës do t’i adresohemi në kohën e duhur.

**Lidhur me faktet e vërtetuara (paragraf për paragraf, individ për individ):**

**(1) –Në periudhën kohore mes datës 23 qershor dhe 27 qershor 2012 kontrabandë e këtyre migratnëve turk duke organizuar udhëtimin e tyre dhe hyrjen në Kosovë si vend kalimtar për vende të tjera si destinacione përfundimtare:**

**M.Oc., T.O. dhe M.K.: A.Ç.**

Lidhur me A.Ç. :

M.Oc., T.O. dhe M.K. arritën në Kosovë me datë 23/06/2012 në orën 1.34 minuta me autobus në pikën kufitare të Kullës së Pejës dhe dolën në të njëjtën ditë në orën 4.58 minuta me automobil përmes kalimit kufitar të Hanit të Elezit; një orë më vonë ai hyri në Kosovë përsëri në orën 6.05 minuta dhe përfundimisht u largua me autobus përmes pikë kalimit kufitar të Gllobocices, me datë 25/06/2012. Kjo e dhënë nga Raporti i SMK-së u vërtetua nga ana e dëshmitares M.J. (shih procesverbalin e datës 24/09/2015) dhe nga V.I. (shih procesverbalin e datës 9/02/2015, faqe 06). Përfshirja e A.Ç.-es mes tjerash është vërtetuar nga fakti se ai pranoi një korrespondencë elektronike nga [adresa elektronike] me letër garantuese të lëshuar nga I.S. për M.Oc., T.O. dhe M.K. për periudhën kohore nga data 25/06/2012 deri me datën 30/06/2012 (shih dosjet e policisë, dosjen 3, faqe 222), çka është konfirmuar po ashtu nga ana e dëshmitarit V.I. (shih procesverbalin e datës 09/02/2015, faqe 5). Duhet të vihet në pah se letër garancia përputhet me datën kur M.Oc., T.O. dhe M.K. lëshuan Kosovën. Veç kësaj, disa përgjime mes datës 22/06/2012 dhe datës 23/06/2012 ndërmjet A.Ç.-es dhe S.I.t, vërtetojnë përfshirjen e A.Ç.-es në kontrabandë të M.Oc., T.O. dhe M.K. Me datë 23/06/2012 në orën 12.13 minuta, A.Ç. në numrin e tij të telefonit [numrit të telefonit] ia dërgoi një mëzash sms S.I.t, në [numrin], ku pyet se a ishte e hapur zyra e noterit (Dosja për Përgjime 1, faqe 45-46); një minutë më vonë në orën 12.14 minuta, S.I. iu përgjigj “të hënën”.

Më vonë me datë 23/06/2012 në orën 21.24 minuta, A.Ç. ia dërgoi një mëzash sms S.I. me këtë përmbajtje: “M.Oc., [datë], M.K., [datë], dhe T.O., [datë]” (Raporti i Parë Ligjor i Përgjimeve, faqe 280). Ky përgjim është vërtetuar nga ana e dëshmitarit V.I. (shih procesverbalin e datës 09/02/2015, faqe 5). Në orën 15.10 minuta, me datë 23/06/2012 A.Ç. i jepi S.I. udhëzimet si në vijim përmes sms mesazhit: “ti kryeje te noteri për 3 të hënën. Kjo pagesë do të kryhet” (Dosja e Përgjimeve 1, faqet 73-74). Në të njëjtën ditë, në orën 22.52.33 sek, A.Ç. morri edhe një herë një sms mesazh nga S.I. “ata do të jenë në kompjuter nesër në orën 3. Dërgoji kopjet me autobus, është më së miri” (Dosja e Përgjimeve 1, faqe 106-107). Ditën e nesërme me datë 24/06/2012 në orën 14.25 minuta, A.Ç. e thirr një migrantë në Prishtinë në [numrin] ku e njoftoi atë se ai duhet të shkonte në internet café për ftesën, dhe se ata duhej të niseshin ditën e nesërme në orën 3 (Dosja 1, faqe 110-112).

Me datë 25/06/2012 në orën 12.06 minuta, A.Ç. pranoi një sms mesazh nga S.I. në Maqedoni në [numrin] (shih dosjen e përgjimeve 1 të PINK 2, faqe 180-181): “dërgoj numrat e

---

<sup>70</sup> Although not needed to say, when the court mentions the pages of the reasoning of each count it is not overlooking the additional reasoning under B, p.103 onwards of the indictment.

pasaportave si dhe emrin e qytetit, nga janë ata ...thua ju që të dërgojnë 150 Euro. Ai që punon në noteri tash është zgjuar”. Pas këtij mesazh, edhe disa mesazhe të tjera janë shkëmbyer mes A.Ç.-es dhe S.I.t lidhur me tre migrantët. Këto biseda tregojnë se në bazë të udhëzimeve nga A.Ç., S.I. i bëri letër garancitë lidhur me M.Oc., T.O. dhe M.K.. Me datë 25/06/2012, në orën 17.12 min, A.Ç. në numrin e tij të telefonit [numrin] pranoi një sms mesazh nga një migrantë me këtë përmbajtje: “ne e kaluam kufirin me Maqedoninë. Jemi rrugës për në Maqedoni” (Dosja e Përgjimeve 1, faqe 329-340). Kjo datë dhe kohë përafërsisht përputhet me datën dhe kohën që këta tre migrantë kaluan kufirin mes Kosovës dhe Maqedonisë siç paraqitet në raportin e sistemit të SMK-së, tashmë i përmendur më sipër.

Përpos kësaj, me datën e arritjes së M.Oc., T.O. dhe M.K. A.Ç., me datë 23/06/2012, në orën 08.58 minuta, A.Ç. u thirr në numrin [numrit të telefonit] nga një individ i cili u përmend si “A.P.”, në përdorim të [numrit të telefonit], dhe ai e njoftoi A.Ç. se “ata erdhën” dhe se “ata janë në Stacionin e Autobusëve në Prishtinë” dhe pyeti se a mos duhej t’i dërgonte ata te M., në çka A.Ç. u përgjigj se ata mund të dërgoheshin atje ose në Hotel TiranA.Ç. po ashtu e pyeti “A.P.”n se a bëhej fjalë për 2 apo për 3 persona, për çka “A.P.” iu përgjigj se ishin tre (Dosja e Përgjimeve 1, faqe 37-39).

Ditën e njëjtë, në orën 12.40 minuta, A.Ç. e thirri O.K. duke përdorur numrin [numrit të telefonit], (Dosja e Përgjimeve 1, faqe 53-55). A.Ç. njoftoi O.K.n se ata do të vizitonin “ata” pas pak dhe se noteri është i hapur të hënën për të rregulluar ftesat, se në rast se ata nuk i lejojnë që të kalojnë dhe do të iu vihej vula “kthim”; O.K. u përgjigj që A.Ç. duhej të “fshinte fletoret e tyre” dhe pyeti se a do mund të arrinin ata atje. A.Ç. u përgjigj se është mirë që këto ditë ata patën mundësi të kalonin. Gjatë të njëjtës ditë, me datë 23/06/2012 në orën 13.49 minuta, A.Ç. duke përdorur numrin e telefonit [numrit të telefonit] thirri migrantët që ishin në përdorim të [numrit] me pyetjen se a ishin që të tretë në dhomën e parë (Dosja e Përgjimeve 1, pp.56-58). Pas ca kohe, në orën 14.20 minuta, kur A.Ç. ishte me migrantët, ai e thirri të quajturin “A.P.” në përdorim të [numrit të telefonit]. Lidhur me rastin e njëjtë, O.K. informoi migrantët që të ia “jepni A.Ç.t 50 Euro në vend të 30 Eurove...ju që të tre së bashku jepjani atij 50 Euro” (Dosja e Përgjimeve 1, faqe 59-61). Mesazhet me tekst dhe thirrjet telefonike mes A.Ç.-es dhe O.K.t vazhduan gjatë udhëtimit të migrantëve; për shembull, me datë 25/06/2012 në orën 21.48.27 sek, kur A.Ç. u thirr në [numrit të telefonit] nga ana “A.P.” në përdorim të [numrit të telefonit] ai e informoi A.Ç. se migrantët nuk kishin hyrë akoma dhe se ata ishin në kontrollin kufitar (shih Dosja e Përgjimeve 1, faqe 477-478).

Bazuar në përgjimin e datës 27/06/2012 në orën 16.04 minuta, mes orës A.Ç.-es në përdorim të numrit të njëjtë [numrit të telefonit] dhe “A.P.” që përdorte numrin [numrit të telefonit], mund të vërtetohet se migrantët ishin kapur në Hungari dhe se ose mund të dënoheshin ose të ktheheshin (Dosja e Përgjimeve 2, faqe 85-88). Korrespondenca postare elektronike nga ana e A.Ç. me datë 31/07/2012 vërteton që migrantët ishin kthyer dhe se ishte organizuar udhëtimi i dytë. A.Ç. po ashtu organizoj rezervim hoteli për M.Oc., T.O. dhe M.K. në Dhomat Nirvana për periudhën kohor nga data 31/07/2012 deri me datën 03/08/2012 siç tregohet nga korrespondenca elektronike e dërguar me datë 31 korrik 2012 nga ana e A.Ç.-es nga adresa e tij e



postes elektronike [adresa elektronike] te Nirvana Rooms në Split, Kroaci. Kjo korrespondencë elektronike është adresuar nga dëshmitari V.I. (procesverbali i datës 09/02/2015, faqe 5). Përfshirja e A.Ç.-es më tej vërtetohet nga përgjimi i datës 30/07/2012 në orën 18.56.55 sek, se A.Ç. dërgoi një sms mesazh në [numrin të telefonit] me këtë përmbajtje “dërgo M.Oc. [numrit të telefonit]” (shih dosjen e përgjimeve 5, lidhja 30, faqe 267). Korrespondenca elektronike e përmendur u konfirmua nga dëshmitarja M.J. (procesverbal i datës 24/09/2014, faqe 14).

**(2) – Në periudhën kohore të korrikut të vitit 2012 kontrabandë e migrantëve në vijim duke organizuar udhëtimin e tyre dhe hyrjen në Kosovë si vend kalimtar për në vendet tjera si destinacione përfundimtare:**

**I.Y., dhe F.K. dhe M.Sol.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Në bazë të raportit të SMK-së, I.Y. së bashku me F.K. hyri në Kosovë me aeroplan në Aeroportin e Prishtinës me datë 18/07/2012, në orën 4.20 minuta, të pasdites, dhe u largua ditën e nesërme, 19/07/2012, në orën 4.58 minuta të pasdites, me autobus, duke kaluar kufirin në Gllobocice. Të dhënat e SMK-së lidhur me I.Y. janë konfirmuar nga ana e V.I. (shih procesverbalin e datës 28/04/2015, faqe 8, dhe procesverbalin e datës 15/04/2015, faqe 14) dhe nga A.R. (shih procesverbalin e datës 16/06/2015, faqe 5) ndërsa, sa i përket F.K., nga V.I. (shih procesverbalin e datës 28/04/2015, faqe 8), nga M.J. (shih procesverbalin e datës 24/09/2014, faqe 7) dhe nga dëshmitari A.R. (shih procesverbalin e datës 16/06/2015, faqe 5; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, Raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin kufitar të migrantëve, i datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC i datës 17/01/2013, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143). Përfshirja e A.Ç.-es mund të vërtetohet nga korrespondenca elektronike e marr nga ai 4 ditë para arritjes së dy migrantëve, e pranuar me datë 14/07/2012 nga H.I., [adresa elektronike] me kopjet e skanuara të pasaportave të I.Y. dhe F.K. të bashkëngjitura (shi po ashtu nga Policia e EULEX-it, NjHKO 4855, raporti policor 15-ditor mbi përgjimin e rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore nga 21/06/2012 – 11/10/2012, i datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC i datës 19/10/2012, dosja policore PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17). Kjo është konfirmuar po ashtu nga ana e dëshmitarit V.I. (shih procesverbalin e datës 15/04/2015, faqe 15) dhe M.J. (shih procesverbalin e datës 24/09/2014, faqe 8). Përveç kësaj, gjatë bastisjes së shtëpisë së A.Ç.-es, është gjetur një pasaportë turke [me numër] (lëshuar për F.K., [me datë të lindjes] (shih dosjen policore 7, dosja 3, faqe 32 pika 13), siç është konfirmuar nga ana e A.R. (shih procesverbalin e datës 16/06/2015, faqe 5) dhe nga ana e V.I. (shih procesverbalin e datës 28/01/2015, faqe 21).

Përveç kësaj, provat e vëzhgimit tregojnë që me datë 18/07/2012 individit e identifikuar si N.N. (e pandehur në tjetër rast) e morri I.Y. dhe F.K. (shih dosjen e kartonit të policisë 1, lidhja 3, faqe 34-38); ky raport i vëzhgimit është adresuar po ashtu dhe përmbajtja e tij është sqaruar nga ana e dëshmitarit V.I. (shih procesverbalin e datës 28/04/2015, faqe 8). Për më tepër, në të

njëjtën ditë, të dy migrantët u morën nga ana e N.N. tek A.Ç. (i cili mandej shkoi në stacion të autobusit), në Kafenenë në Mal të Zi (shih dosjen e katronit të policisë 1, lidhja 3, faqe 40).

Bazuar në raportin e SMK-së, të dhënat tregojnë se këta dy migrantë u larguan nga Kosova me datë 19/07/2012 në orën 45.8 sek të mbrëmjes dhe duke pasur parasysh se në faqen 48 të raportit të parë të vëzhgimit (shih dosjen e policisë 1, lidhja 5) përmendet që me datë 19/07/2012 në orën 16.55 minuta: “Autobusi i Durmo Tours arrin në pikën kufitare të Glllobocica me dy migrantë të pretenduar të cilët akoma janë në autobus”, siç konfirmohet nga ana e V.I. (shih procesverbalin e datës 28/04/2015, faqe 8), është e qartë përtej dyshimit të arsyeshëm që këta dy migrantë të përmendur në raportet e vëzhgimit janë në të vërtetë I.Y. dhe F.K..

Lidhur me M.Sol., gjykata morri parasysh provat në vijim: Në bazë të raportit të SMK-së, M.Sol. hyri në Kosovë me aeroplan në Aeroportin e Prishtinës me datë 3/07/2012 në orën 8.28 minuta, pasdite, dhe largohet të njëjtën ditë, në orën 23.22 minuta, me automobil, duke kaluar kufirin në Han të Elezit, dhe hynë përsëri me automobil në të njëjtin kufi me datë 4/7/2012, në orën 0.22 minuta, dhe në fund largohet me automobil në pikën kufitare të Globocicës me datë 5/7/2012, në orën 14.41 minuta (shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, Raportin e NjHKO-së 5246 të kalimit të kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013 - PSRK/in/52/OC të datës 17/01/2013 -, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143). Këto të dhëna u konfirmuan në seancën e mbajtur me datë 24/9/2014 nga ana e dëshmitares M.J. (shih procesverbalin në fjalë, faqe 13). Përfshirja e A.Ç.-es po ashtu mund të konfirmohet me anën e korrespondencave elektronike: me datë 17/07/2012 ai dërgoi një email ku bëri një rezervim në emrin në fjalë te Nirvana Rooms, Split, në Kroaci dhe mori përgjigjen nga N.P. [adresa elektronike] ku mori konfirmimin e atij rezervimi nga data 18/07/2012 deri me datën 20/07/2012 po ashtu edhe me datë 17/07/2012 (shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, NjHKO 4855, raportin policor 15-ditor mbi përgjimet e rrjetit të kompjuterit - A.Ç. – që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, i datës 17/10/2012, -SPRK/in/1212/OC i datës 19/10/2012 - dosja policore PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17). Dëshmitarja M.J. e sqaroi dhe po ashtu e zuri në gojë një përgjim (shih procesverbalin dhe faqen në fjalë): “në këtë Ndihmë Ligjore Ndërkombëtare me Kroacinë, ne kemi një përgjim të datës 17 korrik 2012 A.Ç. dërgoi një sms mesazh në një numër të caktuar dhe përmbajtja është: ti dërgoje te M.Sol. dhe numri telefonit”.

**(3) – Në periudhën kohore gusht 2012 kontrabandë e migrantëve në vijim duke organizuar udhëtimin e tyre dhe hyrjen në Kosovë si vend kalimtar për në vendet tjera si destinacione të fundit:**

**O.Yl.: A.Ç.**

Lidhur me A.Ç. :

Përfshirja e A.Ç. buron nga fakti që ky migrantë (me shtetësi turke, i [lindur me datë]) në fakt erdhi në Kosovë me datë 12/08/2012, ku erdhi me aeroplan në Aeroportin e Prishtinës, në orën 8.48 minuta, dhe u largua me autobus ditën e nesërme me datë 13/08/2012, në orën 3.10

minuta, me autobus në pikën kufitare të Globocices dhe hyri përsëri mu të njëjtën ditë dhe kufi, më pak se pas një ore, dhe përsëri largohet përmes kufirit të Kullës së Pejës me datë 15/08/2012, në orën 10.24 minuta, me autobus. Dëshmitarët V.I. (shih procesverbalin e datës 28/04/2015, faqe 9) dhe A.R. (shih procesverbalin e datës 16/06/2015, faqe 6) sqaruan kuptimin e këtyre lëvizjeve që i përmban raporti i SMK-së (dosjet e policisë numër 1, faqe 126; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, Raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC e datës 17/01/2013, dosja policore PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143). Ditën e daljes së parë me autobus, 13 gusht 2012, ekipi i vëzhgimit vuri në dukje një migrantë në stacionin e autobusëve me A.Ç. , ai ishte në qebaptore në stacion të autobusëve, pastaj ai shkoi në platformën 10 dhe aty u ndal pranë A.Ç. dhe afër PMP 13<sup>71</sup> – që quhet si “A.P.” – dhe të gjithë filluan të flisnin me njëri tjetrin (shih 15 dosjet – dosja policore mbi raportet e bastisjes – raport hetimor/vëzhgues financiar i datës 13/08/2012, nga faqja 151 deri në faqen 159); vëzhgim për të cilin dëshmitari A.R. konfirmoi hollësitë (shih procesverbalin e datës 16/06/2015, faqe 6 dhe 7); po ashtu në faqet 130 dhe 131 të së njëjtit raport të vëzhgimit shohim fotografi lidhur me raportin e veprimtarisë së përgjimit të aty për atyshëm me datë 14 gusht 2012 dhe kjo ishte në orën 11.25 minuta, kur A.Ç. dërgon një sms mesazh të të njëjtit migrantë, O.YI., ku i thotë që ishte në hotel, dhe më pas A.Ç. e thërret një person të panjohur në orën 11:30 minuta, dhe e njofton këtë personin e panjohur se ishte në hotel me migrantin.

Po ashtu ne mund të shohim që A.Ç. pranoi në adresën e tij elektronike [adresa elektronike] një email me datë 07/08/2012 nga S.Ku. [adresa elektronike] një imazh të pasaportës së migrantit në fjalë dhe kjo u konfirmua po ashtu nga dëshmitari V.I. (shih procesverbalin e datës 15/04/2015, faqe 15; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, NjHKO 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja policore PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17). Po ashtu duke përdorur të njëjtën adresë elektronike, A.Ç. me datë 16/08/2012 dërgoi një e-mail te [adresa elektronike], Nirvana Rooms, Split, Kroaci, ku bëri rezervime mes datës 16/08/2012 dhe 20/08/2012 për migrantin në fjalë (shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, NjHKO 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të 19/10/2012, dosja policore PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe. 1-17).

Në 15 dosjet e policisë, dosjen policore 1, lidhjen 12.1, faqe 126 dhe 127 të raportit të vëzhgimit, në veçanti të veprimtarisë së përgjimit të datës 12 gusht 2012, emri i O.YI. është përmendur në orën 09.10 minuta. Sipas saj, O.YI. sapo kishte arritur në aeroportin e Prishtinës dhe i kishte dërguar një sms mesazh A.Ç.-es në numrin e telefonit që përfundonte me 818, ku përmendte faktin se kishte kaluar kontrollin e pasaportës dhe se po rrinte në radhë për të dalë jashtë.

---

<sup>71</sup> Domethënë Person Mashkull i Pidentifikuar.

Në fund, a kishte ndonjë dyshim, me datë 16/8/2012, në orën 16.09 minuta, A.Ç. i përgjigjet dikujt i cili e identifikon veten si daja i O.Yl.it dhe thotë si në vijim: “ai tani është rrugës për në Kroaci me një shok timin. Unë jam duke folur me ta dhe po e përcjelli situatën” dhe pastaj shton “ata do të hynë në Kroaci, zyrtarisht. Dhe pastaj të nesërmen në mbrëmje ka mundësi që ata do të vazhdojnë për në Austri, Itali” (- shih dosjen e përgjimit - vëllimi 10, lidhja 4. Faqe 201-202).

**I.K.<sup>72</sup>: A.Ç. / A.G.**

Lidhur me A.Ç. :

Kishte dëshmi të dhëna për të vërtetuar kontrabandën e I.K. [lindur me datë].

Sa i përket A.Ç.-es, ai siguronte për dhënien e letër garancisë nën emrin e bashkë – të – pandehurit A.G., zyrtarisht i certifikuar nga noteri, për individin I.K., kjo pasi që ka marr një kopje të pasaportës së tij turke [me numër] që është dërguar me sms mesazh nga “A.P.” te A.Ç., me datë 14/8/2012 në orën 16.47 minuta) nga B.S. me datë 21 gusht 2012 (shih nga Policia e EULEX-it, NjHKO 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç. që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja policore PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

Lidhur me A.Ç. së bashku me A.G.n, ne shohim letër garancinë të lëshuar nga i pandehuri A.G. (dosja e policisë 3, faqe 413), e bërë tek noteri me datë 17/08/2012 dhe i është dërguar me email A.Ç.-es me datë 20/08/2012. Përpos kësaj, ne shohim hyrjen e këtij migranti në Aeroportin e Prishtinës me datë 22/08/2012, në orën 6.43 minuta të pasdites, sipas raportit të SMK-së; këto fakte janë konfirmuar po ashtu nga dëshmitarët A.R. (shih procesverbalin e datës 16/6/2015, faqe 11/12) dhe V.I. (shih procesverbalin e datës 28/4/2015, faqe 12; shih po ashtu Raportin Policor të EULEX-it, raporti i NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143).

Me datë 17/08/2012 një individ i quajtur M.Ki. transferoi një shumë prej 100 Euro te A.G. Ky i pandehur kishte [numrin identifikues] dhe ishte i lindur me datë 7 tetor, e njëjta datë si dhe numri i njëjtë identifikues<sup>73</sup> si në përgjigjen nga Western Union, përkundër asaj që në aktakuzë thuhet se është i [lindur me datë] (dosja e policisë 10, lidhja 1, Përmbledhje e Raportit Financiar e datës 11.04.2013, faqe 17); lidhur me përfitimin material ne mund të themi po ashtu, nga pikëpamjet subjektive (të të pandehurit), se në bazë të kontakteve të tija me bashkë – të – pandehurin A.Ç., me datë 28/9/2012 ai i kërkon atij të holla për ta dërguar djalin e vetë te mjeku. Nga raporti i vëzhgimit (faqe 171) raport lidhur me datën 22 gusht 2012, dhe ky incident

<sup>72</sup> Për arsye sistematike arsyetimi lidhur me A.G.n dhe këtë migrantë do të përmendet përsëri.

<sup>73</sup> Ashtu siç do të përmendet përsëri në arsyetim të kontrabandimit të individit I.K. në gusht 2012 (sipas arsyetimit të pikës së akuzës 6).

raportohet në orën 16:35 minuta, “ekipi i vëzhgimit vuri re një PMP 17, supozohet taksist, që i afrohet një migranti i cili sapo doli nga terminali, i shkurtër me ngjyrë fytyre të mbylltë dhe personi mashkull i panjohur e pyet atë se a mos ishte ai I.K. dhe djaloshi i ri iu përgjigj ‘Jo’. Personi i panjohur shkon përsëri në drejtim të terminalit”. Këto fakte qojnë në përfundim se i pandehuri A.G. shkoi në aeroport për të marr personin për të cilin ai kishte garantuar.

Ky i pandehur, megjithatë, do të ndërpres më pas vullnetarisht bashkëpunimin e tij penal me të pandehurin A.Ç. duke pohuar se nuk dëshironte asnjë punë më me te. Në fakt, me datë 20/8/2012 në orën 18.25 minuta, A.Ç. thirri A.G.n (nga numri [numrit të telefonit] në [numrin të telefonit] dhe A.G. i tha atij “Po, por eja të flasim, nëse ka diçka serioze me policinë, emrin tim, unë nuk dua asnjë, e kupton?; A.Ç.: Jo, asnjë problem, fare, ne kemi sqaruar... mysafir, p.sh. vëlla, vëllai të njeh ty (...); A.G.: po, po, vetëm po them” – shih 64 dosjet e policisë, dosjen 62, lidhja 10, faqet 474/476. Po ashtu me datë 22/08/2012, në orën 17.40 minuta, A.G. (me [numrin të telefonit]) thërret A.Ç. (në [numrit të telefonit]) dhe biseda shkoi kështu: “(...) A.G.: ku e ke shtëpinë? Dua të ta jap këtë dhe ta përfundoj me ty; A.Ç.: Më fal? (...)”- shih 64 dosjet e policisë, dosja 13, lidhja 3, faqe 223.

#### **M.S.B.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Pati prova të paraqitura për të vërtetuar kontrabandën e M.S.B. Ne kemi korrespondencat elektronike të datës 21/08/2012 nga S.Ak. (për të cilat janë dëgjuar dëshmitarët, V.I. dhe A.R. – shih procesverbalin e datës 2/12/2014, faqe 12, dhe procesverbalin e datës 16/06/2015, faqe 10, përkatësisht; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17) dërguar në adresën elektronike të A.Ç.-es [adresa elektronike] dhe ditën e nesërme S.Ak. po ashtu i dërgoi atij një email me kopjen e pasaportës së migrantit turk në fjalë, [pasaporta nr.] e Republikës së Turqisë (dëshmitari A.R. gjithashtu është dëgjuar lidhur me këtë email, shih procesverbalin e datës 16/06/2015, faqe 10). Përpos kësaj, ne mund të shohim hyrjen e migrantit në Aeroportin e Prishtinës me datë 23/08/2012, në orën 08.24 minuta, sipas raportit të SMK-së (dosjet e policisë vëllimi 6, lidhja 5, faqe 269, dhe nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC i datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143) dhe një ditë më përpara (22/08/2012, në orën 23.37 minuta); ne po ashtu shohim se A.Ç. e thirri [Pseudonimi për M.As.] (me [numër telefoni]) me datë 16/08/2012 në orën 16.54 minuta ku pyeste lidhur me punën e fotografisë, datën e lindjes dhe pasaportën e një djali me emrin M.S.B. (64 dosjet, dosja 10, lidhja 5, faqe 235/236; në faqen 246 kemi një sms mesazh nga i njëjti numër përsëri për A.Ç. ku dërgonte hollësi, datën e lindjes dhe numrin e pasaportës dhe në faqen 253 kemi transkriptimin e një bisede tjetër mes A.Ç.t dhe [Pseudonimi për M.As.] ku diskutonin nevojën e A.Ç.t që të ketë një fotokopje të pasaportës dhe paralajmërimin të [Pseudonimi për M.As.] për të kontrolluar posten e tij elektronike për të parë se çfarë i kishte dërguar ai atij nga

adresa [adresa elektronike]); dëshmitari V.I. po ashtu i konfirmoi këto fakte në seancën e mbajtur me datë 2/12/2014.

**M.Ha.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Kishte prova të paraqitura për të vërtetuar kontrabandën e M.Ha.. A.Ç. dërgoi një email me datë 22/08/2012 te [adresa elektronike] ku bëri rezervime me këtë emër në Nirvana Rooms, Split, Kroaci, për periudhën kohore nga data 23 deri me datën 26/8/2012 (për çka është dëgjuar dëshmitari V.I. – shih procesverbalin e datës 15/04/2015, faqe 17; shih nga Policia e EULEX-it, NjHKO 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore prej 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të 19/10/2012, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17). Përpos kësaj, ne shohim që në të vërtet individ i erdhi në Kosovë sepse ai zbriti në Aeroportin e Prishtinës me datë 07/08/2012, në orën 08.45 minuta të mëngjesit, kjo sipas raportit të SMK-së (- shih dosjet e policisë, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 269).

**(4) - Në periudhën kohore shtator 2012 kontrabandë e migrantëve në vijim duke organizuar udhëtimin e tyre dhe hyrjen në Kosovë si vend kalimtar për në vendet tjera si destinacione të fundit:**

**M.Go., R.K.G. dhe T.Ya.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

M.Go., i [lindur me datë] i shtetësi turke, arriti në Kosovë me datë 02/09/2012 në orën 19.23 minuta me aeroplan, në Prishtinë, dhe më pas doli duke kaluar në kalimin kufitar të Kullës së Pejës me datë 04/09/2012, hyri përsëri me datë 05/09/2012 dhe me datë 14/0/20129, dhe pastaj në kufirin e Hanit të Elezit largohet me datë 15/9/2012 me automobil (shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143). Kjo e dhënë nga raporti i SMK-së u konfirmua nga dëshmitari A.R. (shih procesverbalin e datës 16/06/2015, faqe 12/13). Ne po ashtu e dimë që A.Ç. bëri një rezervim me datë 6/9/2012 për individin në fjalë nga data 6 deri me datën 10/9/2012 në Hotel Villa Osa, Mostar, Bosnje dhe Hercegovinë në [adresën elektronike], duke marr kështu përmes e-mailit konfirmimin ditën e nesërme për periudhën kohore nga data 8 deri me datën 12/9/2012 (dëshmitari V.I. e adresoi këtë në seancën e datës 9/2/2015, shih procesverbalin në faqen 10; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012,

të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

R.K.G., i lindur me datë...(i shtetësisë turke), dhe T.Ya., i lindur me datë...(i shtetësisë turke), arriti në Kosovë me datë 4/09/2012 në orën 14.19 minuta me automobil, në Gllobocice, dhe më pas në vendkalimin kufitar të Kullës së Pejës doli me automobil me datë 4/6, hyri me automobil me datë 5/9, hyri me datë 14/9 me autobus dhe u largua me datë 18/9/2012 në orën 16.16 minuta me autobus te Kulla e Pejës. Këto të dhëna nga raporti i SMK-së (shih nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143) u vërtetuan nga ana e dëshmitarit A.R. (shih procesverbalin e datës 16/06/2015, faqe 13) dhe nga ana e V.I. (shih procesverbalin e datës 28/1/2015, faqe 18, dhe procesverbalin e datës 9/2/2015, faqe 9 – kjo pasi që u pyet lidhur me një sms mesazh, “me datë 7 shtator 2012 në orën 12.34.42 sekonda, zotëri A.Ç. merr një sms mesazh nga një grua nga hotel Villa Osa, që thotë, ‘unë i dërgova rezervimet për R.Ko., M.Go., T.Ya. dhe pyeta se kur do të arrijnë’). Po ashtu në të njëjtin email, A.Ç. me datë 07/09/2012 morri konfirmimin nga hotel Villa Osa, Mostar, Bosnje dhe Hercegovinë, më pas me datë 6/9/2012 ai kishte dërguar një email tek [adresa elektronike] ku bëri rezervime për këta 3 individ për periudhën kohore 06/09/2012 deri me datë 10/09/2012 (shih procesverbalin e datës 9/2/2015, faqe 10, shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

Lidhur me këta 3 individ pati disa kontakte mes C.K. dhe A.Ç.-es, nga [numri] në [numrit të telefonit] (si ai i datës 04/09/2012, në orën 11.10 minuta): për shembull, në njërin nga ta A.Ç. morri emrat e tyre, më pas u pyet se a i morri ato dhe kështu A.Ç. shfrytëzoi rastin që të konfirmoi se njeri nga këta individ kishte 3 emra, më pas në të njëjtën ditë por në orën 11.19 minuta, A.Ç. i tregon C.K. se “ftesat nuk duhet të iu dorëzohen deri sa ata të arrijnë kufirin e Bosnjës dhe të japin të hollat. C.K. pajtohet” (- shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 20, lidhja 4, faqe 164, 166 dhe 167).

**D.E., S.E. dhe E.E.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Këta individ, një familje (D.E. e lindur me datë..., S.E. lindur me datë... dhe E.E., fëmijë, lindur me datë...), arritën në Kosovë së bashku, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 14/09/2012 në orën 08.06 minuta, dhe më pas dalin përmes vendkalimit kufitar të Kullës së Pejës me datë 16/9/2012 në orën 10.18 minuta (shih nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143). Këto të dhëna nga

raporti i SMK-së u konfirmuan nga dëshmitari V.I. (shih procesverbalin e datës 20/04/2015, faqe 10). Në adresën e tij elektronike, A.Ç. morri një email me datë 11/09/2012 nga D.E. [adresa elektronike] me skanimet e pasaportave të këtyre 3 personave si dhe mori me datë 16/09/2012 nga adresa book-[adresa elektronike] rezervimet për ta, për periudhën kohore 18 dhe 19/09/2012; dëshmitari V.I. po ashtu sqaroi këto fakte (shih procesverbalin e datës 20/4/2015, faqe 10; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

**H.Ce., K.C. dhe B.C.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Këta individ, një familje tjetër (H.Ce., K.C. dhe B.C.), arrijnë në Kosovë së bashku, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 16/09/2012 në orën 08.07 minuta, dhe më pas në vendkalimin kufitar të Kullës së Pejës, me automobil, dalin me datë 19/9/2012, në orën 3.21minuta (më përpara ata po ashtu kishin shkuar me autobus në vendkalimin kufitar të Hanit të Elezit, me datë 17/9/2012, në orën 7.11 minuta; shih nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosjen e policisë PINK 2, vëllimin 6, lidhjen 5, faqe 135-143). Këta 3 individ janë përmendur në një letër garancie në emër të H.Ku., të datës 13/09/2012, e dërguar përmes postës elektronike nga adresa [adresa elektronike] në adresën elektronike të A.Ç.-es (se ky po ashtu mori me datë 13/09/2012 pasaportat e skanuara të të njëjtëve persona nga I.Ba. [adresa elektronike] dhe me datë 21/09/2012 A.Ç. pranoi nga hotel Villa Osa, në Mostar, Bosnje dhe Hercegovinë, në [adresa elektronike] konfirmimin e rezervimit për periudhën kohore 21-25/09/2012); nga kjo adresë e tij elektronike, A.Ç. dërgoi këtë: me datë 13/09/2012 te H.Ku. [adresa elektronike] skanimet e pasaportave të njëjta, letër garancinë lëshuar nga ana e H.Ku., me datë 21/09/2012 rezervimet në Villa Osa në Mostar, Bosnje, në Villaosa [adresa elektronike], rezervimet për periudhën kohore të deklaruar më sipër, dhe me datë 23/09/2012 rezervimet për periudhën kohore nga data 23/9/2012 deri me datën 26/9/2012 në Nirvana Rooms, në Split, Kroaci, në adresën elektronike [adresa elektronike], dëshmitari V.I. po ashtu sqaroi këto fakte (shih procesverbalin e datës 20/4/2015, faqe 12; po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

Pasi që këta individ tashmë kishin lëshuar Kosovën, A.Ç. merr një sms mesazh nga [numri] në telefonin e tij, [numrit të telefonit], me datë 20/9/2012, në orën 16.15 minuta, me emrat dha datat e tyre të lindjes si dhe numrat e pasaportave (shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 23, lidhja 6, faqe 320).



**L.D., S.K., H.K. dhe A.Ak.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Këta individ po ashu udhëtuan të njëjtën ditë (Dikmen lindur me datë 10/1/1989, Sirin lindur me datë 20/8/1993, Halisa lindur me datë 5/3/1973 dhe A.Ak., lindur me datë 13/8/1982), arritën në Kosovë së bashku, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 20/9/2012 në orën 8.35 minuta, 8.41minuta, 8.42 minuta përkatësisht në orën 8.36 minuta, dhe më pas në vendkalimin kufitar te Dheu i Bardh ata dolën me automobil me datë 21/9/2012, në orën 5.12 minuta pasdite (sërish hynë në Kosovë në orën 5.42 minuta pasdite me automobil përsëri nëpër vendkalimin e njëjtë kufitar, por se, sa i përket A.Ak., nuk ka të dhëna lidhur me këtë hyrje të serishme) dhe largohen përsëri me automobil por kësaj here përmes vendkalimit kufitar të Kullës së Pejës në orën 9.40 minuta të mbrëmjes (shih nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143 ). Skanimet e pasaportave të këtyre individëve ishin dërguar përmes postës elektronike nga M.Gu. [adresa elektronike] me datë 16/6/2012 në adresën elektronike të A.Ç.-es; dëshmitari V.I. po ashtu sqaroi këto fakte (shih procesverbalin e datës 20/4/2015, nga faqja 10 deri në faqen 12; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

**G.K.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es A.Ç.:

Ky individ (i lindur me datë... i shtetësisë turke, siç edhe konfirmoi dëshmitari V.I. – shih procesverbalin e datës 20/04/2015, faqe 14) udhëtoi për në Kosovë, dhe erdhi me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 18/9/2012 në orën 8 të mbrëmjes (shih nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143). Skanimi i pasaportës së këtij individi u dërgua përmes postes elektronike nga ana e M.Gu. [adresa elektronike] me datë 16/6/2012 në adresën elektronike të A.Ç.-es; dëshmitari V.I. po ashtu sqaroi këto fakte (shih procesverbalin e datës 20/4/2015, faqe 10 deri në faqen 12; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

**M.P. dhe E.P.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Këta individ, (M.P. dhe E.P.) arritën në Kosovë së bashku, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 19/09/2012 në orën 08.20, dhe më pas largohen me autobus përmes vendkalimit kufitar të Hanit të Elezit me datë 20/9/2012, në orën 4.44 minuta pasdite dhe hynë sërish në këmbë në orën 5.59 dhe 6 të pasdites. Ata përfundimisht largohen nga Kosova nga vendkalimi kufitar Kulla e Pejës, me automobil, me datë 22/9/2012, në orën 3.44 minuta (shih nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqet 135-143). Lidhur me këta 2 individ A.Ç. pranoi një emai me datë 17/9/2012 nga O.S. në [adresa elektronike] me pasaporta të skanuara të të njëjtëve persona dhe me datë 19/09/2012 nga A.Be. përmes [adresa elektronike] letra e garancisë për njëjtët individ, lëshuar nga M.By. dhe me datë 22/9/2012 ai dërgoi një email te hotel Villa Osa, në Mostar, Bosnje dhe Hercegovinë, [adresa elektronike] ku bëri rezervime për ta për periudhën kohore nga data 23 deri me datën 25/9/2012 dhe nga e njëjta adresë elektronike ai mori konfirmimin për rezervimin në fjalë mu të njëjtën ditë. Nga adresa e tij elektronike, A.Ç. po ashtu me datë 19/09/2012 i dërgoi O.S. përmes [adresa elektronike] letër garancitë; dëshmitari V.I. po ashtu sqaroi këto fakte (shih procesverbalin e datës 19/3/2015, faqe 6, 14, 1512; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

**M.S.D.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Ky individ (i lindur me datë... i shtetësisë turke, po ashtu e konfirmuar nga dëshmitari V.I. – shih procesverbalin e datës 20/04/2015, faqe 13) udhëtoi në Kosovë, erdhi me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 20/9/2012 në orën 8.34 minuta të mbrëmjes (shih nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës, 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143). Pasaporta e skanuar e këtij individ iu dërgua me datë 17.09.2012 përmes adresës elektronike book [adresa elektronike] në adresën elektronike të A.Ç.-es; dëshmitari V.I. po ashtu sqaroi këto fakte (shih procesverbalin e datës 20/4/2015, faqe 13; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

## **F.U. dhe H.E.: A.Ç. / A.M.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Këta individ F.U. dhe H.E., që të dy turq) arritën në Kosovë së bashku, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 25/09/2012 në orën 3.59 minuta pasdite, dhe u larguan me autobus përmes vendkalimit kufitar të Kullës së Pejës me datë 26/9/2012, në orën 10.01 minutë të mëngjesit (dëshmitari A.R. i konfirmoi këto lëvizje, shih procesverbalin e datës 16/6/2015, faqe 14; shih nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143). Lidhur me këta 2 individ A.Ç. pranoi një email me datë 19/9/2012 nga O.S. në [adresa elektronike] me pasaporta të skanuara të të njëjtëve persona dhe me datë 19/09/2012 dhe në datën 26/9/2012 ai dërgoi një email në hotel Villa Osa, në Mostar, Bosnje dhe Hercegovinë, [adresa elektronike] ku bëri rezervime për ta për periudhën kohore nga data 27/9 deri me datë 1/10/2012 dhe nga e njëjta adresë elektronike mori konfirmimin për rezervimin në fjalë mu të njëjtën ditë që e bëri atë (dëshmitari A.R. konfirmoi këto fakte, shih procesverbalin e datës 16/6/2015, faqe 15).

Me datë 20/09/2012 A.Ç. i kishte dërguar A.M.ut në adresën elektronike [adresë elektronike] pasaportat e skanuara (ashtu siç konfirmoi dëshmitari V.I., shih procesverbalin e datës 20/04/2015, faqe 7; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17) dhe me datë 22/09/2012, para arritjes së këtyre individëve në Kosovë, ai ia dërgoi O.S. në adresën [adresa elektronike] letër garancitë e lëshuara nga ana e M.Bo. Po ashtu është me rëndësi një përgjim telefonik nga numri i telefonit të A.Ç.-es që mbaron me numrat 818 me S.S.u, shih 15 dosjet e policisë, dosjen e policisë file 1, lidhjen 12.1, faqe 138, me datë 25/09/2012 në orën 15:54 minuta, kur S.S. përmend që ata po presin në bordin e ardhjeve, por se asnjë udhëtarë akoma nuk po del. Ai duhet të merr me vete H.E. dhe F.U.

Sa i përket A.M.ut:

Marrja e e-mail-it të përmendur nuk do jetë i mjaftueshëm që të vërtetoj përfshirjen e A.M.ut në kontrabandë të këtyre 2 individëve, po ashtu sepse letër garancitë nuk janë lëshuar nga ai por nga ana e M.Bo.it.

Si do që të jetë, më në atë ditë të arritjes, 25/9/2012, para arritjes, gjatë dhe pas arritjes pati biseda të ndryshme mes A.Ç.-es dhe A.M.ut (do të thotë mes orës 14.21 minuta dhe 16.26 minuta, nga faqja 316 deri në faqen 345 lidhja 5 e 64 dosjeve të përgjimeve / dosja e përgjimit vëllimi 25 A ); vlen po ashtu të theksohet se vetëm të shkosh në aeroport nuk është vepër penale (më vonë do të përmendet përsëri), por se është po qe se është pjesë e ekzekutimit të një vepre penale dhe lidhur me këtë është me rëndësi të thuhet se lloji i bisedës vetvetiu tregon se ata vetë

ishin shumë mirë në dijëni se po bënin diçka në kundërshtim me ligjin, duke u munduar që të përdorin formulime të nënkuptueshme në bisedat e tyre, biseda që nga pikëpamja objektive nuk janë të qarta normalisht.

Në këto biseda ne shohim. Përpos atyre që tashmë i përmendëm më herët, se së pari ata diskutojnë kohën e arritjes (që përputhet perfektë me kohën e arritjes që u përmend më sipër sipas raportit të SMK-së), A.M.u diskuton me A.Ç. se a është dërguar apo jo kontakti i një pasagjeri, çka do të ndodhë tutje, pastaj A.M.u shkon në aeroport, më pas në një bisedë tjetër e njofton A.Ç. se ai akoma është duke pritur, më vonë A.Ç. i thotë A.M.ut ta qoj atë burrin brenda në çka A.M.u i thotë se burri është tashmë brenda, etj.

Në të vërtetë, mu me të njëjtin aeroplan po ashtu arritën E.Si., V.Oz. dhe S.C. (që A.M.u pranoi t'i ketë marr nga aeroporti, i morri ata, erdhi në Prizren dhe i vendosi ata në "Holiday" Hotel, dhe më pas ata shkuan në Shqipëri, qëndruan atje pakë kohë dhe u kthyen – shih procesverbalin e datës 18/12/2015, faqe 3/4) por se nuk u lejuan që të dalin nga aeroporti (megjithatë do kthehemi më vonë lidhur me këta migrantë) dhe kjo sqaron jo vetëm përmbajtjen e bisedave të cekura më sipër por edhe lind pyetjen se përse sipas raportit në SMK-së ata përsëri hynë ditën tjetër, me datë 26/9/2012.

Për ngjarjet e kësaj pasditeje, të datës 25/9/2012 shih 64 dosjet e përgjimeve / dosjen e përgjimit vëllimi 25 A dhe po ashtu raportin mbi vëzhgimin të datës 26/9/2012 mbi faktet e pragut të datës (25/9/2012), që mund të gjenden në 15 dosjet e policisë, dosja e policisë 1, lidhja 12.1, faqe 137/138.

#### **U.K.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Ky individ (i lindur me datë...) arrin në Kosovë, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 19/09/2012 në orën 8.19 minuta të mëngjesit, dhe më pas largohet me autobus përmes vendkalimit kufitar të Hanit të Elezit me datë 20/9/2012 në orën 4.44 minuta pasdite, dhe hynë serish në këmbë përmes të njëjtit kufi dhe në të njëjtën ditë, në orën 5.58 minuta pasdite, dhe del me automobil në vendkalimin kufitar të Kullës së Pejës me datë 22/9/2012, në orën 3.44 minuta pasdite (dëshmitari V.I. i konfirmoi këto lëvizje, shih procesverbalin e datës 15/4/2015, faqe 11; shih nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC e datës 17/01/2013, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143). Lidhur me këtë individ, A.Ç. pranoi një email me datë 19/9/2012 nga adresa elektronike e A.Be. [adresa elektronike] me letër garanci të lëshuar nga ana e M.By.t (dhe po të njëjtën ditë ai përmes email të njëjtën letër garancie ia dërgoi O.S. në adresën [adresa elektronike] – ky individ arriti në Kosovë mu atë mbrëmje, në orën 8.19 minuta të mbrëmjes) dhe me datë 22/9/2012 ai dërgon një email në hotel Villa Osa, në Mostar, Bosnje dhe Hercegovinë, [adresa elektronike] ku bëhet rezervimi për periudhën kohore nga data 23 deri me datën 25/9/2012 dhe nga e njëjta adresë elektronike ai merr konfirmimin e rezervimit të njëjtën

ditë që e bëri atë (dëshmitari V.I. konfirmoi këto fakte, shih procesverbalin e datës 15/4/2015, p. 11; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

**I.T.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Ky individ (i lindur me datë...) arriti në Kosovë, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 21/09/2012 në orën 8.01 minuta të mbrëmjes, dhe më pas largohet me autobus në vendkalimin kufitar të Kullës së Pejës me datë 22/9/2012, në orën 10.11 minuta të mëngjesit (shih nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143). Lidhur me këtë individ, A.Ç. merr një email me datë 20/9/2012 nga adresa elektronike e O.S. [adresa elektronike] pasaportën e skanuar të këtij individ – i cili arriti në Kosovë ditën tjetër (shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

**E.Si., V.Oz. dhe S.C.: A.Ç. / A.M.**

Sa i përket A.Ç.:

Këta individë (E.Si., V.Oz., me shtetësi turke) arritën në Kosovë, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 25/09/2012 në orën 3.59 minuta pasdite (V.Oz. në orën 3.58 minuta pasdite) dhe përsëri me aeroplan në të njëjtin aeroport ditë e nesërme por se në orën 1.12 pasdite (nuk ka shënime për dalje pas hyrjes së parë), dhe më pas hynë përsëri me automobil në vendkalimin kufitar të Vërmicës me datë 27/09/2012 në orën 2.33 minuta të mëngjesit (nuk ka shënime për dalje pas hyrjes së dytë) dhe largohet me motoçikletë përmes vendkalimit kufitar të Kullës së Pejës po ashtu me datë 27/9/2012, në orën 10.12 minuta të mbrëmjes (fakte të adresuara nga ana e dëshmitarit A.R. – shih procesverbalin e datës 16/06/2015, faqe 13-15; shih nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143).

Lidhur me E.Si., A.Ç. merr një email me datë 20/9/2012 (dhe me datë 22/09/2012 lidhur me V.Oz.) nga adresa elektronik e O.S. [adresa elektronike] me pasaportat e skanuar të këtyre individëve – të cilët arrijnë në Kosovë 5 ditë më vonë dhe ditë e arritjes (25/09/2012) A.Ç. pranon po ashtu një email nga A.Oz. në [adresë elektronike] (të njëjtin email sikur i pandehuri A.M.) letër garancitë e lëshuara nga M.Haj. (sikur ajo e një dite më parë, me 24/09/2012 A.Ç.

kishte dërguar emailin me pasaportat që kishte pranuar, email-in që e dërgoi në [adresë elektronike]); po ashtu ditën që A.Ç. i mori letër garancitë, me datë 25/09/2012, ai i përcolli ato tek O.S. në [adresa elektronike]. A.Ç. gjithashtu bëri një rezervim përmes postës elektronike në Villa Osa, Mostar, Bosnje dhe Hercegovinë nda data 28/9 deri me datën 2/10/2012 (fakte të adresuara nga dëshmitari V.I. – shih procesverbalin e datës 20/4/2015, faqe 7 dhe 13, dhe më vonë nga A.R. – shih procesverbalin e datës 16/6/2012, faqe 15; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

Megjithëse lidhur me individin S.C. (i lindur me datë..., me shtetësi turke) ka lëvizje të tjera të kalimit të kufirit, siç tregohen përmes raportit të SMK-së (shih faqen 5), ato që u përshkruan më sipër për E.Si. dhe V.Oz. gjithashtu vlejnë edhe për individin në fjalë (në bazë të raportit të SMK-së, faqes 5): në fakt, S.C. arriti në Kosovë, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 25/09/2012 në orën 9.43 minuta të mëngjesit, u largua me automobil në kufirin e Hanit të Elezit në orën 10.49 minuta të mëngjesit me datë 26/6/2012, pastaj hynë përsëri me automobil përmes vendkalimit kufitar të Vërmicës me datë 27/09/2012 në orën 2.33 minuta pasdite dhe largohet me motoçikletë kah pika e kalimit të kufirit në Kullë të Pejës po ashtu me datë 27/9/2012, në orën 10.12 minuta të mëngjesit.

Po ashtu lidhur me S.C., A.Ç. morri një email me datë 22/9/2012 nga adresa elektronike e O.S. [adresa elektronike] me pasaportën e skanuar të këtij individ – i cili erdhi në Kosovë pas 3 ditëve dhe në prag të arritjes (24/09/2012) A.Ç. merr po ashtu një tjetër pasaportë të skanuar nga B.R. nga [adresa elektronike] dhe ditën e arritjes ai merr nga A.Oz. nga [adresë elektronike] (të njëjtin email si i pandehuri A.M.) letër garancitë e lëshuara nga M.Haj. (si të një dite më parë, me datë 24/09/2012 A.Ç. kishte dërguar këtë email me pasaportat që i kishte pranuar, email-in e dërgoi në [adresë elektronike]); po ashtu ditën e arritjes, A.Ç. letër garancinë ia dërgoi O.S. në [adresa elektronike]. A.Ç. gjithashtu bëri një rezervim (me datë 28/09/2012 përmes adresës elektronike në [adresa elektronike]) përmes adresës elektronike në Villa Osa, Mostar, Bosnje dhe Hercegovinë, nga data 28/9 deri me datën 2/10/2012 (fakte të adresuara nga dëshmitari V.I. – shih procesverbalin e datës 20/4/2015, faqe 7, dhe më vonë nga A.R. – shih procesverbalin e datës 16/6/2012, faqe 15; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqet 1-17).

Sa i përket A.M.ut:

Sa i përket të pandehurit A.M.ut, përpos përfshirjes të paraqitura përmes korrespondencave elektronike, të njëjtën ditë të arritjes së parë me datë 25/9/2012 (në orën 3.59 minuta pasdite) në orën 16.23 minuta, ai është përgjuar duke folur me A.Ç. ku thotë se ishte

akoma jashtë aeroportit duke pritur (shih 15 dosjet e policisë, dosjen e policisë 1, lidhjen 2.1, faqen 138 thirrja telefonike nga A.Ç. te A.M. në orën 16:23:25 sekonda, dhe kjo është nga raporti i vëzhgimit, ku A.M.a njofton A.Ç. se ai akoma ishte duke i pritur edhe tre migrantë të tjerë dhe se akoma po priste jashtë aeroportit).

Për të iu shmangur përsëritjeve të panevojshme të arsyetimit, shihni më sipër arsyetimin për F.U. dhe H.E. për hollësi të mëtejme.

**A.Akd. dhe C.D.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Këta individ (A.Akd., C.D.) arritën në Kosovë, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 21/09/2012 në orën 8.02 minuta të mbrëmjes, dhe ditën e nesërme në orën 10.11 minuta të mbrëmjes largohet me autobus kah vendkalimi kufitar i Kullës së Pejës (fakte që adresohen nga dëshmitari V.I. – shih procesverbalin e datës 15/04/2015, faqe 12; shih nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143).

A.Ç. morri një email me datë 20/9/2012 nga adresa elektronike e O.S. si [adresa elektronike] me pasaportën e skanuar të këtyre individëve – të cilët arritën në Kosovë ditën tjetër dhe në ditën e arritjes A.Ç. pranoi po ashtu përmes adresës elektronike nga A.Be. në [adresa elektronike] letër garancitë e lëshuara nga M.Haj. pasi që i kishte dërguar pasaportat e skanuar në [adresë elektronike] e njëjtë si ajo e të pandehurit A.M.); po ashtu, ditën që A.Ç. morri letër garancitë, me datë 25/09/2012, ai ia përcolli ato O.S. në [adresa elektronike] (fakte të adresuara nga dëshmitari V.I. – shih procesverbalin e datës 20/4/2015, faqe 7 dhe të datës 15/4/2012, faqe 13; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

Lidhur me A.M. (duke pasur parasysh përmendjen e bërë në adresën elektronike [adresë elektronike]):

Marrja e korrespondencës elektronike të përmendur më sipër nuk do jetë e mjaftueshme për të vërtetuar përfshirjen e A.M.ut në kontrabandë të këtyre 2 individëve, po ashtu edhe për atë që letër garancitë nuk u lëshuan nga ai por nga M.Haj.

**D.B.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Ky individ (i lindur me datë...) arriti në Kosovë, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 18/09/2012 në orën 7.59 minuta të mbrëmjes dhe ditën tjetër në orën 3.21 minuta pasdite

largohet me automobil përmes vendkalimit kufitar të Kullës së Pejës (fakte të adresuara nga dëshmitari V.I. – shih procesverbalin e datës 15/04/2015, faqe 14; shih po ashtu edhe nga policia e EULEX-it, Raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143).

A.Ç. dërgon një email me datë 23/09/2012 në [adresa elektronike] ku bënë një rezervim me këtë emër në Nirvana Rooms, Split, Kroaci, për periudhën kohore nga data 23 deri me datën 26/9/2012 (lidhur me çka është dëgjuar dëshmitari V.I.; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

### **S.Al. dhe M.Ka.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Këta individ (S.Al. dhe M.Ka.) arritën në Kosovë së bashku, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 26/09/2012 në orën 7.50 minuta, respektivisht në orën 7.49 minuta (dëshmitarja M.J. konfirmoi këto lëvizje, shih procesverbalin e datës 15/10/2014, faqe 6, po ashtu edhe dëshmitari V.I. konfirmoi këto lëvizje, shih procesverbalin e datës 19/3/2015, faqe 12; shih nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosjen e policisë PINK 2, vëllimin 6, lidhjen 5, faqe 135-143). Lidhur me këta 2 individë, A.Ç. mori një email me datë 25/9/2012 nga O.S. në [adresa elektronike] me pasaportat e skanuara të të njëjtëve persona dhe i mori përsëri me datë 26/09/2012 nga O.A. në [adresa elektronike] (shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

Po ashtu lidhur me këta dy individë, me datë 26/09/2012 A.Ç. me datë 26.09.2012 ia dërgoi një email O.S. në [adresa elektronike] lidhur me kartelën identifikuese të Star Mobilja Company, Novi Pazar, Serbi (siç e përmend po ashtu edhe dëshmitari V.I., shih procesverbalin e datës 19/03/2015, faqe 12) dhe ditën e njëjtë dërgoi një tjetër në [adresa elektronike] me pasaportat e skanuar dhe letrat e garancisë të lëshuara nga Star Mobilja Company (siç e përmend po ashtu edhe dëshmitari V.I., shih procesverbalin e datës 15/10/2014, faqe 7).



**(5)- Në periudhën kohore të tetorit të vitit 2012 kontrabandë e migrantëve në vijim duke organizuar udhëtimin e tyre dhe hyrjen në Kosovë si vend kalimtar për në vendet tjera si destinacione të fundit:**

**I.YI.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Ky individ (i lindur me datë...) arriti në in Kosovë, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 26/10/2012 në orën 8.06 minuta të mëngjesit, dhe largohet me autobus nëpër vendkalimin kufitar të Gllobocices me datë 27/10/2012 në orën 4.47 minuta pasdite (dëshmitarja M.J. konfirmoi këto lëvizje, shih procesverbalin e datës 15/10/2014, faqe 5, dhe dëshmitari V.I. gjithashtu i konfirmoi këto lëvizje, shih procesverbalin e datës 19/3/2015, faqe 13 dhe 2/12/2014, faqe 14; shih nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143). Lidhur me këtë individ A.Ç. mori një email me datë 24/09/2012 nga S.Ku. në [adresa elektronike] me pasaportën e skanuar të personit në fjalë, të cilin ai e përcolli më tej të njëjtën ditë tek M.C. në adresën elektronike [adresa elektronike], i cili po ashtu ditën e nesërme (25/9/2012) ia dërgoi nga adresa elektronike [adresa elektronike] A.Ç.-es ftesën për individin në fjalë (dëshmitari V.I., në procesverbalin e datës 19/03/2015, faqe 13, po ashtu përmendi letër garancitë e lëshuara nga Star Mobilja Company dhe të dërguara nga A.Ç. në [adresa elektronike] me datë 28/09/2012; po ashtu dëshmitarja M.J., në procesverbalin e datës 15/10/2014, faqe 4, po ashtu iu referua letër garancisë të lëshuar nga ana e Star Mobilja Company dhe të dërguara nga A.Ç. përmes postes elektronike në adresën [adresa elektronike] me datë 29/09/2012).

Me datë 04/10/2012 A.Ç. ia dërgoi një email O.S. në [adresën elektronike] ku bëri një rezervim në Hotel Evropa, Podgoricë, Mal i Zi nga data 5 deri me datën 8/10/2012 (dhe mori konfirmimin të njëjtën ditë, duke e përcjell më tej në [adresën elektronike]) dhe me datë 29/10/2012 ai bëri rezervim në Nirvana Rooms duke dërguar ia dërguar një email N.P. në [adresa elektronike] nga data 30/10 deri me datën 2/11/2012 dhe ai morri një email me konfirmim të njëjtën ditë, 29/10/2012 (dëshmitari V.I., në procesverbalin e datës 19/03/2015, faqe 13, dhe dëshmitarja M.J., në procesverbalin e datës 15/10/2014, faqe 4, adresuan këto emaile; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëllim 3, lidhja 1, faqe 1-17). Po ashtu V.I., me datë 19/03/2015 (shih procesverbalin në fjalë, faqe 16) konfirmoi përgjimin e thirrjes telefonike mes A.Ç.-es dhe M.C. me datë 25/09/2012 në orën 11.19 minuta.

Po ashtu lidhur me këtë migrantë ekzistojnë mesazhe të përgjuara të rëndësishme, siç përmenden në rastet tjera, me datë 25/10/2012 në orën 20.50 minuta A.Ç. i dërgoi një sms mesazh A.M.ut me emrat, do të thotë të: “(...) A.Ar., M.Y., S.Baj., dhe I.Yl.”.

Sa i përket A.M.ut: trupi gjykues është i mendimit marrja e një sms mesazhi me emrin e individit nuk është e mjaftueshme që të vërtetohet, lidhur me këtë dhe këtë rast, përgjegjësin e tij penale; kur u morë në pyetje lidhur me këtë, dëshmitari V.I. nuk ishte në gjendje të siguroj më shumë hollësi - shih procesverbalin e datës 15/04/2015, p.5.

**C.C.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Ky individ (i lindur me datë...) arriti në Kosovë, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 12/10/2012 në orën 20.41 minuta (dëshmitari V.I. konfirmoi këtë gjë, shih procesverbalin e datës 19/03/2014, faqe 12; shih nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143). Lidhur me këtë individ A.Ç. mori një email me datë 27/9/2012 nga O.S. përmes [adresa elektronike] me pasaportë të skanuar dhe me datë 28/9/2012 A.Ç. ia dërgoi atij në të njëjtën adresë elektronike letër garancinë e lëshuar nga Star Mobilja Company (dëshmitari V.I. e përmend këtë, shih procesverbalin e datës 19/03/2015, faqe 12; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

**E.B.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Ky individ (i lindur me datë...) arriti në Kosovë, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 4/10/2012 në orën 12.09 minuta (dëshmitari V.I. konfirmoi këtë gjë, shih procesverbalin e datës 15/04/2014, faqe 14; shih nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143). Lidhur me këtë individ A.Ç. mori një email me datë 29/9/2012 nga O.S. përmes [adresa elektronike] me pasaportë të skanuar (shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

**N.S.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Ky individ (i lindur me...) arriti në Kosovë, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 4/10/2012 at 19.56 h. Dhe u largua me automobil përmes pikës kufitare të Kullës së Pejës me datë 5/10/2012 në orën 16.52 minuta (dëshmitari V.I. gjithashtu i konfirmoi këto lëvizje, shih procesverbalin e datës 20/4/2015, faqe 14; shih nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143). Lidhur me këtë individ A.Ç. morri një email me datë 02/10/2012 nga H.Si. me [adresa elektronike] me pasaportë të skanuar të personit në fjalë, dhe me datë 04/10/2012 merr një tjetër nga J.S. me [adresa elektronike] me një letër garancie të lëshuar nga ana e E.Y.. Me datë 06/10/2012 A.Ç. dërgon një email në [adresa elektronike] ku bënë rezervime për datën 8/10/2012 dhe merr një email me konfirmim me datë 7/10/2012; me datë 08/10/2012 dërgoi një email ku bëri një rezervim në [adresa elektronike] (fakte të konfirmuara nga dëshmitari V.I., në procesverbalin e datës 20/04/2015, faqe 14; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

**V.A.: A.Ç. / A.M.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Ky individ (me shtetësi turke, i lindur me datë...) arriti në Kosovë, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 17/10/2012 në orën 3.54 minuta pasdite dhe u largua me autobus nëpër pikën e vendkalimit kufitar të Gllobocicës me datë 18/10/2012 në orën 3.54 minuta pasdite (dëshmitari V.I. gjithashtu i konfirmoi këto lëvizje, shih procesverbalin e datës 20/4/2015, faqe 15; shih nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143). Lidhur me këtë individ A.Ç. morri një email me datë 11/10/2012 nga O.S. përmes [adresa elektronike] me pasaportën e skanuar të personit në fjalë, të cilin email të njëjtën ditë ai e përcolli më tej tek M.C. dhe me datë 15/10/2012 nga H.Ki. nga [adresa elektronike] ai përsëri morri një pasaportë të skanuar, të cilin email ai e përcolli më tej me datë 16/10/2012 tek A.M. në [adresa elektronike] (dëshmitari V.I., në procesverbalin e datës 10/08/2015, faqe 15/16, po ashtu iu referua këtyre emaileve). Me datë 26/10/2012 A.Ç. e dergoi një email tek Nirvana Rooms duke ia dërguar një email N.P. në [adresën elektronike] ku bëri një rezervim për individin në fjalë nga data 26 deri me datën 29/10/2012, dhe merr një email me konfirmim të njëjtën ditë (dëshmitari V.I., në këtë procesverbal iu adresohet këtyre emaileve; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 –

11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

Sa i përket A.M.ut:

Po ashtu lidhur me këtë migrant ka mesazhe të përgjuara me rëndësi, siç u përmenden në raste të tjera, me datë 25/10/2012 në orën 20.50 minuta A.Ç. ia dërgoi një sms mesazh A.M. me emra, që do të thotë: “(...) A.Ar., M.Y., S.Baj., dhe I.Yl.”. Në rastin e këtij individ, megjithatë, trupi gjykues është i mendimit se marrja e një sms mesazhi me emrin e individit së bashku me përmbajtjen e përgjimeve telefonike mes A.M.ut dhe A.Ç.-es lidhur me individin në fjalë (do të thotë të datës 5/11/2012, at 22.26 h. – shih 64 dosjet e përgjimeve, dosjen 62, lidhjen 9, faqe 435 dhe më tej) është e mjaftueshme që të vërtetohet, sa i përket këtyre, përgjegjësinë penale si i angazhuar në kontrabandën e tij.

**H.Yu., D.K. and A.D.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Këta individë (të lindur me datë...respektivisht me datë...) arritën në Kosovë, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 11/10/2012 në orën 20.27 minuta dhe i treti në orën 20.28 minuta (dalja e tyre nuk është e shënuar; shih nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143). Lidhur me këta individë A.Ç. mori një e-mail me datë 09/10/2012 nga [adresa elektronike] me letra garancie të skanuara të lëshuara nga ana e Xh.H.t (shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

**L.B.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Ky individ (i lindur me datë...) arriti në Kosovë dhe më pas u largua me automobil përmes pikës së vendkalimit kufitar Kullës së Pejës, me datë 5/10/2012 në orën 16.52 minuta, dhe hynë përsëri me automobil përmes vendkalimit të njëjtë, pra me datë 5/10/2012, në orën 18.08 minuta, dhe u largua me autobus duke shfrytëzua të njëjtin kufi me datë 9/10/2012 në orën 16.22 (fakte të adresuara nga dëshmitari V.I. – shih procesverbalin e datës 20/04/2015, faqe 15; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143).

A.Ç. dërgoi një email ku bëri rezervime për këtë individ me datë 11/10/2012 në rezervime të Hotel Rosa, Mostar, Bosnje dhe Hercegovinë (nga data 10 deri me datën

17/10/2012) dhe një tjetër me datë 17/10/2012 në [adresa elektronike] ku bëri një rezervim me emër të tillë në Nirvana Rooms, Split, Kroaci, për periudhën kohore nga data 17 deri me datë 21/9/2012 (për çka u dëgjua dëshmitari V.I.; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

**I.Pol.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Ky individ (i lindur me datë...) arriti në Kosovë, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 8/10/2012 në orën 8.38 minuta, dhe largohet me automobil përmes vendkalimit kufitar të Kullës së Pejës me datë 9/10/2012 në orën 16.22 minuta (dëshmitari V.I. po ashtu i konfirmoi këto lëvizje, shih procesverbalin e datës 20/4/2015, faqe 15; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143).

A.Ç. dërgoi një email ku bëri rezervime për këtë individ me datë 11/10/2012 në rezervime të Hotel Rosa, Mostar, Bosnje dhe Hercegovinë (nga data 10 deri me datën 10/2012) dhe një tjetër me datë 17/10/2012 në [adresa elektronike] ku bëri një rezervim me emër të tillë në Nirvana Rooms, Split, Kroaci, për periudhën kohore nga data 17 deri me datë 21/9/2012 (për çka u dëgjua dëshmitari V.I. sipas procesverbalit të datës 20/4/2015, faqe 16; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

**S.Sa. dhe S.Ba.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Këta individ (i pari me shtetësi turke, i lindur me datë..., dhe i dyti i lindur me datë...) arritën në Kosovë, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 15/10/2012 në orën 8.17 minuta, respektivisht në orën 8.18 minuta të mbrëmjes, dhe largohet me autobus përmes vendkalimit kufitar të Gllobocicës me datë 16/10/2012 në orën 4.33 minuta pasdite (dëshmitari V.I. i konfirmoi këto lëvizje, shih procesverbalin e datës 20/4/2015, faqe 16; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosjen e policisë PINK 2, vëllimin 6, lidhjen 5, faqet 135-143). Lidhur me këta individë, A.Ç. morri një email me datë 12/10/2012 nga M.Met. me adresë elektronike [adresa elektronike] me pasaporta të skanuar të personave në fjalë (dëshmitari V.I., në procesverbalin e datës 20/04/2015, faqe 16/17, iu referua po ashtu këtyre e-maileve; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi

përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

**A.Bi.: A.Ç. / M.B.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Ky individ (me shtetësi turke, i lindur me datë...) arriti në Kosovë, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 22/10/2012 në orën 7.50 minuta të mbrëmjes, (këto lëvizje i konfirmoi po ashtu dëshmitari V.I., shih procesverbalin e datës 20/4/2015, faqe 17; shih po ashtu për këtë nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143).

Lidhur me këtë individ A.Ç. merr një e-mail me datë 20/10/2012 nga H.A.Y. me [adresë elektronike] me pasaportën e skanuar. Gjithashtu, A.Ç. dërgoi një email ku bënë një rezervim për këtë individ, me datë 24/10/2012 në [adresë elektronike], në Hotel Rosa, Mostar, Bosnje dhe Hercegovinë (nga data 25 deri me datën 29/10/2012) dhe një tjetër me datë 26/10/2012 në [adresa elektronike] ku bëri një rezervim me emër të tillë në Nirvana Rooms, Split, Kroaci, për periudhën kohor nga data 26 deri me datën 29/10/2012 dhe mu të njëjtën ditë merr konfirmimin për rezervimin nga N.P. përmes adresës elektronike të [adresë elektronike] (për çka është marr në pyetje dëshmitari V.I. me datë 20/4/2015, faqe 8 e procesverbalit; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

Sa i përket M.B.t:

Trupi gjykues vërteton përfshirjen e M.B.t në kontrabandën e këtij individ.

Ky individ arriti me datë 22/10/2012 dhe tri ditë përpara me datë 19/10/2012, në orën 14.21 minuta, A.Ç. nga [numri i telefonit] thirri [numrin] që i përket M.B.t (në atë kohë i identifikuar vetëm me termin “mashkull”) dhe mes gjërave të tjera në një moment biseda zhvillohet kështu: A.Ç.: në Turqi; Mashkulli: jo, në Kosovë në zyrën për punë të jashtme, javën e kaluar dy migrantë të mi u kthyen ja sepse; A.Ç.: aha i madhi, i madh i vogël; Mashkulli: aha dy 17-18 vjeç; A.Ç.: aha, aha, tani mund ti fusësh në kompjuter ata mund të vijjnë me datë 22; Mashkulli:2; A.Ç.: 21-22 ata than kështu, dhe unë them se ne duhet të jemi të kujdesshëm, unë nuk dua që ta ngatërroj; Mashkulli: po të duan ata do të i lirojnë dhe t’i përcjelli ata, kjo ka ndodh edhe vitin e kaluar; A.Ç.: ne duhet të jemi të kujdesshëm, ne duhet t’i dërgojmë ata në shtëpi (shih 64 dosje të përgjimit, dosja e përgjimit 61, lidhja 2/2.1, nga faqja 124 deri në faqen 128).

Disa ditë më vonë, me datë 21/10/2012, në orën 15.59 minuta, A.Ç. nga [numri i telefonit dërgoi një sms mesazh në [numrin] që i përket M.B. me këtë përmbajtje: “A.Bi. [i lindur me datë] Konya” dhe siç mund të shohim është data e lindjes së këtij individual, siç u përmend më sipër së bashku me nacionalitetin e tij (shih 64 dosje të përgjimit, dosja e përgjimit 44, lidhja 3, faqe 158).

Ditën e arritjes me datë 22/10/2012, në orën 13.41 minuta (para arritjes, atë mbrëmje pas orës 7 pasdite), përsëri A.Ç. nga [numri i telefonit] thirri [numrin] ë i përket M.B.t dhe në një moment A.Ç. thotë: jo, ai nuk mundet, sa para ia dha atij njeriu që ai po thotë unë e qes jashtë sot; “Mashkulli”: 320 Euro, ai morri 320 Euro; A.Ç.: sa para i ka tani?; Mashkulli: 350 Euro; A.Ç.: kur nuk është e sigurt me ta, ata bëjnë njëjtë si ti, së pari flasin të gjithë dhe ata nuk ndalen kur në 3, ata sigurisht se do ta kapin edhe një tjetër 100 lira që ta ndreq punën, a më kuptove?; Mashkulli: po, t’kuptova; A.Ç.: me këtë rast si e ke familjen?; Mashkulli: ata janë rrugës për të shkuar, a e mban mend që njëri që u kthye nga Kosova?; A.Ç.: cili, nuk e di; Mashkulli: a të kam tregu që 3 janë kthyer, po i qoj sonte, a është në rregull? Po i qoj në Tiranë; A.Ç.: po; Mashkulli: Tiranë, Shqipëri; A.Ç.: Aha. (–shih 64 dosje të përgjimit, dosja e përgjimit 61, lidhja 2.1, nga faqja 134 deri në faqen 140).

**I.D.: A.Ç. / A.M. /A.B.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Ky individ (i lindur me datë...) arriti në Kosovë, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 23/10/2012 në orën 3.42 minuta pasdite dhe u largua me autobus nëpër vendkalimin kufitar të Gillobocicës me datë 24/10/2012 në orën 4.43 minuta pasdite (dëshmitarja M.J. konfirmoi këto lëvizje, shih procesverbalin e datës 10/11/2014, p. 18; shih po ashtu për këtë nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143). Lidhur me këtë individ, A.Ç. morri një email në prag të arritjes, me datë 22/10/2012 nga O.S. në adresën elektronike [adresa elektronike] me pasaportën e skanuar të personit në fjalë, të cilën ai e përcolli më tej të njëjtën ditë në adresën elektronike [adresë elektronike] (të shfrytëzuar nga A.M.) dhe atë ditë me datë (22/10/2012) A.Ç. morri nga [adresa elektronike] një rezervim për Hotel Holiday në Prizren për periudhën kohore 23-30/10/2012 dhe A.Ç. ia e përcolli këtë rezervimin O.S. në adresën [adresë elektronike] po ashtu me datë 22/10/2012 (dëshmitari V.I. iu referua këtyre emaileve, në procesverbalin e datës 20/04/2015, faqe 8, shih po ashtu procesverbalin e datës 10/9/2014, faqe 18, dhe 25/9/2014, faqe 19 dhe 10 nëntor 2014, faqe 18; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

Sa i përket A.M.ut:

Pranimi i këtij e-mail me pasaportë të skanuar të personit në fjalë, të përmendur më sipër, nuk do jetë e mjaftueshme që të vërtetohet përfshirja e A.M.ut në kontrabandë. Megjithatë, po ashtu nga [adresa elektronike], kësaj here nga [adresë elektronike], ai i dërgoi A.Ç.-es një rezervim për Hotel Holiday (rezervim të cilin i pandehuri e pranoi) në Prizren, për periudhën kohore të datës 23-30/10/2012, kurse A.Ç. këtë rezervim ia përcolli më tej O.S., dhe përfshirja e A.M.ut është pjesë e ekzekutimit të veprës penale.

Sa i përket A.B.:

Me datë 24/10/2012 (një ditë pas ardhjes në Kosovë), në orën 14.26 minuta, A.Ç. duke përdorur numrin [numrit të telefonit] thirri A.B. në [numrin] dhe biseda shkoi kështu: A.B.: alo!; A.Ç.: të bekoftë Allahu me paqe!; A.B.: faleminderit vëlla, çka je duke bërë?; A.Ç.: Të faleminderit, jam rrugës për në stacion; A.B.: ku: A.Ç.: jam rrugës për në stacion, po të vjen, vëllai i shokut tendë, a më kuptove?; A.B.: kush, cili?; A.Ç.: ai është duke ardhur, Ibrahim Dunder; A.B.: ku, këtu?; A.Ç.: po, së pari në Gostivar dhe më pas ti e di; A.B.: mirë, mirë, dërgoma numrin, që ta thërras, a i ke tregu, a ia ke dhënë numrin tim atij?; A.Ç.: Ia dhashë, ia dhashë, ia shkrova; A.B.: aha, le të më thërret, sa po të dalë, thuaj le të ma cingëroj e unë mandej do ta thërras menjëherë deri më tani nuk problem; A.Ç.: mirë, u bë!; A.B.: sepse është në të njëjtën kohë apo jo; A.Ç.: po, njëjtë tani në tre; A.B.: tung vëlla!; A.Ç.: tung, dëgjohemi” (shih 64 dosje të përgjimit, dosja e përgjimit 62, lidhja 1, nga faqja 31 deri në faqen 34; shih po ashtu deklaratën e M.J. në procesverbalin e datës 25/09/2014).

Një vëzhgues objektiv nuk do kishte mëdyshje për ta interpretuar këtë bisedë si dhe përfshirjen e drejt për drejt të A.B. në kontrabandë të këtij individi.

**A.O.: A.Ç. /A.M.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Ky individ (i lindur me datë...) arriti në Kosovë, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 23/10/2012 në orën 3.48 minuta pasdite, dhe largohet me automobil përmes vendkalimit kufitar të Kullës së Pejës me datë 24/10/2012 në orën 4.43 minuta pasdite (dëshmitari V.I. konfirmoi këto lëvizje, shih procesverbalin e datës 20/4/2015, p. 17; shih po ashtu lidhur me këtë nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143). Lidhur me këtë individ A.Ç. morri një email në prag të arritjes, me datë 22/10/2012 nga O.S. [adresa elektronike] me pasaportën e skanuar të personit në fjalë, të cilën ai e përcolli të njëjtën ditë në [adresën elektronike] të shfrytëzuar nga ana e A.M.) dhe atë ditë me datë (22/10/2012) A.Ç. morri emailin nga [adresa elektronike] një rezervim për Hotel Holiday në Prizren për periudhën kohore 23-30/10/2012 dhe A.Ç. ia përcolli këtë rezervim O.S. në [adresa



elektronike] po ashtu me datë 22/10/2012 (dëshmitari V.I. iu referua këtyre emaileve, në procesverbalin datës 20/04/2015, faqe 8 dhe 18).

Po ashtu, A.Ç. dërgoi një email ku bëri një rezervim për këtë individ, me datë 24/10/2012 në [adresa elektronike], në Hotel Rosa, Mostar, Bosnje dhe Hercegovinë (nga data 25 deri me 29/10/2012) dhe një tjetër me datë 26/10/2012 në [adresa elektronike] ku bëri një rezervim me këtë emër në Nirvana Rooms, Split, Kroaci, për periudhën kohore nga data 26 deri me 29/10/2012 ndërsa me datë 27/10/2012 pranoi konfirmimin e rezervimit nga ana e N.P. përmes [adresa elektronike] (shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17). Duke pasur parasysh data e njëjtë të këtyre lëvizjeve dhe rezervimeve, ky individ ishte duke udhëtuar së bashku paraprakun.

Sa i përket A.M.ut:

Pranimi i këtij e-mail me pasaportë të skanuar të personit në fjalë, të përmendur më sipër, nuk do jetë e mjaftueshme që të vërtetohet përfshirja e A.M.ut në këtë kontrabandë. Megjithatë, po ashtu nga [adresa elektronike], kësaj here nga [adresa elektronike], ai i dërgoi A.Ç.-es një rezervim për Hotel Holiday (rezervim të cilin i pandehuri e pranoi) në Prizren, për periudhën kohore të datës 23-30/10/2012, kurse A.Ç. këtë rezervim ia përcolli më tej O.S., dhe përfshirja e A.M.ut është pjesë e ekzekutimit të veprës penale.

Po qe se kishte ndonjë mëdyshje, bisedat mes A.M.ut dhe A.Ç.-es në prag të arritjes, i kanë fshirë ato: në fakt, me datë 22/10/2012 në orën 15.02 minuta, ishte një thirrje telefonike nga A.Ç. për A.M.en (nga numri të telefonit] në [numrin]) dhe mes të tjerash A.Ç. i thotë atij që të bëjë rezervim, se ai individ nuk mund të vinte atë ditë sikur se propozoj A.M.u, se vetëm në ditën e nesërme do kishte vend në aeroplan, A.M.u njoftoi A.Ç. se është një oficer në aeroport me të cilin ishin marr vesh për të lejuar kalimin e migrantëve po qe se i sigurohen emrat (po ashtu duke thënë se duke pas parasysh faktin në fjalë nuk kishte nevojë për letra tjera apo rezervime...), pasta A.M. këmbëngul me A.Ç. dhe thotë “unë po të them, nuk ka nevojë... oficerët atje... të tregova në portën e dytë nga hyrja e parë 1, 2 sepse janë nga dy oficerë në secilën”, në çka A.Ç. i përgjigjet “e mora vesh, ti po thuash 1 dhe 2” dhe më pas A.M.u përgjigjet: “po, si do që të jetë pasi t’i jepen emrat” dhe A.Ç. shtoi “ti po thuash sot dhe nesër” dhe më pas A.M. përfundon duke thënë “vëlla do ishte mirë po qe se mund ta bësh sot, por mund t’i dërgosh edhe nesër” (shih 64 dosje të përgjimit, dosja e përgjimit 62, lidhja 8, nga faqja 360 në faqen 364). Më pas, në orën 15.18 minuta, përsëri A.Ç. duke shfrytëzuar numrat e njëjtë thirri A.M.un dhe më pas pasi u diskutua përsëri nevoja apo jo e rezervimit ( letrës) A.M.u tha se do ta bënte në hotel që ishte i një miku të tij dhe pasi që A.Ç. i kërkoi atij që të merreshin shënime se kush do të shkonte brenda etj, A.M.u thotë: “askush nuk ka për të hyrë në polici... vetëm emrat do t’i jepen oficerit ... kur të i lexoj oficeri emrat ai do të thotë shko tek ai njeriu që po pret përjashta” dhe më pas A.Ç., mes tjerash përmendi “... A.O. ....” (- shih të njëjtën dosje që u

përmend më sipër , nga faqja 365 deri në faqe 370). Në faqen 394 të së njëjtës dosje është transkriptimi i bisedës tjetër, kësaj here në ditën e arritjes (23/10/2012 në orën 12.53 minuta) dhe A.M.u këmbëngul me A.Ç. që të dërgoj më shumë, të përgatis 2-3, “nëse dëshiron, përgatiti 2-3 për orën 8, do të ishte shumë mirë”, “ai personi është atje deri në orën 8” dhe po ashtu pyete për “benzinë” (në çka A.Ç. përgjigjet “unë tani do të dërgoj benzinë për vete dhe për ty”).

**A.H.Y.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Ky individ (i shtetësisë turke, i lindur me datë...) arriti në Kosovë, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 24/10/2012 në orën 7.54 minuta të mbrëmjes, dhe largohet me automobil përmes vendkalimit të Kullës së Pejës me datë 24/10/2012 në orën 10.55 minuta pasdite (dëshmitari V.I. konfirmoi këto lëvizje, shih procesverbalin e datës 20/4/2015, faqe 18; shih po ashtu lidhur me këtë nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143). Lidhur me këtë individ A.Ç. morri një email në prag të arritjes me datë 23/10/2012 nga M.Sa. [adresa elektronike] me pasaportën e skanuar të personit në fjalë, i cili me 24/10/2012 datë si dhe A.Ç. dërguan një email ku bënë rezervime për këtë individ, me datë 24/10/2012 në [adresa elektronike], në Hotel Rosa, Mostar, Bosnje dhe Hercegovinë (nga data 25 deri me datë 29/10/2012) dhe një tjetër në [adresa elektronike] ku bënë një rezervim me këtë emër në Nirvana Rooms, Split, Kroaci dhe me datën 27/10/2012 mori konfirmimin e rezervimit nga N.P. përmes [adresa elektronike] (lidhur me çka dëshmitari V.I. është dëgjuar me datë 20/4/2015, faqe 18 i procesverbalit; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

**T.E. dhe H.S.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Keta individ (lindur me datë..., respektivisht me datë...) arritën në Kosovë, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 12/10/2012 në orën 20.45 minuta, dhe respektivisht në orën 20.44 minuta, për të u larguar me automobil përmes pikës kalimtare të kufirit të Kullës së Pejës me datë 14/10/2012 në orën 21.28 minuta, (dëshmitari V.I. konfirmoi këto lëvizje, shih procesverbalin e datës 20/4/2015, faqe 18; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143). Lidhur me këta individ, T.E. dhe H.S., A.Ç. dërgoi emaile në adresën elektronike të [adresa elektronike] ku bëri rezervime aty për ata me datën 17/10/2012, bëri rezervim në Nirvana Rooms, Split, Kroaci për periudhën kohore prej datës 17 deri me datën 21/10/2012 (për çka dëshmitari V.I. u dëgjua me

datë 20/4/2015, faqe 18 dhe 19 e procesverbalit; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

**H.A.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Ky individ (i lindur me datë...) arriti në Kosovë, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 20/10/2012 në orën 8.27 minuta dhe u largua me automobil përmes pikës së kalimit kufitar të Kullës së Pejës me datë 21/10/2012 në orën 9.56 minuta të mbrëmjes (dëshmitari V.I. konfirmoi këto lëvizje, shih procesverbalin e datës 20/4/2015, faqe 19; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143). Lidhur me këtë individ A.Ç. dergoi një email ku bëri një rezervim për këtë individ, me datë 21/10/2012 (ditën e nisjes nga Kosova...) përmes adresës [adresa elektronike], në Hotel Rosa, Mostar, Bosnje dhe Hercegovinë për periudhën kohore nga data 22 deri me datën 27/10/2012 (lidhur me çka është dëgjuar dëshmitari V.I. me datë 20/4/2015, faqe 19 e procesverbalit; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

**A.Ar.: A.Ç. / A.M.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Ky individ (i lindur me datë...) arriti në Kosovë, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 27/10/2012 në orën 8.50 minuta të mbrëmjes, ndërsa nuk ka shënime mbi daljen sipas raportit të SMK-së (shih nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143). Lidhur me këtë individual A.Ç. ia dërgoi një email O.S. 5 ditë para arritjes në adresën elektronike [adresa elektronike] me letër garancinë e lëshuar nga ana e Besnik Karametes (shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17). Po ashtu lidhur me këtë migrant ka mesazhe të rëndësishme të përgjuara, siç janë përmendur në rastet e tjera, me datë 25/10/2012 në orën 20.50 minuta, A.Ç. ia dërgon një sms mesazh A.M.ut me emra, që do të thotë: “(...) A.Ar., M.Y., S.Baj., dhe I.YI.”.

Sa i përket A.M.ut:

Po qe se, një njërën anë, lidhur me këtë migrant ka mesazhe të rëndësishme të përgjuara, siç u përmenden në rastet tjera, me datë 25/10/2012 në orën 20.50 minuta, A.Ç. ia dërgon një sms mesazh A.M.ut me emrat, që do të thotë: “(...) A.Ar., M.Y., S.Baj., dhe I.Yl.”, çka u konsiderua nga ana e trupit gjykues që të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm përfshirjen e A.M.ut sa i përket këtij individ, në këtë rast ne po ashtu kemi një kopje të pasaportës së tij të konfiskuar gjatë bastisjes në shtëpinë e A.M.ut (shih 15 dosjet e policisë, dosja 6, faqe 52; kopjet e pasaportave të tre individëve të tjerë po ashtu të konfiskuara, edhe pse emrat e tyre nuk mund të hasen në aktakuzë). Për më shumë transkriptime të rëndësishme shih 64 dosjet e përgjimeve, dosjen 48, lidhja 7, faqe 379 dhe 388/389 (A.M.u njofton A.Ç. se aeroplani arriti, kjo në ditën e arritjes, 27/10/2012, në orën 20.11 minuta, ndërsa pasagjeri u shënua në raportin e SMK-së në orën 20.50 minuta).

**F.G.: A.Ç.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Ky individ (i lindur me datë...) arriti në Kosovë, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 26/10/2012 në orën 8.07 minuta të mbrëmjes dhe u largua me autobus neper vendkalimin e kufirit të Kullës së Pejës me datë 28/10/2012 në orën 10.09 minuta të mbrëmjes, (dëshmitari V.I. po ashtu iu adresua këtyre lëvizjeve sipas procesverbalit të datës 15/04/2015, faqe 6; shih nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosjen e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143). Lidhur me këtë individ A.Ç. dërgoi një email 4 ditë para arritjes, me datë 22/10/2012, te O.S. në adresën [adresa elektronike] me letër garancie të lëshuar nga B.K.. Po ashtu, me datë 29/10/ 2012 A.Ç. dërgoi një email në hotel Villa Osa, në Mostar, Bosnje dhe Hercegovinë, ku bëri një rezervim për periudhën kohore nga data 30/10/2012 deri me datën 2/11/2012 (dëshmitari V.I. konfirmoi këto fakte, shih procesverbalin e datës 15/4/2015, p. 11; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqe 1-17).

**A.Di.: A.Ç. / I.P.**

Sa i përket A.Ç.-es:

Ky individ (i lindur me datë...) arriti në Kosovë, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës me datë 17/10/2012 në orën 5.36 minuta të mëngjesit (edhe pse ka arritje pasuese) dhe më pas ai mundohej të largohej nga Kosova, tutje, siç paraqesin lëvizjet në vijim: me datë 3/11/2012 tek vendkalimi kufitar i Hanit të Elezit ai largohet me automobil në orën 12.56 minuta, ndërsa hynë në Kosovë si këmbësor minuta më vonë, në orën 14.21. Në të njëjtën ditë, por tani duke

shfrytëzuar vendkalimin kufitar të Kullës së Pejës, ai largohet me autobus në orën 21.56 minuta dhe më pas, pas katër ditëve, me datë 7/11/2012 ai hynë përsëri në Kosovë me autobus, përmes të njëjtit kufi, në orën 2.31 minuta të mëngjesit, por ditën e nesërme, me datë 8/11/2012, largohet përsëri por me automobil përmes të njëjtit kufi, në orën 13.53 minuta, por se hynë sërish në Kosovë ditën tjetër në orën 17.09 minuta dhe largohet përfundimisht me datë 13/11/2012 në orën 1.50 minuta përmes kufirit të Kullës së Pejës me autobus (fakte të përmendura nga dëshmitari V.I. me datë 20/04/2015, faqe 19; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 6, lidhja 5, faqe 135-143).

Lidhur me këtë individ, A.Ç. dërgoi një email ku bënë një rezervim për te, me datë 26/10/2012 e dërgoi në Hotel Rosa, Mostar, Bosnje dhe Hercegovinë në [adresa elektronike], ku bëri një rezervim për periudhën kohore nga data 27 deri me datën 31/10/2012, dhe me datë 27/10/2012 ai ia dërgon një tjetër Villa Osa, Mostar (pas marrjes së konfirmimit nga Villa Osa, Mostar, Bosnje dhe Hercegovinë me datë 28/10/2012) për periudhën kohore nga data 28/10 deri me datën 1/11/2012 (dëshmitari V.I. konfirmoi këto fakte, shih procesverbalin e datës 20/4/2015, faqe 19; shih po ashtu nga Policia e EULEX-it, raportin e NjHKO-së 4855, raportin policor mbi përgjimet 15-ditore të rrjetit të kompjuterit të A.Ç.-es që mbulon periudhën kohore 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëllimi 3, lidhja 1, faqet 1-17). Lidhur me këtë individ, A.Ç. dërgoi emaile me datë 04.11.2012 në [adresa elektronike] me letër garanci të lëshuar nga ana e O. Company, si dhe, po ashtu me datë 07/11/2012 A.Ç. dërgon një email tek [adresa elektronike] me pasaporta dhe letra garancish të lëshuara nga O. Company.

Lidhur me I.P.n:

Rezervimet janë të njëjta sikur ata lidhur me H.M.K. dhe O.K., dhe përsëri koha e vendkalimit të kufirit përmes Kullës së Pejës (17.09 minuta me datë 9/11/2012) është saktësisht e njëjta sikur lidhur me individët në fjalë, H.M.K. dhe O.K., sepse ata po vinin me taksi me I.P.n i cili po i kthente ata nga Rozhaja në Hotel Sara, në Prishtinë. Në të vërtetë ekzistojnë biseda të shumta të zhvilluara mes I.P.t dhe A.Ç.-es lidhur me aranzhimet mbi çështje të ndryshme: çmimet (600 Euro, 700 Euro, 550 Euro etj.), itinerari (në Prishtinë si migrantë<sup>74</sup> këmbëngulës apo ktheheshin), vend takimet (stacionet e autobusëve, pastaj postë), etj. Për arsye të efikasitetit, dhe për shkak se jo çdo gjë duhet të riprodhohet në këtë moment (pasi që tashmë është shpjeguar më shumë se një herë) shih bisedat që ata zhvilluan mes datave 7/11/2012 dhe 14/11/2012 (që gjenden, shih në 64 dosjet e përgjimit, dosja 61, lidhja 4, f. prej 410 deri 496). Po

---

<sup>74</sup> Gjykata nuk sheh asnjë arsye të elaborojë lidhur me atë nëse shprehjet si “bariu”, “delet” kishin të bënin me lopë, sikurse në kontekst, është e qartë që “delet” ishin migrantët, në po të njëjtën mënyrë sikur në këtë ngjarje të veçantë, përveç se atyre u drejtoheshin me fjalën “dele”, ata i quanin edhe “majmunë” – shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 61, lidhja 4, f. 440.

ashtu janë relevante të përmenden këtu bisedat që ata zhvilluan më 14/11/2012 në orën 8.40, kur A.Ç. nga [numri të telefoni] e kishte thirrur I.P. në [numrin], kur A.Ç. i kërkoi paratë që ai (I.P.) i kishte marrë nga tre djemtë/udhëtarët. I.P. tha se ata i kanë paguar atij vetëm 55 (shih 64 dosjet të përgjimit, dosja 52, lidhja 4, f. 240). Një bisedë që ia vlen të përmendet është biseda e zhvilluar më 12/11/2012 në orën 14.34 dhe A.Ç. tha se udhëtarët ishin nisur dhe ata duhet të mbërrinin në destinacion rreth orës 4. A.Ç. tha se personi i thirrur duhet t'i merrte 600-650 Euro dhe t'ia jepte 50 Euro atij (A.Ç.t) (...) - shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 52, lidhja 4, f. 214.

### **H.M.K.: A.Ç./I.P.**

Në lidhje me A.Ç.:

Ky person (i lindur më...) kishte ardhur në Kosovë me aeroplan në aeroportin e Prishtinës më 17/10/2012 në orën 5.52 të mëngjesit (ndonëse ka pasur edhe ardhje të më pastajme me aeroplan, d.m.th, më 25/10/2012 në orën 8.24 të mbrëmjes) si dhe në hyrjen tjetër më 29/10/2012 në orën 2.59 të mëngjesit, me automjetin përmes pikës kufitare Kullë - Pejë; pastaj ai po përpiquej të dilte jashtë Kosovës, më tutje, siç e tregojnë lëvizjet: më 30/10/2012 në pikë-kalimin kufitar të Hanit të Elezit, ai u largua me automjet në orën 6.24 të mbrëmjes dhe ai kishte hyri në Kosovë përmes kufirit të njëjtë në datën e njëjtë, në orën 8.03 të mbrëmjes. Më 1/11/2012 ai prapë ishte larguar me automjet përmes pikës kufitare të Glloboçicës, në orën 15.22, por kishte hyrë sërish në Kosovë në të njëjtën ditë përmes kufirit të njëjtë në orën 16.38, sërish, dy ditë më vonë më 3/11/2012, ai ishte larguar me automjet përmes pikës kufitare të Hanit të Elezit, në orën 12.56 dhe kishte hyrë përmes pikë kalimit të njëjtë kufitar si këmbësor në orën 14.22, në të njëjtën datë ai prapë kishte dalë nga Kosova me autobus përmes pikës kufitare Kullë, Pejë, në orën 21.56, dhe katër ditë më vonë ai kishte hyrë në Kosovë me autobus përmes të njëjtës pikë kufitare në orën 02.31, por ditën e nesërme, më 8/11/2012, ai ishte larguar prapë me automjet përmes pikës së njëjtë kufitare në orën 13.53, kishte hyrë në Kosovë sërish ditën e nesërme më 9/11/2012 përmes pikës së njëjtë kufitare në orën 17.09, dhe ishte larguar përfundimisht më 13/11/2012 në orën 1.50 të pasdites sërish përmes pikës kufitare të Kullës, Pejë me autobus (faktet e trajtuara nga dëshmitari V.I. më 20/04/2015, f. 19; shih po ashtu raportin e Policisë së EULEX-it – raporti i NJHKO-së 5246 mbi kalimin e kufirit nga migrantët, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosjen e policisë PINK 2, vëll. 6, lidhja 5, f. prej 135-143).

Në lidhje me këtë person, A.Ç. po ashtu kishte dërguar një emajl ku bënte rezervimin për këtë person më 26/10/2012 në [adresa elektronike] në Hotel Rosa, Mostar, Bosnjë dhe Hercegovinë, ku bënte rezervimin për periudhën prej 27 deri më 31/10/2012 dhe më 27/10/2012 i kishte dërguar një emajl tjetër Villa Osa, Mostar – ku kishte marrë konfirmimin nga Villa Osa, Mostar, Bosnjë dhe Hercegovinë më 28/10/2012 për periudhën prej 28/10 deri më 1/11/2012 (dëshmitari V.I. i ka konfirmuar këto fakte, shih procesverbalin e datës 20/4/2015, f. 20, shih edhe raportin e policisë së EULEX-it, NJHKO 4855, Raporti 15-ditor i policisë mbi përgjimin e rrjetit kompjuterik të A.Ç.-s që përfshin periudhën 21/06/2012 - 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212 /OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëll. 3, lidhja 1, f. prej 1-17).

Në lidhje me këtë person, A.Ç. ka dërguar emajla më 04/11/2012 në [adresa elektronike] me letrën e garancisë të lëshuar nga O. Company dhe po ashtu më 07/11/2012, A.Ç. ka dërguar një emajl në [adresa elektronike] me pasaportat dhe letrat e garancisë të lëshuara nga O. Company.

Në lidhje me I.P.n<sup>75</sup>:

Rezervimet janë të njëjta sikurse për A.Di. dhe O.K. dhe përsëri koha e pikë kalimit kufitar Kullë, Pejë (orën 17.09 më 9/11/2012) është saktësisht e njëjta sikurse për personat e përmendur, A.Di. dhe O.K., meqë ata vinin me taksi me I.P.n që i voziste ata prapa nga Rozaja për në Hotel Sara, në Prishtinë. Në të vërtetë ka pasur biseda të shumta ndërmjet I.P.t dhe A.Ç. lidhur me aranzhimet në çështje të ndryshme: çmimet (600 Euro, 700 Euro, 550 Euro etj.), itinerari (për Prishtinën pasi që migrantët<sup>76</sup> këmbëngulnin që të ktheheshin prapa), vendtakimi (stacioni i autobusëve, pastaj posta), etj. Për arsye të efikasitetit, dhe për shkak se jo çdo gjë duhet të riprodhohet në këtë moment (pasi që tashmë është shpjeguar më shumë se një herë) shih bisedat që ata zhvilluan mes datave 7/11/2012 dhe 14/11/2012 (që gjenden në, shih në 64 dosjet e përgjimit, dosja 61, lidhja 4, f. prej 410 deri 496).

**O.G.: A.Ç.**

Në lidhje me A.Ç.:

Ky person (i lindur më...) kishte ardhur në Kosovë me aeroplan në aeroportin e Prishtinës më 22/10/2012 në orën 8.13 të mëngjesit, (dëshmitari V.I. e konfirmoi këtë lëvizje, shih procesverbalin e datës 28/4/2015, f. 3), sërish më 29/10/2012 në orën 2.59 të mëngjesit, ai hyri në Kosovë nga pika kufitare e Kullës, Pejë, me automjet, dhe të nesërmen më 30/10/2012, në 8.03 orën të mbrëmjes, ai hyri në Kosovë përmes pikë kalimit kufitar të Hanit të Elezit me automjet dhe më 1/11/2012, në pikë kalimin kufitar të Glloboçicës, ai u largua me automjet në orën 15.22, në të njëjtën ditë ai hyri sërish në Kosovë me automjet, në të njëjtën pikë kufitare në orën 16.38, dy ditë më vonë më 3/11/2012 ai u largua sërish me automjet përmes pikës kufitare të Hanit të Elezit në orën 12.56 të pasdites dhe hyri sërish përmes pikë kalimit të njëjtë kufitar si këmbësor në orën 14.21, dhe përfundimisht u largu më 4/11/2012 në orën 13.20, sërish përmes pikës kufitare të Hanit të Elezit me automjet (dëshmitari V.I. e konfirmoi këtë lëvizje, shih procesverbalin e datës 28/4/2015, f. 3; shih po ashtu në këtë raportin e NJHKO-së 5246 të Policisë së EULEX-it mbi kalimin e kufirit nga migrantët, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosjen e policisë PINK 2, vëll. 6, lidhja 5, f. prej 135-143).

---

<sup>75</sup> Ky paragraf logjikisht është përsëritje e arsyetimit mbi A.Di..

<sup>76</sup> Gjikata nuk sheh asnjë arsye të elaborojë lidhur me atë nëse shprehjet si “bariu”, “delet” kishin të bënin me lopë, sikurse në kontekst, është e qartë që “delet” ishin migrantët, në po të njëjtën mënyrë sikur në këtë ngjarje të veçantë, përveç se atyre u drejtoheshin me fjalën “dele”, ata i quanin edhe “majmunë” – shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 61, lidhja 4, f. 440.

Në lidhje me këtë person, A.Ç. kishte dërguar një emajl ku bënte rezervimin për këtë person më 26/10/2012, në Hotel Rosa, Mostar, Bosnjë dhe Hercegovinë në [adresa elektronike] për periudhën prej 27 deri më 31/10/2012 dhe më 27/10/2012, ai i dërgoi një emajl tjetër në Villa Osa, Mostar, ku bënte rezervimin për periudhën prej 28/10 deri me 1/11/2012 (ku kishte marrë konfirmimin nga Villa Osa, Mostar, Bosnjë dhe Hercegovinë më 28/10/2012 për periudhën prej 28/10 deri më 1/11/2012).

A.Ç. po ashtu kishte dërguar një emajl ku bënte rezervimin për këtë person më 6/11/2012, në Nirvana rooms, Split, Kroaci, në [adresa elektronike] për periudhën prej 6 deri 10/11/2012 (ku kishte marrë konfirmimin nga Nirvana rooms, Split, Kroaci më 6/11/2012 për periudhën prej 6 deri më 10/11/2012).

A.Ç. ka bërë edhe një rezervim tjetër për personin e cekur, këtë herë ai i kishte dërguar një emajl më 8/11/2012, Nirvana Rooms, Split, Kroaci, në [adresa elektronike], ku bënte rezervimin për periudhën prej 8 deri më 11/11/2012 (ku kishte marrë konfirmimin nga Nirvana rooms, Split, Kroaci, më 6/11/2012 për periudhën prej 6 deri 11/11/2012 (dëshmitari V.I. i kishte konfirmuar këto fakte, shih procesverbalin e datës 28/4/2015, f. 3; shih po ashtu raportin e Policisë së EULEX-it, NJHKO 4855, Raporti 15-ditor i policisë mbi përgjimin e rrjetit kompjuterik të A.Ç.-s që përfshin periudhën 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëll. 3, lidhja 1, f.1-17).

### **O.K.: A.Ç. / I.P.**

Në lidhje me A.Ç.:

Ky person (i lindur...) kishte arritur në Kosovë me aeroplan në aeroportin e Prishtinës më 17/10/2012 në orën 5.37 të mëngjesit, (dëshmitari V.I. e ka konfirmuar këtë lëvizje, shih procesverbalin e datës 28/4/2015, f. 3), sërish më 29/10/2012 në orën 2.59 të mëngjesit, ai kishte hyrë në Kosovë përmes pikës kufitare të Kullës, Pejë, me automjet, dhe të nesërmen më 30/10/2012, në orën 6.24 të mbrëmjes, ai kishte dalë nga Kosova përmes pikës kufitare të Hanit të Elezit me automjet dhe kishte hyrë në Kosovë nëpërmes pikës së njëjtë kufitare në po të njëjtën ditë, në orën 8.03 të mbrëmjes. Më 1/11/2012, ai ishte larguar sërish nga Kosova me automjet përmes pikës kufitare të Gllaboçicës në orën 15.22, por kishte hyrë sërish në Kosovë në po të njëjtën ditë përmes pikës kufitare të njëjtë në orën 16.38; sërish, dy ditë më vonë 3/11/2012, ai u largua me automjet përmes pikës kufitare të Hanit të Elezit në orën 12.56 të pasdites, dhe kishte hyrë sërish përmes pikës së njëjtë kufitare si këmbësor në orën 14.21, por në po të njëjtën datë ai sërish kishte dalë nga Kosova, këtë herë me autobus dhe nga një pikë kufitare tjetër, përmes Kullës, Pejë, në orën 21.56. Katër ditë më vonë ai kishte hyrë në Kosovë me autobus përmes pikë kalimit kufitar të përmendur herën e fundit, në orën 02.31, por të nesërmen më 8/11/2012, ai u largua sërish me automjet përmes pikës së njëjtë kufitare në orën 13.53, pastaj ai hyri sërish në Kosovë të nesërmen më 9/11/2012 përmes pikës së njëjtë kufitare në orën 17.09, dhe përfundimisht u largua më 13/11/2012 në orën 1.50 të pasdites – sërish përmes pikës kufitare të Kullës, Pejë, me autobus (dëshmitari V.I. po ashtu i ka konfirmuar këto lëvizje të fundit, shih procesverbalin e datës 28/4/2015, f. 3; shih po ashtu për këtë, raportin e



Policisë së EULEX-it, NJHKO 5246 mbi kalimin e kufirit nga migrantët, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëll. 6, lidhja 5, f. 135-143).

Në lidhje me këtë person, A.Ç. po ashtu kishte dërguar një emajl ku bënte rezervimin për këtë person më 26/10/2012 në Hotel Rosa, Mostar, Bosnjë dhe Hercegovinë, në [adresa elektronike], ku bënte rezervimin për periudhën prej 27 deri më 31/10/2012 dhe më 27/10/2012 kishte dërguar një emajl tjetër ku bënte rezervimin për periudhën prej 28/10 deri më 1/11/2012 - ku kishte marrë konfirmimin nga Villa Osa, Mostar, Bosnjë dhe Hercegovinë më 28/10/2012 për periudhën prej 28/10 deri më 1/11/2012 (dëshmitari V.I. i ka konfirmuar këto fakte, shih procesverbalin e datës 28/4/2015, f. 4; shih edhe raportin e policisë së EULEX-it, NJHKO 4855, Raportin 15-ditor i policisë mbi përgjimin e rrjetit kompjuterik të A.Ç.-s që përfshin periudhën 21/06/2012 - 11/10/2012, të datës 17/10/2012, PSRK /in/1212 /OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëll. 3, lidhja 1, f. prej 1-17). Në lidhje me këtë person, A.Ç. ka dërguar emajl më 04/11/2012 në [adresa elektronike] me letrën e garancisë të lëshuar nga O. Company dhe po ashtu më 07/11/2012 A.Ç. ka dërguar një emajl në [adresa elektronike] me pasaportat dhe letrat e garancisë të lëshuara nga O. Company.

Në lidhje me I.P.n<sup>77</sup>:

Rezervimet janë të njëjta sikurse për A.Di. dhe H.M.K. dhe përsëri koha në pikë kalimin kufitar të Kullës, Pejë (ora 17.09 më 9/11/2012) është saktësisht e njëjta sikurse në lidhje me individët e përmendur A.Di. dhe H.M.K., pasi që ata po vinin me taksi me I.P.n që i sillte ata me automjet nga Rozhaja në Hotel Sara, në Prishtinë. Në të vërtetë ka pasur një numër bisedash ndërmjet I.P.t dhe A.Ç. rreth aranzhimeve për çështje të ndryshme: çmimet (600 Euro, 700 Euro, 550 Euro etj.), itinerari (për në Prishtinë pasi që migrantët<sup>78</sup> këmbëngulnin që të ktheheshin prapa), vendtakimi (stacioni i autobusëve, pastaj posta), etj. Për arsye të efikasitetit, dhe për shkak se jo çdo gjë duhet të riprodhohet në këtë moment (pasi që tashmë është shpjeguar më shumë se një herë) shih bisedat që ata zhvilluan mes datave 7/11/2012 dhe 14/11/2012 (që gjenden në, shih në 64 dosjet e përgjimit, dosja 61, lidhja 4, f. prej 410 deri 496).

**A.Uz.: A.Ç.**

Në lidhje me A.Ç.:

Ky person (i lindur më...) kishte arritur në Kosovë me aeroplan në aeroplanin e Prishtinës më 26/10/2012 në orën 8.07 të mbrëmjes, (dëshmitari V.I. e konfirmoi këtë lëvizje, shih procesverbalin e datës 28/4/2015, f. 4) dhe ai u largua nga Kosova përmes pikës kufitare të Kullës, Pejë me autobus më 28/10/2012, në orën 10.09 të natës. (shih po ashtu lidhur me këtë raportin e Policisë së EULEX-it, NJHKO 5246 mbi kalimin e kufirit nga migrantët, të datës

---

<sup>77</sup> Ky paragraf logjikisht është përsëritje e arsyetimit mbi A.Di. dhe H.M.K..

<sup>78</sup> Gjykata nuk sheh asnjë arsye të elaborojë lidhur me atë nëse shprehjet si “bariu”, “delet” kishin të bënin me lopë, sikurse në kontekst, është e qartë që “delet” ishin migrantët, në po të njëjtën mënyrë sikur në këtë ngjarje të veçantë, përveç se atyre u drejtoheshin me fjalën “dele”, ata i quanin edhe “majmunë” – shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 61, lidhja 4, f. 440.

15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëll. 6, lidhja 5, f. 135-143).

Në lidhje me këtë person A.Ç. (një ditë pas largimit të tij nga Kosova) po ashtu kishte dërguar një emajl ku bënte rezervimin për këtë person më 29/10/2012, në Hotel Rosa, Mostar, Bosnjë dhe Hercegovinë, në [adresa elektronike]<sup>79</sup>, për periudhën prej 30/10 deri më 2/11/2012 (dëshmitari V.I. i ka konfirmuar këto fakte, shih procesverbalin e datës 28/4/2015, f. 4; shih edhe raportin e policisë së EULEX-it, NJHKO 4855, Raportin 15-ditor i policisë mbi përgjimin e rrjetit kompjuterik të A.Ç.-s që përfshin periudhën 21/06/2012 - 11/10/2012, të datës 17/10/2012, PSRK /in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëll. 3, lidhja 1, f. prej 1-17).

**(6)- Në periudhën prej nëntorit të vitit 2012 kontrabandimi i migrantëve të mëposhtëm përmes organizimit të udhëtimit të tyre dhe hyrjes në Kosovë si vend transit për në vendet tjera si destinacion përfundimtar:**

**B.G.: A.Ç./M.B. / M.A.**

Në lidhje me A.Ç.:

Ky person (i lindur 10/07/1984) kishte arritur këtë herë në Kosovë me aeroplan në aeroportin e Prishtinës më 29/11/2012 në orën 8.01 të mbrëmjes, (dëshmitarja M.J. e ka konfirmuar këtë lëvizje, shih procesverbalin e datës 25/9/2014, f. 8) dhe ishte larguar më 30/11/2012 në orën 1.24 të pasdites përmes pikës kufitare të Hanit të Elezit me autobus (shih po ashtu për këtë, raportin e Policisë së EULEX-it, NJHKO 5246 mbi kalimin e kufirit nga migrantët, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëll. 6, lidhja 5, f. 135-143).

Në lidhje me M.B.n dhe M.A.:

Para se t'i trajtojmë rezervimet e bëra nga A.Ç. për muajin paraparak para arritjes (tetor), të shpjegojmë se pse kemi thënë “kishte arritur këtë herë” dhe pse M.B. është i përfshirë edhe me këtë migrant: sepse ky migrant tashmë ishte kthyer nga Kroacia dhe ai përsëri po udhëtonte me aeroplan për në Kosovë dhe M.B. kishte shkuar që ta merrte atë në aeroport dhe në orën 8.28 të mbrëmjes, ai tashmë ishte me B.G.-in, siç i ka treguar M.B., A.Ç. (më 29/11/2012 në orën 20.18 – A.Ç. e thirr M.B... dhe në orën 20.28, M.B. e thirr A.Ç. M.B. i tregon A.Ç. se ai është bashkë me B.G.-in (- shih 15 dosjet – dosjet policore, dosja 4, lidhja 9, faqet 177-178). Po ashtu, përgjimet e tjera në lidhje me M.B.n, një përgjim nga 29 nëntori 2012 në orën 01.19, biseda ndërmjet O.K. dhe A.Ç.. O.K. e thirr A.Ç., dhe më vonë thotë se do të vijë edhe një migrant i cili ishte kthyer nga Kroacia, B.G.i, dhe se M.B. do ta merrte atë (- shih procesverbalin e datës 25/9/2014, f. 8: kjo bisedë mund të gjendet në, shih 15 dosjet – dosja e policisë, dosja 4, lidhja 9, faqe 177). Në të vërtetë, M.B. kishte shkuar në aeroport në ditën e arritjes siç është regjistruar në përgjime (duke përfshirë kërkesën e tij që A.Ç. t’ia dërgonte atij 1 ose 2 Euro mbushje – në orën

<sup>79</sup> Si referencë në emajlin [adresa elektronike] në raportin përfundimtar mbi A.Ç. A.Ç. është gabim pasi që emajli i tillë është përdorur për t’i dërguar letër garancinë e lëshuar nga Kompania O.

18.16 dhe në orën 20.28, M.B. i kishte thënë A.Ç. se ai ishte ende duke pritur që t'i merrte paratë nga B.G.-i dhe do t'ia dërgonte atij në hotel Sara dhe në orën 20.50, biseda vazhdon në lidhje me dërgimin e një 'punëtori' prapa në aeroport dhe në lidhje me çmimet që duheshin paguar). M.B. po ashtu ishte fotografuar gjatë vëzhgimit se atë ditë ai ishte stacionuar te aeroporti (- shih raportin e vëzhgimit, 15 dosjet e policisë, dosja 1, lidhja 17, f. prej 223 deri 227), M.B. kishte mbërritur në terminal në orën 19.47 sikurse edhe i pandehuri dhe M.A. (në kohën e identifikuar si PPM 31) ishte atje ashtu siç ishte vërejtur dhe fotografuar në orën 19.57 dhe në orën 20.08 po shtrëngonin duart me M.B.n. Po ashtu, atë mbrëmje por në Sheshin Bill Clinton, në orën 21.02, M.B. po fliste në telefon dhe pastaj ia kaloi atë M.A. ashtu që ai ta përfundonte bisedën (...) – shih raportin e cekur, f. 226.

Sa i përket përfshirjes së M.B.t në aktivitetet e kontrabandimit, ia vlen të përmendet një bisedë me A.Ç. që kishte ndodhur atë ditë, më vonë (30/11/2012, në orën 10.57) (përmbledhje): “M.B. e thirri A.Ç. M.B. e pyet A.Ç. se çfarë kishte ndodhur me punëtorët e tij. A.Ç. i thotë atij se nuk funksionoi. A.Ç. thotë se edhe ai personi shkoi brenda. Por ne nuk ia kemi dhënë mbiemrin e tij udhëtarëve, kështu që kjo nuk ndodhi. M.B. i thotë atij se askush nuk ka hyrë brenda në aeroport mbrëmë. M.B. i thotë atij se ai ishte atje dhe ai nuk e kishte parë askë të hynte brenda A.Ç. i thotë atij se ai kishte hyrë brenda pasi që ishte larguar M.B. M.B. i thotë A.Ç.t se kjo ndodh për shkak se A.Ç. nuk po ia jep punën M.B.t. B.G.i është te hoteli, ata do të vendosin më vonë se çfarë do të ndodh me të” dhe në orën 13.58, M.B. (nga [numrin]) e thërret A.Ç. (në [numrit të telefonit]) dhe M.B. i tregon A.Ç.t se një familje mund të vijë nesër (- shih 15 dosjet – dosja e policisë, dosja 4, lidhja 9, faqe 178). Kjo ishte 2 ditë para arritjes, por në përgjimin tjetër (edhe më 27/11/2012 në orën 18.54) përmendet një herë “pasnesër në mbrëmje” (dhe B.G. ka hyrë më 29/11 në orën 8.01): “M.A. tha se ky person është në dispozicion për nesër në mëngjes dhe e këshilloi A.Ç. se udhëtarët mund të udhëtojnë me aeroplan nesër në mëngjes (...) M.A. pyeti nëse A.Ç. e kishte aranzhuar atë çështje. A.Ç. tha se ai e kishte aranzhuar atë për pasnesër në mbrëmje. M.A. tha se ai do ta informojë atë njeri lidhur me pasnesër në mbrëmje. A.Ç. po ngurronte të bisedonte dhe kërkoi nga M.A. që ta vizitonte atë me qëllim që ta diskutonin këtë çështje” (- shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 53, lidhja 3, f. 234).

Më 27/11/2012 në orën 16.51, A.Ç. e thirri M.A. në telefonin [numrin e telefonit] dhe biseda shkoi kështu: “M.A. pyeti nëse udhëtarët e rinj do të mbërrin nesër. A.Ç. u përgjigj pozitivisht duke thënë se biletat janë paguar. M.A. tha se sonte ai do të shkojë në Prishtinë, pasi që nesër ai nuk është në detyrë dhe se “H.”i do të paraqitet nesër në Prishtinë, e ai dhe “H.”i do të shkojnë së bashku për t'i marrë udhëtarët” (- shih përmbledhjen e bisedës së cekur në 64 dosjet e përgjimit, dosja 53, lidhja 3, f. 232).

T'i kthehemi përfshirjes së A.Ç.:

Në lidhje me personin B.G., A.Ç., një muaj përpara, siç u shpjegua, e kishte dërguar një email ku bënte rezervimin për të më 21/10/2012, në Hotel Rosa, Mostar, Bosnje dhe Hercegovinë në [adresa elektronike] për periudhën prej 22 to 27/10/2012 dhe më 6/11/2012 ai u

kishte dërguar një emajl tjetër Nirvana rooms, Split, Kroaci në [adresa elektronike] për periudhën prej 6 deri më 10/11/2012 (duke qenë se kishte marrë konfirmim nga Nirvana rooms, Split, Kroaci më 6/11/2012 për periudhën prej 6 deri më 10/11/2012).

A.Ç. po ashtu ka përcjellë më 26/11/2012 skenimin e pasaportës së këtij individ në emajlin [adresa elektronike] (shih raportin e Policisë së EULEX-it, NJHKO 4855, raportin 15-ditor të policisë mbi përgjimin e rrjetit kompjuterik të A.Ç. që përfshin periudhën 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëll. 3, lidhja 1, f. 1-17).

#### **H.T. dhe M.P.: A.Ç./A.M./M.B.**

Në lidhje me A.Ç.:

Personi H.T. (i lindur më...) kishte arritur në Kosovë me aeroplan në aeroportin e Prishtinës më 8/11/2012 në orën 19.54 (dëshmitarja M.J. po ashtu e ka trajtuar këtë sipas procesverbalit të datës 15/10/2014, f. 5; personi M.P. (i lindur më...) kishte arritur në Kosovë me aeroplan në aeroportin e Prishtinës më 8/11/2012 në orën 19.54 (dëshmitarja M.J. po ashtu e ka trajtuar këtë sipas procesverbalit të datës 15/10/2014, f. 6; shih për këto lëvizje po ashtu raportin e Policisë së EULEX-it, raporti i NJHKO-së 5246 mbi kalimin kufitar të migrantëve të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëll. 6, lidhja 5, f. 135-143). Data lidhur me daljen e tyre nuk ishte e regjistruar.

Lidhur me personin H.T., A.Ç. kishte marrë një emajl me pasaportën e skenuar më 26/9/2012 from Z.S. në [adresa elektronike] dhe po të njëjtën ditë ai ia kishte dërguar një emajl me vizitë kartat e Kompanisë Star Mobilja, Novi Pazar, Serbi, O.S. në [adresa elektronike] dhe më 01/10/2012, ai kishte dërguar në [adresa elektronike] letër garancinë e lëshuar nga Star Mobilja (dëshmitari V.I. i ka konfirmuar këto fakte, shih procesverbalin e datës 19/3/2015, f. 16 dhe 17, M.J. në seancën më 10/9/2014, f. 15 të procesverbalit. Në lidhje me M.P., A.Ç. më 1/10/2010 kishte dërguar në [adresa elektronike] letër garancinë e lëshuar nga Star Mobilja dhe më 17/10/2012, ai kishte marrë një emajl me pasaportën e skenuar nga i njëjti emajl (kjo letër garanci ishte lëshuar më 29/9/2012, pasi personi tjetër me të njëjtin emër por i përmendur në paragrafin 4 të pikës 5 tashmë kishte arritur, pasi që ky personi tjetër kishte hyrë në vend më 19/9/2012). Për këto komunikime me emajl, shih po ashtu raportin e Policisë së EULEX-it, NJHKO 4855, raportin 15-ditor të policisë mbi përgjimin e rrjetit kompjuterik të A.Ç. që përfshin periudhën 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëll. 3, lidhja 1, f. 1-17).

Në lidhje me A.M.:

Në lidhje me datën e mbërritjes së këtyre individëve (8/11/2012), A.Ç. i kishte dërguar një sms A.M.-ut paraprakisht më 19/10/2012, në orën 20.51, me përmbajtjen e mëposhtme<sup>80</sup>: “M.Po., H.T., M.Ol.” (-shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 43, lidhja 4, f. 319). Në fakt, në këtë ditë ka shumë biseda ndërmjet A.M. dhe A.Ç. në lidhje me organizimin e kontrabandimit të migrantëve me ndihmën e një zyrtari që punon në aeroport. Në të vërtetë, ne mund ta shohim se sms-i i kopjuar më lart është brenda një konteksti të caktuar, në të cilin A.M. po ankohej se ishte e sikletshme që të mos i kishte ende emrat për t’ia përcjellë zyrtarit, pasi që para atij sms-i, në orën 15.52, A.M. i dërgoi një sms A.Ç. ku thuhej: “është e sikletshme! Njeriu po pret që nga mëngjesi për emrat” dhe në orën 16.46, A.M. e thirr A.Ç. dhe thotë se “ai po kthehej nga aeroporti dhe askush nuk ishte ndaluar. Duket se ishte thashetheme. A.M. thotë se ai kishte pirë kafe me këtë njeri dhe ky njeri i kishte thënë se ai mund të aranzhonte hyrjen e deri 4 njerëzve. A.M. po e shtynte A.Ç. të bënte diçka (atë ditë) dhe A.Ç. i tha se diçka mund të vinte brenda dy-tre ditësh”. Po të njëjtën ditë por në orën 20.21, A.Ç. e thërret A.M.-un dhe thotë se “është një person që po vjen por në Shkup. A.M. i shpjegon A.Ç.t se është me rëndësi që të sillet dikush sot ashtu që ky njeri të mund të shohë se ata janë serioz. Ai i thotë A.Ç.t se ai mund ta humb kredibilitetin sepse ky njeri është mashtruar disa herë”. Në orën 20.46, A.Ç. e thërret A.M.-un dhe e informon atë se “janë ndaluar tre njerëz dhe janë vendosur në një dhomë. A.M. thotë se ai do ta pyes këtë njeri, në ndërkohë A.Ç. do t’i marrë emrat” dhe, në fund, në orën 20.48, A.M. e thërret A.Ç. dhe “e pyet nëse ai mund t’i marrë emrat. A.Ç. thotë se ai do ta zbulojë tani dhe do t’i dërgojë emrat me sms” – dhe ky është konteksti të cilin ne e kemi përmendur më herët (për të gjitha këto transkripte, shih 15 dosjet me dosje të policisë, dosja 6, lidhja 2.1 f. 131).

Në lidhje me M.B.n:

Në ditën e arritjes së M.P. dhe H.T., 8/11/2012, ka pasur një bisedë ndërmjet M.B.t dhe A.Ç.-s (thirrja nga [numri] në [numrin të telefonit], në orën 16.50) ku M.B. e informon A.Ç.-n se “dy persona janë duke ardhur dhe ata do të shkojnë në Prishtinë për t’i marrë ata” dhe “dëshiron të takohet me A.Ç. (...) pasi që punëtorët të jenë vendosur në hotel” (- shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 52, lidhja 3, f. 149).

**R.B. dhe E.Ba.<sup>81</sup>: A.Ç./T.Y./M.B. - R.B. vetëm/A.B. - R.B. vetëm**

Në lidhje me A.Ç., T.Y. dhe M.B. (ky i fundit në lidhje me R.B., siç do të shpjegohet) ka kryer veprën e kontrabandimit me migrantë përmes përfshirjes edhe në kontrabandimin e migrantëve R.B., shtetas i Republikës së Turqisë, i lindur më..., dhe E.Ba., shtetas i Republikës

---

<sup>80</sup> Shtohet theksi dhe se kishte një gabim në lidhje me emrin e individit të dytë, pasi që asnjëherë nuk ka pasur një “M.Po.” por vetëm [“emri i parë” i M.P.] [emri i fundit i M.P.] (në të dyja rastet në paragrafët 4 dhe 6 të pikës 5).

<sup>81</sup> Për arsye të konsistencës ky arsyetim në esencë përkon me atë që do të gjendet më vonë në pikën 8, pasi që pika e tillë ka të bëjë me migrantët e njëjtë.

së Turqisë, i lindur më..., për të përfituar dobi financiare ose dobi tjetër materiale (nga 7/11/2012 deri më 22/11/2012, e jo më 04/12/2012).

Në të vërtetë, R.B. aterroi në Aeroportin Ndërkombëtar të Kosovës më 11/11/2012 në orën 11.44, dhe u largua me autobus përmes pikës kufitare të Hanit të Elezit dy ditë më pas, më 13/11/2012, në orën 4.43 të pasdites (dëshmitari V.I. po ashtu e ka trajtuar këtë sipas procesverbalit të datës 28/04/2015, f. 4, dëshmitari K.G. më 20/5/2015, f. 21 të procesverbalit; shih për këtë Raportin e Policisë së EULEX-it, raporti i NJHKO-së 5246 mbi kalimin kufitar të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëll. 6, lidhja 5, f. 135-143).

E.Ba. aterroi në Aeroportin Ndërkombëtar të Kosovës më 19/11/2012 në orën 7.51 të mbrëmjes, dhe u largua me autobus përmes pikës kufitare të Hanit të Elezit tri ditë më pas, më 22/11/2012, në orën 4.43 të pasdites (dëshmitari V.I. po ashtu e ka trajtuar këtë sipas procesverbalit të datës 28/04/2015, f. 5, dëshmitari K.G. më 20/5/2015, f. 20 të procesverbalit; shih për këtë Raportin e Policisë së EULEX-it, raporti i NJHKO-së 5246 mbi kalimin kufitar të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëll. 6, lidhja 5, f. 135-143).

A.Ç., në lidhje me R.B., më 27/10/2012 nga B.Ef. në [adresa elektronike] ka marrë një pasaportë të skenuar të personit të cekur dhe më 1/11/2012 e ka marrë edhe një herë, por këtë herë nga F.U. Sahin në [adresa elektronike] (dëshmitari V.I. i ka konfirmuar këto fakte, shih procesverbalin e datës 28/1/2015, f. 8, dhe të datës 10/2/2015, f. 4; shih për këtë raportin e Policisë së EULEX-it, raporti i NJHKO-së 4855, Raporti 15-ditor i policisë mbi përgjimin e rrjetit kompjuterik të A.Ç.-s që përfshin periudhën 21/06/2012 - 11/10/2012, të datës 17/10/2012, PSRK /in/1212 /OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëll. 3, lidhja 1, f. prej 1-17).

A.Ç., në lidhje me E.Ba., kishte dërguar një emajl ku bënte rezervimin për këtë person më 26/11/2012 në Hotel Nirvana Rooms, Split Kroaci në [adresa elektronike] (prej 27 deri 30/11/2012) dhe ka marrë konfirmimin në po të njëjtën ditë nga N.P. në [adresa elektronike] (shih për këtë raportin e Policisë së EULEX-it, raporti i NJHKO-së 4855, Raporti 15-ditor i policisë mbi përgjimin e rrjetit kompjuterik të A.Ç.-s që përfshin periudhën 21/06/2012 - 11/10/2012, të datës 17/10/2012, PSRK /in/1212 /OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëll. 3, lidhja 1, f. prej 1-17).

Ndonëse prokuroria iu referua asaj se ai nuk kishte asnjë kopje të letër garancive të lëshuara nga T.Y. (f. 10 të procesverbalit të datës 15/10/2014), trupi gjykues beson se në të vërtetë i pandehuri ka qenë i përfshirë në aktivitetin e kontrabandimit; trupi gjykues erdhi te ky konkluzion pas analizave të përmbajtjeve të përgjimeve ndërmjet numrit që dihet se është përdorur nga i pandehuri T.Y. dhe bashkë i pandehuri A.Ç. Në këtë aspekt, ekzistojnë përgjimet kryesore të datës (dhe kjo duke pasur parasysh kornizën kohore të individëve të kontrabanduar që po diskutohet këtu) 4/11/2012 (në 19.29.34, ekziston një thirrje nga [numri], që i përkiste

T.Y., në [numrin të telefonit], që i përkiste A.Ç., në të cilin T.Y. e kishte pyetur A.Ç. nëse kishte nevojë që t'i dërgonte ftesë ndonjë udhëtari dhe kur udhëtari do të duhej të arrinte në Stamboll, ndaj të cilës A.Ç. u përgjigj sa më parë që të jetë e mundur); po të njëjtën ditë, disa minuta më vonë, në orën 19.38, i njëjti i pandehur e thërret sërish numrin e njëjtë dhe i thotë A.Ç.-s se udhëtari do të mbërrijë në Stamboll ditën e nesërme ose brenda dy ditësh (që do të thotë në ditën 6/11/2012) dhe A.Ç. pastaj do t'ia dërgonte ftesën udhëtarit. Ia vlen të vihet në dukje se në ende jemi duke folur për Stambollin dhe arrijtet e pretenduara në Prishtinë kanë ndodhur pas 7/11/2012 (dhe po ashtu sepse në orën 20.54, T.Y. madje e kishte informuar A.Ç.-n se udhëtari dëshironte ta shtynte udhëtimin e mëtejshëm për 2 ose 3 ditë). Po ashtu, më 6/11/2012, në orën 16.10.54, T.Y. e thirri A.Ç. dhe e informoi se udhëtari do të mbërrinte në Stamboll të nesërmen, dhe çka është shumë e rëndësishme, A.Ç. e thirri T.Y. më 10/11/2012 në orën 19.12 dhe T.Y. e informoi se udhëtari do të mbërrinte të nesërmen (dhe ne do ta shohim më poshtë se R.B. aterroi të nesërmen më 11/11/2012) dhe se e kishte aranzhuar që një veturë ta marrë personin dhe po ashtu kishte pyetur për [emri i parë i N.N.] dhe A.Ç. u përgjigj dhe foli për më shumë udhëtarë që po vinin dhe në lidhje me "M." që ishte nën kujdesin intensiv në spital. Më 11/11/2012, në orën 10.52, sërish T.Y. u thirr nga A.Ç. dhe ky i fundit u informua nga ia se udhëtari do të arrinte me fluturimin e Pegasus të orës 11 që po vinte nga Stambolli. Po ashtu në po të njëjtën ditë, por në orën 12.01, A.Ç. e thirri T.Y. ku e informonte se udhëtari kishte mbërritur, e kishte kaluar kufirin dhe ishte marrë. Në fund, më 13/11/2012, në orën 17.22, T.Y. e thirri A.Ç. (gjithmonë numrat e njëjtë të telefonit tashmë të cekur janë ata që janë të përdorur) dhe A.Ç. tha se ai e kishte marrë një sms ku bëhet me dije se udhëtarët e kishin kaluar kufirit. Më 14/11/2012, në orën 14.11, A.Ç. e thirri T.Y. dhe biseda u përmbledhë kështu "T.Y. pyeti se si është situata informoi se personi i paidentifikuar mashkull (PPM) tashmë është vendosur në një motel ku ai do të jetë së bashku me 4 personat e tjerë. A.Ç. tha se ata janë krejt në fund dhe do të largohen gjatë këtyre 2 ditëve".

Më 17/11/2012 ishin dy biseda telefonike ndërmjet T.Y. dhe A.Ç. (ndërmjet 19.29 dhe 19.45) duke bërë aranzhime për një takim. Pastaj më 18/11/2012 në orën 16.28 T.Y. e thërret A.Ç.-n dhe biseda përmbledhet kështu: "T.Y. e thirri A.Ç. Ai pyeti për situatën. A.Ç. tha se të gjithë janë të mbledhur në atë vend. A.Ç. tha se 2 prej tyre janë të tyre dhe 2 të tjerët i përkasin O.K.. Pastaj T.Y. pyeti nëse ai i kishte takuar të tyre. A.Ç. tha se nuk i kishte takuar. T.Y. e pyeti A.Ç. lidhur me vendndodhjen e tij. A.Ç. tha se ai është në hotel Sara e informoi se "To." është këtu. T.Y. shpreston se ajo puna do të kryhet sot. A.Ç. tha se atyre u ishte premtuar për nesër në mëngjes. T.Y. tha se ata do të jenë në kontakt gjatë ditës". Përveç kësaj, më 18/11/2012, A.Ç. e thirr T.Y., në orën 17.40, dhe A.Ç. e informon se të tyre do të dërgohen tutje të martën në mëngjes".

Në fund, janë marrë në pyetje edhe dëshmitarët lidhur me përmbajtjen e raportit të SMK-së që kanë dhënë konfirmimin dhe shpjegimet për kuptimin e tij, ky ishte rasti me dëshmitarin V.I. (procesverbali i datës 28/04/2015, f. 05) dhe K.G. (procesverbali i datës 20/05/2015, f. 20).

Këto biseda janë të rëndësishme dhe i mundësojnë gjykatës që të vërtetojë përfshirjen e T.Y. në kontrabandim (pa marrë parasysh faktin se kush në të vërtetë i ka përgatitur letër garancitë), përtej dyshimit të arsyeshëm, siç mund ta shohim nga raporti i SMK-së, nga datat dhe koha e mbërritjes në Aeroportin e Prishtinës. Sipas raportit të SMK-së, R.B. kishte arritur në Aeroportin e Prishtinës më 11/11/2012, në orën 11.44, me aeroplan dhe ishte larguar më 13/11/2012 në orën 04.43 me autobus nga Hani i Elezit; E.Ba. kishte arritur më 19/11/2012 në Aeroportin e Prishtinës, po ashtu me aeroplan në orën 07.51, dhe ishte larguar me autobus (Hani i Elezit) më 22/11/2012, në orën 04.43.

M.B. po ashtu ishte i përfshirë në lidhje me R.B. dhe E.Ba., është me rëndësi të ceket përfshirja e M.B.t në marrjen e migrantit R.B. – ndonëse ky person nuk ka ardhur siç ishte planifikuar fillimisht, për 3 nëntor 2012, pasi që ai kishte ardhur vetëm më 11 nëntor, dhe gjykata e tha këtë sepse më 2/11/2012 në orën 18.59, A.Ç. e thirr M.B.n në [numrin] dhe përmbledhja e bisedës shkoi kështu: “A.Ç. dhe M.B. folën lidhur me një udhëtar. M.B. kishte një udhëtar dhe me këtë do t’i kishte dy udhëtarë. Udhëtari i M.B.t do të arrijë nesër në mëngjes. M.B. është i njohur me udhëtarin e A.Ç.t dhe ai ia diktoi detajet: R.B., [data e lindjes], [pasaporta nr.]. M.B. tha se çmimi prej 300 është i përshtatshëm. A.Ç. tha se taksi duhet të përfshihet në këtë çmim. M.B. e tha se ai do t’ia jap 130 Euro zonjës, ndërsa ai [M.B.] do ta mbajë pjesën tjetër të parave. M.B. kërkoi nga A.Ç. që të mos i thotë asgjë O.K. në lidhje me këtë ujd, pasi që ai [M.B.] ishte mësuar të kërkonte 350-400 Euro nga O.K. për të njëjtat shërbime”. Konkluzioni i cekur më lart, se fillimisht R.B. është dashur të kishte arritur më herët, më 3 nëntor (jo vetëm më 11 nëntor) është konfirmuar nga një bisedë tjetër sërish ndërmjet M.B.t (që thirri në [numrin]) dhe A.Ç. (që kishte thirrur nga [numrit të telefonit]) më 3/11/2012, në orën 11.04 dhe biseda shkoi kështu: “A.Ç. e pyeti M.B.n nëse ai kishte arritur në aeroport. M.B. e mohoi se ishte në aeroport duke thënë se udhëtari duhet të arrinte të hënën në mëngjes. M.B. nuk e dinte qëllimin se pse ky udhëtar e kishte vonuar fluturimin e tij” (- shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 52, lidhja 1, f. 20/21).

Në lidhje me A.B.:

Siç themi ne, R.B. aterroi në aeroportin ndërkombëtar të Kosovës më 11/11/2012 në orën 11.44, dhe u largua me autobus përmes pikës kufitare të Hanit të Elezit dy ditë më pas më 13/11/2012, në orën 4.43 të pasdites, që do të thotë se pas Kosovës ai ka shkuar në Maqedoni dhe nga atje më tutje në destinacionin e tij përfundimtar në të cilin ishte i përfshirë A.B., sepse para se ky person të hynte në Maqedoni më 13/11/2012, në orën 15.41, A.Ç. duke përdorur [numrin të telefonit] e thirri A.B. në [numrin] dhe tha se ai individ do të shkojë në Hotel Calabria dhe të kërkoj punë dhe në orën 16.04, nga [numri] A.B. i dërgoi një sms A.Ç. ku e pyeti “cili është emri dhe mbiemri” dhe një minutë më vonë A.Ç. përgjigjet “R.B.” (- shih 15 dosjet e policisë, dosja 4, lidhja 6, f. 66).



**Akr.A., S.Az. dhe fëmijët N.A., Y.A. dhe D.A.: A.Ç. / M.B.**

Në lidhje me A.Ç.:

Kjo familje përbëhet nga 5 persona (shtetas të Sirisë<sup>82</sup>, të lindur më...) arriti në Kosovë, me aeroplan, në aeroportin e Prishtinës më 16/11/2012 në 20.29, 20.31 dhe 20.32, respektivisht (dëshmitari V.I. e kishte trajtuar këtë sipas procesverbalit të datës 28/1/2015, f. 7 dhe 10/02/2015, f. 3; shih për këtë edhe raportin e Policisë së EULEX-it, raporti i NJHKO 5246 mbi kalimin kufitar të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in /52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëll. 6, lidhja 5, f. 135-143). Për këta persona, A.Ç. kishte marrë një email me pasaportat e skenuara më 31/10/2012 nga H.B. në [adresa elektronike] dhe më 14/11/2012 mori një tjetër emajl nga N.E. në [adresa elektronike] në lidhje me konfirmimin i rezervimeve në Hotel Cowana nga dita e mbërritjes në aeroport (16/11/2012) dhe më 16/11/2012 A.Ç. i dërgoi pasaportat e skenuara në emajlin [adresa elektronike] (shih edhe raportin e Policisë së EULEX-it, NJHKO 4855, Raporti 15-ditor i policisë mbi përgjimin e rrjetit kompjuterik të A.Ç. që përfshin periudhën 21/06/2012 - 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëll. 3, lidhja 1, f. 1-17).

Në lidhje me M.B.n:

Përfshirja e M.B.t në kontrabandimin e kësaj familje të përbërë nga 5 persona mund të vërtetohet nga burime të ndryshme; si shembull, pas arritjes (me të aterruar në Aeroportin e Prishtinës më 16/11/2012 në orën 20.29), më 17/11/2012, në orën 14.37, A.Ç. (në [numrin të telefonit]) e thirri M.B.n (në [numrin]) dhe biseda shkoi kështu: A.Ç. e pyeti M.B.n se si do t'ia dërgonte atij emrat dhe pastaj M.B. e pyeti atë "cilën familje" dhe A.Ç. u përgjigj "atë që është në aeroport", në të cilën M.B. thotë "Oh, Akr.A." dhe biseda shkon ashtu që A.Ç. kërkon nga ai që t'ia dërgoj dokumentet atij në të cilën gjë M.B. i përgjigjet, kontrolloje emajlin (...) – shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 60, lidhja 4, f. 132/134. Më vonë, por në orën 16.44, është një bisedë tjetër që kishte të bënte me dokumentet e njëjta dhe qëllimi i A.Ç.-s ishte që të bisedonte me një avokat për këtë.

Po ashtu, meqë problemet në lidhje me dokumentet që kishin të bënin me këtë familje po vazhdonin gjatë ditës, në orën 17.08, O.K. nga telefoni [numrin] e thirri A.Ç. në [numrin të telefonit] dhe biseda shkoi kështu: ("O" nënkupton O.K. dhe "C" A.Ç.): "C: po, fol; O: Akr.A., emri Akr. mbiemri A.; C: A ose E?; O: Akr., Akr.; C: Po. O: Dhe gruaja e tij quhet S.Az.; C: S.; O: A... a i shënove fëmijët?" dhe biseda vazhdon (shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 60, lidhja 4, f. 138/141).

---

<sup>82</sup> Sipas deklaratës së dëshmitarit V.I., shih procesverbalin e datës 10/2/2015, f. 3.

**C.Ko. dhe N.C.: A.Ç.**

Në lidhje me A.Ç.:

Këta persona (të lindur më 10/9/1993 dhe më 1/2/1993) arritën në Kosovë me aeroplan në aeroportin e Prishtinës më 14/11/2012 në orën 9.12 të mëngjesit dhe në 9.23 të mëngjesit (dëshmitari V.I. e ka trajtuar këtë sipas procesverbalit të datës 28/4/2015, f. 4/5; shih për këtë edhe raportin e Policisë së EULEX-it, raporti i NJHKO 5246 mbi kalimin kufitar të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in /52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëll. 6, lidhja 5, f. 135-143). Për këta persona, A.Ç. kishte marrë një emajl me pasaportat e skenuara më 10/11/2012 nga Sun City në [adresa elektronike] dhe më 13/11/2012 (në prag të udhëtimit), ai i dërgoi me emajlin [adresa elektronike] letër garancitë të lëshuara nga L.I. (për këtë dëshmitari V.I. sipas procesverbalit të datës 28/4/2015, f. 4/5; shih edhe raportin e Policisë së EULEX-it, NJHKO 4855, Raporti 15-ditor i policisë mbi përgjimin e rrjetit kompjuterik të A.Ç. që përfshin periudhën 21/06/2012 - 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëll. 3, lidhja 1, f. 1-17).

**M.M.B.:<sup>83</sup> A.Ç./M.A./A.B./M.B.<sup>84</sup>**

Në lidhje me A.Ç.:

Ky person (i lindur më 12/8/1988) arriti në Kosovë për herë të dytë me aeroplan në aeroportin e Prishtinës më 24/11/2012 në orën 8.07 të mbrëmjes dhe u largua të nesërmen më 25/11/2012, përmes pikës kufitare të Hanit të Elezit, me automjet në orën 5.02 të pasdites (dëshmitarja M.J. po ashtu e ka trajtuar këtë sipas procesverbalit të datës 25/9/2014, f. 14 dhe dëshmitari V.I. në seancën e mbajtur më 10/2/2015, sipas procesverbalit, f. 5; shih edhe raportin e Policisë së EULEX-it, NJHKO 5246 mbi kalimin e kufirit të migrantëve, të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëll. 6, lidhja 5, f. 135-143). Në lidhje me këtë person, A.Ç. kishte marrë një emajl me pasaportat e skenuara para arritjes më 21/11/2012, nga emajl-adresa [adresa elektronike] dhe në ditën e largimit nga Kosova për në ISH-RJ të Maqedonisë (përmes Hanit të Elezit), më 25/11/2012, ai dërgoi një emajl në adresën [adresa elektronike] ku bënte rezervimin në Rezervimet në Hotel Centar in Shkup, ISH-RJ të Maqedonisë për periudhën prej 25 deri 28/11/2012 dhe kishte marrë me emajl konfirmimin e rezervimit në të njëjtën ditë që ai e bëri atë (dëshmitarja M.J. po ashtu e ka trajtuar këtë sipas procesverbalit të datës 25/9/2014, f. 13, dhe dëshmitari V.I. në seancën e mbajtur më 10/2/2015, sipas procesverbalit, f. 5; shih edhe raportin e Policisë së EULEX-it, NJHKO 4855, Raporti 15-ditor i policisë mbi përgjimin e rrjetit kompjuterik të A.Ç. që përfshin periudhën 21/06/2012 -

---

<sup>83</sup> Ekzistojnë të dhëna në lidhje me një person tjetër (bashkëshortja) A.Bu., për shembull në raportin e SMK-së dhe referencat nëpër sms-a dhe përgjime. Megjithatë, ky person nuk përmendet në aktakuzë.

<sup>84</sup> Vetëm për tentim hyrjen e parë në Kosovë më 13/11/2012, me aeroplan në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, mbërritja në orën 7:49 të mbrëmjes.

11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëll. 3, lidhja 1, f. 1-17).

Në lidhje me M.A. dhe në lidhje me A.B.

Është e mundur të vërtetohet përfshirja e M.A. në kontrabandimin e këtij personi; për shembull, në prag të arritjes (më 23/11/2012, në orën 15.01) A.Ç. (nga [numri i telefonit]) i dërgoi atij një sms (M.A., në [numrin]) me këtë përmbajtje: “A.Bu., [datë e lindjes], M.M.B. [datë e lindjes]”, dhe këtij sms i kanë paraprirë biseda të rëndësishme. Në të vërtetë, më 21/11/2012 në orën 13.18, A.Ç. e thirri M.A.-in kur ai ishte në Kaçanik dhe i tha atij që të fliste me dikë lidhur me 2 njerëz, një burrë dhe një grua për ftesat dhe të nesërmen (më 22/11/2012) në orën 13.32, kjo bisedë u zhvillua ndërmjet tyre: (përmbledhja) “A.Ç. e thirri M.A.n. A.Ç. e pyeti M.A.n nëse ai kishte folur me dikë për atë familjen. M.A. tha se ai ishte kujdesur për këtë gjë dhe e pyeti nëse ai mund të vinte të shtunën. A.Ç. u përgjigj në rregull. M.A. tha se kjo mund të bëhet edhe të shtunën. M.A. do të fliste me të në orën 4 të pasdites. Daja i tij është zyrtar policor dhe ai është atje çdo natë. M.A. tha se A.Ç. duhet të aranzhojë që biletat të bëhen ose për të shtunën ose për të dielën”. Në po të njëjtën ditë, por tani në orën 14.06, ata thanë si vijon (përmbledhja) “A.Ç. e thirri M.A.n. A.Ç. tha se biletat do të duhej të ishin blerë për të shtunën në mbrëmje. A.Ç. e pyeti M.A.n nëse i afërmi i atij personi do të ishte atje. M.A. u përgjigj se ‘*ai punon atje çdo mbrëmje*’. Në ditën e mbërritjes (24/11/2012) pas sms-it të trajtuar më lart, u zhvilluan edhe këto biseda ndërmjet A.Ç. dhe M.A. (përkatësisht në orën 12.15, 15.09 dhe 16.49; përmbledhjet): “A.Ç. e thirri M.A.n dhe e pyeti se çfarë duhet të thonë ata në aeroport. M.A. u përgjigj se ‘ata, nuk kanë nevojë të thonë asgjë’. A.Ç. tha se ‘ata duhet të thonë se po e vizitojnë ‘H.’in, i cili punon në Xhami’ “. “A.Ç. e thirri M.A.n dhe i tha se çifti do të nisen në mbrëmje. A.Ç. tha ‘Unë do t’i thërras ata dhe do t’u them se ata po shkojnë në Kaçanik për ta vizituar ‘H.’in’. M.A. u përgjigj ‘nuk do të jetë problem’” dhe “A.Ç. e thirri M.A.n. M.A. i tha A.Ç.t se ‘H.’i do të hynte brenda te zyrtari policer dhe do t’i marrë udhëtarët. M.A. do t’i priste ata jashtë. ‘H.’i po ashtu do t’ia jepte emrat zyrtarit policor”. Po ashtu, në orën 20.10, M.A. e thirri A.Ç. dhe ai i tha A.Ç. se ai i mori udhëtarët dhe se do t’i çonte ata te Hotel Sara. Në vazhdim, më 25/11/2012, në orën 14.43 (dita kur personat e përmendur u larguan nga Hani i Elezit për në Maqedoni – dhe kjo po ashtu na sjell te A.B. -<sup>85</sup>) A.Ç. e thirri M.A. dhe M.A. e pyeti atë për disa migrantë. A.Ç. u përgjigj se “ai do t’i dërgojë ata për Kroaci nesër në orën 1. A.Ç. tha se ai po i dërgonte disa në Maqedoni sot me A.B.n. M.A. u përgjigj se emrat i janë dhënë zyrtarit policor atë ditë. M.A. kërkoi edhe një punë tjetër nga A.Ç.”<sup>86</sup>. Më 26/11/2012 ishin sërish disa biseda ndërmjet tyre ku bënin aranzhime për më shumë persona, domethënë, në orën 12.25 (përmbledhja) u zhvillua biseda në vijim: “M.A. pyeti nëse do të lëvizte ndonjë gjë. A.Ç. e konfirmoi dhe e ftoi M.A.n që t’i bënte aranzhimet e nevojshme ashtu që ai të mund t’i blinte biletat. M.A. pohonte se ai ishte në praninë e “djalit’ dhe se atij i duhet vetëm t’i dijë emrat e tyre” dhe në atë ditë në orën 16.32,

<sup>85</sup> Shtohet theksi.

<sup>86</sup> Këto biseda po kopjohen gjerësisht me qëllim të sqarimit të përfshirjes së M.A. në kontrabandimin e personave të ndryshëm– a kishte dyshime...

biseda përfshinte detajet për një familje dhe çmimet: “A.Ç. e thirri M.A.n i cili ishte i informuar lidhur me mbërritjen e një gruaje të familjes dhe të 2 fëmijëve me pasaporta të Turqisë dhe të burrit nga Mardin me pasaportë të Sirisë ‘ata mund të numërohen si 3 njerëz’ tha A.Ç. M.A. theksoi se çmimi që ata kishin kërkuar 500 Euro për person pa marrë parasysh se sa njerëz vijnë. Nuk ka zbritje për grupe’. A.Ç. dukej i shqetësuar pasi që ai besonte se pagesa e kërkuar nga zyrtarët policorë ishte tepër shumë por M.A. u përgjigj se ‘ata e kishin thirrur “H.”in’. Ata janë 3 njerëz plus “H.”i, që do të thotë janë 4 sish.’ Kur ata i ndajnë paratë ata nuk marrin mjaft para në fund. M.A. deklaroi se ‘atje janë 3 zyrtarë policorë. Ata duan 500 Euro për person. Ata kërkojnë 400 Euro për person, ne i marrim nga 100 Euro. Ne do t’i kemi 200 Euro prej 1500 Eurove. Mund t’ua kërkosh atyre 2000 Euro, mund të fitosh edhe më shumë’. A.Ç. dukej të ishte i bindur kur deklaronte se puna është e garantuar”.

Më shumë biseda u zhvilluan deri më 27/11/2012, në orën 12.02, A.Ç. e pyeti M.A.n për situatën dhe ky tha se më vonë do të thoshte diçka dhe pastaj në orën 16.51 (përmbledhja): “A.Ç. e thërret M.A.n. A.Ç. i thotë M.A.t se ai i kishte thënë migrantit që të priste te Hotel Bristol. Ai nuk është atje dhe telefoni i tij është i shkyçur. Migranti quhet [emri i parë i M.M.B.]. A.Ç. i tregon atij se ai me gjasë ka folur me të afërmit e tij në Francë dhe ata ia kanë ndërruar mendjen atij. M.A. i tregon A.Ç.t se ai do t’i thërrasë të afërmit e tij në Francë tani. M.A. i thotë A.Ç.t se ai do të shkojë në Prishtinë sot. Ata nuk punojnë nesër. Edhe A.Ç. do të shkojnë në Prishtinë nesër”. Pasi ta kontrollojë nëse është në dispozicion për të nesërmen, M.A., në orën 17.54 (në po të njëjtën ditë) e thërret A.Ç. dhe i thotë se (përmbledhje): “ata mund t’i blejnë biletat për nesër në mëngjes. M.A. dhe ai (“H.”i) mund të shkojnë në aeroport në orën 6 të mëngjesit, nuk është problem për ta” dhe në orën 18.54, M.A. e thirri A.Ç. dhe e pyet (përmbledhje): “nëse ai ishte kujdesur për këtë gjë. A.Ç. i thotë atij se do të jetë pasnesër në mbrëmje. A.Ç. i thotë atij se ai do të flasë me M.A.n më vonë kur ai të mbërrijë te shtëpia e tij”.

Pas shumë bisedave të tjera, në ditët pasuese (28/11/2012 dhe 29/11/2012, në orën 14.50 dhe 16.08), u zhvilluan këto biseda ndërmjet A.Ç. dhe M.A. (përmbledhje): A.Ç. e thirr M.A.n dhe “e pyet nëse ai ka biseduar me ata (zyrtarët policorë) lidhur me punën e tyre. M.A. thotë se është e aranzhuar. M.A. thotë se kjo është e aranzhuar për nesër në mbrëmje” dhe përsëri A.Ç. e thirr M.A.n dhe i thotë “se ai ia tregoi kësaj familjes emrin e “H.”it pasi që ata ngurronin. A.Ç. e pyeti M.A.n nëse edhe ai ka nevojë që t’ua tregojë mbiemrin e “H.”it, atyre. M.A. i thotë atij se emrat janë dhënë brenda. M.A. i tregon A.Ç.t se emrat që A.Ç. i ka dërguar përmes sms-it i janë dhënë “H.”it nga M.A. dhe “H.”i i ka dhënë brenda. A.Ç. e pyet nëse është me rëndësi se cilës biletari ata t’i afrohen, M.A. thotë se kjo nuk është me rëndësi. Pasaportat do të kontrollohen brenda (dhomë). Pra, “H.”i e ka aranzhuar çdo gjë me ta. Ata do ta kryejnë punën. M.A. thotë se ata do të jenë duke pritur në aeroport. Ai po ashtu e pyet A.Ç. se cili është numri i tyre i telefonit. A.Ç. do ta dërgojë numrin”- pavarësisht se kjo ngjarje e veçantë e kontrabandimit nuk përfundoi ashtu siç ishte planifikuar (shih thirrjet në të njëjtën ditë në orën 20.34 dhe 21) dhe ashtu siç ata e kuptuan se çfarë kishte shkuar keq (d.m.th., duke e marrë “H.”in në pyetje dhe duke e marrë në

shënim emrin e M.A.) ata e zhvilluan bisedën e mëposhtme më 29/11/2012, në orën 21.47 (përmbledhje):

A.Ç. e thirri M.A.n dhe M.A. i tregon atij se “ata e lëshuan atë personin (“H.”in). M.A. i tregon A.Ç.t se udhëtarët ishin me të vërtetë të veshur keq dhe ishin të çrregullt. “H.”i i pa ata. Ata (udhëtarët) ia përmendën zyrtarit policor, emrin e “H.”it dhe të A.Ç.t, 4-5 zyrtarë policorë dolën jashtë dhe i kërkuan A.Ç. dhe “H.”in. Ata po ashtu i thanë atij djalit (“H.”it) që të mos merrte asnjë arab para Vitit të Ri. Ata mund të marrin arabë pas Vitit të Ri. Nuk do të ketë probleme pas Vitit të Ri. Nuk ka asnjë mundësi që ata të mund të hyjnë para Vitit të Ri. A.Ç. i tregon atij se ata ishin të martuar. Zyrtari policor tha se nuk do të ishte problem për gruan, por problemi është ai burri. A.Ç. thotë se do të ketë më shumë punë brenda pak ditësh. Nuk kishte asnjë problem me djalin (“H.”in). Daja i tij (vëllai i nënës së “H.”it) është një zyrtar i policisë dhe ai tha se ai është nipi, se nuk kishte asnjë problem, se zyrtari kryesor i policisë e kishte ngatërruar punët krejt. M.A. i thotë A.Ç.t se ai duhet të aranzhojë diçka tjetër”; përveç kësaj, përfshirja shumë e qartë e M.A.it buron nga pyetjet (përveç asaj që tashmë është pohuar), bisedat si kjo (më 30/11/2012 në orën 14.42): M.A. është duke folur me A.Ç. dhe pastaj ai thotë se “aranzho diçka tjetër gjatë kësaj jave. A.Ç. i thotë atij që ta pyes atë personin për kur. A.Ç. i tregon atij se ata kishin pyetur për mbiemrin e tij. Ata i thanë atij (“H.”it) se nuk do të jetë problem nëse ata janë shtetas turq. M.A. i tregon atij se ai është me “H.”in tani dhe ai po kërkon udhëtarë të tjerë”.

Natyrisht gjykata mund të përsëris shumë më shumë biseda, por për ta përfunduar këtë pjesë, vetëm edhe dy që u zhvilluan më 1 dhjetor 2012, në orën 10.55 dhe në orën 13.22, A.Ç. e thirri M.A.n dhe M.A. e pyeti A.Ç. “nëse ka ndonjë punë. A.Ç. thotë se mund të ketë nesër. M.A. i thotë atij që të aranzhojë 3 njerëz për të, nëse ka ndonjë punë”, dhe më vonë M.A. e thërret A.Ç. dhe ky i fundit thotë se “ai ka një punë, por ka frikë se do të jetë e njëjtë si herën e fundit. M.A. i thotë atij se ai mund ta aranzhojë për nesër, 3 njerëz. A.Ç. thotë se çmimi duhet të jetë 350 për person. A.Ç. i thotë M.A.t që të bisedojë me ta. M.A. i tregon atij se ai do ta informojë atë” (A.Ç.) - për të gjitha këto biseda shih 15 dosjet e policisë, dosja 6, lidhja 2.1, f. 141 deri në 148 dhe procesverbalin e datës 25/9/2014, f. 13, kur dëshmitarja M.J. merrej me migrantin M.M.B..

Në lidhje me A.B., kjo rrjedh nga lidhja e bisedave të zhvilluara dhe datat e ngjarjeve, nga i tërë konteksti, për shembull, biseda tashmë cituar mes M.A.i më 25/11/2012, në orën 14.43, gjersa fliste me A.Ç., dhe kur e pyeti se si emigrantët do të dërgoheshin më tutje, A.Ç. i ishte përgjigjur atij “se ai po i dërgonte disa në Maqedoni sot me A.B.n”. Siç e pamë, M.M.B. aterroi në Aeroportin Ndërkombëtar të Kosovës për herë të dytë më 24/11/2012, në orën 8.07 të mbrëmjes, dhe u largua me automjet përmes pikës kufitare të Hanit të Elezit një ditë më pas, më 25/11/2012, në orën 5.02 të pasdites, kjo do të thotë se pas Kosovës ai kishte shkuar në Maqedoni dhe nga atje më tutje drejt destinacionit të tij përfundimtar, në të cilin ishte i përfshirë A.B., sepse përpara se ky person të hynte në Maqedoni, më 25/11/2012, në orën 14.43, në bisedën tashmë të cituar më lart, në orën 14.43, M.A. e pyeti A.Ç. se “a ka ndonjë lajm nga [emri

i parë i M.M.B.]?” në të cilën A.Ç. tha “ai do të dalë nesër, të thashë (...) nesër, nesër unë do ta marr atë rreth orës një ose dy mbëdhjetë”, dhe më vonë A.Ç. thotë se “tani për një kohë të shkurtër do t’i dërgojmë ata në Shkup dhe shpresoj se nuk do të kemi asnjë problem...”, në të cilën M.A. u përgjigj: “Shpresoj që të mos kesh asnjë problem... Të lutem bëje një punë të mirë “dhe A.Ç. u përgjigj” A.B. po përpiqet”.

Biseda e kopjuar tani do të ishte më se e mjaftueshme për një vëzhgues objektiv, por në të njëjtën ditë më 25/11/2012, në orën 15.13, A.Ç. përsëri duke e përdorur numrin [numrit të telefonit] e thirri O.K. dhe biseda shkoi kështu: A.Ç.: “Sapo i bëra përgatitjet, taksisti do të vijë së shpejti, për 30-40 minuta ... tani është ora 3.15 ... ata do të dalin në orën 15.45, kështu që ata nuk kanë nevojë të presin atje ... thuaju atyre që të jenë të durueshëm”, dhe O.K. pyeti: “si ia dolët me kufirin?”, në të cilën A.Ç. u përgjigj: “kufiri ... ai majmuni nuk është duke punuar sot, ai do të punojë nesër pasdite .. do të përgatis nja dy letra nga ajo qendër përsëri” dhe pastaj O.K. tha “e drejtë, bëji ato...në rregull ... çfarë desha të them ... a do të shkojë edhe A.B. në atë anë?” dhe A.Ç. shpjegoi, “jo ai nuk do të shkojë, A.B. ... këtu” (- shih 64 dosjet e përgjimeve, dosja 60, lidhja 5 f. 199-200, 201-206 dhe 209-210).

Në lidhje me M.B.n:

Gjykata, përtej dyshimit të arsyeshëm, ka konstatuar se M.B. ishte duke shkuar t’i merrte edhe dy migrantë atë ditë, një çift, që mbërrinte më 13/11/2012 “rreth orës 8 si zakonisht”, - por më pas ne e transkriptuam bisedën që ai zhvilloi me A.Ç. - dhe nëse e shikojmë raportin e SMK-së do të shohim se në të vërtetë më 13/11/2012, në orën 7.49 të mbrëmjes, çifti i përbërë nga M.M.B. dhe A.Bu. kishte mbërritur në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës (- shih faqen 275 të raportit të SMK-së).

Por tani ta shikojmë një bisedë të zhvilluar në ditën kritike: më 13/11/2012, në orën 14.46, A.Ç. (nga [numri të telefonit]) e thirri M.B.n (në [numrin]) dhe M.B. tha se ai “është duke pritur për dy punëtorët dhe A.Ç. tha: e di se, në çfarë kohe ... jam në dijeni për këtë; M.B.: sonte, në orën 7, 8, si çdo mbrëmje tjetër, pra në mbrëmje; A.Ç.: Shpresoj kështu; M.B.: Jo, ndoshta nuk do të jetë e vështirë, pasi ata janë burrë e grua; A.Ç.: Atëherë do të doja që ju ta kryenit atë (...) “- shih 64 dosjet e përgjimeve, dosja 61, lidhja 2.1, f. 211 deri 214.

**A.Gi.: A.Ç.**

Në lidhje me A.Ç.:

Ky person (i lindur më...) arriti në Kosovë me autobus përmes pikës kufitare të Hanit të Elezit më 25/11/2012 në orën 6.25 të mëngjesit, pastaj të nesërmen më 26/11/2012, ai u largua përmes pikës kufitare të Kullës, Pejë, me automjet në orën 5.12 të mbrëmjes, por hyri sërish me automjet në orën 6.33 të mbrëmjes; gjatë ditë më pas, më 2/12/2012 ai hyri përsëri në vend (nuk ka të dhëna nëse ai ishte larguar ndërmjet dy datave të fundit të cekura) përsëri përmes pikës së njëjtë kufitare, këtë herë me autobus, në orën 2.58 të pasdites, dhe u largua nga vendi

përmes pikës kufitare të Hanit të Elezit me autobus në orën 18.57 të mbrëmjes (dëshmitari V.I. po ashtu i ka konfirmuar këto lëvizje të fundit, shih procesverbalin e datës 10/2/2015, f. 6; po ashtu për këtë shih raportin e Policisë së EULEX-it, raporti i NJHKO-së 5246 mbi kalimin kufitar të migrantëve të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëll. 6, lidhja 5, f. 135-143). Më 26/11/2012, A.Ç. e kishte dërguar një email ku e bënte një rezervim në Villa Osa, Mostar, Bosnje dhe Hercegovinë në [adresa elektronike] për periudhën prej 27 deri më 30/11/2012 (lidhur me këtë dëshmitari V.I. sipas procesverbalit të datës 10/2/2015, f. 5; shih po ashtu raportin e Policisë së EULEX-it, NJHKO 4855, raportin 15-ditor të policisë mbi përgjimin e rrjetit kompjuterik të A.Ç. që përfshin periudhën 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëll. 3, lidhja 1, f. 1-17).

### **Numri i ngjarjeve ose momenteve të kontrabandimit krahasuar me numrin e personave të kontrabanduar.**

Numri i momenteve (ose i ngjarjeve ose vendimeve kriminale – që mund të jetë i ndryshëm nga numri i personave të kontrabanduar, nëse në një ngjarje ka më shumë se një person të kontrabanduar) në lidhje me këta të pandehur që është relevante për bashkimin e veprave penale është konstatuar duke marrë parasysh datat e operacioneve (domethënë e vlerësuar nga datat e arritjes në Kosovë), itinerari i ndjekur për t'u larguar nga Kosova dhe nëse aranzhimet janë bërë për një ose për më shumë se një person njëherësh.

Për të gjithë të pandehurit mund të konstatohet nga arsyetimi më lart; në lidhje me këta të pandehur ku dallimi ndërmjet numrit të ngjarjeve ose vendimeve kriminale (në momente të ndryshme) është më relevant, ashtu siç e ka konstatuar tashmë gjykata: M.B. ishte i përfshirë në kontrabandimin e 11 migrantëve në 6 momente të ndryshme (më 22/10/2012 1 migrant, 29/11/2012, 1 migrant, 8/11/2012 2 migrantë, 11/11/2012, 1 migrant, 16/11/2012, 5 migrantë dhe 24/11/2012, 1 migrant), A.M. ishte përfshirë në kontrabandimin e 11 migrantëve në 7 momente (më 25/9/2012, 2 migrantë, 25/9/2012, 3 migrantë, 17/10/2012, 1 migrant, 23/10/2012, 1 migrant, 23/10/2012 1 migrant, 27/10/2012, 1 migrant dhe 8/11/2012, 2 migrantë), A.B. ishte përfshirë në kontrabandimin e 3 migrantëve në 3 momente të ndryshme dhe M.A. ishte përfshirë në kontrabandimin e 2 migrantëve në 2 momente të ndryshme.

### **Lidhur me faktet e pa konstatuara në pikën 5:**

Më herët, disa komente tashmë janë bërë sipas arsyetimit lidhur me konstatimin e përfshirjes së një të pandehuri të caktuar dhe jo të një tjetri. Megjithatë, diçka më shumë duhet të thuhet.

- Në par. 3: **A.Se.:** Në rastin e këtij personi faktet që e përbëjnë një akuzë nuk janë konstatuar pasi që ajo është shtetase e Kosovës dhe mbajtëse e pasaportës së Republikës së Kosovës; këtë mund ta shohim nga emaili i datës 15/08/2012 nga J.S. drejtuar emailit të A.Ç.s [adresa elektronike] në të cilën është bashkëngjitur një kopje e pasaportës. Po ashtu, dëshmitari

V.I., bazuar në përmbajtjen e raportit të SMK-së, nuk ka shtuar shumë) A.Se. hyri në Kosovë më 13 gusht 2012 me automjet përmes pikës kufitare të Kullës, Pejë dhe kishte dalë më 13 gusht 2012 me automjet nëpërmjet pikë-kalimit të njëjtë kufitar. Një dalje tjetër ishte regjistruar më 24 gusht 2012 me autobus përmes pikë-kalimit kufitar Merdare, f. 269 të raportit të SMK-së.

- Në par. 3: **S.Baj.:** Në lidhje me këtë person ne kemi dy lëvizje të regjistruar anë raportin e SMK-së, ka dalë dhe ka hyrë në Kosovë më 24/8/2011 (në orën 11.06 dhe në orën 12.52), me automjet në pikën kufitare të Hanit të Elezit. Po ashtu është një korrespondencë me email ku përmendet emri i njëjtë (S.Baj.) më shumë se një vit më pas, ndërmjet 29/30 tetorit 2012, dhe emailat e tillë kanë të bëjnë me rezervimet prej 31/10/2012 deri më 5/11/2012 në Nirvana Rooms, Split, Kroaci. Dëshmitari V.I. është pyetur për këtë person por nuk ka mund të shtojë më shumë fakte. Ky person nuk përmendet në raportin financiar mbi A.Ç.. Trupi gjykues është i mendimit se vetëm faktet, domethënë emailat, nuk janë të mjaftueshëm për të konstatuar se ky person në të vërtetë është kontrabanduar, po ashtu ekziston një interval prej më shumë se një viti nga datat e përmendura në një provë dhe ato që përmenden në emailja. Përveç kësaj, komunikimet që cekura që lidhen me muajin tetor dhe prokuroria e vendos ngjarjen në gusht të vitit 2012. Gjithë kjo megjithë faktin se një vit më pas emri “S.Baj.” përmendet gjithashtu në një sms tjetër, më 25/10/2012 në orën 20.50, A.Ç. i dërgoi një sms A.M. me emrat, domethënë: “(...) A.Ar., M.Y.er, S.Baj., dhe I.Yl.”. Por, siç u tha më parë dhe tani në lidhje me A.M.: trupi gjykues është i mendimit se marrja e një sms me emrin e personit nuk është e mjaftueshme për të konstatuar, në këtë aspekt, përgjegjësinë penale panel; kur është marrë në pyetje për këtë, dëshmitari V.I. nuk ishte në gjendje të ofronte më shumë detaje, shih procesverbalin e datës 15/04/2015, f. 5.

- Në par. 5 **G.Ba.:** Ky person (i lindur më 23/02/1992) kishte arritur në Kosovë me aeroplan në aeroportin e Prishtinës më 31/10/2012 në orën 11.50 të natës. (shih për këtë po ashtu raportin e Policisë së EULEX-it, raporti i NJHKO-së 5246 mbi kalimin kufitar të migrantëve të datës 15/01/2013, SPRK/in/52/OC të datës 17/01/2013, dosja e policisë PINK 2, vëll. 6, lidhja 5, f. 135-143).

Megjithëse A.Ç. ka pasur një email në lidhje me këtë person (shih raportin e Policisë së EULEX-it, NJHKO 4855, raportin 15-ditor të policisë mbi përgjimin e rrjetit kompjuterik të A.Ç. që përfshin periudhën 21/06/2012 – 11/10/2012, të datës 17/10/2012, SPRK/in/1212/OC të datës 19/10/2012, dosja e policisë PINK 2, vëll. 3, lidhja 1, f. 1-17), trupi gjykues është i mendimit se provat nuk janë të mjaftueshme për të konstatuar përtej dyshimit të arsyeshëm se çfarë ka ndodhur me këtë person, pasi që jo vetëm që nuk ka të dhëna për daljen e tij nga vendi, por po ashtu për shkak se ky person nuk është trajtuar gjatë seancave.



**Pika 6 (i pandehuri A.G.)<sup>87</sup>:**

**Në periudhën ndërmjet 17 gushtit dhe 22 gushtit 2012, i pandehuri A.G. është i përfshirë në kontrabandimin e migrantit I.K. përmes ofrimit të letër garancisë, përmbajtja e të cilës nuk përkon me të vërtetën dhe shkuarja në aeroport për ta marrë personin për të cilin ai kishte garantuar, I.K., për të përfituar dobi financiare ose dobi tjetër materiale, duke siguruar në mënyrë specifike letër garancinë për personin e cekur.**

**I.K.:** Janë paraqitur prova për të konstatuar këtë fakt pasi që mund ta shohim letër garancinë të lëshuar nga i pandehuri (dosja e policisë 3, f. 413), të bëra te noteri më 17/08/2012 dhe i ishte dërguar me email A.Ç. më 20/08/2012. Përveç kësaj, ne mund ta shohim hyrjen e migrantit në Aeroportin e Prishtinës më 22/08/2012 sipas raportit të SMK-së; këto fakte po ashtu janë konfirmuar nga dëshmitari A.R. (procesverbali i datës 16/6/2015, f. 11/12) dhe V.I. (procesverbali i datës 28/4/2015, f. 12). Më 17/08/2012, një person i quajtur M.Ki. ka transferuar një shumë parash prej 100 Euro, A.G.t (dosja e policisë 10, lidhja 1, Përmbledhje e raportit financiar të datës 11.04.2013, faqe 17).

Megjithëse i pandehuri e ka mohuar këtë, në të vërtetë numri i tij i identifikimit (1005985915 – është saktësisht i njëjti numër i tij i identifikimit të KB-ve i caktuar nga Administratat e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara) përmendet saktësisht në informatat e dhëna nga Western Union më 05/03/2013 në kërkesën për publikimin e të dhënave financiare – shih 15 dosjet e policisë, dosja 11, lidhja 6, f. 91.

Por, përveç rastësisë së mbiemrit I.K., data e transferit e njëjtë sikur ajo e letër garancisë (17/08/2012), nëse dikush më kërkues se një vëzhgues objektiv do të kërkonte më shumë se kjo për të konstatuar nëse ai i pandehur kishte përfituar dobi materiale nga aktet e tij së bashku me A.Ç., atëherë ne madje do të mund ta shpërfillnim këtë dhe do të fokusoheshim në përmbajtjen e një sms që tipikisht nuk ka asgjë të bëjë me mesazhet normale ndërmjet një taksisti dhe një klienti, pasi që ai po kërkonte nga A.Ç. para për ta çuar djalin te mjeku [më 28/9/2012, në orën 17.42, A.G. nga [numri të telefonit] i ka dërguar A.Ç. në [numrin] një sms me këtë përmbajtje: A.G.: A.Ç. si je. A mundesh të m'i gjesh ca para, djali im i vogël është i sëmurë, dhe më duhet ta çoj te mjeku, jam krejt pa pare (- shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 62, lidhja 10, f. 504)]<sup>88</sup>.

Nga raporti i vëzhgimit (f.171), raportit që tashmë është përmendur, në lidhje me 22 gushtin 2012, dhe ky incident është raportuar në orën 16:35, “ekipi vëzhgues e kishte vërejtur një PPM 17, siç supozohet, taksisti, duke iu afruar një migranti i cili sapo kishte dalë nga terminali, i shkurtër dhe me ngjyrë të errët të lëkurës dhe personi i panjohur mashkull e pyet atë nëse ai ishte I.K.-i dhe djaloshi i ri përgjigjet ‘Jo’. Personi i panjohur lëviz sërish në drejtim të terminalit”.

---

<sup>87</sup> Siç u shpjegua më herët, arsyetimi i kësaj pike tashmë është reprodukuar më herët, në pikën 5, par. 5, ku ishte përmendur migranti i njëjtë.

<sup>88</sup> Një pjesë e kësaj tashmë është shpjeguar në arsyetimin në lidhje me kontrabandimin e migrantit të njëjtë por në pikën 5.

Këto fakte e mundësojnë përfundimin se i pandehuri A.G. shkoi në aeroport për ta marrë personin për të cilin ai kishte garantuar.

**Pika 7 (procedurat janë veçuar)<sup>89</sup>**

**Pika 8: (i pandehuri T.Y.)<sup>90</sup>**

**Në periudhën ndërmjet datës 7 nëntor 2012 dhe datës 7 (jo 4) dhjetor 2012, i pandehuri T.Y. përfshihet në kontrabandimin e migrantëve R.B. dhe E.Ba. duke i siguruar informata bashkë të pandehurit A.Ç. (përveç diskutimit të çështjes me personat e tjerë të përfshirë) dhe duke marrë pjesë në aranzhimet për udhëtimin e tyre nga Turqia në Kosovë dhe hyrjen në Kosovë për përfitim të dobisë financiare ose dobisë tjetër pasurore.**

**R.B. dhe E.Ba.: A.Ç./T.Y./M.B. – vetëm në lidhje me R.B.**

Në lidhje me A.Ç. dhe T.Y.:

Sipas raportit të SMK-së, R.B. kishte arritur në Aeroportin e Prishtinës më 11/11/2012, në orën 11.44, me aeroplan, dhe ishte larguar më 13/11/2012 në orën 04.43 me autobus nga Hani i Elezit; E.Ba. kishte arritur më 19/11/2012 në Aeroportin e Prishtinës, gjithashtu me aeroplan në orën 07.51, dhe ishte larguar me autobus (përmes Hanit të Elezit) më 22/11/2012, në orën 04.43

Përveç A.Ç., edhe T.Y. e ka kryer veprën penale të Kontrabandimit me migrantë, të paktën, me kontrabandimin e migrantëve R.B., shtetas i Republikës së Turqisë, i lindur më 01 janar 1968, dhe E.Ba., shtetas i Republikës së Turqisë, i lindur më 01 janar 1966, për të përfituar dobi financiare ose dobi tjetër pasurore (prej 7/11/2012 deri 22/11/2012, e jo 04/12/2012).

Megjithëse prokuroria e ka përmendur që nuk ka kopje të letër garancive të lëshuara nga T.Y. (më f. 10 të procesverbalit të datës 15/10/2014), trupi gjykues beson se në të vërtetë i pandehuri ishte i përfshirë në aktivitetin e kontrabandimit; trupi gjykues erdhi në këtë përfundim pas analizës së përmbajtjes së përgjimeve ndërmjet numrit që dihet që përdorej nga i pandehuri T.Y. dhe bashkë i pandehuri A.Ç. Në këtë aspekt, ekzistojnë përgjime shumë të rëndësishme të datës (dhe këtë duke pasur parasysh kornizën kohore të kontrabandimit të individëve që po diskutohet këtu) 4/11/2012 (në orën 19.29.34 minuta ka qenë një thirrje nga [numri], që i përkiste T.Y., në [numrin të telefonit], që i përkiste A.Ç., në të cilën T.Y. e pyeti A.Ç. nëse kishte nevojë t'i dërgohej ftesa një udhëtari dhe se kur udhëtari do të duhej të mbërrinte në Stamboll, në të cilën A.Ç. u përgjigj sa më shpejt që të jetë e mundur); më po të njëjtën ditë, disa minuta më vonë, në orën 19.38, i pandehuri i njëjtë thërret sërish në numrin e njëjtë dhe i thotë A.Ç. se udhëtari do të mbërrijë në Stamboll të nesërmen ose brenda dy ditësh (kjo nënkupton ditën 6/11/2012) dhe A.Ç. pastaj do t'ia dërgonte ftesën udhëtarit. Ia vlen të vihet në dukje se në ende

---

<sup>89</sup> Pika 7 nuk është duke u marrë parasysh më siç u shpjegua më herët, për shkak të faktit se në lidhje me të pandehurin Suleyman S.S. procedura është veçuar.

<sup>90</sup> Siç shpjegohet më herët, arsyetimi i kësaj pikë tashmë është trajtuar më herët, në pikën 5, par. 6, ku u përmendën migrantët e njëjtë.

po flasim për Stambollin dhe arritjet e pretenduara në Prishtinë kanë ndodhur pas datës 7/11/2012 (dhe po ashtu sepse në orën 20.54, T.Y. madje e ka informuar A.Ç. se udhëtari dëshironte ta shtynte udhëtimin e mëtejshëm për 2 ose 3 ditë). Po ashtu, më 6/11/2012, në orën 16.10, T.Y. e thirri A.Ç. dhe e informoi se udhëtari do të arrinte në Stamboll të nesërmen dhe, shumë e rëndësishme, A.Ç. e thërret T.Y. më 10/11/2012 në orën 19.12 dhe T.Y. e informoi se udhëtari do të arrinte të nesërmen (dhe ne do të shohim më poshtë se R.B. aterroi të nesërmen më 11/11/2012) dhe se ai kishte aranzhuar një veturë për ta marrë personin dhe po ashtu kishte pyetur për [emri i parë i N.N.]-in dhe A.Ç. ishte përgjigjur dhe kishte folur për më shumë udhëtarë që do të vinin dhe rreth asaj që “Mu.” ishte nën kujdesin intensiv në spital. Lidhur me përfshirjen e T.Y. në kontrabandim, një tjetër shembull mund të jetë biseda që ai kishte me A.Ç. më 8/11/2012 në orën 18.18, më 11/11/2012, në orën 10.52, sërish T.Y. ishte thirrur nga A.Ç. dhe ky i fundit u informua nga ai se udhëtari do të arrinte me fluturimin e Pegasus nga Stambolli. Po ashtu, po të njëjtën ditë, por në orën 12.01, A.Ç. e thirri T.Y. ku e informonte se udhëtari kishte arritur, e kishte kaluar kufirin dhe është marrë. Në fund, më 13/11/2012, në orën 17.22, T.Y. e thirri A.Ç. (gjithmonë në numrat e njëjtë të telefonit tashmë janë përmendur ata që janë duke u përdorur) dhe A.Ç. thotë se ai e kishte marrë një sms ku tregohej se udhëtarët e kishin kaluar kufirin. Më 14/11/2012, në orën 14.11, A.Ç. e thirri T.Y. dhe biseda u përmbledhë kështu: “T.Y. pyeti se si është situata. A.Ç. e informoi se një PPM tashmë është vendosur në një motel ku ai do të jetë me 4 persona të tjerë. A.Ç. tha se ata janë në pikën e fundit dhe do të largohen gjatë këtyre 2 ditëve”.

Më 17/11/2012, ka pasur dy biseda telefonike ndërmjet T.Y. dhe A.Ç. (mes orës 19.29 dhe 19.45) ku bënin aranzhimet për një takim. Pastaj më 18/11/2012 në orën 16.28, T.Y. e thërret A.Ç. dhe biseda ishte përmbledhur kështu: “T.Y. e thirri A.Ç. Ai e pyeti për situatën. A.Ç. tha se të gjithë janë mbledhur te ai vendi. A.Ç. tha se 2 prej tyre janë të tyre dhe 2 të tjerët i takojnë O.K.-it. T.Y. pastaj e pyeti nëse ai i takoi të tyre. A.Ç. tha se nuk i kishte takuar. T.Y. e pyeti A.Ç. për vendndodhjen e tij. A.Ç. tha se ai është te hotel Sara informoi se “To.” është këtu. T.Y. shpreson se gjërat do të kryhen sot. A.Ç. tha se atyre u ishte premtuar për nesër në mëngjes. T.Y. thotë se ata do të jenë në kontakt gjatë ditës”. Përveç kësaj, më 18/11/2012, A.Ç. është duke e thirrur T.Y., në orën 17.40, dhe A.Ç. e informon se të dytë do të dërgohen tutje të martën në mëngjes”.

Në fund, dëshmitarët po ashtu u morën në pyetje për përmbajtjet e raportit të SMK-së duke dhënë konfirmime dhe shpjegime për kuptimin e tij, ky ishte rasti i dëshmitarit V.I. (shih procesverbalin e datës 28/04/2015, f. 05) dhe K.G. (procesverbali i datës 20/05/2015, f. 20).

Këto biseda janë të rëndësishme dhe i mundësojnë gjykatës që të konstatojë përfshirjen e T.Y. në kontrabandim (pavarësisht faktit se kush i kishte përgatitur letrat e garancive), përtej dyshimit të arsyeshëm, siç mund ta shohim nga raporti i SMK-së, datat dhe kohët e mbërritjeve në Aeroportin e Prishtinës.

Në lidhje me M.B.n (përkitazi me R.B.):

Sa i përket R.B. dhe E.Ba., është me rëndësi të ceket përfshirja e M.B.t në marrjen e migrantit R.B.. Në fakt, më 2/11/2012 në orën 18.59, A.Ç. e thërret M.B. në [numrin] dhe përmbledhja e bisedës është kështu: “A.Ç. dhe M.B. biseduan për marrjen e një udhëtari. M.B. ka një udhëtar dhe me këtë ai do t’i ketë dy udhëtarë. Udhëtari i M.B.t do të arrijnë nesër në mëngjes. M.B. është i njohur me udhëtarin e A.Ç.t dhe ai i diktoi detajet: R.B. [data e lindjes...], [pasaporta nr.]. M.B. tha nëse çmimi prej 300 është i përshtatshëm. A.Ç. tha se edhe taksi duhet të përfshihet në këtë çmim. M.B. tha se ai do t’ia jap 130 Euro, zonjës, ndërsa ai [M.B.] do të mbajë pjesën tjetër të parave. M.B. kërkoi nga A.Ç. që të mos i thotë asgjë O.K.-it në lidhje me këtë ujdë, pasi që ai [M.B.] është mësuar t’i kërkojë 350-400 Euro nga O.K.-i për shërbimet e njëjta”.

Dëshmitarët po ashtu janë marrë në pyetje në lidhje me përmbajtjen e raportit të SMK-së duke dhënë konfirmimin dhe shpjegim të kuptimit për kuptimin e tij, ky ishte rasti me dëshmitarin V.I. (procesverbali i datës 28/04/2015, f. 05) dhe K.G.n (procesverbali i datës 20/05/2015, f. 20).

E fundit por jo më pak e rëndësishme, në këtë pikë të akuzës po diskutojmë për kontrabandimin e R.B. dhe E.Ba. dhe ekziston një transaksion financiar i regjistruar në Njësinë Financiare Prishtinë (Western Union), të datës 16/11/2012 (në kornizën kohore të përfshirë nga akuza) sipas të cilit nga një person, mbiemri i të cilit është gjithashtu [emri i familjes R.B.], dërguesi në Turqi, ky i pandehur ka marrë 1000 Euro (f. 19 e raportit financiar lidhur me këtë pandehur)<sup>91</sup>.

**Në pikën 8** nuk ishte konstatuar nëse përveç përfshirjes dhe angazhimit, pra duke kontaktuar me udhëtarët dhe duke siguruar informacion në lidhje me aranzhimet e udhëtimit, i pandehuri T.Y. ka përgatitur letër garanci.

-

Tani është koha që të bëhen disa referenca të shkurtra në pikat 1, 2 dhe 9, duke pasur parasysh këtu se çfarë u tha më herët në lidhje me realitetin se në disa raste thjesht dallimi midis fakteve dhe ligjit (ose koncepteve) është shumë i vështirë për t’u konstatuar.

**Në lidhje me pikat 1 dhe 2**, nuk ishte e mundur të konstatohen faktet që përbëjnë veprën penale të krimit të organizuar, domethënë, të pandehurit ishin një grup i organizuar kriminal (dhe çfarë do të thotë ky koncept në aspektin e fakteve). Megjithatë, faktet janë konstatuar dhe nëse është kështu atëherë ato në fund do të vlerësohen në një mënyrë të ndryshme (tani nuk është momenti i duhur për të trajtuar çështje të tjera që lidhen me veprën penale të cekur).

---

<sup>91</sup> Në këtë pikë, Prokuroria ka pretenduar se dobia materiale e përfituar ishte 900 Euro. Gjykata nuk ka mundur të gjeje fakte relevante për këtë konkluzion në raportin financiar në lidhje me T.Y. (dhe lidhja e A.Ç.-s me raportin e njëjtë, shuma e vetme e transferuar prej 900 Euro ishte më 2/4/2011 te U.A.).

Siç është thënë në faktet e vërtetuar, në lidhje me të pandehur të ndryshëm (A.Ç. i cili i njihnte të gjithë bashkë të pandehurit, M.B.n, A.M., M.A. dhe A.B.) është e mundur të thuhet se ata e njihnin njëri tjetrin dhe kanë vepruar (në bashkëkryerje) si anëtarë të një grupi të përbërë prej (të paktën) 3 individëve, në rastin e të tjerëve (I.P., T.Y. dhe A.G.) madje nuk ishte fare e mundur të konstatohej se ata i njihnin individët e tjerë të përfshirë ose bashkëkryerësit, nuk ishte e mundur të thuhet se ata po vepronin në ngjarjet e këtij rasti si anëtarë, si pjesë e një grupi dhe aq më pak si pjesë e një grupi të organizuar kriminal, i cili, në këtë rast, po ashtu çon drejt pamundësisë së konstatimit të dashjes që kërkohet nga ligjvënësi në këtë vepër penale të kimit të organizuar ose të pjesëmarrjes në krim të organizuar.

**Në lidhje me pikën 9**, nuk janë paraqitur prova dhe madje prokuroria e ka pranuar këtë në fjalët e saj përfundimtare. Vepra penale e pastrimit të parave e ka si një nga elementet përbërëse të saj dashjen e caktuar dhe faktet e nevojshme për të nuk janë konstatuar.

-

Gjykata ka konstatuar edhe faktin e mëposhtëm<sup>92</sup>: “A.Ç. po i **falsifikonte pasaportat** sa herë që ishte nevoja, në disa raste duke i fshirë vulat e refuzimit të hyrjes në një kufi të caktuar me qëllim që të mos krijohej asnjë mëdyshje ose dyshime tek zyrtaret e kufirit në kontrollet e kufijve të mëtejme”. Ekziston një numër transkriptesh ku përmendet aktiviteti i tillë, ku pasaportat quhen “fletore”. Në të vërtetë, më 7/11/2012, në orën 15.49, N.N. e ka përdorur telefonin e A.Ç.-s ([numrit të telefonit]) dhe e ka thirrur M.B.n (në [numrin]) dhe gjatë bisedës ajo ia përmend atij se A.Ç. po i pastronte pasaportat [në një moment të caktuar, gjatë bisedës, aty thuhet: “M.B.: Hallo; N.N.: Hallo, jam unë [emri i parë i N.N.]. Çka ka të re? Vëlla A.Ç. është duke e pastruar një fletore dhe ai më kërkoi që të thirrja ty” (- shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 51, lidhja 3, f. Prej 229 deri 232)]. Po ashtu, në një bisedë tjetër, më 23/06/2012, në orën 12.40, A.Ç. ishte thirrur nga O.K. përmes [numrit të telefonit], (-shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 1, f. 53-55). A.Ç. e informoi O.K. se ai do t’i vizitonte “ata” edhe pak dhe se noteri është i hapur të hënën për t’i aranzhuar ftesat, pasi që në rast se nuk i lënë ata të kalojnë dhe atyre do t’u vulosej “kthim”; O.K.-i u përgjigj se A.Ç. duhej “t’i pastronte fletoret e tyre” dhe pyeti nëse ata do të ishin në gjendje të arrinin këtu. A.Ç. u përgjigj se është mirë që këto ditë ata të mund të kalojnë (- shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 1, f. 56-58).

Lidhur me faktin që individët e cekur si migrantë ishin individë që vinin në Kosovë si në një **vend transit**, ndonëse ata nuk e deklarojnë këtë, ose se e deklarojnë madje edhe të kundërtën para autoriteteve, pasi që synimi i tyre ishte arritja në vendet e treta, përkatësisht në vendet e Bashkimit Evropian, gjykata vëren se zakonisht njerëzit i përdorin biletat e kthimit, sepse ato janë më të lehta dhe më të lira, dhe gjithashtu është e zakonshme që njerëzit të largohen nga vendi prej nga ata kanë hyrë (pasi që, në mënyrën, siç është vënë në dukje nga Prokuroria në fjalët e saj përfundimtare), por këtu, në këtë rast, një shikim i thjeshtë në raportin e SMK-së është

---

<sup>92</sup>Pasi që të gjitha faktet, përmbajnë dhe kanë të bëjnë me aktakuzën.

qartësues... individët (migrantët) vinin në Kosovë dhe largoheshin nga Kosova duke përdorur pothuajse gjithmonë kufij dhe mjete të ndryshme të transportit. Përveç këtij fakti të mirënjohur, gjykata thekson, si shembuj dhe përveç asaj që u tha më parë, fragmentet e mëposhtme:

- Më 10 shtator 2012, një bisedë ndërmjet A.Ç. dhe A.M., kur A.Ç. thotë “Sapo isha duke e dërguar një sms, e di ti ata kanë shkuar në Mostar. Njeriu ka shikuar në ekran dhe nuk ka gjetur asgjë; ne e kopjuam atë siç e di ti, kështu që tash është zhdukur nga ekrani. I shkrova në Turqi që të shkruajë direkt në emajlin tënd”, dhe pastaj A.M. u përgjigj “Nuk ka problem, por të paktën të kemi njëfarë dokumenti në duart tona”, dhe pastaj A.Ç. tha “E shkrova [adresë elektronike], a është në rregull” (shih dosja 56 e dosjeve të përgjimit, faqe 282; shih po ashtu deklaratat e dëshmitarit V.I. lidhur me këtë fragment në procesverbalin e datës 20/04/2015).

- Më 16/8/2012, në orën 16.09, A.Ç. i përgjigjet dikujt që e identifikonte veten si daja i O.Yl. tha si më poshtë: “Ai tani është rrugës për në Kroaci me një shok timin. Unë jam duke folur me ta dhe po e përcjell situatën” dhe pastaj shton “ata do të hynë në Kroaci, zyrtarisht. Dhe pastaj nesër në mbrëmje ekziston mundësia që ata do të vazhdojnë për në Austri, Itali” (- shih Dosja e përgjimit -vëll. 10, lidhja 4. faqet.201-202).

- Më 17 dhjetor 2011, e regjistruar në orën 17.24, është një bisedë ndërmjet A.Ç. dhe A.B. dhe A.B. i thotë A.Ç. “I kam dy në Suboticë, si t’i qes në Kroaci ata” dhe pastaj A.Ç. u përgjigj “a janë të pastër”, në të cilën A.B. tha “po, janë të pastër” dhe A.Ç. u përgjigj “dërgoj ata në Mostar”, në të cilën A.B. reagon duke thënë “si në Mostar, a nuk duhet t’i çoj ata në Beograd” dhe pastaj A.Ç. u përgjigj “je di detyruar t’i lësh ata në Beograd dhe të shkosh” (shih dosjet e NJN të Italisë, dosja 14, faqe 335; shih po ashtu deklaratën e dëshmitarit V.I. në procesverbalin e datës 24/11/2014, f.11 deri 14).

- Mes datave 22 qershor 2012 dhe 19 gusht 2012, në komunikimet ndërmjet A.Ç. dhe S.I., A.Ç. e përmend “ata janë duke shkuar në Novi Pazar si më parë, unë do t’i sjell librat sonte. Ata do të shkojnë në Kroaci të mërkurën dhe të enjten në Rijekë, dy janë të “E.?” në Kroaci dhe ai do të më informoj mua pas pak se ku janë atë” (për këtë shih dëshminë e V.I. në seancën e mbajtur më 09/02/2015, f. 7).

-Më 24 korrik 2012, në orën 19.04, A.Ç. thirri (me numrin 049819946) A.B. (në numrin 049507481) dhe biseda e tyre shkoi kështu: “Unë po thërras vazhdimisht, ai madje nuk po përgjigjet as në telefon tani. Unë do të merrja 1500 Euro. Ne do të ishim të lehtësuar dhe mirë këtu. Këtu pari nuk ka shokë të vërtetë. Personi që ishte këtu me mua, ata e njohin atë, ti nuk e di, ai ka ndejtë këtu për 20 ditë, ai po u spiunon atyre kështu e ashtu, kam dërguar njerëz në një destinacion të largët, ata njerëz. Më beso (...)” – shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 5, lidhja 24, f. 462/464 (biseda që pason, megjithatë, çon në konkluzionin që shumica e cekur nuk ishte marrë ashtu siç ishte planifikuar).

- Më 11 shtator 2012, në orën 12.24, A.Ç. thirret nga ““N.”i” - “E kam këtu një person, ai mund t’i rregullojë letrat dhe vetëm ma tregoi rrugën që ai e ka. Rrugën nga Kosova drejt

Maqedonisë, Shqipërisë deri në Greqi, dhe pastaj i transporton ata me anije nga Igumenica” në të cilën A.Ç. tha “Fol edhe me këtë person”. Më vonë, “N.” u prezantua para këtij personi dhe i thotë atij, “Jam shok i A.Ç.t, jam nga Shqipëria”, dhe ai e pyeti këtë person “Çfarë je në gjendje të bësh ti?” Personi i panjohur mashkull, tha, “Unë mund të rregulloj dokumente të Çekisë, çmimi total i dokumenteve është 1300 Euro. Dokumentet janë në emër të personit nga Çekia, por ne e vendosim foton e personit që ju dëshironi. Gjithashtu, unë i shoqëroj ata nga Prishtina deri në Igumenicë, a e dini ju ku është ajo? Pastaj unë i hipi ata në anije “(f. 291 i raportit dhe dëshmisë së Vincenzo Improtes në seancën e mbajtur më 09/02/2015, f. 10 të procesverbalit).

- Më 7 korrik 2012 A.Ç. i tha personit të panjohur “ti do ta blesh vetëm biletën e autobusit, do të shkosh në Novi Pazar, taksisti im e ka shtëpinë atje, nuk ka problem, më thirr kur të zbresësh nga autobusi” dhe pastaj personi i panjohur pyeti “a nuk do të ecim ne nëse shkojmë, ai personi na tha”, në të cilën A.Ç. tha “ju do të shkoni në një rrugë tjetër, do të ecni 45 minuta ose 1 orë nga Kroaci në Slloveni, kjo është e tëra, ti nuk po më kupton mua mirë, nuk është përmes Hungarisë, më thirr kur të arrish atje, nuk është e sigurt të flasësh gjersa je në autobus” (- shih transkriptin dosja 2, faqe 74 dhe më tej; për këtë shikoje po ashtu dëshminë e V.I. më 3/12/2014, f. 8).

- Më 7 korrik 2012, në orën 11.18 “Komisari” i thotë A.Ç.-s “A fole me ta?” dhe A.Ç. përgjigjet, “Po, fola shkurt me ta. Ata thanë jo, por unë do t’i thërras përsëri. U thashë se ata do të udhëtojnë në mënyrë legale për Bosnje dhe Kroaci dhe pastaj Itali ose Vjenë. Ata do të ecin vetëm 40 minuta – më së shumti 1 orë e 20 minuta”, në të cilën “Komisari” përgjigjet se “Tani e kam një shok, kushëriri i tij ka ardhur këtu nga Siria. Ai ka shkuar për Kroaci dhe Bullgari. Ai është në Bullgari tani dhe nuk ka asnjë dokument. A mund t’i ndihmosh këtij personi? Nëse mund t’i ndihmosh atij, unë do ta dërgoj numrin e tij”, dhe pastaj A.Ç. përgjigjet “Mundem. Nuk mund t’i ndihmoj drejtpërdrejt por kam shokë”, pastaj “Komisari” përgjigjet “Në rregull, bëj ca hulumtime dhe më thirr” dhe në fund A.Ç. përgjigjet “në rregull, shpresoj që të funksionojë” (shih dosja 2 e përgjimeve, faqe 70; shih për këtë edhe dëshminë e V.I. më 3/12/2014, f. 3).

- Më 25 nëntor 2012 në orën 23.11, ishte një bisedë ndërmjet A.Ç. dhe O.K. dhe O.K. tha se B.I. i ka dhënë para policisë maqedonase, dhe A.Ç. u përgjigj “si mundi i çmenduri, futja”, dhe më pas O.K. tha “ata, secili i dhanë nga 20 Euro gjersa po largoheshin nga Maqedonia. Policia e Maqedonisë i mori paratë. I futën në xhepat e tyre, dhe tani policia e Serbisë po kërkon para (...) nuk është se familja por ata të tjerët”, në të cilën A.Ç. shtoi “çfarë budallenjsh janë!” dhe pastaj O.K. u përgjigj se “ata po ashtu ia dhanë 300 Euro policisë serbe (...) u thashë atyre, nëse zyrtari policor serbe kërkon para, atëherë unë u thashë atyre nga 20 Euro secili” (shih dosjen e përgjimit 60, f. 227; shih po ashtu dëshminë e M.J. në seancën e mbajtur më 24/9/2014, procesverbali f. 9).

- Më 27/11/2012, në orën 12.02<sup>93</sup> “A.Ç. e pyeti M.A. lidhur me situatën dhe ky i tha se më vonë do të thoshte diçka dhe pastaj, në orën 16.51 (përmbledhje): “A.Ç. e thërret M.A.n. A.Ç. i thotë M.A.t se ai i tha migrantit që të presë te Hotel Bristol. Ai nuk është atje dhe telefoni i tij është i çkyqur. Migrantit quhet [emri i parë i M.M.B.]. A.Ç. i thotë atij se me siguri ai ka folur me të afërmit e tij në Francë dhe ata kanë ndërruar mendje. M.A. i thotë A.Ç.t se ai do t’i thërrasë të afërmit në Francë<sup>94</sup> tani. M.A. i thotë se ai do të shkojë në Prishtinë sot. Ata nuk punojnë nesër. Edhe A.Ç. do të shkojë në Prishtinë nesër”.

Një bisedë tjetër që ia vlen të ceket në këtë pikë është zhvilluar më 12/11/2012 në orën 14.34 ndërmjet A.Ç.-s dhe I.P. dhe A.Ç. tha se udhëtarët janë nisur se ata do të jenë në destinacionin e tyre rreth orës 4. - shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 52, lidhja 4, f. 214).

Të pandehurit, meqë e dinin se aktivitetet e tyre ishin të paligjshme, shpesh kanë shfaqur shenja të shqetësimit për atë se flisnin në telefon për disa çështje ose detaje; si shembull i kësaj, më 13/11/2012 në orën 20.47, A.Ç. (me numrin [numrit të telefonit]) e thërret I.P.n (në [numrin]) dhe biseda ishte si vijon (A.C. paraqet A.Ç. dhe I.P. paraqet I.P.n): I.P.: tungjatjeta (...); A.C.: Mirë. Do t’i them atij me mustaqe ‘jepjani 50 Euro atyre djemve’. Nuk ka problem. I.P.: Jo. Asgjë, unë do ta thërras atë tani; A.C.: jepu, jepu; I.P.: mos fol tepër shumë, telefoni po dëgjohet, a e din – shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 55, lidhja 3, f. 127.

Siç shpjegohet më lart, vetëm shembujt (disa prej tyre të dobishëm për më shumë se një qëllim ose për arsyen e më shumë se një fakti) janë cituar, jo lista complete ose e plotë e provave në këtë drejtim.

Por, në këtë pikë, po e përmendim një bisedë ndërmjet A.M. dhe A.Ç., që ka të bëjë jo vetëm me përmendjen e destinacioneve përfundimtare (si Vjena, në Austri), por edhe për **dobinë pasurore** – si një listë e vogël e shembujve që kanë të bëjnë me dobinë pasurore po ashtu do të pasojë (tani e cekim “dobia pasurore”, por në të vërtetë elementi relevant është qëllimi që ta përfitojë atë, e jo që në të vërtetë është përfituar):

- Më 24 korrik 2012, në orën 19.04<sup>95</sup>, A.Ç. e thirri (me numrin 049819946) A.B. (në numrin 049507481) dhe biseda shkoi kështu: Unë po thërras vazhdimisht, ai madje nuk po përgjigjet as në telefon tani. Unë do të merrja 1500 Euro. Ne do të ishim të lehtësuar dhe mirë këtu. Këtu pari nuk ka shokë të vërtetë. Personi që ishte këtu me mua, ata e njohin atë, ti nuk e di, ai ka ndejtë këtu për 20 ditë, ai po u spiunon atyre kështu e ashtu, kam dërguar njerëz në një destinacion të largët, ata njerëz. Më beso (...) – shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 5, lidhja 24, f. 462/464 (biseda që pason, megjithatë, çon në konkluzionin që shuma e cekur nuk ishte marrë ashtu siç ishte planifikuar).

---

<sup>93</sup> Kjo bisedë më herët ishte kopjuar në arsyetimin e M.M.B. (Shih 15 dosjet e policisë, dosja 6, lidhja 2.1, f. 144).

<sup>94</sup> Shtohet theksi.

<sup>95</sup> Kjo bisedë po ashtu është përdorur si shembull më herët, lidhur me dërgimin e migrantëve në destinacionin më të largët...



- Më 13/11/2012 në orën 17.59, në një bisedë ndërmjet A.Ç. dhe M.B., M.B. tha “ku janë punëtorët tani? A.Ç. pyeti: Cilët? Dhe më vonë M.B. i drejtohet A.Ç.-së dhe ai tha: ‘Nuk është për këtë, nëse djaloshi ka 600-700 Euro ai mund të shkojë atje zyrtarisht. Personi i mori paratë dhe po ashtu i mori paratë e tjetrit. Ai i rrahu disa fëmijë. Nuk e di çfarë , ai nuk është udhëtari im, përndryshe do t’ia ...atij, ai nuk ka pasur punë me mua, unë ia kam dhënë një-dy punë për ata që nuk kanë mundur ta kalojnë kufirin zyrtarisht. Ai i ka kapërcyer ata, nuk kam pasur kurrfarë problemesh’. A.Ç. deklaroi se ai nuk e di cilat janë problemet e këtyre njerëzve”.

- Më 2/11/ 2012, në orën 1.45 (- shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 52, lidhja 1, f. 1), në një bisedë ndërmjet A.Ç. dhe A.M., A.Ç. tha se ai do t’i kontrollonte destinacionet përfundimtare. Në të njëjtën ditë, A.Ç. i kishte diktuar A.M. emrat e mëposhtëm A.T., [data e lindjes], I.G. [data e lindjes], S.U. [data e lindjes]. A.M. e pyeti se në çfarë kohe do të mbërrinin ata në Kosovë dhe A.Ç. nuk ishte i sigurt për këtë, por tha se fillimisht këta udhëtarë do të mbërrinin në Stamboll dhe pastaj do ta kontrollonte destinacionin e tyre. Dhe A.M. e pyeti nëse ai duhej t’i përgatiste ftesat për ditën e nesërme dhe A.Ç. e pyeti se sa do të fitonte A.M., dhe A.M. i tha se ai donte 450 Euro dhe pjesa tjetër do të ishte për ty (A.Ç.), dhe A.M. po ashtu ia rikujtoi atij një borxh prej 250 Eurosh nga e kaluara dhe A.Ç. i tha atij se ai mendonte se ai (A.M.) i kishte marrë paratë nga udhëtarët.

- Më 5/11/2012, në orën 22.26 (shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 62, lidhja 9, f. 435 dhe më tej): A.Ç. i ankohet A.M.-ut se Volkan-i pasi ka shkuar në Vjenë ditë më përpara nuk po përgjigjet në telefon dhe A.M. thotë “natyrisht, pasi që ai është dashtë t’i japë paratë”. A.Ç. pastaj tha se ai është i dëmtuari dhe A.M. tha se edhe ai është dëmtuar pasi që ai është dashur të fitonte. Pas një diskutimi të vogël përmes telefonit, A.M. ankohet se është dëmtuar në shumën prej 5000 Eurosh dhe më vonë e sqaron se ishin 4760 Euro dhe më vonë A.Ç. thotë si vijon: “ju po ashtu po thoni se më keni shkaktuar mua një dëm prej 5000 Euro...ju i keni rezervuar pesë bileta... i çmendur, pesë bileta nuk kushtojnë 5000 lira. Pesë bileta kushtojnë... të themi 1500-1600 lira... ju nuk po i numëroni ata që janë larguar, ju nuk po i numëroni as ata që kanë zbritur... pse po i rezervon pesë 5... mos i blloko pesë bileta për një person... kjo do të thotë se t’i do t’i fitosh 10000 lira nga ai person, pra kjo është arsyeja se pse po i rezervon pesë bileta njëherësh” dhe A.M. përgjigjet “Do të flas me ty më vonë”.

Një shembull i mirë i dashjes nga ana e të pandehurve dhe se si ka përfshirë njerëz të ndryshëm, ka diskutuar çmimet, margjinat e fitimit, ryshfetet për zyrtarët policorë, etj. është, ndër të tjera, që tashmë janë përmendur krahas këtij arsyetimi, si vijon (tashmë të cituara më parë në lidhje me arsyetimin e kontrabandimit të personit që quajtur M.M.B.): “A.Ç. e thirri M.A.n i cili ishte njoftuar për ardhjen e një gruaje të familjes dhe 2 fëmijëve me pasaporta turke dhe të bashkëshortit nga Mardin-i me pasaportë siriane ‘ata mund të llogariten si 3 persona’, tha A.Ç.. M.A. theksoi se çmimi që ata kërkojnë është 500 Euro për person, pavarësisht se sa njerëz do të vijnë. Nuk ka zbritje për grupe’. A.Ç. dukej të ishte i shqetësuar pasi që ai besonte se pagesa që kërkonin zyrtarët e policisë ishte tepër shumë, por M.A. iu përgjigj se ‘ata e kanë thirrur “H.”in’. Ata janë 3 persona plus “H.”i, kjo i bën ata 4’. Kur ata i ndajnë paratë ata nuk marrin para të

mjaftueshme në fund. M.A. deklaroi se ‘janë 3 zyrtarë policorë atje. Ata duan 500 Euro për person. Ata kërkojnë 400 Euro për person, ne i marrim 100 Euro. Ne do t’i kemi 200 Euro prej 1500 Eurove. Mund t’u kërkojsh 2000 Euro, po ashtu mund të fitosh më shumë’. A.Ç. dukej të ishte i bindur ku deklaronte se puna është e garantuar<sup>96</sup>.

- Më 1/12/2012, në orën 13.22, M.A. e thërret A.Ç.tn dhe ky i fundit “ai e ka një punë, por ka frikë se do të jetë njëjtë sikurse herën e kaluar. M.A. i thotë atij se ai mund ta aranzhojë këtë për nesër, 3 njerëz. A.Ç. thotë se çmimi duhet të jetë 350 për person. A.Ç. i thotë M.A.t që të flasë me ta. M.A. i thotë atij se ai do ta informojë atë” (A.Ç.)<sup>97</sup>.

- Më 14/11/2012 në orën 8.40, kur A.Ç. (nga [numri të telefonit] e thirri I.P. në [numrin]), dhe kur A.Ç. i kërkoi paratë që ai (I.P.) i kishte marrë nga tre djemtë/udhëtarët. I.P. tha se ata i kanë paguar atij vetëm 55 (shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 52, lidhja 4, f. 240), por kjo duhet të bazohet në kontekstin e bisedave që ata kishin në atë periudhë kohore që nga 7 nëntori, pasi që kjo nuk ishte vetëm për pagesën e xhiros me taksi, ajo ishte për atë se sa duhet të kërkohet nga migrantët (600, pastaj 550, etj., në lidhje me ose kundrejt shumave që migrantët deklarorin se i kishin në posedim të tyre dhe nevojës së tyre supozuar që të shkonin në Western Union Prishtina ose Peja për të marrë më shumë para dhe diskutimi i tyre në atë ditë të javës ishte dhe nëse do të ishte e hapur; si një shembull i bisedës së cekur më 12/11/2012 në orën 14. A.Ç. tha se personi i thirrur duhet t’i merrte 600-650 Euro dhe t’ia jepte 50 Euro atij (A.Ç.t) (...) - shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 52, lidhja 4, f. 214.

Siç u tha, ekzistojnë një numër shembujsh krahas shkresave të lëndës dhe një numër i konsiderueshëm i tyre janë shkruar përgjatë këtij aktgjykimi.

Pas kësaj liste shembujsh për dobinë pasurore, gjykata pohon se veprimet e të pandehurve që janë përshkruar si pjesë përbërëse e veprave penale kishin për synim përfitimin e dobisë financiare ose dobisë tjetër pasurore nga ajo; gjykata thekson se duhet të kihet parasysh se gjykata detyrohet nga kriteri ligjor (në vlerësimin e provave) të qytetarit të zakonshëm, se si një *bonus pater familiae* do ta interpretonte atë, për të marrë parasysh “përvojën e zakonshme” të vlerësuar nga një qytetar i rëndomtë – siç thuhet – domethënë kur i përgjigjet pyetjes “*pse ata do të përfshiheshin në këtë nëse nuk do të merrnin ndonjë gjë, ndonjë dobi financiare ose pasurore nga kjo?*”) – ndaj kësaj, disi *pyetje retorike*, gjykata konsideron se përgjigja është e dukshme: askush nuk përfshihet në këtë lloj “pune”, aktiviteti, po ashtu përfshirja në telashe (potenciale) me policinë, sistemin e drejtësisë, etj.. (pasi që ata shpesh ata shfaqen të jenë të frikësuar nga kjo, kur flasin në telefon dhe madje kur e përdorin një mënyrë të çuditshme të të folurit – fjalori, slengu, etj., - në shumicë e bisedave dhe ky lloj i zhvillimit të bisedave nuk përkon me mënyrën në të cilën njerëzit normalë flasin në telefon...) pa pasur asnjë lloj përfitimi, asnjë përfitimi, ose, si në këtë vepër penale të veçantë ceket një referencë në “dobi pasurore”.

---

<sup>96</sup> Shih 15 dosjet e policisë, dosja 6, lidhja 2.1, f. 143.

<sup>97</sup> Shih *aty*, f. 145.

Gjykata do t'u kthehet, në një fazë të mëvonshme' elementeve përbërëse të veprës penale, por ia vlen të vihet në dukje qysh tash (siç tashmë është përmendur shpejt e shpejt më lart) se vërtet ligji nuk e kërkon nëse një person në të vërtetë ka marrë ose përfituar një fitim të vërtetë, ka pasur dobi pasurore; çfarë kërkon ligji është se a ka vepruar individi me **dashje** (shtohet theksi) në arritjen e dobisë pasurore, andaj gur themeli nuk është rezultati (në të vërtetë a ka përfituar dobi) por **dashja** (shtohet theksi) e individit ("çdo veprim me **qëllim** të përfitimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një dobie financiare ose të një dobie tjetër pasurore nga hyrja e paligjshme e personit në Republikën e Kosovës, kur personi i tillë nuk është shtetas i Republikës së Kosovës (...)" – shih neni 170, par. 8, nën-par. 8.1 KPRK-së.

Para se të përfundohet kjo pjesë, një shembull tjetër i fundit i asaj që është duke e deklaruar gjykata: Më 9/11/2012 në orën 15.14, A.Ç. (nga [numri të telefonit]) e thirri I.P.n (në [numrin]) dhe biseda ishte si vijon (A.C. paraqet A.Ç. dhe I.P. paraqet I.P.n): I.P.: hajde A.Ç.; A.C.: Qysh je Çoban (duke menduar bari), ti the se do të dalësh atje. Ata i kanë gjithsej 600 – 700 diçka ashtu; I.P: ka 400. Ai tha 'nuk kam më shumë'; A.C.: Jo. Ai bosi tha se dikush do t'i marrë 400 tani dhe ai do ta dërgojë pjesën e dytë të hënën tjetër: I.F.: Ata po rrejnë, t'i e di këtë; A.C.: Do të pyes. Jo, jo, ata janë të pastër. Unë po them se do të pyes, nuk e di; I.P: Jo, jo, nuk ka mundësi sepse ai atje po i kërkon, e di ti; A.C.: po (...) – shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 55, lidhja 8, f. 356/357.

Në fund, por jo e fundit për nga rëndësia, për ta përfunduar këtë pjesë, gjykata konsideron se konkluzionet e paraqitura në faqe 28 e më tutje të Raportit të Përmbledhur të Hetimit Financiar të datës 11/4/2013 (që gjendet në 15 dosjet e policisë, dosja 10, "DOC") mund të jetë sqaruese kur bie fjala për shumat e parave që janë transferuar ndërmjet disa prej të pandehurve në këtë rast dhe personave të tjerë të cilët po ashtu janë të pandehur në raste të ngjashme (p.sh. N.N. dhe M.C.) dhe personave të tjerë të cilët shpesh përmenden nga të pandehurit në bisedat e tyre (p.sh. O.K.).

Po ashtu në lidhje me **transaksionet financiare** (pasi që është fakt notor se ai që e udhëheq një biznes ose që kryen çfarëdo veprimesh ekonomike legale, sot duhet të ketë një xhirollogari bankare, për t'u regjistruar në sistemin e tatimeve, etj.), por tani në një perspektive të ndryshme, gjykata mori në konsideratë<sup>98</sup> informatat nga Doganat e Kosovës/Ministria e Financave, të datës 28/02/2013, informatat nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë të Kosovës, të datës 20/02/2013 dhe Raportin e Përmbledhur të Hetimeve Financiare, ref. nr. 2011-DHKO-027/2013, të datës 11/04/2013, që gjenden respektivisht në 15 dosjet e policisë, dosja 11, lidhja 10, f. 134/135, në 15 dosjet e policisë, dosja 11, lidhja 11, f. 141/142 dhe në 15 dosjet e policisë, dosja 10, f. 1 deri 59.

Rreth asaj se **a e kanë njohur të pandehurit njëri-tjetrin**, gjykata ka konstatuar po ashtu se "të gjithë të pandehurit e tjerë të këtij rasti e njihnin të pandehurin A.Ç., i pandehuri

---

<sup>98</sup> Siç është përmendur më herët tashmë, në vendin e duhur, për arsye të sqarimit.

A.Ç. dhe të tjerët si M.B., A.M. dhe A.B. i njihnin të pandehurit e rasteve të ndërlidhura (si, për shembull, N.N. dhe O.A.) ose personat e tjerë të përfshirë (O.S.-in, për shembull) dhe disa nga të pandehurit e këtij rasti ka pasur kontakte mes tyre dhe kanë bashkëpunuar në ngjarje të ndryshme të kontrabandës. Në të vërtetë, nëse A.Ç. i njihnte të gjithë ata, është e vërtetë se të pandehurit M.B., A.M., M.A. dhe A.B. nganjëherë vepronin vetëm ose me persona të tjerë (duke përfshirë zyrtarë të policisë apo zyrtarë kufitar), por nganjëherë ata vepronin së bashku, në ngjarje të ndryshme, duke qenë se është e mundur të konstatohet se ata ishin në dijeni dhe ishin në kontakt me të paktën edhe me 2 prej tyre”.

Për ta konstatuar këtë fakt, përveç asaj që rrjedh nga arsyetimi i mësipërm për secilin prej migrantëve, është konfirmuar nga përmbajtja e përgjimeve (ka shembuj të shumtë të bisedave ndërmjet dy të pandehurve, ku një emër i tretë përmendet dhe nuk ka dyshim se kush mund të jetë personi i tillë, që do të thotë se personat e përfshirë në bisedë e dinin saktësisht se për këtë po flisnin). Përveç asaj që mund të nxirret nga pjesët e tjera të arsyetimit, këtu ka shembuj të referencave që të paktën një bashkë i pandehur përveç atij(tyre) merrte pjesë në atë bisedë: Përveç përgjimeve të bisedave të A.Ç.-s me të gjithë bashkë të pandehurit, M.B. më 19/10/2012, në orën 11.04 ka pasur një bisedë me A.Ç. ku përmendet emri i një bashkë të pandehuri tjetër në këtë rast (A.B.), pasi që A.Ç. po i tregonte M.B.t se kur duhet ai të shkojë atje që ta thërrasë A.B.n; A.M. më 8/12/2012, në orën 17.59 ka pasur një bisedë me A.Ç. ku ata biseduan për A.B.<sup>99</sup>, përmendet (një tjetër bashkë i pandehur); M.A. më 25/11/2012, në orën 14.43, gjersa fliste me A.Ç., dhe kur e pyeti se si do të dërgoheshin migrantët tutje, A.Ç. iu përgjigj atij “se ai po i dërgonte disa në Maqedoni sot me A.B.n” dhe në lidhje me A.B., logjikisht, kjo rrjedh nga ajo që sapo u tha në lidhje me të tjerët.

Përveç kësaj, e përmendur si shembull, kjo mund të konfirmohet gjithashtu nga fakti se, në përputhje me rrethanat, kontaktet e më shumë se një bashkë të pandehuri u gjetën në analizën forenzike të kryer në telefonat dhe sim kartat që kishin të bënin me numrat e telefonit të cekur gjatë këtij shqyrtimi dhe në përdorim nga të pandehurit. Për shembull, A.B. ka pasur kontakte të paktën<sup>100</sup> me M.A. dhe A.Ç. (të cilët ka pasur kontakte të shumta me të gjithë bashkë të pandehurit) të ruajtura në numrin e tij të telefonit [numri] (shih f. 251 të raportit mbi analizën e numrave zbuluar në pajisjet/SIM kartat janë krahasuar me raportet përfundimtare sa i përket numrit në fjalë), M.B. gjithashtu kishte kontakte të paktën me A.Ç. dhe A.B. (shih f. 4/5 të raportit analizues për thirrjet hyrëse dhe dalëse të numrave të telefonit në rastin Pink, të datës 02/12/2013), A.M. (nga [numri]) gjithashtu kishte telefonata me A.B. në [numrin] [shih faqen 5 të raportit në fjalë (dhe ky numri i fundit është përdorur nga A.B., bile kur ishte në kontakt me

---

<sup>99</sup> Biseda e cekur shkoi kësisoj (përmbledhje): “A.Ç.i e informoi A.M. se udhëtarët janë në aeroplan dhe se ai i kishte këshilluar ata të thonë se në vitin 2005 ata kishin punuar në ndërtimin e ndërtesës së komunës dhe se tani ata janë duke e vizituar A.M. i cili mund të hap një biznes për ta. A.M. tha se ai e ka gjetur një shok nga Shkupi i cili mund t’i transportojë ata (me aeroplan) njerëz në të gjitha destinacionit për një çmim prej 2200 Euro. Ata vazhduan të flisnin për A.B. A.Ç.i ia kaloi telefonin e tij A.B. Pastaj A.Ç. i e mori telefonin e tij prapa. A.Ç.i e këshilloi A.M. se ku ta parkonte veturën e tij në kompleksin e aeroportit për një çmim më të lirë” – Shih 64 dosjet e përgjimit, dosja 56, lidhja. 1, f. 62/63.

<sup>100</sup> Siç e thamë ne po flasim thjesht për shembuj ...

A.Ç. - shih faqen 12 të raportit të njëjtë)] dhe M.A. po ashtu kishte 109 telefonata me A.Ç. dhe të paktën 1 telefonatë me numrin e Maqedonisë të A.B. ([ ]) - shih f. 24 e raportit analizues për thirrjet hyrëse dhe dalëse të numrave të telefonit në rastin Pink, të datës 2013/02/12.

Lidhur me **përfshirjen e zyrtarëve policorë** në disa ngjarje të kontrabandimit: Më lart, në njërin nga faktet e konstatuara thuhet, si vijon: “Në rastet e tjera, si në Kosovë, ashtu edhe në vendet e tjera, domethënë në Ish-RJ të Maqedonisë dhe në Serbi, ishin të korrumpuar dhe e dinin paligjshmërinë e kalimeve kufitare nga disa individë të cilët ishin duke u kontrabanduar dhe i kanë lejuar kalimet e paligjshme, në përputhje me marrëveshjet që kishin bërë me kontrabanduesit (çmimin, sasinë e ryshfetit për emigrant të kontrabanduar - emrat e të cilëve kanë qenë, ndonjëherë , të dhëna apo me të cilat qenë pajisur, paraprakisht). Të paktën të pandehurit A.Ç., M.B., A.M., M.A. dhe A.B. kanë qenë, në disa ngjarje të veçanta të kontrabandimit të migrantëve, jo vetëm që ishin në dijeni për këtë situatë, por edhe kjo ishte pjesë e ekzekutimit”.

Le ta sqarojmë ne tani se një fakt i tillë që përcaktuar në këtë mënyrë. Në lidhje me “vetëdijen dhe pritjet” e përmendura, në lidhje me të pandehurit A.Ç. dhe A.B. dy biseda mjaftojnë që të sqarojnë se përse gjykata që e bindur në këtë. Në të vërtetë, me datë 08/11/2012, në ora 14:10 min. A.Ç. (me [numër të telefonit]) e thërret A.B. (në [numrin]) dhe biseda vijoi kështu (përmbledhje) “A.Ç. i thotë A.B. se ai i ka dërguar 3 migrantë në Rozhaje. A.Ç. thotë se ai është duke u përpjekur për të zbuluar nëse ndonjë nga vozitësit ka ndonjë lidhje me zyrtarët policorë në kufirin me Serbinë. A.Ç. thotë se ai do e dërgojë një migrant në Maqedoni nesër ” - shih 15 lidhëse policore, lidhja 6, pika 1, fq. 36.

Po ashtu, me datë 18/11/2012, në ora 19:06 min, A.Ç. (nga numri [numrit të telefonit]) e thërret A.B. (në [numrin]) dhe pastaj A.B. pyet “Në rregull, në rregull miku im, kur do vijnë të tjerët. A ka edhe ndonjë tjetër? Dhe A.Ç. përgjigjet: “të nesërmen në mbrëmje”. A.B. pastaj thotë “shpresoj që nesër në mbrëmje do kalojë” dhe A.Ç. përgjigjet “ai do kalojë, do kalojë” (- shih 64 lidhëse të përgjimeve, lidhja 60, pika 4, fq.157 deri në 160.

Me datë 20/11/2012, në ora 13:11min, dhe në ora 13:13min, respektivisht, kanë ndodhur këto biseda (A.B. ka qenë së bashku me “njeriun e tij” të cilit i duheshin emrat e migrantëve meqë ai do punonte atë natë dhe A.Ç. është dashur që ti dërgojë emrat me SMS, andaj, pas telefonimit në Hotel Sara, ku ai i kishte vendosur ata, ai bile ia bën të çartë një migranti se me rastin e kalimit të kufirit, kjo gjë do bëhej me bashkëpunimin e një zyrtari policor): A.B., “A.B.” (nga [numri]), e telefonon A.Ç.n, “A.Ç.” (në [numrin të telefonit]), dhe biseda zhvillohet si në vijim: A.B.: Vëlla, mi dërgo emrat menjëherë, a është kjo në rregull?; A.Ç. u kry!; A.B.: ky person është pranë meje... është pranë meje...mi dërgo emrat menjëherë sepse ai është duke shkuar në punë... në ora 5 do i vendosni ata në Rule Turs (...) që të tre në një... por emrat, menjëherë.... Kur mund ti dërgoni ato? (...) ky person është afër meje; A.Ç.: për 5 minuta do i dërgoj”. Pastaj, në ora 13.13, në të njëjtin numër A.Ç. thërret Hotel Sara nga 038236203 dhe flet me një migrant (dhe pasi që i përmend emrat e tjerëve) dhe në një rast i thotë atij: “Këto në

Maqedoni... ti do të shkosh në marrëveshje me zyrtarin policor” (- shih lidhëset e përgjimit me numër 64, lidhja 60, pika 4, fq. 161/163). Po ashtu, , më parë, me datë 25 nëntor 2012 në ora 23:11 min, ka pasur një bisedë në mes të A.Ç. dhe O.K. dhe në atë moment A.Ç. është përgjigjur “si ndodhi që i çmenduri, vaftë në djall”, dhe pastaj O.K. ka thënë “ ata kanë dhënë nga 20 euro secili gjersa janë larguar nga Maqedonia. Policët Maqedon i kanë marrë paratë. I kanë futur në xhep, dhe tani policia Serbe po kërkon para (...) nuk është familja por ata tjerët”, në të cilën gjë A.Ç. ka shtuar “çfarë budallenjsh që janë!” dhe pastaj O.K. është përgjigjur se “ata po ashtu kanë dhënë edhe 300 Euro për policinë Serbe (...) Unë u thashë atyre, nëse zyrtari policor Serb kërkon para, atëherë unë ju kam thënë që 20 euro secili,” (shih dosjen e përgjimit 60, fq. 227; shih po ashtu edhe dëshminë e M.J. në seancën e mbajtur me datë 24/9/2014, procesverbali fq.9).

- Me datë 10/11/2012, në ora 16:46, A.B. (nga [numri]) e ka thirrur A.Ç.n (në [numrin të telefoni]) dhe në momentin në fjalë i ka thënë A.Ç.s: “Më thuaj, a duhet ai që të shkoj tek ai personi apo jo”, dhe A.Ç. thotë “paj, lëre që të shkojë”, në të cilën gjë A.B. përgjigjet “a e kupton, ai do shkojë tek personi më i madh.... fare, fare... ai është duke shkuar tek ... gjithë kufijtë... ai është duke shkuar tek shefi i gjithë kufijve” dhe pastaj A.Ç. përgjigjet: “e kuptova... nuk ke nevojë të vazhdosh që të flasësh, ne nuk jemi amatorë... lëre që të shkojë” (-shih lidhjen e përgjimit, lidhja 62, pika 1, fq. 43 deri në 46).

- Me datë 13/11/2012, në ora 14:46 min, A.Ç. (nga [numri të telefonit]) e ka thirrë M.B.n (në [numrin]) dhe në një moment të caktuar biseda shkoi si në vijim: “A.Ç.: ata djem... ata të rinjë ... kanë arritur në cak... unë kam folur rreth orës 10/11; M.B.: Ata janë tek vendi?; A.Ç.: Po, unë kam qenë shumë i lumtur për ta ... posa ata ... ju e dini dhe pastaj me zyrtarin e kam kryer, mirë, ... ka qenë ashtu, së paku ata kanë fjetur vetëm një natë dhe pastaj ata kanë shkuar; M.B.: kjo ishte mirë; A.Ç.: po, vërtetë... djemtë ... ka skaduar ... dhe zyrtari ka marrë... në tren zyrtari policor ka marrë, maskarai...; M.B.: aha; A.Ç.: ai po ashtu ka marrë 50, Serbi ka marrë 50, s’ka gjë, unë e kam thënë vetëm për ta parandaluar kthimin e tyre, apo jo?; M.B.: nuk ka rëndësi, sinqerisht ndonjëherë fati i rregullon gjërat (...)”- shih lidhjen e përgjimeve 64, lidhja 61, pika 2.1, fq. 211 deri 214.

Në lidhje me M.A., edhe pse biseda veq ka qenë transkript, për arsye sistematike do të përsëritet këtu. Është një bisedë e veçantë në mes të A.Ç. dhe M.A. (në mesin e shumë bisedave që kanë pasur) që vijon kështu: “A.Ç. e ka telefonuar M.A.n i cili ka qenë i informuar në lidhje me arritjen e familjes, gruas dhe dy fëmijëve, me pasaporta turke, dhe të burrit nga Mardin me pasaportë Siriane ‘ata mund të numërohen si 3 persona’ ka thënë A.Ç. M.A. ka theksuar se çmimi që ata kanë kërkuar 500 euro per person pa marë parasysh se sa njerëz po vinin. Nuk ka zbritje për grupe’. A.Ç. dukej që të ishte i brengosur meqë ai besonte se pagesa e kërkuar nga zyrtarët policorë ishte shumë e lartë, por M.A. është përgjigjur se ‘ ata e kanë thirrur “H.”in’. Ata janë 3 persona plus “H.”i, që i bën 4 prej tyre’. Kur ata i ndajnë paratë ata në fund nuk marrin shumë para. M.A. ka theksuar se’ janë 3 zyrtarë policorë atje. Ata duan 500 euro për person. Ata

kërkojnë 400 euro për person, ne marrim 100 euro. Ne do na mbesin 200 Euro nga shuma e 1500 eurove. Ju mund të kërkonit nga ata 2000 Euro, ju po ashtu mund të fitoni më shumë<sup>101</sup>.

Në lidhje me A.M., në këtë aspekt, dhe si një shembull, ne do përdorim këtu pjesën e arsyetimit të dhënë më sipër në lidhje me migrantët H.T. dhe M.P.. Në fakt, me datë 19/10/2012 ka pasur shumë biseda në mes të A.M. dhe A.Ç. në lidhje me organizimin e kontrabandimit me migrantë me ndihmën e një zyrtari që punonte në aeroport dhe në SMS, A.M. ankohej se ishte e turpshme të mos i kishte ende emrat për të ia dhënë zyrtarit, meqë para atij Sms-i, në ora 15:52, A.M. veq e kishte dërguar një SMS tjetër tek A.Ç. që thoshte: ‘ është e turpshme! Personi është duke pritur që nga mëngjesi për emrat’ dhe në ora 16:46 A.M. e telefonon A.Ç.n dhe thotë se “ ai është duke u kthyer nga aeroporti dhe nuk është askush që ishte ndaluar. Duket që të ishte një thashetheme. A.M. thotë se ai kishte pirë kafe me këtë person dhe ky person ka thënë se ai mund ta rregullonte një hyrje për deri në 4 personA.M. është duke e shtyrë A.Ç. që të bëj diçka ( në po atë ditë) dhe A.Ç. ka thënë se diçka mund të dilte në dy-tre ditë”. Në po të njëjtën ditë, por në ora 20:21 min, A.Ç. e ka thirrur A.M.un dhe ka thënë se “ është një person duke ardhur por në Shkup. A.M. ia sqaron A.Ç.t se është me rëndësi që të silllet dikush sot ashtu që njeriu i tij të mund ta shohë se këta ishin seriozë. Ai i thotë A.Ç.t se ai mund ta humbasë besueshmërinë sepse njeriu i tij ishte mashtruar disa herë”. Në ora 20:46 min, A.Ç. e thërret A.M.un dhe e informon atë se “ janë tre persona që janë ndaluar dhe janë vendosur në një dhomë. A.M. thotë se ai do e pyes personin, ndërsa A.Ç. do i marrë emrat” dhe në fund në ora 20:48, A.M. e thërret A.Ç. dhe e pyet nëse ai mund ti marrë emrat. A.Ç. thotë se ai do e zbulojë tani dhe se do i dërgojë emrat përmes SMS-it”- dhe kjo është përmbajtja të cilën ne e kemi përmendur më parë ( për të gjitha këto transkripte, shih lidhjen 15 të dosjes së policisë, lidhja 6, pika 2.1, fq 131)<sup>102</sup>.

### **Referenca të shkurtra për "deklaratat e të pandehurit.**

Të pandehurit kishin dhënë deklaratat që janë përdorur për ti marrë ata në pyetje tërthorazi, datat e deklaratave të tilla kanë qenë në ditët si në vijim<sup>103</sup>: A.Ç. me 10/6/2013 dhe 5/8/2013<sup>104</sup>, M.B. me 21/1/2013<sup>105</sup>, A.M. me 11/1/2013<sup>106</sup> dhe me 14/11/2013<sup>107</sup>, M.A. me

---

<sup>101</sup> Shih 15 lidhëset e policisë, lidhja 6, pika 2.1, fq. 143.

<sup>102</sup> Po ashtu edhe në lidhje me këtë çështje, në seancën e datës 15 prill 2015, kur dëshmitari V.I. është marrë në pyetje ai është marrë në pyetje në lidhje me një transkript me përmbajtje si në vijim: A.Ç. e thërret A.M.un dhe A.M.u thotë “është mirë se paku që të përpiqemi me një familje. A.M. e informon A.Ç.n se ai i ka thënë njeriut të tij se ai do marri 1900 Euro për një familje, dhe sipas A.M. pjesët do ndahen si në vijim: pesëqind euro për A.M., një mijë euro për zyrtarin policor brenda, dhe pesëqind euro për njeriun e tij”.

<sup>103</sup> Në fusnota do të përmendim thelbin e deklaratave të dhëna në atë kohë pa hyrë në detaje, pasi deklaratat e plotë mund të lexohet; do të jetë përmbledhje shumë të shkurtër.

<sup>104</sup> Me datë 10/6/2013 dhe me 5/8/2013, A.Ç. në PSRK deklaroi se ai kishte ardhur në Kosovë në fund të vitit 2011 apo fillimin e vitit 2012; ka pranuar ta kishte përdorur [numrin të telefonit] gjersa ishte arrestuar. A.Ç. deklaroi se ai ka punuar në kompaninë Gold Star që merret me qeramika, të gjitha llojet e pajisjeve që përdoren në ndërtesa dhe punonte me përqindje, duke marrë 3-5%, varësisht se sa shiste. Ai tha që ai e njihte M.A. si punëtor në xhaminë e Kakanic-it që bënte renovime. Kur është pyetur nëse e njihte M.B.n, A.Ç. kishte deklaruar që të mos I kujtohej, iu kujtua që e njihte T.Y. si punëtor në një shitore Doneri; po ashtu ka deklaruar të mos I njihte A.G.n dhe I.P.. A.Ç. tha që ai e njihte A.M.un, që punonte me dyer dhe dritare të plastikës. A.Ç. ka mohuar ta ketë përdorur

1/6/2013 dhe 14/11/2013<sup>108</sup> (i cili vërtetë e ka inkriminuar A.Ç.n dhe po ashtu veten e tij...), I.P. me 18/1/2013<sup>109</sup>, A.B. me 17/1/2013<sup>110</sup>, A.G. me 8/2/2013<sup>111</sup> dhe T.Y. me 14/6/2013<sup>112</sup>.

---

[numrin], ndërsa në lidhje me [numrin] tha që mendonte se ishte numri I vjetër dhe se ishte marrë nga Policia në mbajtje.

<sup>105</sup> me 21/1/2013 M.B. është intervistuar në PSRK. Dhe ka pranuar ta ketë përdorur numrin [numrin]. Ai ka deklaruar se nuk e njihje asnjë nga të pandehurit e përmendur në aktakuzë. Ai më tej mohoi të dinte vendndodhjen e Hotel Sara, dhe ka deklaruar se ai e di se çfarë është një letër garancie dhe është përgjigjur me “po” nëse ndonjëherë kishte bërë ndonjë letër garancion për dikë që do vinte në Kosovë.

<sup>106</sup> A.M. ka pranuar ti ketë përdorur numrat e telefonit të përmendur nga hetuesit, si dhe adresat e-mailit, të jetë i vetë-punësuar duke kaluar një periudhë të vështirë, mohoi të dijë emrat e disa individëve më vonë të përmendur në aktakuzë si emigrantë, vetëm e ka njohur A.Ç.in apo A.Ç.in e “dehur” (jo nga mbiemri A.Ç.), që kanë udhëtuar për të vizituar familjen në Turqi një vit më parë, që të ketë shitur plastike dhe prodhime të kornizave të dritareve, ai tha se ai kurrë nuk kishte ndonjë lidhje biznesi me A.Ç.in, nuk e di sa herë kishte folur me A.Ç.in në telefon.

<sup>107</sup> A.M. ka pranuar se A.Ç. i kishte thënë atij se kishte disa mysafirë që do vinin nga Turqia dhe nëse ai mund të shkonte që ti merrte ata në aeroport - të cilën gjë ai edhe e bëri 2 ose 3 herë, se bile kishte paguar edhe biletën e 3 personave që po vinin dhe se ka pritur të kishte një profit me interes, që kishte punuar me “kompaninë B.”, mohoi të kishte pranuar ndonjë gjë nga A.Ç.i për marrjen e personave nga aeroporti (se A.Os., H.O. dhe “M.” ia kanë arritur që të futen në Kosovë dhe të tjerët jo më së shumti sepse nuk i kanë përmbushur kërkesat edhe pse kishin zbritur në Kosovë), e ka dërguar A.Os. tek Hoteli Holiday në Prizren dhe dy të tjerët tek Hotel Bujari po ashtu në Prizren, me një rast tjetër ka shkuar në aeroport për të marrë persona siq i ishte kërkuar nga A.Ç.i, por personat nuk kishin dalur jashtë (njëri ka qenë M.V.). Po ashtu tha që jetonte tek prindërit me një vëlla dhe një motër.

<sup>108</sup> Me datë 13/6/2013 dhe 14/11/2013 M.A. kishte deklaruar në PSRK se ai ishte në Kosovë që nga viti 2008, ka theksuar se punonte në një xhami, xhaminë Fati, për 6 vjet, ka pranuar se e ka përdorur [numrin] IPKO dhe po ashtu tha se me A.Ç.n nuk k pasur asnjë punë – ata kanë qenë vetëm shokë në Café. Ai ka pranuar se rreth muajit dhjetor 2012 A.Ç. e ka telefonuar atë dhe e ka informuar se 3 mysafirë (mashkull, femër dhe një fëmijë) do vinin dhe do kërkonin nga ai që ti pranonte, dhe pastaj ai ka shkuar në aeroport që ti marri ata por ata nuk kishin ardhur, ata ishin kthyer prapa në Turqi. M.A. ka thënë se ai do merrte para për këtë gjë. Në pyetjen “ a e di se përse mysafirët po vinin në Kosovë tek A.Ç.i?” M.A. kishte thënë “A.Ç. i ka organizuar ata dhe i ka dërguar në Evropë, ai ka bërë çdo gjë, dhe ai është shefi”. Ai ka theksuar se ai kishte shkuar vetëm një herë në aeroport për ti marrë mysafirët e A.Ç.it.

<sup>109</sup> I.P. tha se ka pasur një procedurë të vazhdueshme kundër tij në Gjilan, por nuk dua të them se çfarë ishte, ka pranuar të ketë përdorur [numrin e telefonit], deklaroi të jetë shofer taksie që nga viti 2000 dhe të kishte shkuar në Malin e Zi shpesh (vetëm për Rozhaje), të ketë të ardhura mesatare në mes të 200 dhe 250 euro, të ketë njohur A.Ç.n që nga 2 ose 3 vjet më parë, se në kohën e fundit ka jetuar rreth 300 metra nga vendqëndrimi i taksive, dhe një herë e ka dërguar atë në Malin e Zi dhe ka pritur për rreth një orë për ta sjellë atë përsëri në Pejë dhe që atëherë nuk e ka takuar atë përsëri derisa ai e ka telefonuar në tetor / nëntor 2012 duke e pyetur nëse ai ishte ende duke shkuar me makinë në Rozhaje? (në lidhje me atë kishte rreth 4/5 telefonata deri sa A.Ç.i ishte arrestuar), se që nga koha e këtyre telefonatave të fundit, A.Ç. ishte duke jetuar në Prishtinë.

<sup>110</sup> A.B. e ka konfirmuar se ai i ka përdorur numrat e telefonit [numri] (IRJM) dhe [numri] (Kosovë) dhe tjerat nuk ka mundur që ti mbaj ne mend, ka sqaruar se disa kushërinjë jetojnë në Kosovë, ai tha se ai kishte folur turqisht me mikun e tij A.Ç. – po ashtu te njohur si “ A.Ç.i i dehur” – të cilin e njihje që prej para 4 vitesh, ditën kur ishte kryer bastisja ai kishte qëndruar tek A.Ç.i ku ai kishte arritur me të dhe kur kanë ardhur policia ai e ka thirrur A.Ç.in- telefoni i te cilit ka qenë aty dhe ka cingëruar- dhe e ka dëshmuar bastisjen, nuk e mban në mend të ketë qenë në Kosovë 3 ditë para bastisjes, ka deklaruar që të jetë një punëtor ndërtimtarie i papunë por të ardhurat mujore të familjes së tij të jenë rreth 800 euro, i ka mohuar akuzat dhe të ketë kryer ndonjëherë ndonjë punë për A.Ç.in, se A.Ç.i ka punuar në ri-konstruimin e monumenteve dhe urave, xhamive, ka mohuar që ta njohë O.A., O.K., A.By., “N.”, Personi me nofkën “T.”, “Ha.”, B.F., A.M., I.S., O.S., L.L., Y.D. dhe vetëm e ka takuar M.B. në rrugë për në burgun e Dubravës dhe S.S. ka qenë fqiu i A.Ç.it. Ka deklaruar se ndoshta e njeh ndonjë zyrtar policor të IRJM por jo që punon në kufi. Ka thënë ti ketë pranuar 85 Euro në xhironlogarinë e tij përmes Western Unionit që kanë qenë për A.Ç.n sepse ai nuk ka pasur pasaportë me vete, po ashtu ka thënë që ata kurrë nuk kanë folur në lidhje me migrantët dhe se A.Ç.i ia kishte përmendur “ punëtorët” atij dhe se me sa ai e dinte A.Ç.i nuk ka punuar për ndonjë kompani, ka deklaruar se e di Hotel Sarën në Prishtinë meqë ndodhet rrugës për në shtëpinë e A.Ç.it dhe që kishte



Gjatë gjykimit asnjë nga të pandehurit nuk ka pranuar të ketë kryer ndonjë vepër penale, pavarësisht nga të gjitha, ata i kanë pranuar disa fakte (për shembull A.G.), të jenë pronarë apo ti kenë përdorur e-mail adresat (A.Ç. dhe A.M.) apo numrat e telefonit për të cilat prokuroria ka pohuar të ishin të tyre<sup>113</sup> dhe që janë përdorur me rastin e përgjimit të telefonatave dhe mesazheve tekstuale. Të pandehurit kanë sqaruar edhe cilën gjuhë e flasin, pasi kjo mund të ketë qenë në fakt gjuha e përdorur, të paktën nga një pikëpamje teorike, që përfundimisht do hedhi dyshime mbi atë se cilët mund të jenë individët e përgjuar, duke pasur parasysh nacionalitetet e tyre dhe gjuhët amtare - sigurisht kjo do të duhet të përballet me problemin se raportet e vëzhgimit dhe të dhënat e ngjarjeve që ndodhën në vijim, do të shpijnë në një përfundim të ndryshëm...

Kur është marrë në pyetje në lidhje me përmbajtjen e dyshimtë të bisedës së regjistruar (verbatim) apo përmbledhjeve, apo transkriptet të mesazheve tekstuale, përgjigja, në të shumtën

---

shkuar atje një herë që ta pinte një kafe, ka deklaruar se nuk ka shkuar kurrë me A.Ç.in tek ndonjë noter dhe e ka përshkruar bastisjen e kryer tek shtëpia e A.Ç.it dhe si ka qenë i autorizuar që të shkoj.

<sup>111</sup> Me datë 8/2/2013 në PSRK, ai ka pranuar se para arrestimit të tij ai ka përdorur vetëm një [numër të telefonit mobil], dhe se ka punuar si vozitës taksie dhe se e kishte njohur A.Ç.n para një viti, të cilit i kishte ofruar shërbime si vozitës taksie; po ashtu tha se një ditë A.Ç. kishte kërkuar ndihmën e tij dhe e kishte pyetur nëse mund të bëhej garantor për dy “punëtorë”, për të cilën gjë ai ka thënë se ata mund ta pyesnin policinë dhe gjykatat dhe se nëse ato dy institucione do japin leje ai do ua bënte garancionin. Pasiqë A.Ç.i i kishte thënë atij se kjo gjë duhej që të bëhej përmes noterit dhe pas kësaj A.Ç. i ka marrë të dhënat e tij dhe në po të njëjtën ditë, apo të nesërmen, ata kanë shkuar në zyrën e noterit, ai po ashtu ka thënë se e ka bërë për çështje humanitare....Pas nënshkrimit të dokumenteve, A.Ç.i ka thënë se ato dokumente do dërgohen me Fax në Turqi meqë ata persona ishin gati për të ardhur dhe i ka thënë atij se ai do e informonte atë në mënyrë që të shkojë e ta marri njërin nga ata persona në aeroport. Një ditë më vonë ka qenë i informuar në lidhje me kohën e arritjes dhe ai ka shkuar në aeroport që ta marri atë, por meqë personi është vonuar ai ka shkuar në deskun e informatave dhe pastaj atij i është thënë aty se kjo ishte një çështje për policinë dhe se më vonë një zyrtar policor i kishte thënë se ky person në fjalë, nuk mund të futej në Kosovë dhe pasi identifikimi i tij u regjistrua atij i është lejuar që të shkojë duke e ditur se udhëtari nuk mund të vijë dhe të dali nga terminali. Pasi që ai e ka pyetur A.Ç.in me Telefon që ta paguaj për shkuarjen e tij në aeroport dhe e kujton emrin I.K..

<sup>112</sup> Me 14/6/2013 në PSRK, ai kishte thënë që ka ardhur në Kosovë që nga muaji maj apo qershor i vitit 2000 dhe se pas kësaj ai ishte punësuar në restorantin “Extreme Pizza”. A ka pranuar ta ketë përdorur numrin e telefonit 044781961, që e njihte A.Ç.n që nga koha kur ai punonte në restorant dhe ku ai ka shkuar si një klient; ai po ashtu ka thënë se A.Ç. po i thoshte atij se ai ishte pronar i kompanisë dhe se ai kishte punëtorë që punonin për të. Ai ka thënë se ai e kishte një shok nga Turqia që dëshironte për të ardhur këtu për të punuar dhe A.Ç.i i kishte thënë se shoku i tij mund të vinte e të punonte për të, por, në fund A.Ç.i nuk e kishte sjellë shokun e tij nga Turqia. Po ashtu tha që kishte kërkuar nga A.Ç.i se çfarë ishte procedura për të ardhur në Kosovë? Dhe pasi që kishin folur në lidhje me procedurat, ai ka dashur që të ia bëj një favor shokut të tij dhe të garantojë për të, por pastaj kishte hequr dorë për arsye të ndryshme dhe i kishte thënë shokut të tij që të vij vetë. T.Y. i ka thënë A.Ç.it se shoku i tij po vinte me aeroplan me Pegasus dhe e ka pyetur A.Ç.in nëse mund ta rregullonte një mënyrë për ta marrë atë në aeroport, dhe A.Ç.i i ka përmendur disa nga shokët e tij. T.Y. ka thënë se ai sërisht kishte ndërruar mendje dhe i kishte thënë shokut të tij që po vinte nga Turqia që ta merrte një Taksi për në Prishtinë dhe të paguajë 15 euro. Shoku i tij kishte ardhur të Dielën, ata kishin ndenjur bashkë dhe kishin pirë kafe. Të nesërmen në mëngjes ai kishte shkuar në punë dhe A.Ç.i kishte ardhur në restorant dhe shoku i tij i kishte thënë atij se ai po shkonte në Maqedoni që të punojë atje dhe pastaj A.Ç.i e kishte pyetur atë se si ai po shkonte atje? Dhe ai i kishte thënë që me “autobus”. Pas kësaj, ai ishte brengosur për shokun e tij por A.Ç.i i kishte thënë se shoku i tij ishte në Suboticë. Ai e kishte pranuar që shoku i tij quhej [R.] dhe arsyeja se pse ai kishte folur me A.Ç.in ka qenë për ta zbuluar procedurën e letrave.

<sup>113</sup> Ashti siq është thënë M.B. ka theksuar se disa nga numrat janë të lidhura me procedura tjera dhe A.B. ka refuzuar ta ketë përdorur ndonjëherë [numrin].

e rasteve, ka qenë “ nuk e mbaj në mend”, ashtu siq tregojnë në mënyrë të çartë procesverbalet nga shqyrtimet kryesore në lidhje me deklaratat e të pandehurve.

Siç u tha tashmë, se logjika dhe vërtetësia e deklaratave (si çdo pjesë e provave), duhet të vlerësohet në pikëpamjen e një vëzhguesi objektiv, nga gjykimi i shëndoshë i një qytetari normal dhe të zakonshëm, të ngjashme me kriterin një të përdorur në Nenin 19 të KPPK-së në lidhje me përkufizimin e "dyshimit të bazuar" - "provave të pranueshme që do të bindte një vëzhgues objektiv që" (dhe tani ne shtojmë) se faktet kanë apo nuk kanë ndodhur siç pretendohet, gjithmonë duke vlerësuar besueshmërinë e versioneve të ndryshme në pikëpamjen e përvojës së përbashkët.

Në të vërtetë, shumica e përgjigjeve të dhëna gjatë gjyqimit e kanë shpënë gjykatën për të i vlerësuar ato si thelbësisht të pabesueshme (për të thënë më së paku), në pikëpamjen e kriterit të "vëzhguesit normal dhe objektiv", dhe në dritën e përvojës së përbashkët. Nuk do kishte kuptim për të thënë, se i pandehuri A.Ç., se ai ishte i angazhuar nga një kompani, do të thotë punëdhënësi i tij, në lidhje me marrëveshjet e udhëtimeve për individët që vijnë për të punuar në Kosovë dhe jashtë saj (madje edhe në vendet ku kompania në fjalë nuk do kishte asnjë biznes, sipas vetë deklaratave të tija), jo vetëm që kjo nuk është e logjikshme pasi që nuk ka asnjë informacion në lidhje me ndonjë rekrutim, por po ashtu edhe të dhënat që i përmbajnë emrat dhe datat e lindjes të atyre që udhëtonin, tregojnë se ne po flasim ndonjëherë edhe për familje dhe fëmijë. Po ashtu duke pasur parasysh situatën e tij para autoriteteve në Kosovë (Zyra e Migracionit, sistemi Tatimor e tjera) mungesën e llogarive bankare, ai nuk ka mundur që të angazhohet në ato aktivitete që pretendon.

E njëjta gjë vlen edhe për punëtorët e pretenduar duke u siguruar nga i pandehuri A.Ç. për të pandehurin A.M. dhe edhe pse ky i fundit do të i përdortë të ashtuquajturat “shërbime” të A.Ç.’s për të sjellë fuqi punëtore nga jashtë në Kosovë (në Mamushë), ku papunësia është aq e lartë (ashtu si në tërë vendin...) dhe mbi të gjitha, ne e vërejmë një mungesë të plotë të ndonjë mesazhi të lidhura me punën (duke diskutuar përvojë profesionale, pagat, vendin e punës dhe kushtet e tjera të kontratës, për shembull, të “punëtorëve” të supozuar).

Në lidhje me faktin, se disa nga “punëtorët e pretenduar” po hynin dhe po e lëshonin vendin në një periudhë të shkurtë ( në disa raste edhe brenda disa orësh, në raste tjera në po të njëjtën ditë apo në dy ditët në vijim), duke mos përdorur biletat kthyesë për të dalë jashtë vendit, ashtu siq e mbështesin raportet e SMK; po ashtu sqarimi i dhënë në lidhje me faktin se të ashtuquajturit “punëtorët” po qëndronin për periudha të shkurta kohore (për të cilën sqarimi apo përgjigja ishte se “punëtorët” në fjalë po kalonin një periudhë trajnimit apo testimi) nuk përmban fare kuptim në pikëpamje të kriterëve të përmendura më sipër- ashtu siq nuk ka fare kuptim sqarimi i dhënë nga i pandehuri M.B. në lidhje me përmbajtjen e bisedave të shpeshta dhe telefonatave mes tij dhe A.Ç., kur ai ka sqaruar duke thënë se A.Ç. ka qenë shpesh i dehur dhe kjo do e sqaronte, sipas tij, numrin e telefonatave dhe përmbajtjet e mesazheve. Në këtë drejtim, është pikëpamje e gjykatës se ky lloj sqarimi nuk ja vlen që të diskutohet më tej.

I pandehuri M.B. po ashtu tha, gjatë marrjes në pyetje tërthorazi nga prokuroria, se “B.G.” ishte shoku i tij por nuk iu kanë kujtuar fare përgjimet për të cilat atëherë ai ishte marrë në pyetje:

- Ajo e datës 29 shtator 2012, në ora 17:21 min, kur M.B. po fliste me A.Ç.n, “Amo”, dhe A.Ç. e ka pyetur atë; “sa vjeç janë fëmijët, a e di?” dhe M.B. kishte thënë “njëri është tre, tjetri pesë dhe nëna dhe babai”, dhe pastaj A.Ç. përgjigjet “pra, dy të rritur, mirë” dhe ai (M.B.) është përgjigjur “do të thotë që unë nuk kam marrë më shumë se 900 euro para dhe tarifën e taksisë” dhe pastaj A.Ç. qe përgjigjur “natyrisht”, në të cilën gjë M.B. sërish kishte thënë “900 Euro plus paratë për taksi, për fëmijët mora gjysmë çmimi, një i rritur për dy fëmijë; çmimi për një të rritur është 300 Euro, dy të rritur 600 plus 2 fëmijë 300 Euro, totali 900 euro, dhe unë i mora 100 Euro për taksi, totali prej 1000 Eurosh”, për të cilën gjë A.Ç. u përgjigj “natyrisht, a kanë ardhur ata tek ti apo vetë e kanë thërritur një taksi?” dhe ju (M.B.) jeni përgjigjur “nuk e di, si mund ta di?”;

- Me datë 9 tetor 2012, në ora 9:17 min: A.Ç. pyet M.B.n “a i ka vendosur nënë mysafirët” dhe ju (M.B.) jeni përgjigjur “ajo i ka vendosur, pro dreqi ta hajë ata janë duke na dhënë më pak para, ata janë duke u tallur me ne”;

- Me datë 8 nëntor 2012, në ora 22:52 min, O.K. i thotë M.B.t: “dëgjo, mos u bëj asgjë atyre” dhe M.B. iu përgjigj atij “çfarë të bëjmë, ne do marrim 300 euro më shumë” dhe O.K. tha “mos thuaj asgjë të tillë në praninë e tyre” dhe M.B. u përgjigj “ne do marrim 300 euro më shumë dhe ne do të shkojmë në Prizren në Matrix” dhe pastaj M.B. vazhdon duke folur në lidhje me paratë: “lë të marrim edhe 300 lira më shumë, që të mos shkojmë atje me xhepa të zbrazët”, për të cilën gjë O.K. thotë: “I unë i kam dërguar 3 persona andaj nga secili prej tyre ti do marrësh 350 lira” dhe pastaj ju (M.B.) jeni përgjigjur “O.K., 350 lira për secilin është në rregull, sepse zonja po shkon dhe ajo mund ti marri ata” dhe O.K. u përgjigj sërish “biri im, ata nuk janë të mitë, unë i kam marrë 500 lira për ti sjellë ata”, për çka ju (M.B.) jeni përgjigjur “në rregull.” (– në lidhje me këto transkripte, shihni procesverbalin e datës 01/12/2015).

Sa i përket të pandehurit M.A., kur është konfrontuar me të dhënat e mbledhura, dhe përgjimet e incizuara, ai ose do thoshte” që nuk mbante në mend më për arsye se ishte i burgosur për një kohë aq të gjatë ose do të insistonte në versionin e tij se ai kishte shkuar në aeroport vetëm një herë ( përkundër faktit që nuk po e përmende më në dëshminë e tij se ai kishte shkuar për ti marrë të afërmit e tij ashtu siq kishte bërë apo pohuar gjatë një prej shpërthimeve të tija në fillim të njërës prej seancave) dhe ka insistuar se ka pasur vetëm dy telefonata me të A.Ç. Edhe një herë, deklarata e tij, ai ka insistuar se “ ai e kishte marrë dikë në aeroport” dhe se kjo nuk ishte një vepër penale...- këto fjalë të frazuara ashtu siq i thotë ai.

Në lidhje me të pandehurin I.P. nga: gjersa A.Ç. do të thoshte se përveç që ka përdorur shërbimet e tij (të I.P.) për të transportuar “punëtorë” dhe për të shkuar në vendet me “muzike të gjallë”, I.P. theksoi se ai nuk punon në kontrollin kufitar (që do të thotë ai nuk është një zyrtar i

kufirit), se ai është një shofer taksie dhe për këtë arsye nuk sheh asnjë problem në të gjitha dhe, përsëri, deklaroi se ishte i pafajshëm. Në lidhje me shpeshësinë e kontakteve të tij me A.Ç.n, dhe kur sfidohet me përmbajtjen e disa bisedave të përgjuara që ai i kishte pasur me A.Ç.n, ai gjithashtu pretendonte se nuk i kujtohen ato më dhe nuk dha asnjë shpjegim më tej.

Kur është fjala për deklaratën e T.Y.: pasi ka adresuar ardhjen e tij në Kosovë, prapa në vitin 2000, sfondin e tij profesional, dhe duke thënë se ai ishte bërë një i njohur A.Ç.'s pasi ky i fundit ishte një klient në restorant ku ai ka punuar, i pandehuri T.Y. deklaroi se ai mban në mend vetëm të kenë folur për individin "R.B." dhe si është bërë letër garancia, duke pretenduar se ata nuk kanë biseduar për ndonjë gjë tjetër. Në lidhje me letrën në fjalë, ftesën apo garancinë nën emrin e tij dhe në emër të individit në fjalë, R.B., sipas T.Y. ai e ka pyetur A.Ç.n vetëm se ku ishte noteri, duke marrë parasysh se R.B. ishte shoku i tij, nga Turqia . . . ai gjithashtu shtoi se më vonë kur mori vesh se shtetasit turq nuk kanë nevojë për vizë ose një letër garancie për të hyrë në mënyrë të ligjshme në Kosovë, ai nuk e ka dërguar letrën e garancisë së përmendur më lart, kështu që shoku i tij erdhi në Kosovë si turist. Për udhëtimin më tutje nga [emri i familjes R.B.], T.Y. tha se gjersa ai ishte duke punuar në restorant, e vetmja gjë që ai e dinte në lidhje me atë ishte se në një moment të caktuar R.B. i kishte treguar atij se ai do të shkojë në Maqedoni, këtë pa e mbajtur në mend se kur pikërisht kjo bisedë u zhvillua dhe kur me të vërtetë [emri i familjes R.B.] u nis në IRJ të Maqedonisë. Së fundi, në këtë çështje abstrakte, është po ashtu e vlefshme që të përmendet se T.Y. ka konfirmuar që të jetë përdoruesi i telefonit mobil me numër [numri] (–në lidhje me këtë deklaratë, shih procesverbalin datës 18 shkurt 2016).

Së fundi, në këtë përmbledhje shumë të shkurtër të deklaratave të të pandehurit, është radha e adresimit të A.G.t<sup>114</sup>. Sipas tij, ai i kishte ofruar tre deri në katër herë shërbime Taksije A.Ç.s, duke pasur, në versionin e tij, vetëm disa kontakte përmes telefonit dhe po ashtu një bisedë në të cilën A.Ç. e ka adresuar atë duke kërkuar që ai të nënshkruaj një letër Garancioni apo ftese për një punëtor që do vinte, në të cilën gjë ai është përgjigjur se ai do jetë në gjendje për ta bërë këtë pasi që do shkonte në polici dhe tek noteri për ta sqaruar se diçka e tillë ishte në rregull. Ai ka shtuar se një ditë ai ka shkuar në aeroport për ta marrë një "klient" dhe pastaj ai e ka kuptuar që diçka nuk ishte në rregull kur të gjithë udhëtarët që kishin arritur në atë fluturim nga Turqia, veq kishin dalur jashtë nga terminali, por jo dhe personi për të cilin ai kishte shkuar atje, I.K., dhe kjo ka qenë arsyeja se përse ai më vonë ka shkuar në deskun e informacioneve në aeroport për të pyetur se çfarë ishte problemi dhe ky ka qenë momenti kur atij i është thënë se ishte një çështje e policisë. Në mesin e detajeve të tjera, ai ka sqaruar se ai e identifikoi veten tek punonjësit e policisë si një shofer taksie dhe u tregoi dokumentet e tija, pas së cilës ai u lejua të largohet nga aeroporti, por jo pa iu thënë se ka pasur një letër garanci që ishte lëshuar prej tij në emër të pasagjerit në fjalë, I.K. Ai gjithashtu konfirmoi se ishte në posedim dhe të përdorimit të [numrit të telefonit]. Në fund, në pyetjen prokurorit "pse ju keni pranuar për të garantuar për një person që ju kurrë nuk e kishit parë më parë", ai u përgjigj duke thënë se ai pranoi se kjo gjë

---

<sup>114</sup> Shumica e deklaratave të të pandehurit janë adresuar tashmë, kur arsyetimi mbi kontrabandimin e migrantit I.K. qe adresuar; për arsye sistematike, pjesa e deklaratës së tij është duke u përsëritur në këtë rast.

ishite një gabim dhe se ai kishte qenë duke e pyetur veten e tij për 38 muaj me pyetje të tilla, ende pa qenë në gjendje për t'iu përgjigjur atyre ... (- shih procesverbalin datës 18 shkurt 2016).

Gjykata i ka vendosur faktet përtej dyshimit të arsyeshëm. Të gjitha provat e prodhuara gjatë seancave janë shënuar tekstualisht, duke qenë për këtë arsye në dispozicion për rivlerësim, në qoftë rasti.

#### **D - Faktet dhe përgjegjësia penale e të akuzuarit (Neni 361 dhe 370, par. 7, KPPK):**

#### **Ligji i aplikueshëm (parashkrimi dhe faktet e vërtetuara dhe përgjegjësia penale në lidhje me veprat penale të mbetura.**

##### **Parashkrimi**

Analiza e parashkrimit në lidhje me çdo vepër penale:

Le të kontrollojë secili prej veprave penale në lidhje me këtë kërkesë procedurale se parashkrimi nuk ka skaduar<sup>115</sup>.

**1** – Kontrabandimi me migrantë sipas Nenit 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të KPPK-së (aktualisht dhënë në nenin 170, paragrafët 1 deri në 6, të KPRK-së).

Veprat penale kanë qenë në përputhje me pikat 3, 4, 5 të aktakuzës, të kryera mes datave 25/06/2011 dhe 02/12/2012; kjo sipas Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe për këtë arsye nenet 90 dhe 91 zbatohen.

Vepra penale është e dënueshme me “burgim prej shtatë e deri në njëzet vjet”, e cila çon në zbatimin e periudhës së parashkrimit të 10 viteve (neni 90, par. 1.3, KPPK) në lidhje me fillimin e hetimeve dhe 20 vjet (neni 91, parag. 1 dhe 6, KPPK) në ndalimin absolut të ndjekjes penale (duke përfshirë edhe mundësinë e gjykatës të dënojë për akuzën). Duke pasur parasysh se afati fillon në ditën kur vepra penale (pretendohet) të jetë kryer (sipas nenit 91, par. 1, KPPK), që është “ndërprerë me çdo veprim i cili ndërmerret për qëllime të ndjekjes penale të veprës penale” (neni 91, par. 3, KPPK) dhe se “hapi i parë ndërmarrë në drejtim të ndjekjes penale ka ndodhur në çdo rast në vitin 2012<sup>116</sup>, atëherë arrijmë në përfundimin se hetimi ka filluar brenda afatit të lejuar nga ligji (edhe para përfundimit të kryerjes së fakteve, në vazhdim, si për aktakuzën).

---

<sup>115</sup> Kjo do të bëhet në lidhje me veprën penale, në përgjithësi; vetëm nëse pas një vlerësimi të tillë më shumë detaje në lidhje me një të pandehur të caktuar (akuzë - dhe datat e rëndësishme për vlerësimin e gjykatës), është e nevojshme, atëherë gjykata do ta trajtojë atë.

<sup>116</sup> Me 17 gusht 2012, prokurori ka lëshuar një Aktvendim mbi zgjerimin e hetimeve kundër A.Ç. A.Ç. me 3 dhjetor 2012, M.B. i është nënshtruar një aktvendimin tjetër identik me 5 dhjetor 2012, një Aktvendim tjetër mbi zgjerimin e hetimeve është lëshuar nga prokurori në lidhje me M.A., A.M., A.G., I.P., T.Y. (...) dhe me 14 dhjetor 2012 prokurori ka lëshuar një aktvendim mbi zgjerimin e hetimeve në lidhje me A.B. Aktvendimi në fjale ka pasur të bëjë me Hetimet e veprave penale të kontrabandimit me migrantë, krim të organizuar dhe shpëlarje e parave sipas legjisllacionit në fuqi.

Ndalimi absolut mbi ndjekjen penale do të ndodhë më 25/06/2031 (në rastin më të keq për prokurorinë).

**1.1** – Kontrabandimi me migrantë, sipas nenit 138 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK-së (aktualisht dhënë në nenin 170, paragrafët 1 deri në 3, të KPRK-së).

Veprat penale kanë qenë në përputhje me pikat 6 (A.G.) dhe 8 (T.Y.) të aktakuzës, kryer në mes të datave 17/08/2012 dhe 22/08/2012 (A.G.) dhe në mes të periudhës 07/11/2012 dhe 04/12/2012 (T.Y.); kjo është sipas Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe për këtë arsye nenet 90 dhe 91 zbatohen.

Vepra penale është e dënueshme me "burgim prej dy deri në dymbëdhjetë vjet.", e cila çon në zbatimin e periudhës së parashkrimit prej 3 vjet (neni 90, par. 5, KPPK) në lidhje me fillimin e hetimeve dhe 6 vjet ( Neni 91, Parag. 1 dhe 6, KPPK) në ndalimin absolut të ndjekjes penale (duke përfshirë mundësinë e gjykatës të dënojë për akuzën). Duke pasur parasysh se afati fillon në ditën kur vepra penale (pretendohet) të jetë kryer (sipas nenit 91, par. 1, KPPK), se "ndërpritet me çdo veprim i cili ndërmerret për qëllime të ndjekjes penale të veprës penale" ( Neni 91, par. 3, KPPK) dhe se "hapi i parë i ndërmarrë në drejtim të ndjekjes penale ka ndodhur në çdo rast në vitin 2012<sup>117</sup>, atëherë arrijmë në përfundimin se hetimi ka filluar brenda afatit të lejuar nga ligji. Ndalimi absolut i ndjekjes penale do ndodhë me datë 17/08/2018 (A.G.) ose me datë 04/12/2018 (T.Y.).

**2-** Krim i organizuar, sipas nenit 274, paragrafët 1, 2 dhe 3, KPPK., (aktualisht dhënë në nenin 283, paragrafët 1 dhe 2, KPPK).

Vepra penale ka qenë, në përputhje me pikën 1 të aktakuzës, e kryer mes datës 1/10/2010 dhe 03/02/2013; kjo është sipas Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe për këtë arsye nenet 90 dhe 91 zbatohen.

Vepra penale është e dënueshme me "një gjobë deri në 500.000 euro dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet", e cila çon në zbatimin e periudhës së parashkrimit prej 10 vjetësh (neni 90, par. 1.3, KPPK.) në lidhje me fillimin e hetimeve dhe 20 vjet (neni 91, par. 1 dhe 6, KPPK ) në ndalimin absolut të ndjekjes penale (duke përfshirë edhe mundësinë e gjykatës të dënojë për akuzën). Duke pasur parasysh se afati fillon në ditën kur vepra penale (gjoja) është kryer (sipas nenit 91, Pjesa. 1, KPPK), se "ndërpritet çdo veprim i cili ndërmerret për qëllime të ndjekjes penale të veprës penale" (neni 91, par. 3, KPPK) dhe se "hapi i parë ndërmarrë në drejtim të ndjekjes penale ka ndodhur në çdo rast në vitin 2012<sup>118</sup>, atëherë arrijmë në

---

<sup>117</sup> Më 17 gusht 2012, prokurori ka lëshuar një aktvendim për zgjerimin e hetimeve kundër A.Ç., më 3 dhjetor 2012 M.B. ishte subjekt i një aktvendimi të njëjtë, më 5 dhjetor 2012 një tjetër aktvendim për zgjerimin e hetimeve është lëshuar nga prokurori në lidhje me M.A., A.M., A.G., I.P., T.Y., (...) dhe më 14 dhjetor 2012, prokurori ka lëshuar një vendim për zgjerimin e hetimeve sa i përket A.B.s. Aktvendimi në fjalë ka pasur të bëjë me hetimin për veprat penale të kontrabandimit të emigrantëve, krimit të organizuar dhe pastrimit të parave sipas legjisllacionit në fuqi.

<sup>118</sup> Ashtu siq është sqaruar më parë.

përfundimin se hetimi ka filluar brenda afatit të lejuar nga ligji (edhe para përfundimit të kryerjes së fakteve, në vazhdimësi, sipas aktakuzës). Ndalimi absolut i ndjekjes penale do të ndodhë më 01/10/2030 (në rastin më të keq për prokurorinë).

**2.1** - Pjesëmarrja në krimin e organizuar, sipas nenit 274, paragrafi 1 dhe KPPK, sa i përket të pandehurve A.G. dhe T.Y..

Vepra penale ka qenë, në përputhje me pikën 2 të aktakuzës, e kryer mes datave 17/08/2012 dhe 13/12/2012 (A.G.) dhe 07/11/2012 dhe 13/12/2012 (T.Y.); kjo është sipas Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe për këtë arsye nenet 90 dhe 91 zbatohen.

Vepra penale është e dënueshme me “dënohet me burgim prej së paku pesë vjet.”, e cila çon në zbatimin e të njëjtës periudhë të parashkrimit të 10 viteve (neni 90, par. 1.3, KPPK) në lidhje me fillimin e hetimeve dhe 20 vjet (neni 91, par. 1 dhe 6, KPPK) në ndalimin absolut të ndjekjes penale (duke përfshirë mundësinë që gjykata të dënojë sipas akuzës). Duke pasur parasysh se afati fillon në ditën kur vepra penale (gjoja) është kryer (sipas nenit 91, Pjesa. 1, KPPK), se “ndërpritet çdo veprim i cili ndërmerret për qëllime të ndjekjes penale të veprës penale” (neni 91, par. 3, KPPK) dhe se “hapi i parë ndërmarrë në drejtim të ndjekjes penale ka ndodhur në çdo rast në vitin 2012<sup>119</sup>, atëherë arrijmë në përfundimin se hetimi ka filluar brenda afatit të lejuar nga ligji (edhe para përfundimit të fakteve të kryerjes, në vazhdimësi, sipas aktakuzës). Ndalimi absolut i ndjekjes penale do të ndodhë më 18/08/2032 (A.G.) dhe me datë 07/11/2032 (T.Y.)- në rastin më të keq për prokurorinë.

**3** – Shpëlarja e parave, sipas nenit 32 të Ligjit 03/L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit e datës 3 shtator 2010, shpallur më 18/10/2010, dhe ndërsa e zbatueshme, neni 10.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2004/2 mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale.

Vepra penale është në përputhje me pikën 9 të aktakuzës, e kryer mes datave 1/10/2010 dhe 13/12/2012 [dhe 03/02/2013, A.Ç.]; kjo është sipas Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe për këtë arsye nenet 90 dhe 91 zbatohen [Kodi Penal i Republikës së Kosovës do të përmendet më pas].

Vepra penale është e dënueshme me "burgim deri në dhjetë vjet", e cila çon në zbatimin e periudhës së parashkrimit prej 10 vitesh (neni 90, par. 1.2 dhe 1.3 dhe 2, KPPK) në lidhje me fillimin e hetimeve dhe 20 vjet (neni 91, Par. 1 dhe 6, KPPK) me ndalimin absolut të ndjekjes penale (duke përfshirë mundësinë e gjykatës të dënojë për akuzën). Duke pasur parasysh se afati fillon në ditën kur vepra penale (gjoja) është kryer (neni 91, par. 1, KPPK), se “ndërpritet çdo veprim i cili ndërmerret për qëllime të ndjekjes penale të veprës penale” (Neni 91, par. 3, KPPK) dhe se "hapi i parë i ndërmarrë në drejtim të ndjekjes penale ka ndodhur në çdo rast në vitin

---

<sup>119</sup> Ashtu siq është sqaruar më parë.

2012<sup>120</sup>, atëherë arrijmë në përfundimin se hetimi ka filluar brenda afatit të lejuar nga ligji (edhe para përfundimit të kryerjes së fakteve, në vazhdimësi, sipas aktakuzës). Ndalimi absolut mbi ndjekjen penale do të ndodhë më 01/10/2030 (në rastin më të keq për prokurorinë) [në lidhje me datën 03/02/2013, A.Ç., dhe të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 103, par. 1.3 dhe 2, dhe 107, par. 1 dhe 8].

### **Faktet e vërtetuara dhe përgjegjësia penale në lidhje me veprat penale**

Për arsye sistematike, veprat penale<sup>121</sup> do të trajtohen jo në mënyrë siq ato janë përmendur në aktakuzë; së pari gjykata do të trajtojë veprën penale të pastrimit të parave, pastaj veprat penale të krimit të organizuar dhe që marrin pjesë në krimin e organizuar dhe në fund veprën penale të kontrabandimit të migrantëve

### **Analiza e veprës penale të pastrimit të parave.**

Të pandehurit A.Ç., M.B., A.M. dhe A.B. janë akuzuar, në pikën 9, me këtë vepër penale (neni 32 i Ligjit 03/L-196).

Siç u tha në fillim të këtij aktgjykimi, edhe pse në deklaratat mbyllëse prokuroria ka pranuar provat nuk kanë prodhuar në pikën 9, mbi pastrimin e parave, asnjë akuzë nuk është tërhequr (ashtu siq kanë mundur, sipas nenit 363, par.1. 1.1., KPK., e cila do shpinte në refuzimin e akuzës në përputhje me nenin 363, par. 1.1 , KPPK., e jo në një lirim eventual nga akuzat, sipas nenit 364, par. 1.3, KPPK. Pasi akuza nuk u tërhoq atëherë gjykata duhet të analizojë këtë vepër penale po ashtu.

A.Ç. mes datës 1 tetor 2010 dhe 3 shkurt 2013, M.B. mes datës 6 prill 2011 dhe 13 dhjetor 2012, A.M. mes 28 qershor 2011 dhe 13 dhjetor 2012 dhe A.B. mes 4 nëntor 2010 dhe 13 dhjetor 2013, sipas nenit 32 të ligjit 03/L-196, në territorin e Kosovës dhe shtetet tjera, e kanë

---

<sup>120</sup> Ashtu siq është sqaruar më parë

<sup>121</sup> Përgjatë këtij aktgjykimi kemi drejtuar klasifikimet ligjore të bëra nga Prokuroria. Nuk ka nevojë të thuhet se, nëse ka ndonjë pyetjeje, gjykata nuk është e lidhur me ta, neni 360, par. 2, KPPK pasi vetëm faktet janë detyruese për gjykatën, neni 361, par. 1, KPPK



kryer veprën penale të pastrimit të parave, duke e ditur ose duke pasur arsye të dinin, se disa pasuri të caktuara, do të thotë para të gatshme apo mjete tjera monetare, janë rezultat aktiviteteve kriminale, dhe të cilat pasuri janë në fakt të hyra nga krimi (kontrabandimi i migrantëve nga anëtarët e grupit kriminal).

Sipas aktakuzës<sup>122</sup>, dhe sipas nenit 32 të Ligjit 03/L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit e 3 shtatorit 2010, shpallur më 18/10/2010, dhe ndërsa e zbatueshme, paragrafi 10.2 e rregullores së UNMIK-ut 2004/2 mbi Pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale, adoptuar me 5 shkurt 2004 (siq është ndryshuar), pastrimi i parave është vepër e dënueshme me burgim deri në dhjetë vjet dhe me gjobë deri në tri herë vlerën e pasurisë që është objekt i veprës penale.

Tani, Neni 308 KPK thotë: “kushdo që kryen vepër penale të pastrimit të parave, dënohet siç përcaktohet në Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”, duke mos shtuar apo zbritur asgjë në lidhje me elementet apo dënimin e vetë veprës penale, pasi ligji në fuqi nuk ka ndryshuar.

Është e rëndësishme për të adresuar këtu konceptin e "përfitimit material" nga një vepër penale.

“Përfitimi Material” nuk është përkufizuar në KPPK, e as në nenin 107 (mbi përkufizimet e disa termave), e as në ndonjë nen tjetër; KPPK tani përmban një përkufizim të përfitimit material<sup>123</sup> në nenin 120, par. 34, “çdo pasuri që rrjedhë drejtpërdrejt ose tërthorazi nga vepra penale. Pasuria e fituar në mënyrë të tërthortë nga një vepër penale përfshin pasurinë në të cilën çdo pasuri e përfituar drejtpërdrejt nga vepra penale më vonë është konvertuar, transformuar, ose është përzier, si dhe të ardhurat, kapitali apo përfitimet tjera ekonomike të realizuara për pasurinë e tillë në çfarëdo kohe që prej kryerjes së veprës penale”.

Instrumentet kryesore ligjore ndërkombëtare duke bërë vendosjen e kornizës ligjore dhe kërkesat e pastrimit të parave janë Konventa e Palermos (domethënë Neni 6, par. 1, dhe nenin 3, paragrafi 1, nën paragrafi b) dhe Konventa e Vjenës.

“Shpëlarja e parave”, në shumicën e sistemeve gjyqësore, mund të përkufizohet si çdo veprim që përfshin, fshehë, maskon "natyrën" ose "origjinën", vendndodhjen, asgjësimin, trajtimin, ose pronën e një aktivi, të drejtën ose vlerën, që të ardhurat nga vepra e ndërlydhur penale; në përputhje me këtë, “*termi "të ardhurat nga krimi" i referohet pasurisë që rrjedh "nga një kallëzues i vepër penale", në të cilën konteksti termi "vepër penale" padyshim duhet të zbatohet për të treguar një veprim konkret të dhënë të dënueshme nga ligji penal material i cili është kryer në një kohë dhe vend të caktuar. Me fjalë të tjera, duhet të ketë një vepër të veçantë*

---

<sup>122</sup> E cila duket se përkon me një model të ri në klasifikimin ligjor të akteve të përfshira në aktakuzë, pasi në raste të ngjashme nuk ekzistonte kjo akuzë [per shembull P. Nr 244/10 Gjykata Themelore në Prishtinë, P. 233/2013 e Prizrenit, P. 316/14 e Gjykatës Themelore të Prishtinës] dhe në një tjetër është tërhequr nga prokuroria pas marrëveshjes për pranimin e fajësisë: shihni rastin PKR.Nr.488 / 14 (PPS 40/13) Gjykata Themelore e Prishtinës, faqe 8 e aktgjykimit, e datës 3 qershor 2015 (versioni në Anglisht)

<sup>123</sup> Siç u tha, përfitimi material nuk është i njëjtë si duke vepruar me qëllim të marrjes së tij.

*penale nga të cilat asetet janë gjeneruar (vepra penale) dhe prokuroria duhet të provojë lidhjen midis kësaj vepre dhe veprës që lidhet PP*<sup>124</sup>.

Ka tre faza tipike përgjatë kryerjes së kësaj vepre penale dhe për të marrë parasysh përgatitjen e saj të përfunduar nuk është e nevojshme që kryesi të kalojë nëpër tre prej tyre: "vendosjen", "fshehjen" dhe "integrimin". Kjo çështje, kjo pyetje, është po ashtu edhe në lidhje me natyrën e kontestuar, klasifikimi i kësaj vepre penale si i menjëhershëm, i përhershëm ose i menjëhershëm me rezultate të përhershme<sup>125</sup>. Në këtë rast ne e ndjekim qëndrimin e Profesor Cruz Bottini<sup>126</sup> se ai është i menjëhershëm me rezultate të përhershme (ose efektet). Në të njëjtën mënyrë, pastrimi i parave është kryer që nga momenti kur prona është e fshehur fillimisht, siq është momenti kur vlera juridike e mbrojtur nga inkriminimi (Administrata e Drejtësisë) është e prekur, pavarësisht se kryesi i veprës mban fuqinë e ndërprerjes së pastrimit për periudhën kohore për aq sa akti i fshehjes dhe i maskimit zgjat.

*Parimi mens rea* përbëhet nga një qëllim i veçantë dhe është nga më të rëndësishmet për të përcaktuar saktësisht qëllimin e kryesit; duhet të ketë tregues të mjaftueshëm që kryesi vërtetë të ketë kërkuar për "të fshehur" ose "fshehi" të ardhurat nga vepra penale. Për shembull, nëse kryerësi shpenzon një sasi në restorante ose në rroba qëllimi specifik i pastrimit të parave mungon, por një përfundim i ndryshëm mund të arrihet në qoftë se të njëjtën sasi e depoziton në llogarinë e një të afërmi, në mënyrë që të transferohen mbrapa, por, si gjithmonë do të varet prej procedurës së provave, që do të thotë deri në çfarë mase provat lejojnë për të ardhur në një përfundim të sigurt, së paku përtej dyshimit të bazuar, se në themel të një veprimi është qëllimi specifik i nevojshëm.

Në legjislacionin e brendshëm, qëllimi specifik është shumë i qartë në përshkrimin e përgjithshëm të veprës penale, për shembull, në paragrafët e mëposhtëm "2.1. konverton, transferon ose përpiket të konvertojë apo transferojë pasurinë me qëllim të fshehjes dhe maskimit të natyrës, burimit, vendndodhjes, disponimit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë; 2.2. konverton, transferon ose përpiket të konvertojë apo transferojë pasurinë me qëllim të ndihmës së personit i cili është i përfshirë në të, ose supozohet të përfshirë, në kryerjen e veprës penale që ka shkaktuar shmangien e pasojave ligjore apo të pasojave të qarta ligjore, nga veprimet e tij ose të saja".

---

<sup>124</sup> Shih RAPORTIN E DETAJUAR TE VLERESIMIT në përputhje me standardet ndërkombëtare në fushën e pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit (AML / CFT), të datës 10 qershor 2013 - në [http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press\\_corner/2590\\_peck\\_aml\\_final\\_dar\\_17\\_06\\_2013.pdf](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press_corner/2590_peck_aml_final_dar_17_06_2013.pdf), fq. 42.

<sup>125</sup> Si në lidhje me kryesin (në Doktrina Kontinentale) veprat penale mund të jenë të menjëhershme ose të përhershme. Të Menjëhershme janë ato tek të cilat kryerja përfundon kur ndodh rezultati (vjedhja, për shembull) dhe të përhershme janë ato në të cilat kryerja zgjat me kalimin e kohës (psh vozitja në gjendje të dehur). Ka një kategori tjetër e veprave të ngjashme penale, të menjëhershme me efekte të përhershme, si pastrimi i parave, edhe pse vepra penale është e plotë kur kryesi fsheh ose maskon, por efekti i kryerjes zgjat me kalimin e kohës: mbajtja e pushtetit de facto mbi pronën e fshehur ose të maskuar (kjo është pasojë e thjeshtë e aktit fillestar).

<sup>126</sup> Profesor në Fakultetin Juridik, Universiteti i Sao Paulo's, Brazil.

Në paragrafët e tjerë, qëllimi specifik është po ashtu shumë i qartë ("për qëllim", si në paragrafin 2.3 dhe 2.4), përjashtimi është bërë tek nën paragrafi 2.5 ("2.5. Fiton, posedon ose shfrytëzon apo përpiket të marrë, posedojë ose përdorë, pronën"), pasi formulimi i saj vërtetë mund të shkaktojë dyshime<sup>127</sup> nëse përdorimi i thjeshtë, le të themi, i të hollave, mund të konsiderohet si kryerje e veprës penale.

Nuk ka ligj që është i sigurt nga interpretimi dhe kjo është detyrë e gjykatësit-ve (mes tjerash) për ta interpretuar atë dhe ajo duhet të bëhet gjithmonë duke pasur parasysh vlerën juridike që është e mbrojtur nga vepra penale (Administrimin e Drejtësisë, siç u tha): të gjitha elementet e tjera të mishëruara në veprën penale dhe gjithë sistemi; në rast paqartësie interpretimi duhet të jetë në favor të personit ndaj të cilit janë duke u zhvilluar procedurat penale, pasi parimi i ligjshmërisë e thotë qartë (Neni 1, par. 3, KPPK dhe neni 2, par. 3, KPRK).

“Pastrimi i parave "nuk mund të jetë (i keq) kuptuar si të qenit" dobi pasurore "që rezulton nga kryerja e vetë veprës penale, nëse veprime të mëtejshme me qëllim të specifik të fshehjes dhe maskimit të saj mungojnë; për shembull, nëse shumat e parave, maxime, pagesat e fituar, transferohen dhe nga të pandehurit nuk ishin përdorur më shumë se pagesat për "shërbimet" e parashikuara, për veprimet e ndërmarra, duke qenë, pra vetëm përfitime materiale (që rrjedhin nga vepra penale, meqë si element përbërës është vetëm qëllimi i marrjes) e veprës penale, meqë përpos kësaj kërkohet një qëllim specifik për kryerjen e veprës penale të shpëlarjes së parave, qëllimi për të fshehur ose maskuar të ardhurat e krimit<sup>128</sup>, siq është thënë.

Në lidhje me "të ardhurat", në "pronë", ajo duhet të përcaktohet nga cilat vepra penale ato vijnë; "Kjo mund të konkludohet se objekt i SHP mund të jetë çdo pasuri që rrjedh nga kryerja e një ose më shumë vepre penale konkrete, duke përfshirë çdo lloj të veprave penale që mund të gjenerojnë të ardhura, por jo një koncept më i gjerë i" veprimtarisë kriminale "në aspektin e kriminalitetit të pacaktuar (krimet e drogës, krimet e trafikimit etj në përgjithësi). Nuk ka dënim për SHP që shfaqet i mundur kur është provuar se pasuria që përbën objektin e SHP që ka rrjedhur nga një vepër penale por që nuk mund të përcaktohet saktësisht se cila vepër."<sup>129</sup>

Në lidhje me pyetjen nëse një dënim i mëparshëm ose të paktën paralel për veprën e ndërlidhur penale është i nevojshëm për të dënuar dikë për pastrimin e parave [pasi neni 32 paragrafi 4.1 i / Ligjit FT LPP parasheh se: "(...) një person mund të dënohet për veprën penale të

---

<sup>127</sup> Në kritikave të tjera të përkufizimit ligjor dhe për një "ekzagjerim" në ndërtimin e veprës penale dispozita në fjalë, shih faqet 39 deri 42 të RAPORTIT TË DETAJUAR TË VLERËSIMIT VLERËSIMIT në përputhje me standardet ndërkombëtare në fushën e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit (AML/CFT), me datë 10 qershor 2013, në [http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press\\_corner/2590\\_peck\\_aml\\_final\\_dar\\_17\\_06\\_2013.pdf](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press_corner/2590_peck_aml_final_dar_17_06_2013.pdf) . Rreth kritikave në lidhje me "ndonjë formë të aktivitetit kriminal" në nenin 32, paragrafi 2, shih detajet në faqen 43.

<sup>128</sup> Në këtë kuptim, shih vendimin e Gjykatës së Apelit në park. 25/14, e datës 3 shkurt 2015 f. 18 (versioni në anglisht).

<sup>129</sup> Shih [http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press\\_corner/2590\\_peck\\_aml\\_final\\_dar\\_17\\_06\\_2013.pdf](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press_corner/2590_peck_aml_final_dar_17_06_2013.pdf) fq. 43.

pastrimit të parave, edhe në qoftë se ai ose ajo nuk ka qenë i dënuar në çdo kohë të veprës së ndërlidhur penale prej të cilave të ardhurat e krimit në veprën penale të pastrimit të parave kanë dalur "], mendojmë se për aq kohë sa elementet që janë përbërëse të veprës penale të pastrimit të parave janë krijuar (duke përfshirë cila vepër penale është kryer), nuk është e nevojshme (edhe pse ai është i përshtatshëm apo lehtësues) "që një dënim i mëparshëm ose të paktën paralel për veprën penale të ngjarë të jetë një parakusht për të arritur një bindje të veprës penale të lidhur të PP" pasi kjo në një farë mënyre e bën dispozitën në fjalë, tek neni 32, par. 4.1, të pakuptimtë. Ne besojmë se ky qëndrim nuk është kundër prezumimit të pafajësisë (pasi ajo natyrisht e ka rolin e saj në procedurat të cilat kanë të bëjnë me vetë pastrimin e parave), duke pasur parasysh se autori i pastrimit të parave mund të jetë një tjetër individ në vend të atij (atyre) që e kanë kryer, vepra penale (shih, për shembull, se Neni 32, par. 2.2, në mënyrë të qartë thotë "për të konvertuar, transferuar ose përpiqet të konvertojë apo transferojë pasurinë me qëllim të ndihmës së personit i cili është i përfshirë në vepër, ose gjoja të përfshirë në vepër , kryerja e veprës penale që ka prodhuar pronën për t'iu shmangur pasojave ligjore, ose pasojave të qarta ligjore të veprimeve të tij ose të saj ").

Duke pasur parasysh konsideratat e mëparshme dhe duke pasur parasysh faktet krijuara është e qartë se qëllimi specifik që kërkohet nga vepra penale mungon dhe për këtë arsye të pandehurit do të lirohen nga kjo akuzë (pika 9).

### **Analiza e veprës penale të krimit të organizuar.**

Të pandehurit A.Ç., M.B., A.M., A.B., I.P. dhe M.A. janë akuzuar në pikën 1 me veprën penale të krimit të organizuar (neni 274, paragrafët 1, 2 dhe 3, KPPK., aktualisht dhënë në nenin 283, paragrafët 1 dhe 2, KPK), ndërsa në pikën 2 të pandehurit A.G. dhe (...) T.Y. janë akuzuar me veprën penale të pjesëmarrjes në krim të organizuar (neni 274, paragrafët 1 dhe 2, KPPK., aktualisht dhënë në nenin 283, par. 1, KPK).

Në akuzën 1, A.Ç. mes datës 1 tetor 2010 dhe 3 shkurt 2013, M.B. mes datës 6 prill 2011 dhe 13 dhjetor 2012, A.M. mes datës 28 qershor 2011 dhe 13 dhjetor 2012, A.B. mes datës 4 nëntor 2010 dhe 13 dhjetor 2013, I.P. mes datës 5 tetor 2012 dhe 13 dhjetor 2013 dhe M.A. mes datës 21 qershor 2012 dhe 24 janar 2013 janë akuzuar me veprën penale të krimit të organizuar sepse (sipas aktakuzës) në territorin e Kosovës dhe vendeve të tjera e kanë kryer veprën penale të krimit të organizuar duke organizuar, duke bërë mbikëqyrjen, administrimin apo drejtimin e aktiviteteve të një grupi të organizuar kriminal, i përbërë nga vetë ata dhe shumë individë të tjerë të përmendur në aktakuzë, kryerjen e një krimi të rëndë, përkatësisht kontrabandës së migrantëve, si pjesë e një grupi të organizuar kriminal të përbërë prej tyre dhe shumë individë të tjerë të përmendur në aktakuzë dhe duke marrë pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet kriminale apo të tjera të grupit të organizuar kriminal në fjalë, duke e ditur se pjesëmarrja e tyre do të kontribuojë në kryerjen e krimeve në fjalë të rënda nga grupi, për të përfituar, direkt ose indirekt, dobi pasurore, financiare apo të tjera.

Në pikën 2, A.G. mes datës 17 gusht 2012 dhe 13 dhjetor 2012 dhe T.Y. mes datës 7 nëntor 2012 dhe 13 dhjetor 2012 janë të akuzuar me veprën penale të pjesëmarrjes në krimin e organizuar, sepse (sipas aktakuzës) në territorin e Kosovës, e kanë kryer veprën penale të pjesëmarrjes në krim të organizuar duke kryer një krim të rëndë, pra kontrabandën e migrantëve, si pjesë e një grupi të organizuar kriminal të përbërë prej tyre, nga të bashkë-të-pandehurit dhe individë të tjerë të përmendur në aktakuzë dhe duke marrë pjesë në mënyrë aktive në aktivitete kriminale apo të tjera të grupit të organizuar kriminal në fjalë, duke e ditur se pjesëmarrja e tyre do të kontribuojë në kryerjen e krimeve të rënda nga grupi, me qëllim për të përfituar, direkt ose indirekt, dobi pasurore, financiare apo të tjera.

Sipas nenit 274 KPPK, sipas aktakuzës, vepra penale është përshkruar si në vijim:

#### **Neni 274**

(1) Kushdo që kryen krim të rëndë si pjesë e një grupi të organizuar kriminal dënohet me gjobë deri në 250.000 euro dhe me burgim së paku shtatë vjet.

(2) Kushdo që aktivisht merr pjesë në aktivitete kriminale ose në aktivitete të tjera të një grupi kriminal të organizuar, duke e ditur se pjesëmarrja e tij do t'i kontribuojë kryerjes së krimeve të rënda nga grupi kriminal i organizuar dënohet me burgim së paku pesë vjet.

(3) Kushdo që organizon, formon, mbikëqyrë, udhëheq apo drejton veprimet e ndonjë grupi kriminal të organizuar dënohet me gjobën deri në 500.000 euro dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet.

(4) Kushdo që kryen vepër penale nga paragrafi 2 i këtij neni dënohet me gjobë deri në 500.000 euro dhe me burgim së paku dhjetë vjet ose me burgim afatgjatë nëse veprimtaria e grupit të organizuar rezulton me vdekje.

(5) Gjykata mund ta lirojë nga dënimi kryerësin i cili kryen vepër penale nga paragrafi 2 ose 3 i këtij neni nëse personi i tillë, para se grupi të kryejë veprën, e lajmëron policinë apo prokurorin publik në hollësi lidhur me ekzistimin, përbërjen dhe informacionet e grupit të organizuar për t'i mundësuar policisë arrestimin e grupit apo prokurorit publik ndjekjen e atij grupi.

(6) Kushdo që është dënuar me dënime plotësuese nga neni 57 i këtij Kodi për kryerjen e veprës penale nga ky nen dhe i shkel kushtet e atyre dënimeve plotësuese, dënohet me burgim deri në një vit.

(7) Sipas këtij neni,

1) Shprehja “krim i organizuar” do të thotë krim i rëndë i kryer nga ndonjë grup i strukturuar për të përfituar drejtpërsëdrejti ose tërthorazi dobi pasurore a financiare;

2) Shprehja “grup kriminal i organizuar” do të thotë grup i strukturuar i cili ekziston për një kohë të caktuar dhe i cili vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një ose më shumë krimeve të rënda për përfitim të drejtpërdrejtë ose tërthortë të dobisë pasurore apo financiare;

3) Shprehja “krim i rëndë” do të thotë veprë penale që dënohet me burgim prej së paku katër vjet dhe

4) Shprehja “grup i strukturuar” do të thotë grup prej tre ose më shumë personave i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e atypëratyshme të ndonjë veprë penale dhe nuk do të thotë formalisht t’i ketë të përkufizuara rolet për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë së tij apo strukturën e zhvilluar.

Aktualisht, sipas nenit 283 të KPRK-së, vepra penale përshkruhet si në vijim:

### **Neni 283**

1. Kushdo që me dashje dhe me dijeni qoftë të qëllimit dhe veprimtarisë së përgjithshme të grupit kriminal të organizuar ose qëllimit të grupit për të kryer një apo më shumë vepra penale të cilat janë të dënueshme me burgim prej së paku katër (4) vjet, aktivisht merr pjesë në veprimtaritë kriminale të grupit duke ditur se pjesëmarrja e tillë do të kontribuojë në realizimin e veprimtarive kriminale të grupit, dënohet me gjobë deri në dyqind e pesëdhjetë mijë (250.000) Euro dhe me burgim prej së paku shtatë (7) vjet.

2. Kushdo që organizon, themelon, mbikëqyr, menaxhon ose drejton veprimtaritë e grupit kriminal të organizuar, dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) Euro dhe me burgim prej së paku dhjetë (10) vjet.

3. Kur veprimtaritë e grupit kriminal të organizuar të parapara në paragrafin 1. ose 2. të këtij neni rezultojnë në vdekje, kryesi dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) Euro dhe me burgim prej së paku dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm.

4. Gjykata mund të zbusë dënimin e anëtarit të grupit kriminal të organizuar i cili, para se grupi kriminal i organizuar të ketë kryer veprën penale, raporton në polici ose prokurori, ekzistimin, formacionin dhe jep informata për grupin kriminal të organizuar në detaje të mjaftueshme për të mundësuar arrestimin apo ndjekjen e grupit të tillë.

5. Për qëllime të këtij neni, “aktivisht merr pjesë” përfshin, por nuk kufizohet në ofrimin e informatave ose mjeteve materiale, rekrutimin e anëtarëve të rinj dhe të gjitha format e financimit të veprimtarive të grupit.

Dallimet kryesore mes dy versioneve janë të lidhura kryesisht me strukturën dhe teknikën legislative të përdorur në përshkrimin e veprës penale.

Për këtë arsye, ish paragrafi 7, në lidhje me përkufizimet, është zhdukur, si tani në KPRK, paragrafi mëparshëm. 7.1 (që ishte një lloj i një përmbledhje të elementeve përbërëse të

veprës penale) nuk ka korrespondencë në nenin e ri, në paragrafin e mëparshëm. 7.2 Termi "grup i strukturuar" u zëvendësua me "asociacion i strukturuar" tani i përcaktuar në nenin 120, par. 14 KPK, përkufizimi i mëparshëm i "krimit të rëndë" të përfshirë në paragrafin e mëparshëm. 7.3 (që do të thotë "një vepër penale e dënueshme me burgim prej së paku katër vjet") është tani dhe përsëri (si në praktikë nuk ka asnjë ndryshim, si vepër e caktuar penale duhet të jetë e dënueshme në abstrakt me burgim prej së paku katër vjet) të përfshira në kriter, i përbërë nga dënimi minimal që në abstrakt është i zbatueshëm për veprat penale) që janë kryer, e cila është përfshirë në paragrafin 1 të nenit 283 KPK: "e dënueshme me burgim prej së paku katër vjet". Në raport me të njëjtin paragraf të mëparshëm. 7.4 termi "Grupi" është përcaktuar tashmë në mënyrë autonome si "grup i njerëzve", në nenin 120, par. 12, KPK, si "tre ose më shumë persona", nuk është më e përcaktuar në vepër penale, si termi i mëparshëm "grup i strukturuar" që është ekuivalent me përcaktimin aktual të "asociacion i strukturuar", që do të thotë se ajo është një që nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të një vepre penale, por nuk është e nevojshme të ketë të përcaktuar rolet e anëtarëve të tij, vazhdimësinë e anëtarësisë së saj, apo një strukturë të zhvilluar.

Dallimi tjetër ka të bëjë me bashkimin e "kryerjes" (paragrafi i mëparshëm 1) me "pjesëmarrje aktive" (par. i mëparshëm 2), pasi më parë këto veprime kriminale janë përshkruar në paragrafët e ndryshëm pa një arsye logjike për të tilla, meqë të dy veprimet janë ende brenda konceptit të kryerjes. Megjithatë, dënimi që ishte paraparë në par. 2 për të " marrë pjesë në mënyrë aktive " (në vend të "kryer") ishte më i butë, pasi afati minimal i burgimit ishte 5 vjet, pra më e favorshme, pasi tani kufizim i tillë është 7 vjet.

Paragrafi i mëparshëm 3 ("Kushdo që organizon, themelon, mbikëqyr, menaxhon ose drejton aktivitetet e një grupi të organizuar kriminal dënohet me një gjobë deri në 500.000 euro dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet") korrespondon me një rrethanë rënduese tani paraparë në par. 2, me të njëjtën gjobë, por me një minimum të lartë me burgim, pasi tani ajo është 10 vjet dhe për këtë arsye ajo nuk është më e favorshme.

Ish par. 4 korrespondon tani me par. 3, versioni i ri saktë i referohet 2 formave të kryerjes që janë të përmendura më parë në paragrafët 1 dhe 2, pasi më parë rrethana rënduese është përmendur vetëm në par. 2, e jo në 1, e cila nuk është e kuptueshme. Përveç kësaj, minimumi i burgimit të parashikuar në ditët e sotme është më i lartë, pasi është 10 vjet dhe për këtë arsye dispozita aktuale nuk është më e favorshëm.

Paragrafi aktual 4 korrespondon me ish paragrafin 3 dhe nuk është më i favorshëm po ashtu, meqë tani gjykata mundet vetëm që ta zvogëlojë dënimin gjersa më parë ka mundur që të heqë dorë në tërësi

Së fundi, nuk ka asnjë ekuivalent me paragrafin e mëparshëm 6 dhe në ditët e sotme par. 5 është përkufizimi i shprehjes " merr pjesë në mënyrë aktive".

Nga ajo që është thënë, është e logjikshme për të ardhur në përfundim se kodi i ri penal, kur bëhet fjalë për rastet e dënimit të veprave të tilla penale nuk mund të konsiderohet më i favorshëm në ndonjë nga paragrafët.

Në këtë vepër penale kryesi mund të jetë çdo person, pra duke qenë një vepër penale e përbashkët - pasi nuk ka kërkesa të veçanta që duhet të plotësohen nga ana e agjentit <sup>130</sup>.

Në lidhje me vlerën juridike të mbrojtur nga kjo vepër penale, është dominuese në doktrinën ideja se është "qetësia publike", "siguria e brendshme" dhe rendi - sundimi i ligjit të shtetit. <sup>131</sup>, që synon për të shmangur rrezikun shoqëror <sup>132</sup>.

Ne pajtohemi me këtë qasje doktrinale <sup>133</sup> se është e mundur të flitet për krimin e organizuar, kur takimi i vullneteve të anëtarëve gjeneron një entitet autonom, të ndryshëm dhe mbi të gjitha të natyrshëm për vetë anëtarët.

Pas kësaj, është e mundur për të mbrojtur një kuptim tërësor të veprës penale të "krimit të organizuar", për ta bazuar rrezikshmërinë e saj në ekzistencën e grupit të organizuar kriminal de per se (edhe pse në Kosovë është kuptuar se vepra penale kërkon kryerjen e një vepre tjetër penale (në këtë rast të dënueshme me të paktën 4 vjet burgim), për të qenë në harmoni me të, dhe kjo rrezikshmëri justifikon inkrimimin e llojit të tillë të shoqatave, pasi ato krijojnë rrezik (në abstrakt) të rendit dhe qetësisë publike, për sundimin e ligjit, për shtetin (vlera juridike e mbrojtur).

Edhe pse është e diskutueshme, ne e kemi kuptuar se për kryerjen e kësaj vepre penale është e nevojshme një takim i vullneteve, e me të paktën një përhershmëri me kalimin e kohës, për të kryer një shumicë të veprave penale, qëllimi synon në përputhjen me qëllimin e përbashkët, aktiviteti, dhe jo autori i veçantë i një vepre të caktuar penale; duhet të ketë një strukturë organizative dhe procesi i formimit të vullnetit të përbashkët në lidhje me lidhjen që i lidh anëtarët e grupit të strukturuar. Kjo kërkon të paktën një stabilitet dhe qëndrueshmëri me kalimin e kohës për të arritur vullnetin e përbashkët të grupit - dhe kjo është në lidhje me dimensionin tërësor të një grupi të organizuar kriminal dhe rrezikshmërinë e saj për Qetësinë publike dhe Shtetësisë (sundimi i ligjit Shtetësia) - të cilat janë vlerat juridike të mbrojtura nga vepër penale, siç u tha.

---

<sup>130</sup> “Që vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni mund të kryhet nga çdo person”. Shih pikën 6 sipas paragrafit 1 të nenit 283 Komentari.

<sup>131</sup> Ne pajtohemi me Santos Cabette (Profesor i se drejtës penale ne Universitetin Juridik te Sao Paulos, USP Brazil) se kjo vepër penale mbron nje rrezik abstrakt ( shih <http://jus.com.br/artigos/31419bem-juridico-tutelado-nos-crimes-de-organizacao-ou-associacao-criminosa>).

<sup>132</sup> “Kjo vepër penale sipas paragrafit 1 të këtij neni, ka karakterin e veprimeve përgatitore për rrezikun e përgjithshëm social, e cila është arsyeja për ndëshkimin e aktiviteteve të tilla”. Shih pika 3 në paragrafin 1 të nenit 283 Komentari.

<sup>133</sup> Ndër të tjera, ky është koncepti i Figueiredo Dias dhe Costa Andrade (Profesor/Profesorëve të së Drejtës Penale në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Coimbra).



Elementet e veprës penale, siç është përshkruar më parë, janë sipas mendimit tonë të shënuar nga një kontradiktë e brendshme konceptuale si përkufizimet e "strukturuar" (qoftë "grup" në KPPK ose "shoqata" në KPRK) nuk mund të jetë boshe; një gjë është për të përcaktuar një "grup" ose një "shoqatë", dhe pastaj ne mund të biem dakord se do të ishte e përshtatshme për të e përshkruar atë si "një shoqatë që nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të një vepre penale, por ajo nuk ka nevojë të ketë të përcaktuar rolet për anëtarët e saj, vazhdimësinë e anëtarësisë së saj, apo një strukturë të zhvilluar ", por në qoftë se ky është përkufizimi i një asociacioni të strukturuar, dhe kjo është, atëherë sipas mendimit tonë ideja e "strukturës "mungon nga vetë definimi i saj.

Aktualisht, Neni 283, në par. 6, të KPRK-së, gjithashtu përshkruan kuptimin e "aktivisht merr pjesë": përfshin, por nuk kufizohet në, ofrimin e informacionit apo mjeteve materiale, rekrutimin e anëtarëve të rinj dhe të gjitha format e financimit të aktiviteteve të grupit) dhe në nenin 120, par. 13, i KPRK-së ku thuhet se një grup i organizuar kriminal është një "shoqatë e strukturuar (e cila, në anën e saj, është përcaktuar në par. 14, si" një shoqatë që nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të një vepre penale, por ajo nuk ka nevojë të ketë të përcaktuar rolet për anëtarët e saj, vazhdimësinë e anëtarësisë së saj, ose një strukturë të zhvilluar '), e krijuar gjatë një periudhe kohore, prej tre ose më shumë personash për kryerjen e një vepre të caktuar penale që vepron në koncert me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave penale të rënda në mënyrë që të përfitojë, direkt ose indirekt, dobi pasurore a financiare apo të tjera ". Strukturuar nuk do të thotë, megjithatë, se ajo duhet të ketë një strukturë hierarkike<sup>134</sup>.

Këto koncepte, me përcaktime të tilla të gjera, ka gjithashtu të ngjarë të bien ndesh me aspekte të tjera të Shkencës së Ligjit Penal, si për shembull në lidhje me format e bashkëkryerjes (bashkëkryerje stricto sensu, mbështetja dhe nxitja), pasi ajo disi duket të përfshijë automatikisht çdo formë të bashkëkryerjes për sa përfshinë 3 ose më shumë persona.

Sipas pikëpamjes së këtij paneli, dhe në lidhje me të pandehurit I.P. (pika 1) dhe A.G. dhe T.Y. (pika 2) ka të paktën një fakt thelbësor që mungon, se ata ishin duke vepruar si anëtarë të një grupi dhe për këtë arsye dhe a fortiori shumë më pak mund të konsiderohet se ata ishin duke vepruar si anëtarë të një grupi të organizuar kriminal. Në pikëpamje të elementeve përbërëse të veprës penale, është një që mungon në lidhje me të gjithë të pandehurit, pasi vepra themelore penale e kontrabandimit të migrantëve nuk është e dënueshme me burgim prej së paku 4 vjet (dhe për të shmangur dyshime, versionet shqip dhe serbisht të Kodit, gjuhët që në rast të mospërputhjes mbizotërojnë mbi gjuhën angleze, në fakt përdorin shumë të njëjtën shprehje, jo ndonjë të ngjashme ose që mund të interpretohet në mënyra të ndryshme); kështu që, vepra themelor penale e kontrabandimit të migrantëve dënohet nga 2 vjet deri në 12 vjet burgim (neni

---

<sup>134</sup> Shih faqen 16 të versionit anglisht të vendimit të Gjykatës së Apelit në rastin PARK 259/14, të datës 22 maj 2015.

138, par. 1, i Kodit të Përkohshëm Penal ) ose deri në 10 vjet burgim (neni 17, par. 1, Kodi Penal i Republikës së Kosovës).

Në fakt, siç tha, kjo është një kërkesë e veprës penale të "krimit të organizuar" kryerja e një krimi të rëndë<sup>135</sup>, një veprë penale e dënueshme me më së paku 4 vjet burgim. Termi i përdorur nga ligjvënësi "e dënueshme" na çon në kufijtë abstrakt të dënimit, pasi nuk mund të lexohet si "ku një dënim prej katër vitesh mund të vendoset" – shikoni se si legjislatori e bën të qartë dallimin në mes këtyre dy shprehjeve ("dënohet me burgim prej së paku" vs. "dënimi prej X vjet mund të vendoset"), për shembull kur adresohet një tentim, në nenin 28, par. 2, KPRK (e njëjta gjë ka ndodhur kur KPPK ka qenë në fuqi, në atë kohe neni 20, par. 2) "një përpjekje për të kryer veprë penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me tre ose më shumë vjet (...)" . Kjo nuk lë vend për dyshim se legjislatura përdor dy shprehjet në fjalë me dy kuptime të sakta dhe në gjykatë nuk mund të vijë në një interpretim sikur shprehjet të ishin sinonime, sepse ato nuk janë; gjykata nuk mund të vijë në një interpretim të një dispozite ligjore të caktuar pa mbështetje në formulimin literal të dispozitës juridike duke u konsideruar, aq më pak gjykata mund të vijë në një interpretim *contra legem* (përveç këtyre kritereve të përgjithshme mbi interpretimin e ndonjë ligji, në rastin e ligjit penal, ekziston një argument shtesë që ne do të e trajtojmë më pas, për çdo paqartësi në interpretimin e elementeve të veprës penale).

Çështja vetëm trajtohet, nga vitet minimale të zbatueshme me burgim për veprën penale të kontrabandës me migrantët (që mund të jetë 2 vjet) mund të na shpijë në një tjetër: për ta ditur nëse pragu abstrakt për të qenë "i dënueshëm me burgim prej së paku 4 vjet" (si minimum, "të paktën") është domosdoshmërisht duke iu referuar veprës së pastër penale (paragrafi 1 në çdo version), ose në qoftë se ajo mund të kuptohet se ajo është duke iu referuar edhe në rastin e rrethanave rënduese. Në favor të opsionit të fundit (të paktën rrethanë rënduese), mund të thuhet vlerat juridike të mbrojtura janë të ndryshme në veprat penale (të krimit të organizuar dhe të veprave të tjera penale, si, për shembull, kontrabandimi i migrantëve); në favor të së parës, fakti që legjislatori mund të ketë dashur për të krijuar në mënyrë të qartë një kriter abstrakt mbi çfarë do lloj të veprave penale mund të konsiderohet së bashku me krimin e organizuar, pavarësisht nga mënyra gjykata i vlerëson ato në raste të veçanta (nëse një rrethanë rënduese u vlerësua të ekzistojnë, e përcaktuar, ose jo), pasi ne e shohim se, për shembull, termi minimumi i burgimit të paraparë për qeniet njerëzore të trafikimit, është 5 vjet (neni 171 të KPK-së)<sup>136</sup>.

---

<sup>135</sup> Siç e pamë më parë, pavarësisht se ligji, nuk është duke e përdorur më këtë shprehje, minimumi i dënimit në abstrakt nuk ka ndryshuar pasi është po ashtu 4 vjet burgim.

<sup>136</sup> Një lloj i veprës penale zakonisht e lidhur me krimin e organizuar është vepra narkotike drogës, aktualisht në kapitullin XXIII C.C.K. (Nenet 273 deri në 282) dhe ne vërejmë se asnjë prej tyre (edhe në formë të rëndë) nuk parashikon një minimum prej të paktën 4 vjet burgim, gjithmonë më pak; ndoshta ky është një gabim i ligjvënësit kur e ka përdorur kriterin 4 vjet (jo 2, për shembull), ngjashëm me gabimin që ka ekzistuar më parë në nenin 138 të KPPK, ku vepra e rëndë penale e kontrabandës me migrantë, si një anëtar i një grupi, është dënuar më butë se veprat penale të thjeshtë, pa ndonjë rrethanë rënduese ... por jo të gjitha gabimet mund të "ndryshohen" me anë të interpretimit, pasi ka kufizime.

Përveç kësaj, probleme të tjera do të ndodhin me siguri nëse do kuptohej që referimi ndaj minimumit mund të bëhet në rast të rrethanave rënduese: jo vetëm që nuk do të jetë një element përbërës i vendosur në abstrakt, përkundrazi, ajo do të ishte konkretisht dhe varësisht nga vlerësimi i veçantë i një paneli, ose i një gjykate, por, po ashtu, kjo do të çojë në probleme të vlerësimit të dyfishtë të të njëjtit fakt në kundërshtim me parimin bazë të *ne bis in idem*, pasi kjo do të jetë e qartë në rastin e kontrabandës, si një anëtar i një grupi, në qoftë se përpos ekzistencës së grupit, grupi në fjalë, mund të klasifikohet në të njëjtën kohë si një grup i organizuar kriminal (që minimumi i brugimit është 5 vjet): në një rast të tillë, zgjidhja do të jetë për të përdorur elementin e "grupit" vetëm për të përmbushur kërkesat e dënueshme me të paktën 4 vjet burg, por më pas, për të shmangur vlerësimin e dyfishtë të të njëjtit fakt (grup), për të ndëshkuar kontrabandën vetëm në përputhje me paragrafin 1, vepër e thjeshtë penale e kontrabandimit (kjo për të mos përmendur vështirësi shtesë doktrinare që rezulton nga të kuptuarit e tillë), i përbërë nga fakti se vlerat juridike të mbrojtura në veprat penale janë të ndryshme, siç është shpjeguar tashmë).

Një gjë nuk është e kontestueshme: pavarësisht sqarimit të të kuptuarit të këtij paneli, problemi ekziston dhe nuk mund të shkojë pa u vënë re, nuk mund të injorohet, kjo do të thotë se të paktën ekziston një paqartësi.

Në këtë drejtim, ne kujtojmë pastaj parimin e ligjshmërisë, neni 1, par. 3, KPPK (Neni 2, par. 3, C.C.R.K.) ", përkufizimi i veprës penale do të interpretohen në mënyrë rigoroze dhe interpretimi me analogji nuk lejohet. Në rast paqartësie, përkufizimi i veprës penale interpretohet në favor të personit duke u hetuar, ndjekur penalisht apo të dënuar ". Prandaj, ne jemi të mendimit se zgjidhja më e mirë do të jetë për të ndjekur kuptimin e deklaruar në mënyrë të qartë më sipër, kërkesën "e dënueshme me burgim prej së paku 4 vjet" që i referohet veprës së thjeshtë e të pastër penale dhe në këtë rast të veçantë mungon.

Duke iu rikthyer analizës së aspekteve të tjera të kësaj vepre penale, edhe pse mund të përcaktohet se të pandehurit e tjerë (në pikën 5, A.Ç., M.B., A.M., M.A. dhe A.B.) kanë vepruar si anëtarë të një grupi, ky grup nuk mund të konsiderohet si i strukturuar, as nuk mund të konsiderohet si një asociacion i strukturuar pasi ligji aktualisht thotë, edhe pse "bashkë-kryerja" nga disa individë ka qenë më e shpeshtë.

Të pandehurit në të vërtetë kanë vepruar si anëtarë të një grupi në varësi të rrethanave <sup>137</sup>, pavarësisht se është gjithashtu e vërtetë se të pandehurit u njohën me njëri-tjetrin (në mënyrë të saktë shpjegohet në faktet e vërtetuara), ata e dinin për njëri-tjetrin duke qenë të prirur për t'u angazhuar në kontrabandimin e migrantëve; nëse nga njëra anë nuk është absolutisht e saktë të pohohet se ishte pikërisht një grup *ad hoc* i njerëzve (pasi ata i kishin kontaktet e tyre, i kishin planifikuar ngjarjet, etj), nga ana tjetër ajo është po aq e vërtetë se ata vepruan për të përmbushur interesat e tyre dhe do të veprojnë, duke vepruar vetëm në përputhje me interesat e tyre,

---

<sup>137</sup> Siç tregohet në arsyetimin plotë të fakteve.

disponueshmërinë dhe dëshirën në çdo moment të caktuar ose rast; nuk është e mundur të thuhet se ka pasur një interes të ndryshëm nga ai i tyre, një "interes holistik më të lartë" (i një grupi të organizuar). Ne gjithashtu shohim sërish se ata nuk kishin role të veçanta, pavarësisht se disa ishin më të kufizuara në lidhje me llojin e fakteve për të qenë në gjendje që të angazhohen në të; për shembull, A.Ç. ishte në gjendje të kujdeset për lëshimin e letrave të garancisë, bëri rezervimet, planin dhe rregulloi udhëtimet e mëtejme, pritja dhe përcjellja e migrantëve, pasaporta të pastër, të udhëzojë dhe të organizojë të bashkë-të pandehurit e tjerë.

Është një fakt që individët të cilët e njohin njëri-tjetrin, që të angazhohen në një aktivitet të caktuar, mund të ketë disa kontakte mase të rregullta, për të rregulluar veprimtaritë e tyre me njëri-tjetrin, por kjo nuk do të thotë se është një grup i strukturuar ose asociacion, e as një bashkë-kryerje e thjeshtë apo e rastit; ajo mund të jetë diçka në mes. Ligji ofron të gjitha mjetet për të marrë në konsideratë të gjitha faktet, si mënyrat e kryerjes së veprës penale (nga e thjeshta bashkëkryerje, si një anëtar i një grupi i cili angazhohet në veprime të ndryshme, me një anëtar të një asociacioni të strukturuar) mund të të merren parasysh në vlerësimin e intensitetit të qëllimit, personalitetit të portretizuar në aktet, të gjitha rrethanat relevante për të përcaktuar dënimin.

Në këtë drejtim, vepra penale "kontrabandimi me migrantët" (si në KPPK dhe në KPRK) ndër të tjera, parashikojnë dy rrethana rënduese: veprimtarinë kriminale të individëve që veprojnë si një anëtar i një grupi dhe organizimin ose drejtimin e të tjerëve. Në lidhje me "veprimin si anëtar i një grupi" duhet të konsiderohet se që të flasim për një "grup" (nuk po flasim për thjeshtë bashkë-kryerësit, apo edhe disa bashkë-autorë, pa marrë parasysh se sa këta mund të jenë ..., siç u tha) ajo kërkon një minimum organizimi; përndryshe ata nuk mund të kishin vazhduar me veprën penale. Rrethana tjetër rënduese, të organizimit ose drejtimit të të tjerëve, është më e rëndë se duke vepruar si anëtar i grupit, që në mënyrë të qartë rezulton nga dënimet e parashikuara në ligj.

Në jurisprudencë në lidhje me këtë veprë penale së bashku ose në konkurrencë me veprën penale të kontrabandimit të migrantëve, në raste të ngjashme ku disa prej individëve të përmendur nga prokuroria në pikën 1 janë ndjekur penalisht, mund të gjejmë shembuj të ndryshëm (pavarësisht fakteve të natyrshme të ndryshme të përcaktuara ) duke deklaruar se nuk ishte e mundur për të përcaktuar ekzistencën e krimit të organizuar, për të mos përmendur se akuza është refuzuar edhe në numrin e lëndës penale P. 233/2013 e po kësaj gjykate, me aktgjykim të datës 30 tetor 2013: gjykata e hodhi poshtë akuzwn 1 në krimin e organizuar në bazë të nenit 271 paragrafët 1, 2 dhe 3 të Kodit Penal të Kosovës, pasi prokurori tërhoqi akuzën gjatë shqyrtimit gjyqësor <sup>138</sup>, në të njëjtën mënyrë e ka tërhequr atë në seancën fillestare në procedurën nr. PKR. 316/14 të Gjykatës Themelore të Prishtinës <sup>139</sup>.

---

<sup>138</sup> Në fakt, një numër i madh i emrave janë pikërisht të njëjtat emra sikurse në dosjen e rastit, duke përfshirë edhe disa që në këtë janë të pandehur: A.Ç., M.B. dhe A.M.; "(...) SEPSE mes datës 5 shkurt 2012 dhe 17 prill 2012, A.By., në territorin e Kosovës, Malit të Zi, Kroacisë, Sllovenisë dhe Italisë, kanë kryer veprën penale të krimit të organizuar duke: 1. Organizuar, mbikëqyrur, administruar apo drejtuar aktivitetet e një grupi kriminal të

Në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PARK 259/14, të datës 22 maj 2015 (kundër Ibrahim Podrimja, i cili është gjithashtu i pandehur në këto procedura, dhe të tjerët), mund të lexohet "Paneli konstaton se edhe pse një shkallë e strukturës mund të identifikohet në të cilën të pandehurit kanë vepruar, të dhënat tregojnë se një strukturë e tillë ishte e dobët (...). Prandaj, Paneli plotësisht pajtohet me arsyetimin e Gjykatës Themelore se provat e parashtruara nga prokuroria nuk provojnë përtej dyshimit të arsyeshëm se veprimet e kryera nga të pandehurit janë kryer si pjesë e një asociacioni të strukturuar, të krijuar gjatë një periudhe kohore"<sup>140</sup>.

Edhe në aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, P. 38/12, e datës 23 janar 2013, ishte pohuar se provat nuk e kanë lejuar përfundimin se ishte një grup i strukturuar.

Në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. 244/10, të datës 17 qershor 2011, Paneli ka dhënë dënim për krim të organizuar, pasi ka ardhur në përfundimin se provat treguan një grup të fortë dhe të strukturuar kriminal (ky rast nuk është i lidhur me rastin tonë në fjalë në lidhje me anëtarët e pretenduar të grupit të organizuar kriminal, përkundër se është po ashtu në lidhje me kontrabandim të migrantëve).

Duke marrë parasysh atë që u tha më lart dhe faktet e vërtetuara, trupi gjykues konstaton se nuk janë krijuar të gjitha elementet e veprës penale, maxime, ekzistenca e elementit "grup i strukturuar" mungon dhe një tjetër element është gjithashtu që mungon, ai që lidhet me veprën themelore apo të njëkohshme që duhet të jetë e dënueshme me të paktën 4 vjet burgim (pasi periudha minimale e burgimit të paraparë për kontrabandimin e migrantëve është 2 vjet), dhe për këtë arsye të pandehurit janë liruar nga akuzat të përfshira në pikat 1 dhe 2 (dhe në lidhja me të pandehurit tashmë të përmendur as nuk është përcaktuar se ata kanë vepruar si anëtarë të ndonjë grupi ndonjëherë).

### **Analiza e veprës penale të kontrabandimit me migrantë.**

Të pandehurit janë akuzuar, në akuza të ndryshme, me këtë vepër penale (nenet 138 dhe 23 KPPK):

- **Nw pikën 3** A.Ç. dhe A.B., mes 25 qershorit 2011 dhe 14 dhjetor 2011 (nw bashkw-kryerje me O.Y. dhe tw tjerwt), sipas "Nenit 138 paragrafw 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të Kodit Penal të Kosovës, në veçanti me organizimin dhe drejtimin e të tjerëve për të kryer vepër (...) me rrethanën rënduese të të vepruarit si anëtar i grupit ose në një mënyrë që ka gjasë të rrezikojë jetën apo sigurinë e migrantëve, ose që përfshin trajtimin çnjerëzor apo poshtërues, duke përfshirë shfrytëzimin, e migrantëve të tillë";

- **Në pikën 4** A.Ç., mes datës 5 tetor 2011 dhe 9 tetor 2011, "tentim" (nw bashkw-kryerje), sipas "Neni 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të Kodit Penal të Kosovës, në veçanti me

---

organizuar që përbëhet nga O.K., C.K., E.K., L.K., "N.", A.By., A.Ç., N.N., M.B., A.M., Isuf [last name of T.H.], Mirgim [last name of T.H.] ("Bahri"), Personi me nofkën "T." [last name of T.H.], S.B., Nevenka Perković, Z.G., M.Ca., Zlatko Marković, Grozdana Nonković, dhe kyres të tjerë të pidentifikuar (...).

<sup>139</sup> Shih faqet 5 dhe 14 të versionit në anglisht të aktgjykimit në fjalë, me datë 16 korrik 2014.

<sup>140</sup> Shih faqet 12 të versionit në Anglisht të aktgjykimit në fjalë.

organizimin dhe drejtimin e të tjerëve për të kryer vepër (...) me rrethanën rënduese të të vepruarit si një anëtar i një grupi;

- **Në pikën 5**, A.Ç., M.B., A.M., A.B., I.P. dhe M.A., mes datës 23 qershor 2012 dhe 2 dhjetor 2012 (nw bashkë-kryerje), sipas nenit 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të Kodit Penal të Kosovës, në veçanti me organizimin dhe drejtimin e të tjerëve për të kryer vepër (...) me rrethanën rënduese të të vepruarit si anëtar i grupit ose në një mënyrë që ka gjasë të rrezikojë jetën apo sigurinë e migrantëve ose që përfshin trajtimin çnjerëzor ose poshtëruës, duke përfshirë eksploatimin e migrantëve të tillë”;

- **Në pikën 6**, A.G., mes datës 17 gusht 2012 dhe 22 gusht 2012 (në bashkëkryerje me A.Ç.n dhe të tjerët), sipas “ nenit 138 paragrafët 1, 2, 3 të Kodit Penal të Kosovës (...) duke u angazhuar në kontrabandimin e migrantit I.K. Kiliç, shtetas i Republikës së Turqisë, duke siguruar dhe ofruar dokumente të falsifikuara të identitetit për të mundësuar kontrabandën e (...) migrantit për të përfituar dobi financiare apo të tjera veçanërisht duke siguruar një garanci”

dhe

- **Në pikën 8** T.Y., mes datës 7 nëntor 2012 dhe 4 dhjetor 2012 (në bashkëkryerje me A.Ç. dhe të tjerët), sipas “ nenit 138 paragrafët 1, 2, 3 të Kodit Penal të Kosovës (...) duke u angazhuar në kontrabandimin e migrantëve R.B., E.Ba. dhe të tjerëve, qytetarë të Republikës së Turqisë, duke u siguruar dhe ofruar dokumente të falsifikuara të udhëtimit për të mundësuar kontrabandën e (...) migrantëve për të përfituar një dobi pasurore financiare apo të tjera, veçanërisht duke siguruar një garanci”.

Duke filluar me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës (sipas aktakuzës), KPPK ", të nenit 138, Kontrabandimi me Migrantë <sup>141</sup>:

(1) Kushdo **që merret** me trafikimin të migrantëve dënohet me burgim prej dy deri në dymbëdhjetë vjet.

(2) Kushdo që **prodhon, prokuron, siguron ose posedon dokument të rrejshëm të udhëtimit ose të identifikimit** me qëllim të mundësimit të marrjes me trafikimin me migrantë dhe për të fituar drejtëpërdrejt ose tërthorazi dobi pasurore a financiare dënohet me burgim deri në pesë vjet.

(3) Kushdo që personit i cili nuk është banor i Kosovës i mundëson të qëndrojë në Kosovë ose personit i cili nuk është banor vendor a i përhershëm për të qëndruar në shtetin në fjalë pa i respektuar kushtet e domosdoshme ligjore për të mbetur sipas mjeteve nga paragrafi 2 i këtij neni **ose me çfarëdo mjatesh të tjera joligjore** dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

(4) Tentativa për të kryer vepër nga paragrafi 3 i këtij neni është e dënueshme..

(5) Kushdo **që organizon ose urdhëron personat e tjerë për të kryerë vepër penale nga paragrafi 1, 2 ose 3** dënohet me gjobë deri në 500.000 euro dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet.

---

<sup>141</sup> Theksimi do të shtohet përgjatë kuotimit.

(6) Nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni kryhet nga kryerësi **si anëtar i grupit ose** në një mënyrë e cila rrezikon ose ka gjasë të rrezikojë jetërat a sigurinë e migrantëve përkatës ose që përfshin trajtimin çnjerëzor a degradues, duke përfshirë eksploatimin e migrantëve të tillë, ai dënohet me burgim prej dy deri në dhjetë vjet.

(7) Sipas këtij neni:

1) Shprehja "kontrabandim me migrantët" do të thotë prokurim me qëllim të fitimit të drejtpërdrejtë ose tërthorazi të një dobie pasurore a financiare i një hyrjeje të paligjshme të personit në Kosovë, i cili nuk është banor i Kosovës ose në shtetin në të cilin personi nuk është banor i përhershëm apo shtetas i huaj.

2) Shprehja "hyrje e paligjshme" do të thotë kalim i kufirit ose i kufirit administrativ të Kosovës pa i respektuar kushtet e domosdoshme për hyrje të ligjshme në Kosovë ose kalim i kufinjve të shtetit pa i respektuar kushtet e domosdoshme për hyrjen e ligjshme në atë shtet.

3) Shprehja "dokument i rrejshëm i udhëtimit ose i identifikimit" do të thotë çfarëdo dokumenti i udhëtimit ose i identifikimit:

(i) Që është falsifikuar ose ndryshuar në ndonjë mënyrë të caktuar nga cilido person pos nga personi ose organi i autorizuar në bazë të ligjit për të prodhuar ose lëshuar dokument udhëtimi ose identifikimi;

(ii) Që është lëshuar ose është siguruar në mënyrë jo të duhur përmes keqinterpretimit, korrupsionit ose trysnisë apo në çfarëdo mënyre tjetër të kundërligjshme ose

(iii) Që shfrytëzohet nga personi i cili nuk është mbajtësi i tij i vërtetë.

(8) Personi nuk është penalisht përgjegjës sipas këtij neni nëse ai është migrant që është objekt i veprës penale nga ky nen".

Në Kodin e ri, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (K.P.R.K.), në fuqi që nga 1 janari 2013, dispozita në fjalë është "Neni 170 kontrabandimi me migrantë

1. Kushdo **që merret** me kontrabandim të migrantëve dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri dhjetë (10) vjet.

2. Kushdo që me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore, **prodhon, furnizon, siguron ose posedon dokument të rrejshëm të udhëtimit ose të identifikimit** me qëllim të mundësimin të kontrabandimit me migrantë, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.

3. Kushdo që i mundëson personit i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës të qëndrojë në Republikën e Kosovës ose personit i cili nuk është shtetas apo banor i përhershëm për të qëndruar në shtetin në fjalë, pa i përfillur kushtet e domosdoshme ligjore për qëndrim, me mjetet nga paragrafi 2. i këtij neni ose me çfarëdo mjete tjera të paligjshme, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në një (1) vit.

4. Tentativa për të kryer veprën penale nga paragrafi 3. i këtij neni është e dënueshme.

5. Kushdo që **organizon ose drejton personat e tjerë për të kryer veprë penale nga paragrafi 1. ose 2** dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) Euro dhe me burgim prej shtatë (7) deri në njëzet (20) vjet, ose me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet për veprën penale nga paragrafi 3. i këtij neni.

6. Kur vepra penale nga paragrafi 1., 2. ose 3. i këtij neni kryhet nga kryesi i **cili vepron si anëtar i grupit** ose në një mënyrë që rrezikon ose ka gjasë të rrezikojë jetërat apo sigurinë e migrantëve përkatës ose që përfshin trajtimin çnjerëzor apo poshtëruës, duke përfshirë eksploatimin e migrantëve të tillë, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim jo më pak se pesë (5) vjet.

7. Nëse vepra penale nga paragrafi 1., 2. ose 3. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim së paku dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm.

8. Për qëllime të këtij neni shprehjet si më poshtë e kanë kuptimin si në vijim.:

8.1. Shprehja “**kontrabandim me migrantë**” nënkupton çdo veprim me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një dobie financiare ose të një dobie tjetër pasurore nga hyrja e paligjshme e personit në Republikën e Kosovës, i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës ose i një personi qoftë shtetas i Republikës së Kosovës apo shtetas i huaj në shtetin në të cilin personi i tillë nuk është banor i përhershëm ose shtetas i atij shteti.

8.2. Shprehja “**hyrje e paligjshme**” nënkupton kalimin e kufirit ose vijës kufitare të Republikës së Kosovës pa i përfillur kushtet e domosdoshme për hyrje të ligjshme në Republikën e Kosovës ose kalim i kufijve të ndonjë shteti pa i përfillur kushtet e domosdoshme për hyrjen e ligjshme në atë shtet.

8.3. Shprehja “**dokument i rrejshëm i udhëtimit ose i identifikimit**” nënkupton çfarëdo dokumenti i udhëtimit ose i identifikimit:

8.3.1. Që është falsifikuar ose ndryshuar në ndonjë mënyrë të caktuar nga cilido person përveç nga personi ose organi i autorizuar në bazë të ligjit për të prodhuar ose lëshuar dokument udhëtimi ose identifikimi;

8.3.2. Që është lëshuar ose është siguruar në mënyrë jo të duhur përmes keqinterpretimit, korrupsionit, trysnisë apo në ndonjë mënyrë tjetër të kundërligjshme;

ose

8.3.3. Që shfrytëzohet nga personi i cili nuk është mbajtësi i tij i vërtetë.

9. Personi nuk është penalisht përgjegjës sipas këtij neni nëse ai është migrant që është objekt i veprës penale nga ky nen.



10. Kushdo që abuzon me regjimin e liberalizimit të vizave me shtetet anëtare të BE-së apo të Marrëveshjes Shengen dënohet si më poshtë:

10.1. personi i cili rekruton, nxit, organizon, strehon ose bart persona në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, ose në ato të Marrëveshjes Schengen, me qëllim të realizimit dhe të përfitimit ekonomik, social ose të të drejtave të tjera, që janë në kundërshtim me të drejtën e Bashkimit Evropian dhe me rregullat e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, të Marrëveshjes Schengen dhe të së drejtës ndërkombëtare, dënohet së paku me katër (4) vjet burgim;

10.2. nëse personi vepron në kundërshtim me paragrafin 10.1 dhe/ose ka qene në dijeni se me bartjen do të realizohen përfitime ose ndonjë të drejte nga paragrafi 10.1, në kundërshtim me të drejtën e Bashkimit Evropian dhe me rregullat e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, të Marrëveshjes Schengen dhe me të drejtën ndërkombëtare, dënohet prej një (1) deri në pesë (5) vjet burgim;

10.3. nëse vepra është kryer për përfitime personale, kryesi do të dënohet për veprën, me burgim, së paku tetë (8) vjet, ndërsa për veprën e kryer, sipas paragrafit 10.2, dhe së paku do të dënohet me katër (4) vjet burgim për veprën e kryer sipas paragrafit 10.2;

10.4. nëse vepra është kryer nga personi juridik, do të dënohet me gjobë;

10.5. pajisjet dhe mjetet transportuese të përdorura për kryerjen e kësaj vepre do të konfiskohen.

10.6. ky paragraf fillon të zbatohet në momentin kur Këshilli i Bashkimit Evropian merr vendim për heqjen e regjimit të vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës”.

### **Elementet përbërëse të veprës penale**

Pas të cituarit të përshkrimit të veprave penale, mund të thuhet se, në thelb, elementet e veprës penale mbeten të njëjta.

Nga versionin e mëparshëm gjer tek ky aktual, ka ndryshime të vogla në formulimin (si, për shembull, në nën-paragrafin 2 të të dy versioneve, në përkufizimin e "kontrabandimit të migrantëve", duke pasur parasysh se më parë fjala "prokurim" në nën-paragrafin 7.1 është përdorur dhe tani në nën-paragrafin 8.1 shprehja "çdo veprim" është përdorur), nuk është një rrethanë e re rënduese (aktualisht par. 7, nëse vepra nga paragrafët 1, 2, 3 e këtyre neneve rezulton në vdekjen e një ose më shumë personave) dhe ka ndryshime në sanksionet e parashikuara në disa nga paragrafët (si, për shembull, në paragrafin aktual 6, kur rrethana rënduese e paraparë ndodh, sanksioni është tani një gjobë dhe minimumi është rritur në 5 vjet, si në versionin e mëparshëm, nga ajo që duket të jetë një gabim, me rrethanë rënduese paraparë në par. 6 (d.m.th., "duke vepruar si anëtar i grupit") ishte dënuar më butë (me burgim nga 2 deri në 10 vjet) atëherë, vepra themelore penale e paraparë në paragrafin 1, pa një rrethane specifike rënduese (burgim prej 2 deri në 12 vjet).

Gjithashtu, në përshkrimin e ri të përcaktuar në nenin 170 të Kodit Penal të Kosovës (KPRK-së), i tëri një paragraf i ri (10) është futur (por jo në fuqi, ende), në lidhje me "kushdo që abuzon regjimin e liberalizimit të vizave me BE-në Shtetet anëtare ose Marrëveshjen e Shengenit dënohet si më poshtë (...)"

Nëse një sqarim i mëtejshme, për një çështje të caktuar, është i nevojshëm, atëherë ajo do të bëhet, meqë është relevante kur ligji i ri mund të konsiderohet më i favorshëm sipas nenit 2, par. 2, KPPK ( neni 3, paragrafi 2 KPRK)"Në rast të një ndryshimi në ligjin e zbatueshëm në një çështje të caktuar para një vendimi të formës së prerë, ligji që është më i favorshëm për kryesin e veprës do të zbatohet", - dhe kjo mund të jetë për shkak të një sanksioni më të butë, ose, për shembull, në qoftë se nga ndryshimet në përshkrimin e veprës penale çështja e de-kriminalizimit mund të ngrihet, si edhe, sipas parimit të ligjshmërisë, neni 1, paragrafi 3 KPPK", përkufizimi i një vepre penale do të interpretohet në mënyrë strikte dhe interpretimi me analogji nuk lejohet. Në rast paqartësie, përkufizimi i veprës penale interpretohet në favor të personit duke u hetuar, ndjekur penalisht apo dënuar ", ekuivalente me nenin aktual 2, par. 3KPRK: "përkufizimi i veprës penale do të interpretohet në mënyrë rigoroze dhe interpretimi me analogji nuk lejohet. Në rast paqartësie, përkufizimi i veprës penale interpretohet në favor të personit kundër të cilit procedurat penale janë në vazhdim e sipër".

Përveç përjashtimeve të përmendura, rregulli është, në pajtim me nenin 2, par. 1 (Neni 3, par. 1, KPRK.) KPPK ", ligji në fuqi në atë kohë kur një vepër penale është kryer do të zbatohet ndaj kryesit të veprës".

Vlera juridike që e nënvizon kriminalizimin e kontrabandimit të migrantëve është për të mbrojtur një situatë vulnerabiliteti që buron nga faktorë të ndryshëm socialë dhe ka për qëllim luftimin e dobisë pasurore nga shfrytëzimi i saj. Në këtë drejtim, në Komentarin<sup>142</sup> thotë si në vijim: "*1. Baza për inkriminimin ndërkombëtar të kësaj vepre është e përbërë nga Protokoll kundër Kontrabandës së Migrantëve nëpërmjet Tokës, ujit apo ajrit. Ky Protokoll plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar. 2. Objekti i mbrojtjes kundër kësaj vepre penale është i dyfishtë. Mbrojtja e parë kundër kësaj vepre është projektuar për të mbrojtur liritë dhe të drejtat e themelore të migrantëve, dhe, së dyti, për të mbrojtur regjimin e kalimit ligjor të migrantëve nga një vend në tjetrin (...)"<sup>143</sup>.*

Përgjatë një kohe rregullat e emigracionit piren të jenë gjithnjë e më shumë të rrepta në shumicën e vendeve, sa i përket të huajve që të punojnë dhe banojnë, është një problem tjetër që i paraprinë: për të udhëtuar dhe për të hyrë në këto vende destinacioni, pasi kërkesat ligjore janë përsëri gjithnjë e më të ngushta. Dobësia është pastaj e lidhur thellësisht me migrimin e personave të cilët janë të gatshëm të paguajnë që të përpiqen për t'u zhvendosur në një vend

---

<sup>142</sup> "Kodi Penal I Republikës Së Kosovës", Komentari, Botimi I", nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Bonn dhe Eschborn, Gjermani (në tekstin mëtejshëm "Kommentari"). Në pikën 1, përkthimi në anglisht, i komentarit për nenin në fjalë.

<sup>143</sup> Shih pikat 1 dhe 2 të Komentari nenit 170 K.P.R.K.

tjetër për arsye ekonomike, për të bërë jetesën e tyre dhe për të përmirësuar kushtet e tyre të jetesës.

Dallimi kryesor midis kontrabandimit të migrantëve dhe të trafikimit të personave është se në kontrabandimin e migrantëve ka prokurim, çdo veprim, për të mundësuar që dikush të hyjë në mënyrë të paligjshme apo të qëndrojë në një vend (kur personi nuk është shtetas apo rezident i përhershëm ose mënyra të tjera që lejojnë për të hyrë në mënyrë të ligjshme, kjo është arsyeja pse është një "migrant" për këtë qëllim) kundër qëllimit të përfitimit të dobisë pasurore, zakonisht pagesën e një shume, por gjithë procesi zhvillohet me pëlqimin (edhe në qoftë se në bazë të gabimeve) e viktimës, ndërsa në veprën penale të trafikimit të personave pëlqimi në fjalë, mungon dhe eksploatimi mbetet me kalimin e kohës, edhe pasi personi ka arritur destinacionin final (për të krijuar fitim të trafikantit), e cila nuk ndodh në rastin e kontrabandës – pasi që përfundon kur marrëveshja, "kontrata" është mbyllur, ose deri në përfundimin e udhëtimit.

Edhe pse, më qartë në trafikimin e personave sesa në kontrabandimin e migrantëve, në të dyja ka shfrytëzim të dikujt (dhe sipas definicionit në Shkallë shumë të ndryshme), por ia vlen për ta vënë në dukje se në rastin e kontrabandimit të migrantëve, siq u tha, ka pëlqim (me dëshirën ...) e individit të kontrabanduar dhe ndoshta kjo është arsyeja pse ligjvënësi trajton personat e kontrabanduar si **objekte** të veprës, e jo si viktima ... siç thuhet shprehimisht në nenin 138, par. 8, KPPK dhe në nenin 170, par. 9, KPRK "Personi nuk është penalisht përgjegjës sipas këtij neni nëse ai është migrant i cili është objekt i veprës penale nga ky nen" [**theximi i shtuar**].

Në të dyja versionet, sa i përket kryesit, kjo është një vepër penale e cila është e zakonshme, jo specifike, kjo do të thotë se çdokush mund ta kryej këtë vepër penale, kryesi nuk duhet të ketë ndonjë karakteristikë të veçantë.

*Mens rea* (ose "elementi subjektiv" në doktrinën kontinentale) është qëllimi. Në të dy versionet vepra penale duhet të kryhet me dashje (të drejtpërdrejtë në disa forma të veprimit ose të paktën eventuale, siç përcaktohet në nenin 15 KPPK ose në nenin 21të KPRK-së), dhe neglizhenca nuk është një mënyrë e pranueshme për kryerjen e saj (pasi " personi është penalisht përgjegjës për kryerjen nga pakujdesia të një veprë penale vetëm kur kjo është e parashikuar shprehimisht në ligj ", -.... neni 11, par 3, KPPK, dhe neni 17, par 2, i KPRK-së), dhe kjo është për faktin se në të kundërtën shumica e veprave penale të kryera me qëllim, për atë që mjafton një qëllim i përgjithshëm, në këtë vepër penale që nuk është e mjaftueshme, sepse një qëllim i veçantë (*dolus specialis*) kërkohet nga ligjvënësit, dhe ky qëllim duhet të pastaj të drejtohet në "marrjen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të një përfitimi financiar ose material tjetër (...)". Megjithatë, çdo lloj i këtij qëllimi të veçantë, qoftë i drejtpërdrejtë ose eventual, mjafton.

Në lidhje me mënyrën e kryerjes, kjo vepër penale, në të dy versionet, mund të kryhet vetëm nga një akt (shih nenin. 31, par. 1, KPPK, dhe nenin 8, par. 1, KPRK), pasi në versionin e

mëparshëm është lexuar "angazhohet" dhe "prokurimi" dhe tani lexon "angazhohet" dhe "çdo veprim".

Në lidhje me subjektin pasiv të veprimit mund të jetë çdo kush, çdo kush i gatshëm për ta zhvendosur nga një vend në tjetrin në mënyrë të paligjshme për mos plotësimin e kërkesave ligjore, “*subjekti pasiv i kësaj vepre penale është i përbërë nga një ose më shumë migrantë të cilët kalojnë në territorin e një vendi tjetër*”<sup>144</sup>. Në lidhje me mënyrën e paligjshme apo hyrjen ilegale ose të qëndrimit, referencat e tjera do të bëhen më përpara.

Disa koncepte të përdorura ose në lidhje me këtë vepër penale, kërkojnë disa sqarime - se me gjithë respektin e duhur për të kuptuarit e ndryshëm janë pikëpamjet e panelit.

Në këtë aspekt, gjykata thekson se në aktgjykime të ndryshme në të njëjtën çështje ekzistojnë kuptime të ndryshme kur është fjala për çështje të ndryshme, të tilla si klasifikimimi i veprimeve si vepër penale në tentativë ose si vepër e kryer penale, numri i veprave penale të kryera varet prej numrit të migrantëve, e jo sipas numrit të vendimeve (kriminale) të marra nga kryesi i veprës penale, etj.

### **Numri i veprave penale**

Në lidhje me çështjen e parë të sapo ngritur, tentativa *vs.* kryerja, trupi gjykues është i mendimit se vepra penale është ajo çfarë doktrina e klasifikon si vepër penale formale ose vepër penale të veprimit të plotë, për dallim nga veprat penale materiale - ku një rezultat i caktuar duhet të ndodhë kështu që mund të thuhet se akti ka shkuar përtej tentativës. Në të vërtetë, trupi gjykues beson se kur, përfshirja, prokurimi ose çfarëdo veprimi kryhet nga personi duke vepruar me qëllim të caktuar të përmendur më parë, pas kryerjes së veprimit nga ana e personit, vepra penale është kryer. Gjukata thekson se në disa raste është vendosur se në qoftë se një migrant nuk lejohet të hyjë në vendin tranzit ose vendin e destinacionit të fundit, atëherë vepra penale konsiderohet vetëm si tentativë<sup>145</sup>. Megjithatë, pas asaj që sapo u tha, trupi gjykues është i mendimit se ligji nuk fajëson vetëm kontrabandën e suksesshme, ligji fajëson çdo përfshirje, prokurimin ose çdo veprim me qëllimin e përmendur, “me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një dobie financiare ose të një dobie tjetër pasurore, nga hyrja e paligjshme e personit në Kosovë, ku personi në fjalë nuk është banor i Kosovës, apo në shtetin në të cilin personi i tillë nuk është banor i përhershëm apo shtetas i atij shteti”.

Çfarë duket të jetë e rëndësishme është dashja (e veprimit) edhe e personit dhe e migrantit të kontrabanduar, pa marrë parasysh veprimet ose mosveprimet e personave apo subjekteve të tretë (apo ndonjë fakt apo arsye tjetër se pse hyrja nuk është arritur) pasi këto veprime ose mosveprime tashmë janë krejtësisht jashtë kontrollit edhe të kontrabanduesit dhe të kontrabanduarve (edhe pse ndonjëherë përfshirja apo prokurimi mund të kërkojnë që të ketë

---

<sup>144</sup> Komentari, 2 në lidhje me paragrafin 1

<sup>145</sup> Për shembull, Gjukata Themelore Gjilan, PKR 56/13, datë 05 dhjetor 2013, konfirmuar me vendimin e Gjukatës së Apelit PAKR 259/14 datë 22 maj 2015.

kontroll të plotë të të gjitha ngjarjeve të mundshme përgjatë gjithë procesit duke çuar në një rezultat të suksesshëm ... për shembull, dhënia e ryshfetit ndonjë zyrtari në pikën kufitare të kontrollit të pasaportave në mos kryerjen e detyrave apo në shkeljen e tyre).

### **Tentativa vs. përpjekja**

Kjo çështje është e lidhur me konceptet doktrinale të tentativës në lidhje me llojin e veprës penale, duke qenë se është gjithashtu e diskutueshme nëse është e mundur që të ketë një tentativë për një veprë penale të konsideruar formale në kuptimin e shpjeguar më lartë (dhe në shumë pak raste konsiderohet të jetë e mundur, shembulli klasik është shtrëngimi në tentativë).

Në këtë çështje, është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se ligjvënësi iu ka referuar në mënyrë specifike “tentativës”, në nenin 138, par. 4, të KPPK-së (neni 170, par. 4, të KPRK-së), por e ka bërë këtë në lidhje me veprimet e përshkruara në paragrafin 3 (në të dy versionet) sipas mjeteve të parashikuara në paragrafin 2 (në të dy versionet) - në lidhje me prodhimin, prokurimin, sigurimin, posedim të dokumentit të rrejshëm të udhëtimit apo identifikimit - dhe kjo referencë konsiderohet të jetë në favor të asaj që po themi, pasi ndryshe veprimet e tilla mund të konsiderohen vetëm si veprime përgatitore (në kuptimin e përmendur në nenin 26, par. 1, të KPPK-së ose ashtu si tani rregullohet në mënyrë të plotë në kodin e ri penal sipas nenit 27, paragrafi 1, të KPRK-së)<sup>146</sup>, veprime të cilat *iter criminis* janë përpara veprimeve të vetë kryerjes dhe, pasi kodi i ri e ka bërë të qartë, janë të dënueshme vetëm nëse parashihet shprehimisht me ligj (neni 27, par. 1, të KPRK-së).

Nëse referimi lidhur me tentativën e dënueshme në paragrafin 4 nuk ishte bërë, mjetet e parashikuara në paragrafin 2 të përmendura në paragrafin 3 dhe 4 të veprës penale të kontrabandimit me migrantë (në të dy versionet), mund të konsideroheshin si jo të dënueshme për të qenë e mundur për t’u kuptuar se ato do të bien vetëm në kategorinë e akteve përgatitore (të plota) - sipas nenit 27, paragrafit 2 të KPRK-së.: “(...) përgatitja e veprës penale përfshin furnizimin ose aftësimin e mjeteve për kryerjen e veprës penale (...)”.

Arsyet që përcaktojnë këtë lloj të veprës penale dhe aktgjykimin meritor që kryesi e meriton, ose që mund të kryhet me veprimin e tij ose të saj, janë të njëjta, pavarësisht nga veprimi i personit të tretë, hyrja e suksesshme e paligjshme nuk ndodh (edhe në rastin kur ka ndodhur ndonjë ryshfet ndaj një zyrtari kufitar dhe për shkak të ndryshimit operacional në minutën e fundit përtej kontrollit të atij zyrtari të caktuar, zyrtari përgjegjës zëvendësohet dhe behet vlerësimi i dokumentacionit të migrantit dhe i kërkesave ligjore për të hyrë në një shtet, duke çuar në ndalimin e hyrjes).

---

<sup>146</sup> Për sa i përket veprimeve përgatitore, shih edhe Komentarin, pikën 1 në lidhje me paragrafin 2, “për shkak të rrezikut të lartë dhe mbi baza kriminale politike, në mënyrë që të ndërhyjë në ligjin penal në një fazë më të hershme të kryerjes së kësaj vepre, paragrafi 2 i këtij neni gjithashtu inkriminon veprimet përgatitore të cilat janë ndërmarrë me qëllim të kryerjes së veprës së kontrabandës me migrantë”.

Nuk ka asnjë arsye për të vlerësuar ndryshe, nga pikëpamja penale, veprimet e ndërmarrë në të dyja rastet, varësisht prej faktit nëse hyrja ka ndodhur apo jo<sup>147</sup>: dëmi i vlerave juridike të mbrojtura tashmë është shkaktuar<sup>148</sup>. Në të vërtetë, pasi u tha kjo, do të jetë e vështirë për të shpjeguar se si autori (ose ndryshe “kryesi në tentativë”) do të meritonte një dënim më të butë dhe më të zbutur, pasi sipas rregullit të përgjithshëm mbi sanksionimin e tentativës, dënimi mund të jetë “më i butë” (neni 20, par. 3, të KPPK-së) ose “i zbutur” (neni 28, par. 3, të KPRK-së).

Kur prokuroria, në këtë drejtim, e cilëson veprimin si një tentativë, kjo nuk përbën pengesë juridike në kuptimin e trupit gjykues pasi “Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës” - neni 360, par. 2, të KPP-së.

Aspekti tjetër që meriton vëmendje është numri i veprave penale që janë kryer.

### **Numri i veprave penale, bashkimi i veprave penale dhe veprat penale në vazhdim**

Në aktgjykimet e ndryshme ekzistojnë vendime të ndryshme sa i përket mënyrës së përcaktimit të veprave penale; për shembull, në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. 244/10, të datës 17 qershor 2011, në f. 65 (versioni në gjuhën angleze) mund të lexohet: “(...) për secilin migrant të kontrabanduar për veprat penale të kontrabandimit me migrantë në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 138, paragrafin 6 dhe nenin 23 të KPK-së (kontrabandimi i secilit migrant përfshin kryerjen e një vepre penale në kundërshtim të nenit 138, paragrafi 6, të KPK-së, pra i pandehuri i lartpërmendur ka kryer pesë vepra penale në kundërshtim të nenit 138, paragrafit 6 të KPK-së”, ndërsa në aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR 56/13, të datës 05 dhjetor 2013, ishte konsideruar (duke iu referuar 3 migrantëve që nuk kishin arritur në destinacionin final) se të pandehurit kishin kryer “(...) ku kanë kryer veprën penale të kontrabandimit me migrantë në tentativë sipas nenit 170 paragrafit 1 të KPRK-së (...)”<sup>149</sup>.

Gjykata nuk sheh arsye për të devijuar nga rregullat e përgjithshme mbi teorinë e veprës penale, sipas të cilës numri i veprave penale përcaktohet nga numri i vendimeve kriminale, numri i vendimeve kriminale të kryera nga kryesit, të cilat mund të çojnë në situata të bashkimit homogjen (pasi veprat penale janë të të njëjtit lloj) të veprave penale, për shkak të bashkimit

---

<sup>147</sup> Gjithashtu, në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. 244/10, të datës 17 qershor 2011, f. 60 (versioni në gjuhën angleze), trupi gjykues ishte i mendimit të ngjashëm: “(...) në fakt, në mënyrë që vepra penale të konsiderohet e përfunduar, është e mjaftueshme që migranti të kalon kufirin, edhe pse nuk arrin në shtetin tjetër” - trupi gjykues iu ka adresuar faktit se migrantët tashmë ishin larguar nga një shtet pa u futur ende në tjetrin, pasi ata vdiqën para se të arrinin kufirin.

<sup>148</sup> Kjo çështje po ashtu ndërlidhet me konceptet e ndryshme mbi heqjen dorë nga kryerja e veprës penale, nëse rezultati kur ligji nuk kërkon të ndodh është shmangur për shkak të faktit se kryesi ka ndaluar kryerjen, *iter criminis*, ka hequr dorë prej planifikimit në kohë për të shmangur rezultatin apo nëse rezultati nuk ka ndodhur për shkak se plani ka përfunduar me dështim për një arsye të jashtme. Në lidhje me këto çështje specifike, shih nenet 21 dhe 22 të KPPK-së dhe nenet 29 dhe 30 të KPRK-së, përkatësisht lidhur me tentativën e papërshtatshme dhe heqjen dorë vullnetare nga tentativa.

<sup>149</sup> Shih f. 3 të aktgjykimin në fjalë, versioni në gjuhën angleze.

real<sup>150</sup> (nga pikëpamja natyraliste), duke përsëritur veprën penale me kalimin e kohës, në kohë të ndryshme.

Sipas kësaj, në qoftë se kryesi në ndonjë rast, në bazë të një vendimi ka kontrabanduar 1 person apo 3 persona, në të dyja rastet do të ketë kryer një veprë penale, pa marrë parasysh se në rastin e dytë, numri i personave të kontrabanduar mund të merret parasysh për qëllime të tjera, si në vlerësimin e intensitetit të *mens rea*, peshën e veprës penale dhe, në një fazë të mëvonshme, do të jetë relevante në përcaktimin e dënimit; nëse pas kësaj kryerje të parë, kemi të bëjmë me një vendim të ri kriminal dhe personi e kryen përsëri veprën penale, atëherë do të ketë 2 vepra penale në vazhdim (ose në qoftë se plotësohen kushtet, njëra në vazhdim).

Çështja e mëparshme shpjen tek një problem tjetër, për mënyrën e shqyrtimit të dënimit të bashkimit të veprave penale.

Në fakt, ajo çfarë mund të trajtohet si bashkim i veprave penale mund të jetë po ashtu objekt i institutit ligjor të veprës penale në vazhdim, siç tani parashikohet shprehimisht në nenin 81 të KPRK-së.

Sipas nenit 81 të KPRK-së, “vepra penale në vazhdim përbëhet nga disa vepra të njëjta ose të ngjashme të kryera në lidhshmëri kohore nga i njëjti kryes, dhe të cilat paraqesin tërësi për shkak të ekzistimit të së paku prej dy (2) kushteve në vijim: 1.1 viktimës së njëjtë të veprës penale; 1.2 objekt i njëjtë i veprës penale; 1.3 shfrytëzimi i situatës apo marrëdhënies së njëjtë kohore; 1.4 vendi apo hapësira e njëjtë e kryerjes së veprës penale, apo 1.5 dashja e njëjtë e kryesit”.

Qasja e përgjithshme doktrinale lidhur me bashkimin e veprave penale qëndron në atë se, si rregull, numri i veprave penale korrespondon me numrin e veprave penale të kryera, përjashtim është kur veprat e shumta (të paktën dy) janë kryer në mënyrën që përputhet me kushtet përcaktuara në ligj, kur mënyra e kryerjes është identike, gjendja e përgjithshme ose korniza është faktikisht e njëjtë, në atë mënyrë që është e mundur të pohohet se faji i kryesit është zvogëluar ndjeshëm. Për të vlerësuar zvogëlimin e fajit, kushtet e përcaktuara në ligj shfrytëzohen; me pak fjalë, vepra penale në vazhdim ekziston vetëm kur ndaj personit (kryesit) mund të merret vetëm një aktgjykim fajësues, jo më shumë.

Arsyeja pse dënimi më i butë në veprat penale në bashkim të përcaktuara sipas ligjit është që të sigurojë gjykatën me mjetet ligjore për ta lejuar që kjo të jetë vetëm në aspektin e zvogëlimit të fajit, kjo nuk shërben për t’i ofruar kryesit një zbritje për kryerjen e më shumë se një veprë penale.

---

<sup>150</sup> Në kundërshtim me bashkimin ideal, kur veprimi i njëjtë (nga pikëpamja natyraliste) është i mjaftueshëm që të materializoj vepra të ndryshme penale (e cila, si pasojë, mund të jetë homogjene ose heterogjene, varësisht nëse bëhet fjalë për të njëjtin lloj të veprës penale apo ndonjë tjetër).

Nëse kushtet janë plotësuar, bashkimi i veprave penale duhet të merret parasysh nën ombrellën e dënimit të veprës penale në vazhdim, si rregull specifike duhet të mbizotërojë atë të përgjithshmen mbi dënimin e bashkimit të veprave penale. Kjo është e lidhur me faktin se ndërsa kodi i ri penal ka një dispozitë për dënimin e bashkimit të veprave penale, neni 80 të KPRK-së, dhe dënimin e veprave penale në vijim, neni 81 të KPRK-së, Kodi i Përkohshëm Penal vetëm ka parashikuar dënimin e bashkimit të veprave penale, në nenin 71 (paragrafin 1 thuhet “nëse kryesi, me një apo me më shumë veprime kryen disa vepra penale për të cilat gjykohej në të njëjtën kohë, gjykata së pari shpallë dënime për secilën nga këto vepra, e pastaj për të gjitha këto vepra e shqipton dënimin unik”) dhe kjo ka pasoja, pasi është në të mirën, ose është më e favorshme për të pandehurin që të dënohet me një vepër penale në vazhdim sesa sipas rregullave që rregullojnë dënimin e bashkimit të veprave penale *tout court*. Përjashtim për këtë pohim bëjnë, për shembull, rastet kur jo vetëm afatet e burgimit janë ndryshuar dhe janë ngritur, ose nëse për shembull, në ligjin e mëvonshëm ka sanksionim të ri, si gjobë kumulative së bashku me burgimin.

Në rastin tonë të pandehurit për kryerjen e disa kontrabandimeve të njëjta ose të ngjashme të migrantëve (me, të paktën, dy vendime kriminale<sup>151</sup>, kjo vlerësuar po ashtu nga datat e veprimeve të tyre – të cilat në rastin e A.Ç.-es, M.B.t, A.M., M.A., A.B. dhe T.Y.<sup>152</sup>), në vendin e njëjtë (apo territorin, si në Kosovë), duke përfutur nga situata e njëjtë (njohuria praktike, *modus operandi*, fluksi i personave në nevojë të gatshëm për t’u kontrabanduar), me dashje të njëjtë, ne mund të konsiderojmë se kemi kërkesat e përcaktuara në ligj për veprën penale në vazhdim: dashja e njëjtë (specifike) siç përcaktohet në përshkrimin e veprës penale dhe në nën-paragrafin 1.5 të nenit në fjalë, 81 të KPRK-së, duke vepruar në vendin apo hapësirën e njëjtë të kryerjes së veprës penale (kërkesë e përcaktuar në paragrafin 1.4) dhe po ashtu të asaj që gjendet në paragrafin 1.3, shfrytëzimi i situatës së njëjtë, kjo nuk do të thotë se në një situatë të tillë veprat penale kanë të njëjtin objekt siç përmendët në paragrafin 1.2 (pasi 1.1. ka të bëjë me “viktimën” e veprës penale). Natyrisht, në asnjë mënyrë kjo nuk nënkupton që ligji më pak i favorshëm mund të zbatohet, pasi saktësisht qëndron rregulli se ligji në fuqi në kohën e fakteve është i zbatueshëm, përveç nëse ligji i ri është më i favorshëm.

Së fundi, duke pasur parasysh atë që u tha më herët në lidhje me vlerën juridike të mbrojtur në këtë vepër penale dhe pozicionimin sistematik të kësaj vepre penale në kodin penal (neni 138 të KPPK-së, në kapitullin XIV, veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare dhe aktualisht në nenin 170 të KPK-së, në kapitullin XV, veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare), vepra penale e kontrabandimit me migrantë nuk

---

<sup>151</sup> Sipas fakteve të vërtetuara A.Ç. ka marrë pjesë në kontrabandimin e 79 personave, M.B. dhe A.M. në kontrabandimin e 11 personave, M.A. në kontrabandimin e 2 personave, A.B. në kontrabandimin e 3 personave dhe T.Y. në kontrabandimin e 2 personave.

<sup>152</sup> Nga pikëpamja natyraliste, në lidhje me dy të pandehur është e mundur të vërtetohet vetëm një vendim kriminal: për A.G.n më 17 (plotësuar më 22) gusht 2012, në lidhje me një person, dhe për I.P.-n, po ashtu edhe një vendim kriminal, më 9 nëntor 2012, në lidhje me tre persona.



mund të konsiderohet si vepër penale e kryer ndaj personalitetit<sup>153</sup> për qëllimet e nenit 81, par. 2, të KPRK-së.

Aspekti tjetër që vlen të përmendet është elementi “duke vepruar si anëtar i grupit” (që gjendet në nenin 138, par. 6, të KPPK-së ose në nenin 170, par. 6, KPRK-së), pasi në kodin e përkohshëm nuk kishte përkufizim të “grupit” në asnjë nen<sup>154</sup>, duke përfshirë nenin 107 të KPPK-së, në lidhje me përkufizimet, ndërsa “grupi” aktualisht përkufizohet në nenin 120, par. 12, të KPRK-së. “grup njerëzish - tre (3) ose më shumë persona” dhe, për këtë arsye, koncepti ishte në një farë mase i prekshëm për interpretim, pavarësisht se duket të jetë mjaft i logjikshëm për t’u marrë parasysh edhe në bazë të kodit të përkohshëm një “grup” është dashur të jetë më shumë se thjesht “një palë” - një “palë” është 2 prej një lloji, sipas definicionit.

### **Elementi “hyrje e paligjshme”**

Një nga elementet përbërëse të veprës penale, në të dyja versionet (pavarësisht disa dallimeve në formulim, siç tashmë u përmend, pikërisht në lidhje me fjalët “në mënyrë që të” dhe “dashja”), është “hyrje e paligjshme”, ashtu si neni 138, paragrafët 7.1 dhe 2, të KPPK-së dhe neni 170, paragrafi 8.1 dhe 8.2 të KPRK-së, e përcaktojnë “kontrabandimin me migrantë” dhe “hyrjen e paligjshme” si “kontrabandimi me migrantë nënkupton veprimin, me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejt ose të tërthortë, të një dobie financiare ose dobie tjetër pasurore nga hyrja e paligjshme e personit në Kosovë, ku personi në fjalë nuk është shtetas i Kosovës, ose në shtetin në të cilin personi në fjalë nuk është shtetas apo banor i përhershëm i Kosovës” dhe “hyrje e paligjshme” nënkupton kalimin e kufirit apo vijës kufitare të Kosovës, pa i përfillur kushtet e domosdoshme për hyrjen të ligjshme në Kosovë ose kalim i kufijve të ndonjë shteti pa i përfillur kushtet e domosdoshme për hyrjen e ligjshme në atë shtet”.

Thënë shkurtimisht, “kontrabandimi me migrantë” është prokurim me qëllim (në fakt nuk është e nevojshme që në fund kryesi ta siguron atë) të përfitimit (të drejtpërdrejt ose të tërthortë) të një dobie financiare ose dobie tjetër pasurore nga hyrja e paligjshme e personit në Kosovë apo kalimit të kufijve të shtetit tjetër (pa i përfillur kushtet e domosdoshme për hyrjen të ligjshme).

Afati kohor i mbuluar nga pikat e akuzës shtrihet nga data 25 qershor 2011 deri më 2 dhjetor 2012 (4 dhjetor, në rastin e pikës së akuzës 8), dhe rrjedhimisht është e rëndësishme të dihen se çfarë ishin dispozitat përkatëse ligjore në fuqi në atë kohë që rregullojnë hyrjen, lëvizjen (dhe “lëvizja” është e rëndësishme për personat që hyjnë në Kosovë si vend tranzit, që nënkupton se nuk është destinacioni final i personit, pasi ligji gjithashtu përcakton kërkesat për personat që

---

<sup>153</sup> Pavarësisht se mund të thuhet se personaliteti i pambrojtur i dikujt gjithmonë dëmtohet kur shihet si objekt i veprës penale..

<sup>154</sup> Vetëm nga “grupi terrorist”, në nenin 109, par. 5, “grup i strukturuar prej më shumë se dy persona, i themeluar gjatë një periudhe kohore dhe i cili vepron në bashkëpunim për kryerjen e terrorizmit” dhe në nenin 274, paragrafin 4, mbi krimin e organizuar, në përcaktimin e termit “grup i strukturuar”, “Termi grup i strukturuar “do të thotë një grup prej tre ose më shumë personave, i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e atypëratyshme të ndonjë veprë penale dhe nuk do të thotë formalisht t’i ketë të përkufizuara rolet për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë së tij apo strukturën e zhvilluar”.

gjenden në Kosovë në tranzit për vendet e tjera) dhe qëndrimin e të huajve në Republikën e Kosovës ose të kalimit të kufijve të shtetit tjetër, kështu që mund të vlerësohet nëse hyrjet/kalimet kufitare të migrantëve ishin të paligjshme.

Ligji për të Huajt (në secilin version), në nenin 1 përcakton qëllimin e tij, “me këtë ligj rregullohet hyrja, lëvizja dhe qëndrimi i të huajve në Republikën e Kosovës”.

Në vitin 2008, është shpallur Ligji Nr. 03/L-126 Ligji, datë 16 dhjetor 2008, publikuar në Gazetën Zyrtare më 10/08/2009 dhe në pajtim me nenin 98 ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës: Ligji ka hyrë në fuqi më 25/08/2009. Prandaj, ky është ligji i cili përcakton kërkesat për migrantët që kanë arritur në mes të datave 25/06/2011 dhe 26/01/2012.

Në vitin 2011, është shpallur Ligji Nr. 04/L-069 Ligji, datë 21 dhjetor 2011, publikuar në Gazetën Zyrtare më 12/01/2012 dhe në pajtim me nenin 99, ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës: Ligji ka hyrë në fuqi më 27/01/2012. Prandaj ky është ligji i cili përcakton kërkesat për migrantët që kanë arritur në mes të datave 27/01/2012 dhe 04/12/2012<sup>155</sup>.

Dispozitat më të rëndësishme të përfshira në Ligjin Nr. 03/L-126 2008, përbëhen nga nenet 2 (domethënë për të huajt, pasi ata që nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës - dhe emrat në aktakuzë janë të huaj...), nenet 7 dhe 25 mbi detyrat e transportuesve (1. Transportuesi mund ta sjell të huajin në piken e kalimit kufitar nëse i plotëson kushtet e nenit 4 të këtij ligji) - dhe kjo është arsyeja pse vendet e tranzitit janë të rëndësishme, pasi migranti mund të ketë të drejtë për të hyrë në një vend tranzit si Kosova, por jo destinacioni final, arsyeja se perse migrantët nuk fluturojnë direkt për në destinacionin e vërtetë, është sepse ata nuk plotësojnë kërkesat ligjore të aplikueshme atje, domethënë Vizën ... , neni 26 mbi hyrjen në Kosovë (1. i huaji ka hyrë në Republikën e Kosovës, kur ai/ajo ka kaluar kufirin shtetëror), dhe disa të tjerë.

Nga të gjitha këto nene, disa do të adresohen: Neni 29 (ndalesa për hyrje), thotë se “Hyrja në Kosovë nuk i lejohet të huajit nëse ai/ajo: 1.1 nuk i plotëson kushtet nga neni 4 të këtij ligji; 1.2 nuk posedon mjete të mjaftueshme për jetesë gjatë kohës së qëndrimit të tij/saj në Republikën e Kosovës dhe për të udhëtuar në një shtet tjetër të gatshëm për të pranuar atë; 1.3. është në transit dhe nuk i plotëson kushtet për hyrje në shtetin e tretë” dhe ky nen shpjegon rëndësinë e të ashtuquajturës “letër e garancisë” dhe “ftesë”, pasi dikush mund të lirohet nga viza për të hyrë në Republikën e Kosovës<sup>156</sup> dhe përsëri mund të mos lejohet për të hyrë për mos posedim të

---

<sup>155</sup> Ndërkohë, Ligji i ri ishte shpallur, Ligji Nr. 04/L-219, datë 31 korrik 2013, publikuar në Gazetën Zyrtare më 05/09/2013 dhe në pajtim me nenin e tij 138 është në fuqi që nga data 24/09/2013.

<sup>156</sup> Shtetasit turq, për dallim nga shtetasit sirian, nuk kanë nevojë për vizë për të hyrë në Kosovë për një periudhë deri në 90 ditë (shih faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës, <http://www.mfa-ks.net/?page=2,157>). Gjithashtu shtetasit turq nuk kanë nevojë për vizë për të udhëtuar në shumë vende, përfshirë vendet fqinje të Kosovës: Shqipëri (për 90 ditë), Bosnje dhe Hercegovinë (90 ditë), Maqedoni (60 ditë), Mali i Zi (90 ditë) dhe Serbi (60 ditë) – shih [https://en.wikipedia.org/wiki/Visa\\_requirements\\_for\\_Turkish\\_citizens](https://en.wikipedia.org/wiki/Visa_requirements_for_Turkish_citizens). Nuk është e nevojshme.

mjeteve të mjaftueshme, ose të lirohet nga viza për të hyrë në shtetin në qoftë se është destinacioni final, por mund të mos lejohet të hyjë në shtetin, nëse është në tranzit, për mos plotësimin e kushteve për të hyrë në shtetin e destinacionit, domethënë, një vizë për atë shtet.

Një tjetër nen shumë i rëndësishëm është neni 30, pasi e shpjegon pse një hyrje në dukje e ligjshme bëhet e paligjshme, përkatësisht nëse lexohet së bashku me atë që sapo u tha në lidhje me nenin 29. Në të vërtetë, neni 30 parashikon si më poshtë: “kalim ilegal i kufirit, 1. Me kalimin ilegal të kufirit shtetëror kuptohet nëse i huaji: 1.1. tenton të kalon kufirin shtetëror jashtë pikës së kalimit kufitar shtetëror ose pikës kufitare të shtetit, ndërsa është e mbyllur; 1.2. shmanget apo tenton t’i shmanget kontrollit kufitar; 1.3. përdor një dokument të pavlefshëm të udhëtimit, dokumentin e udhëtimit të personit tjetër, ose ndonjë dokument tjetër të pavlefshëm gjatë kalimit të kufirit; 1.4. **i jep të dhëna të rreme zyrtarëve të autorizuar për kontrollin e kalimit të kufirit shtetëror për të lehtësuar hyrjen e paligjshme të tij/saj [theksimi i shtuar];** 1.5. hyn në Republikën e Kosovës, derisa urdhri për depërtim me ndalesë për ri-hyrje është në fuqi ndaj tij/saj”.

Sipas nenit 30 par. 1.4., çdo hyrje bazuar në një deklaratë apo të dhëna të rreme është e mjaftueshme për ta bërë atë të paligjshme<sup>157</sup>. Kjo qëndron nëse dikush dyshohet se udhëton për në Kosovë, si destinacion përfundimtar, pavarësisht nevojës për vizë apo jo, jep informacione të rreme në lidhje me mjetet, punësimin, ftesën, ose çdo të dhënë tjetër të ngjashme; e njëjta gjë ndodh, *a fortiori*, kur personi pretendon të vijë në Kosovë si destinacion përfundimtar, kur në fakt është duke e përdorur thjesht si një pikë tranziti, asgjë më tepër se një vend përgjatë udhëtimit drejt një shteti ku viza do të jetë e nevojshme për të hyrë në mënyrë të ligjshme, përkatësisht në vendet e zonës Schengen<sup>158</sup>. Në të dy rastet e përmendura, hyrjet janë të paligjshme, që është e mjaftueshme për konceptin e kontrabandimit me migrantë, “(...) nga hyrja e paligjshme e personit (...)”.

Prandaj, esenca e kësaj është se personi i cili përfshihet është në dijeni për falsitetin e situatës, është në dijeni të planin e hyrjes në Kosovë duke përdorur të dhëna të rreme (që përfshin shembujt e dhënë më lartë), dhe kjo është edhe arsyeja pse migrantët janë të gatshëm për të paguar, kjo është për shkak se, në radhë të parë, ata kanë nevojë për ndihmë (ose besojnë se kanë nevojë për ndihmë, ose mendojnë se ajo që ata do të marrin është e dobishme) duke e ditur se çfarë është në gjendje të krijojë një iluzion, një shtrembërim i realitetit (për shembull, çfarë t’u

---

<sup>157</sup> Në lidhje me nenin 7 (respektimi i ligjit, është e rëndësishme nëse personi është duke përdorur Kosovën si vend tranzit, pavarësisht mos deklarimit të kësaj dhe kështu duke siguruar deklarata të rreme, sepse për udhëtarët në transit zbatohen kushte të tjera, përkatësisht nenet 15, 16, 18 për vizat tranzite (3. I huaji mund të qëndrojë në Republikën e Kosovës për jo më shumë se pesë ditë në bazë të vizës tranzite. 4. viza tranzite i lëshohet vetëm të huajit i cili mund të argumentojë se atij/asaj i lejohet hyrja në shtetin e destinimit) për ata të cilët janë në tranzit, pasi për ata që kanë Kosovën si destinacion ose që janë të liruar nga vizat ose duhet të ketë një vizë hyrëse, në përputhje me nenin 17, 19 vizat e tranzitit-ajror (1. I huaji i cili gjatë tranzitit-ajror në Republikën e Kosovës, nuk e lëshon hapësirën tranzite-ajrore nuk i kërkohet viza.).

<sup>158</sup> Që nga data 12 dhjetor 2008 përfshin të gjitha vendet e BE-së përveç Mbretërisë së Bashkuar, Rumanisë, Bullgarisë dhe Qipros (pavarësisht se të gjitha tani janë anëtare të BE-së, ato nuk i janë bashkuar ende zonës Schengen) dhe Norvegjia, Islanda dhe Zvicra – shih [https://en.wikipedia.org/wiki/Schengen\\_Area](https://en.wikipedia.org/wiki/Schengen_Area).

thuhet zyrtarëve, “se udhëtoj si turist”, “se udhëtoj si i ftuar”, “udhëtoj si punëtor me letër garancion ose kinse me ndonjë kontratë, etj.), çfarë të thuhet dhe çfarë të mos thuhet; ata paguajnë edhe për informimin dhe organizimin e udhëtimit në vijim për në destinacionin përfundimtar, etapa e udhëtimit duke filluar në Kosovë (ku duhet qëndruar, kur dhe si duhet udhëtuar, duke përfshirë mjetet e transportit dhe itinerarin; ndonjëherë rregullohet edhe strehimi dhe udhëtimi i mëtutjeshëm, duke përfshirë transportuesit).

Këto vështirësi me të cilat ballafaqohen të gjithë ata të cilët migrojnë, të gatshëm për të hyrë në një shtet në mënyrë të paligjshme, e konkretizojnë faktin se ata ishin të cenueshëm për të cilën biseduam më parë. Nga ana tjetër, nga pikëpamja e kryerësit, fakti i të qenit i cenueshëm dhe “nevoja për ndihmë”, krijojnë situatën për kryerjen e veprës penale: pavarësisht se nuk është ndonjë agjent turizmi apo punëtor i agjencisë turistike, duke mos punuar për asnjë entitet i cili ofron ndihmë në mënyrë të ligjshme për udhëtarët, dhe me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore nga hyrja e paligjshme e dikujt në Kosovë (ose/dhe në shtete tjera) prokurojnë (“prokuroj” duke qenë sinonim i shprehjes “për t’u realizuar në çdo mënyrë”, duke mbuluar çfarëdo veprimi të pjesëmarrjes), përfshihen, kryejnë çfarëdo veprimi të përshtatshëm për të mundësuar qëllimin e migrantit: që të migrojnë ilegalisht madje edhe duke u kontrabanduar - siç u tha më parë, kjo veprë penale kërkon pëlqimin e objektit, të “viktimës”.

Kjo e shpjegon arsyen se perse nuk qëndrojnë disa argumente<sup>159</sup> të përdorura nga të pandehurit për të mohuar akuzat e kontrabandimit, për shembull:

a) Ekzistenca e marrëdhënies familjare (çdo lloj lidhjeje) në mes të kryerësit dhe migrantit: kjo situatë nuk përbën ndonjë përjashtim për kushtet për hyrje të ligjshme, sipas Ligjit për të Huajt; ky fakt mund të jetë i rëndësishëm, për shembull, dhe në qoftë se vërtetohet, si rrethanë lehtësuese, jo më shumë se kaq.

b) Duke mos qenë zyrtari i cili ka lejuar hyrjen: kjo nuk ka asgjë të bëjë me objektin e inkriminimit përfshirë në veprën penale të kontrabandimit më migrantë, pasi zyrtar kufitar mundet të gjendet vetëm në dy situata: ose është në dijeni ose jo se hyrja e atij personi është e paligjshme. Nëse është në dijeni, atëherë zyrtari është bashkë kryes, të paktën bashkëpunëtor; nëse nuk është në dijeni, zyrtari nuk është përgjegjës (për sa kohë që detyrimet janë kryer në mënyrë të rregullt, pra duke kontrolluar kushtet pas mbërritjes, pas hyrjes) dhe kjo është arsyeja pse sigurimi i të dhënave të rreme, informacionit, për zyrtarin kufitar, e bën hyrjen, *de per se*, të paligjshme, siç është shpjeguar.

c) Nëse shtetasi nuk ka nevojë për vizë për të hyrë në një shtet, nuk mund të kontrabandohet: kjo është gabim për shkak se të qenit në posedim të një vize nuk është i vetmi kusht bazuar në Ligjin për të Huajt, siç është shpjeguar. Të qenit qytetar i një shteti ndaj të cilit

---

<sup>159</sup> Siç u tha në arsyetimin e fakteve, në lidhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, gjykata nuk ka nevojë të trajtojë secilin argument të vetëm të ngritur në procedurë; Megjithatë, pasi të pandehurit këmbëngulin në këtë lloj të argumenteve (e që është në përputhje me mungesën totale për të shprehur keqardhje apo pendim nga ana a tyre), atëherë gjykata do t’i trajtojë ato).

nuk zbatohet kërkesa për vizë, nuk e liron personin nga përfillja e kushteve tjera ekzistuese ligjore, ku përfshihet vetëm dhënia e informacionit të vërtetë, qoftë nëse shteti është shtet transit apo destinacionin final dhe nëse është final, informacioni në lidhje me kushtet e zbatueshme sa i përket mjeteve për të mbijetuar, qëllimin e udhëtimit, etj.

d) Vetëm për të marrë pjesë në diçka, që në mënyrë të izoluar nuk do të ishte veprë penale, të tilla si marrja e dikujt në aeroport ose bërja e një rezervimi përmes internetit ose dërgimi, përcjellja e një bilete elektronike (ose skanimi i saj), një taksist duke vozitur një taksë dhe pasagjerët: pavarësisht se disa fakte dhe pretendime janë vetë-shpjeguese (përfshirë deri në çfarë mase gjykata është e nevojshme për t'i hedhur poshtë ato) përsëri është e qartë se dijenia, qëllimi dhe konteksti janë faktorët kyç për të vërtetuar dallimin; në qoftë se veprime ndodhin në kuadër të kryerjes të veprës penale të kontrabandës me migrantë, atëherë, për aq kohë sa janë përmbushur kushtet e tjera, ato bien në kategorinë e (disi) të përfshirjes në kontrabandë: është prokurim, është “çdo veprim” siç përcaktohet në ligj.

Përsëri, ajo që ka rëndësi është gatishmëria për mashtrim të ligjit, dhe se gatishmëria vlerësohet nga faktet, por në fund të fundit është një çështje se në çfarë beson gjykata, kjo është një çështje e bindjes - për aq kohë sa gjykata, kuptohet, ta arsyetoj atë. Për të krijuar një pamje të një realiteti të ligjshëm dhe realitet i ligjshëm janë pa dyshim dy gjëra të ndryshme...

Së fundi, në nenin 32 (mbi) largimin nga Republika e Kosovës, thuhet se nuk i lejohet të huajit nëse: “2.1 paraqet dokument të pavlefshëm të udhëtimit, dokumentin e udhëtimit të personit tjetër, ose ndonjë dokument tjetër të pavlefshëm; 2.2 nuk i plotëson kushtet për hyrje në shtetin tjetër” - dhe kjo është arsyeja pse është e rëndësishme të bëhet e qartë në kufi (pas mbërritjes në shtetin e parë), nëse Kosova është destinacioni përfundimtar ose një vend transit (sepse në rastin e aeroportit tranzit, pasagjerët nuk shkojnë përmes kufijve nëse shkojnë përmes linjës jo direkte ose nëse kalojnë nëpër kufirit pastaj në qoftë se deklarohet se hyrja është si vend tranzit, duhet plotësuar kushtet për destinacionin përfundimtar) dhe ata që hyjnë në kufi duhet të qëndrojnë në atë shtet, vetëm nëse ata plotësojnë kushtet për të dalë (për shembull, një shtetas turk nuk mund të largohet nga Kosova, nëse udhëton në një shtet ku kërkohet viza).

Shumë nene të tjera mbi qëndrimin e përkohshëm, qëndrimin e përhershëm dhe qëndrimin e paligjshëm mund të përmendën, por për qëllimin e parashikuar të tanishëm nuk janë të nevojshme.

Pas shqyrtimit të Ligjit Nr. 03/L-126, datë 16 dhjetor 2008 (duke përcaktuar kushtet për migrantët që arrijnë ndërmjet datave 25/06/2011 dhe 26/01/2012), është e rëndësishme të thuhet se Ligji Nr. 04/L-069, datë 21 dhjetor 2011 (duke përcaktuar kushtet për migrantët që arrijnë ndërmjet datave 27/01/2012 dhe 04/12/2012), se me nenin 97 shfuqizohet Ligji 03/L-126, dhe kjo nuk ka ndryshuar asnjë nga aspektet e përmendura në lidhje me paraardhësit e tij, vetëm numri i neneve dhe paragrafëve, në disa raste, janë ndryshuar, për shembull, dhënia e të dhënave

të rreme ose informacionit për hyrje të paligjshme: neni 30, par. 1.4 të Ligjit Nr. 03/L-126 është bërë neni 32, par. 1.5 të Ligjit Nr. 04/L-069.

### **Natyra e ftesës dhe letër-garancisë**

Së fundi, është koha për t'u përqendruar në atë që mund të konsiderohet, apo jo, si "dokument i rrejshëm i udhëtimit apo identifikimit", pikërisht për shkak të letër garancisë, ose ftesës të diskutuara në procedurën gjyqësore, duke pasur parasysh, se vepra penale kryhet nga kushdo që përfshihet ose prokuron, kryen çfarëdo veprimi në kontrabandimin e migrantëve.

Dispozitat më të rëndësishme gjinden në ligjin Nr. 03/L-126 2008, janë nenet që kanë të bëjnë me atë që mund të konsiderohet si "dokumenti i udhëtimit": 3, 4, 5 (konkretisht, paragrafi 1), 10 (mbi dokumentet e huaja të udhëtimit - ku përmendën lloje të ndryshme të pasaportave) dhe 15 (mbi vizat dhe dokumentin e udhëtimit). Përmbajtja e këtyre neneve nuk ka ndryshuar nga ligji pasues i cili e ka shfuqizuar atë.

Përkufizimet "dokument i rrejshëm i udhëtimit apo identifikimit" në Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) dhe në Kodin Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) përqendrohen në konceptin "të rrejshëm", jo në atë se çfarë është një "dokument udhëtimi" (aq më pak "dokument identiteti"), por japin një aluzion kur përmendet "falsifikuar apo ndryshuar (...) nga cilido person tjetër pos nga personi ose organi i autorizuar me ligj (...)", ndërsa letër garancia ose ftesa mund të falsifikohen nga çdo person (edhe pse ka kushte, të tilla si verifikimi në noteri ose në gjykatë).

Letër garancia apo ftesa nuk janë "dokument i udhëtimit", më saktë, ato janë dokumente<sup>160</sup> por jo kusht për të hyrë në një shtet, qëllimi i saj është për të bindur zyrtarët kufitarë për vërtetësinë e (në këtë rast, të rremë) të deklaratës, ka për qëllim lehtësimin e procesit të mashtrimit të zyrtarëve, për të bërë më të lehtë bindjen e tyre se deklaratat e paraqitura në rastin e kontrollit të pasaportës (rreth destinacionit, motivit, datave, mjeteve, etj.) korrespondojnë me të vërtetën, domethënë se "po vijnë për të punuar", "po vijnë për të vizituar dikë".

Prandaj, në këtë drejtim, gjykata nuk pranon qëndrimin e prokurorisë, se letër garancitë apo ftesat, përmbajtja e të cilave është e rreme sepse nuk korrespondojnë me të vërtetën e mbështesin një "dokument udhëtimi".

Pastaj mund të thuhet se lëshimi i një letër garancie apo ftese (të rreme), që nuk korrespondon me një fakt të vërtetë është një veprë tjetër penale, pasi gjykata mund ta ri-kualifikon atë (neni 360, par. 2, të KPP-së, "gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës") për veprën penale të legalizimit të përmbajtjes së pavërtetë - në pajtim me nenin 334, të KPPK-së apo nenin 403 të KPRK-së.

---

<sup>160</sup> Dhe sipas definicionit të dokumentit të paraqitur në ndërkohë në Kodin Penal të Kosovës (neni 120, par 8, të KPK-së.), "dokument - çdo dokument apo send tjetër i përshtatshëm ose i caktuar që shërben si provë e ndonjë fakti përkatës për marrëdhëniet juridike".

Megjithatë, akti i prodhimit të një “dokument të rremë” (duke nxjerrë një letër garancie përmbajtja e të cilës është e rreme pasi nuk korrespondon me të vërtetën, është e rreme për shkak se është e rreme, sepse përmbajtja e saj është thjesht false - e cila në Sistemin Penal të Kosovës korrespondon me veprën penale të legalizimit të përmbajtjes së pavërtetë) pasi qëllimi në fjalë bie në kategorinë e përfshirjes në kontrabandimin e migrantëve, duke qenë se është një veprim i prokurimit dhe ky është një veprim me qëllim të caktuar, veprë penale që ofron mbrojtje më të mirë për vlerën juridike është në fakt, kontrabandimi i migrantëve, sipas par.1 në të dy versionet e kodit penal, dhe dy të pandehurit për të cilët ka të bëjë ky modalitet janë akuzuar nga paragrafët 1, 2 dhe 3 dhe për këtë arsye nuk është e nevojshme të ri-kualifikohen.

Për hir të qartësisë, gjykata po i adresohet çështjeve të ndryshme, një nga një. Para përfundimit të analizës së kësaj veprë penale, dhe zbatimin e fakteve të vërtetuara, ekziston edhe një institut tjetër ligjor që duhet të adresohet, bashkëkryerja në veprën penale (pavarësisht se disa vërejtje tashmë janë bërë në vendin e duhur).

### **Bashkëkryerja**

Në nenet 23 të KPPK-së ose 31 të KPRK-së, në bashkëkryerje, thuhet se “*kur dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet siç është përshkruar për veprën penale*”.

Bashkëkryerja është një koncept shumë kompleks, në varësi të qasjeve të ndryshme doktrimore; ajo që përfshihet në nenin 31 të KPP-së, është shumë e gjerë<sup>161</sup>. Në formën më të dukshme dhe të qartë të bashkëkryerjes, duhet të ketë një marrëveshje të mëparshme dhe reale, ndërsa në format e tjera kjo “marrëveshje” vetëm mund të **nënkuptohet [theksimi i shtuar]**<sup>162</sup>, por, në të dy rastet, “marrja pjesë” ose “thelbësisht duke i kontribuar” përsëri duhet të çojnë në

---

<sup>161</sup> Në të njëjtën mënyrë, shih pikën 1 të Komentarit, rreth nenit 31 të KPRK-së. Rreth “lidhjes objektive dhe subjektive”, pikat 6 dhe 7 [“6. Lidhja objektive qëndron në atë se secili bashkëpunëtor duhet të ndërmarrë ndonjë veprim me të cilin i kontribuon kryerjes së veprës penale. Të gjitha veprimet që i ndërmarrin bashkëpunëtorët, pa marrë parasysh a i ndërmarrin në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend, duhet të jenë të lidhura në mes tyre dhe të drejtuara që të arrihet rezultati i njëjtë, që të shkaktohen pasojat e caktuara. Me fjalë të tjera, pasoja e veprës penale duhet të jetë rezultati i përbashkët i veprimeve të të gjithë bashkëpunëtorëve. 7 Lidhja subjektive qëndron në atë se të gjithë bashkëpunëtorët duhet të jenë të vetëdijshëm se në kryerjen e veprës penale të caktuar do të marrin pjesë, do të veprojnë së bashku në mënyra të ndryshme (...)].

<sup>162</sup> Shih pikën 18A, *in fine*, të Komentarit mbi nenin 31 të KPRK-së, “në bazë të kësaj rezulton se bashkëkryerja mund të shprehet edhe në rastet kur nuk ka ekzistuar marrëveshje paraprake, por ajo në ndërkohë gjatë kryerjes është shprehur. Lidhur me ekzistimin e bashkëkryerjes as ligjvënësi nuk e parasheh marrëveshjen si kusht të domosdoshëm”.

një kontribut objektivisht të përbashkët në kryerjen e të njëjtës vepër penale<sup>163</sup>; prandaj, nisur nga aspekti i fakteve, duhet ardhur tek përfundimi se personat dëshironin të kryenin veprën e **njëjtë** penale, se një **rezultat i caktuar** mund të arrihet si pasojë e veprimit/mos veprimit të tyre, por nuk është e domosdoshme që gjithë bashkë kryesit të marrin pjesë në të gjitha veprimet e kryerjes së veprës.

Rrjedhimisht, nuk ka nevojë për një marrëveshje të shprehur, pasi një **bashkëpunim i vetëdijshëm** në veprimtarinë e tjetrit(ve)<sup>164</sup> për të përmbushur, ose përfunduar veprën penale do të mjaftonte në bashkëkryerje. Bashkëkryerja ekziston, pavarësisht nga fakti se nuk ka pasur marrëveshje të shprehur, kur rrethanat në të cilat ka vepruar apo mos vepruar personi, tregojnë se ka pasur një marrëveshje të nënkuptuar. **Kjo marrëveshje e nënkuptuar bazohet në ekzistencën e një gatishmërie të vetëdijshme për të bashkëpunuar, vlerësuar në aspektin e përvojës së përbashkët [theksimi i shtuar].**

Pra, në qoftë se në disa nga rastet marrëveshja ishte eksplicite, e bërë dhe e rregulluar paraprakisht, në rastet të tjera në qoftë se nuk ka qenë eksplicite, të paktën ka qenë implicite, duke iu bashkuar kryerjes në një fazë të caktuar.

Ky është një rast i “bashkëkryerjes suksesive”. Bashkëkryerja ekziston në rastet kur ndonjë person tjetër i bashkohet një personit i cili është duke kryer veprën penale dhe, me veprimet e tij ose të saj, merr pjesë në kryerjen e asaj vepre penale<sup>165</sup>, por veprimet mund të jenë edhe mosveprime “*Bashkëkryerja të veprat penale me mosveprim shprehet në rastet kur dy apo më shumë persona së bashku janë të detyruar të ndërmarrin ndonjë veprim, mirëpo ata nuk e ndërmarrin këtë*”<sup>166</sup>. Kjo qëndron edhe në rastet kur veprimet përbëhen nga veprimet dhe mosveprimet, dhe mosveprimet mund të jenë, në rastin e zyrtarëve të kufirit, të cilët nuk i përmbushin detyrat e tyre.

Më në fund, bashkëkryerja është një nga elementet në të drejtën penale dhe nuk kërkohet apo nuk do të thotë se të gjitha elementet e tjera të rëndësishme në kryerjen e veprës penale janë *ipso facto* të zbatueshme për të gjitha bashkëkryerësit, kjo do të thotë se jo domosdoshmërisht nënkupton që të gjitha elementet relevante dhe rrethanat të cilat mund të gjenden në rastin e një bashkëkryerësi shtrihen ose zbatohen për të gjitha bashkëkryerësit (modalitetet e kryerjes së veprës penale, rrethanat lehtësuese dhe rënduese, etj.); thelbi është gjithmonë shkalla e dënjësive, e dashjes, dhe përgjegjësia individuale - shih, për shembull, në këtë drejtim, neni 27 të KPPK-së (ose neni 36 të KPRK-së) mbi “Kufijtë e përgjegjësive penale dhe ndëshkimi për bashkëpunim:

---

<sup>163</sup> Shih pikat 15 dhe 16 të Komentarit mbi nenin 31 të KPRK-së, “(...) së bashku kryejnë veprën e tyre të përbashkët, në të cilën secili prej tyre jep një kontribut të rëndësishëm pa të cilin nuk do të arrihet vepra penale ose nuk do të përfundojë (...) Kontributi i secilit është një pjesë e rëndësishme e arritjes së planit kriminal. Kontributi i njërit plotësohet me kontributin e tjetrit dhe të gjithë ata janë përgjegjës për të gjithë veprën e kryer penale”.

<sup>164</sup> Shih pikën 19 të Komentarit mbi nenin 31 të KPRK-së, rreth konceptit të “bashkëkryerjes së domosdoshme”.

<sup>165</sup> Shih pikën 22 a) të Komentarit mbi nenin 31 të KPRK-së.

<sup>166</sup> Shih pikën 22 c) të Komentarit mbi nenin 31 të KPRK-së.



(1) bashkëkryerësi është penalisht përgjegjës brenda kufijve të dashjes apo të pakujdesisë së tij ose të saj, ndërsa personi që e shtytë apo e ndihmon në kryerjen e veprës penale duhet të mbahet penalisht përgjegjës brenda kufijve të dashjes së tij ose të saj”.

### **Faktet dhe vepra penale**

Duke pasur parasysh faktet dhe të gjitha ato që gjykata tashmë i ka thënë më herët, tani është momenti për t'i cilësuar (në kuptimin juridik) veprimet e të pandehurve.

Të gjithë të pandehurit kanë kryer veprën penale të kontrabandimit me migrantë, edhe pse në mënyra të ndryshme.

I pandehuri A.Ç. e ka kryer në formën renduese, pasi ai ka vepruar jo vetëm si anëtar i grupit, në bashkëkryerje, por edhe duke organizuar dhe drejtuar të tjerët në veprimtarinë e kontrabandimit të migrantëve, në bazë të nenit 138 paragrafët 1, 5, 6 dhe 7.1 dhe 7.2 të KPPK-së (parashikuar aktualisht sipas nenit 170, paragrafët 1, 5, 6 dhe 8.1 dhe 8.2 të KPRK-së).

Të pandehurit M.B., A.M., M.A., A.B., gjithashtu kanë kryer veprën penale në fjalë me rrethanën renduese duke vepruar si anëtarë të grupit, në bazë të nenit 138 paragrafët 1, 6 dhe 7.1 dhe 7.2 të KPPK-së (parashikuar aktualisht sipas nenit 170, paragrafët 1, 6 dhe 8.1 dhe 8.2, të KPRK-së).

Të pandehurit I.P., T.Y. dhe A.G. janë përfshirë në kontrabandimin e migrantëve dhe kanë kryer veprën penale të thjeshtë, të vetme, në bazë të nenit 138 paragrafët 1 dhe 7.1 dhe 7.2 të KPPK-së (parashikuar aktualisht sipas nenit 170, paragrafët 1 dhe 8.1 dhe 8.2 të KPRK-së).

Të gjithë të pandehurit, përpos A.G.t (i cili ka vepruar me dashje eventuale<sup>167</sup>, sipas nenit 15, par. 3, të KPPK-së, apo nenit 21, par. 3, të KPRK-së), kanë vepruar me dashje direkte (sipas nenit 15, par. 2, të KPPK-së apo nenit 21, par. 2, të KPRK-së) dhe duke e ditur se veprimet e tyre ishin të ndaluara dhe të dënuara me ligj.

Të gjithë të pandehurit kanë vepruar në bashkëkryerje në kuptimin e shpjeguar më herët (sipas nenit 23 të KPPK-së apo nenit 31 të KPRK-së).

Të pandehurit A.Ç., M.B., A.M., M.A., A.B.<sup>168</sup> dhe T.Y., kanë kryer vepra penale në bashkim të kontrabandimit të migrantëve (përshkruar në mënyrë të hollësishme më lart për

---

<sup>167</sup> Dashja eventuale, jo direkte, është pasojë e formulimit të përdorur për të përshkruar dashjen e tij në faktet e vërtetuara.

<sup>168</sup> Ashtu siç u tha më shumë se një herë, mbi *kriteret* e sapo shpjeguara dhe mbi datat e shpjeguara në arsyetimin e fakteve të vërtetuara që do të pasojnë, ngjarjet e ndërlidhura me M.B.n ishin më 22/10/2012 (1 migrant), 29/11/2012 (1 migrant), 8/11/2012 (2 migrantë), 11/11/2012 (1 migrant), 16/11/2012 (5 migrantë) dhe 24/11/2012 (1 migrant); në lidhje me A.M. ishin më 25/9/2012 (2 migrantë), 25/9/2012 (3 migrantë), 17/10/2012 (1 migrant), 23/10/2012 (1 migrant), 23/10/2012 (1 migrant), 27/10/2012 (1 migrant) dhe më 8/11/2012 (2 migrantë); në lidhje me M.A. ishin më 24/11/2012 (1 migrant) dhe më 29/11/2012 (1 migrants) dhe në lidhje me A.B. ishin më 24/10/2012 (1 migrant), 13/11/2012 (1 migrant) dhe më 25/11/2012 (1 migrant).

secilën prej tyre), pasi ata vepruan më shumë se një herë, duke plotësuar të gjitha elementet përbërëse të veprës penale (në bazë të nenit 71 të KPPK-së ose nenit 80 - dhe nenit 81 në lidhje me veprat në vazhdim - të KPRK-së). Kur të shqiptohet dënimi dhe kur të merren parasysh edhe faktet e tjera, do të shqyrtohet numri shumë i madh i rasteve në kohë të ndryshme kur ata kanë kryer veprat penale.

Duke marrë parasysh atë që u tha më parë, gjykata vendos se janë plotësuar kërkesat e veprës penale në vazhdim (në kushtet e shpjeguara saktë tashmë, në pajtim me nenin 81 të KPRK-së) dhe kjo është forma më e përshtatshme e trajtimit të përgjegjësisë së tyre penale (me përjashtim të I.P. dhe A.G., pasi të dytë kanë marrë pjesë vetëm në ngjarje të vetme), madje edhe në aspektin e dënimit, kur është më i favorshëm (i cili do të zbatohet në shumicën e situatave, me përjashtim të një rrethane - kur vepron si anëtar i grupit, sipas nenit 138, par 6, të KPPK-së, - kur vendoset dënimi për ata të cilët kodi në fuqi në atë kohë është më i favorshëm, në pajtim me nenin 138, par 6, të KPPK-së - por kjo do të adresohet me rastin e shqiptimit të dënimit).

Para shqiptimit të dënimit, është i nevojshme një shënim i fundit në lidhje me dënimin për bashkim të veprave penale ose, kur është e mundur, veprave penale në vazhdim.

Gjykata është në dijeni të jurisprudencës në ndjekje të kuptimit që në rast të bashkimit të veprave penale aplikohet vetëm një dënim, si i përbashkët apo tashmë si dënim unik - pa përcaktuar fillimisht dënimin për secilën vepër penale ose për secilin rast në të cilin është kryer i njëjti lloj i veprës penale. Megjithatë, duke marrë parasysh doktrinën e të drejtës penale e cila ka të bëjë me mënyrën e përcaktimit të numrit të veprave penale, se si duhet përcaktuar dënimi për bashkimin e veprave penale dhe tekstin e ligjit sa i përket dënimit për bashkimin e veprave penale, gjykata konstaton se është jashtëzakonisht e vështirë, për të mos thënë e pamundur, për të justifikuar kuptimin ose jurisprudencën në fjalë, duke pasur parasysh përmbajtjen e tekstuale të nenit 71 të KPPK-së (ose nenit 80 të KPRK-së) dhe kriteri tashmë i përmendur i interpretimit të ligjit, se duhet të ketë pajtim me tekstin e ligjit.

Në të vërtetë, përcaktimi i numrit të herëve kur është kryer një vepër e caktuar penale është i domosdoshëm, në mënyrë që gjykata pastaj mund të shqiptojë dënimin për secilën prej tyre, në të njëjtën mënyrë është thelbësore që të shqiptojë dënimin për secilën prej llojeve të ndryshme të veprave penale të cilat eventualisht janë kryer, kjo para përcaktimit të shqiptimit të dënimit unik.

Përndryshe, gjykata nuk sheh asnjë mënyrë të veprimit në përputhje me ligjin, domethënë dispozitat e përcaktuara shprehimisht në nenin 71 të KPPK-së, (ose nenin 80 të KPRK-së) mbi “Dënimin për Bashkimin e Veprave Penale” konkretisht, par. 1, “(1) nëse kryesi me një ose me më shumë veprime kryen disa vepra penale për të cilat gjykohet në të njëjtën kohë, gjykata së pari shpallë dënimin për secilën vepër dhe pastaj shqipton dënimin unik për të gjitha këto vepra” dhe më pas, në përputhje me par. 2, “(2) Gjykata shqipton dënimin unik sipas këtyre rregullave (...)” [theksimi i shtuar].

Pavarësisht se nuk ka nevojë për ta thënë, kur ligji thotë “me një ose me më shumë veprime kryen disa vepra penale” nuk ka dallim sa i përket disa veprave penale të cilat janë të të njëjtit lloj (bashkim homogjen) ose i llojeve të ndryshme (bashkim heterogjen).

Ky kuptim nuk pengohet apo kufizohet nga mënyra se si janë përshkruar apo kualifikuar akuzat apo pikat e akuzës në aktakuzë sa i përket kualifikimit juridik të veprave; në të vërtetë, neni 360 i KPP-së, është i qartë, kështu në par. 1 thuhet: “aktgjykimi mund t’i referohet vetëm personit të akuzuar dhe vetëm veprës që është objekt i akuzës (...)” dhe në paragrafin 2 thuhet “gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës” [theximi i shtuar]. Megjithatë, aktakuza, në secilën pikë të akuzës, përmend vetëm emrin e veprës penale (për shembull, “kontrabandim me migrantë”) dhe formën e kryerjes (bashkëkryerje), nuk përmban ndonjë kualifikim ligjor të veprave në aspektin e numrit të herëve kur vepra penale është kryer ose në qoftë se vepra ishte në vazhdim (duke pasur parasysh se aty gjenden referenca lidhur me momentet e ndryshme kohore, me “muaj” për shembull).

Duke pasur parasysh të lartpërmendurat, me gjithë respektin për të kuptuar ndryshe, gjykata do të ndjekë të kuptuarit e saj të ligjit, thënë më mirë, gjykata do të ndjekë se çfarë thotë ligji në nenin 71, të KPPK-së (ose nenin 80, të KPRK-së), lexuar së bashku me nenin 360, të KPP-së, dhe në rastin e bashkimit të veprave penale (të llojit të njëjtë apo tjetër) “fillimisht do të shpallë dënimin për secilën vepër dhe pastaj do të shqipton dënimin unik për të gjitha këto vepron” - në përputhje me rregullën e aplikueshme, përkatësisht par. 2.2 të nenit në fjalë. Në rastin e veprave penale për të cilat kodi i ri është më i favorshëm, nëse janë plotësuar kushtet, atëherë gjykata do të zbatojë nenin 81, “dënimi për veprat penale në vazhdim “(ku gjykata shqipton dënimin unik, për dallim nga rastet e bashkimit të plotë të veprave penale, siç është shpjeguar).

### **Shqiptimi i dënimit**

Këtë pjesë e fillojmë me dy pohime të bëra tashmë përgjatë këtij aktgjykimi sipas nenit 2, par. 2, të KPPK-së (nenit 3, par. 2, të KPRK-së), “në rast të ndryshimit të ligjit të zbatueshëm për një çështje të caktuar para vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji më i favorshëm”, dhe kjo mund të jetë për shkak të një dënimi më të butë; pohimi tjetër është se në varësi të rrethanave të tjera ligjore, sesa të kufijve të vetë dënimit, grupi i rregullave si i tërë në lidhje me sanksionimin mund të jetë më i favorshëm në njërin kod, sesa në tjetrin, i cili është për shembull rasti i rregullave për pushimin e dënimit apo në përcaktimin e dënimit për bashkim të veprave penale, *tout court*, apo edhe si vepër penale në vazhdim, por secila rrethanë është e ndryshme dhe për këtë arsye pozitat e ndryshme në të cilat ndodhen të akuzuarit duhet vlerësuar veç e veç.

Tani do të trajtojmë të pandehurit një nga një dhe të gjitha faktet relevante për secilin të pandehur (edhe pse jo e nevojshme për t’i përsëritur të gjitha në këtë pikë, pasi ato janë të

përcaktuara në këtë aktgjykim, nën “C”) do të trajtohen me referenca të shkurtra, për të lejuar kuptimin e dënimeve të shqiptuara në pajtim me rregullat ose *kriteret* e zbatueshme.

Sipas nenit 34 të KPPK-së, “qëllimet e dënimit janë: 1) të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; dhe 2) të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale”, që në thelb përputhet me nenin 41 të KPRK-së, “qëllimet e dënimit janë: 1.1 të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; 1.2. të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale; 1.3. të bëjë kompensimin e viktimave apo të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale; dhe 1.4. të shpreh gjykimin e shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit”.

Gjithashtu në të dyja kodet kriteret për të përcaktuar dënimet janë në thelb të njëjta: në nenin 64 të KPPK-së (paragrafët 1 dhe 3<sup>169</sup>) tek “Rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit” thuhet “(1) Gjykata e cakton dënimin për vepër penale brenda kufijve të paraparë me ligj për atë vepër penale, duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rëndimin e dënimit (rrethanat lehtësuese dhe rënduese) dhe sidomos shkallën e përgjegjësisë penale, motivet nga të cilat është kryer vepra, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e mëparshme të kryerësit, pranimin e fajit, rrethanat e tij personale të kryerësit dhe sjelljet e tij pas kryerjes së veprës penale. Dënimi duhet të jetë në proporcion me veprën si dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryerësit”. (3) Me rastin e matjes së dënimit me gjobë, gjykata merr parasysh edhe gjendjen pasurore të kryerësit dhe posaçërisht shumën e të ardhurave personale dhe të ardhurat e tjera të tij, pasurinë dhe detyrimet e tij. Gjykata nuk e cakton lartësinë e gjobës mbi mjetet e kryerësit”. Neni aktual 73, para. 1 deri 3, të KPRK-së, thuhet “(1). Kur cakton dënimin për vepër penale, gjykata duhet të ketë parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për veprën penale. Gjykata pastaj duhet të merr parasysh qëllimin e dënimit, parimet e përcaktuara në këtë kapitull dhe rrethanat lehtësuese ose rënduese lidhur me veprën penale të caktuar ose me dënimin. (2). Dënimi duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryerësit. (3). Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme: 3.1. shkallën e përgjegjësisë penale; 3.2. motivet për kryerjen e veprës; 3.3. intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur; 3.4. rrethanat në të cilat është kryer vepra; 3.5. sjelljen e mëparshme të kryesit; 3.6. pranimin e fajit; dhe 3.7. rrethanat personale të kryesit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale”.

---

<sup>169</sup> Gjykata do të marrë parasysh dosjet e mëparshme kriminale të të pandehurve në kuptimin që mund të përdoren për të treguar se një dënim më i lartë bëhet i nevojshëm duke mos qenë hera e parë që personi nuk e respekton ligjin, sistemin formal të kontrollit, që përbëhet nga ligji penal, por gjykata nuk do të marrë parasysh asnjë nga dosjet kriminale me qëllim të recidivizmit pasi *kriteret* nuk janë përmbushur, as sipas nenit 70 të KPPK-së, dhe sipas nenit 79 të KPRK-së, (përkatësisht në rastin e të pandehurit I.P.). Prandaj, më lartë nuk iu është referuar par. 2.

Këto janë rrethanat që gjykata do t'i marrë parasysh, për aq sa të jetë e mundur, por do të merret parasysh, gjithashtu, se përveç të pandehurit z. A.G. në një farë mase, të pandehurit e tjerë asnjëherë nuk e kanë pranuar fajin e tyre dhe asnjëherë nuk kanë treguar asnjë lloj keqardhje ose pendimi deri në fund të gjykimit.

Pavarësisht se gjykata tashmë iu ka referuar disa herë ligjit më të favorshëm, tani është koha që më në fund të vendosim se cili është i duhuri në secilin rast, për secilin të pandehur, në përputhje me faktet e vërtetuara, mënyrën/mënyrat se është/janë kryer vepra/veprat penale dhe dënimet e parashikuara në kodet e ndryshme për situata të ndryshme, në kuptimin e shpjeguar më sipër dhe në përputhje me nenin 2, para. 1 dhe 2 të KPPK-së [(1) Ndaj kryerësit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale. (2) Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryerësit zbatohet ligji që është më i favorshëm.)] dhe nenin 3.2 të KPRK-së [Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm], normat që përfshijnë parimin në fjalë të ligjit më të favorshëm, dhe duke pasur parasysh atë që është vendosur më parë për mënyrën në të cilën të pandehurit e kanë kryer veprën penale, atëherë gjykata tani vendos që kodi më i favorshëm për secilin të pandehur është si vijon:

- A.Ç.: I pandehuri A.Ç. ka kryer veprën penale të kontrabandimit me migrantë në formën renduese, pasi ai ka vepruar jo vetëm si anëtar i grupit, në bashkëkryerje, por po ashtu ka organizuar dhe drejtuar të tjerët në veprimtarinë e kontrabandës së migrantëve (rrethana renduese e paragrafit 5 edhe në nenin 138 të KPPK-së ose 170 të KPRK-së, “organizon apo drejton persona të tjerë”), sipas nenit 138 paragrafët 1, 5, 6 dhe 7.1 dhe 7.2 të KPPK-së (aktualisht parashikuar sipas nenit 170, paragrafët 1, 5, 6 dhe 8.1 dhe 8.2 të KPRK-së).

Duke pasur parasysh se maksimumi dhe minimumi i dënimit me burg (7 deri në 20 vjet), së bashku me një gjobë deri në të njëjtën shumë (500.000 euro) janë të njëjta, të cilat *a priori* do të çojnë në zbatueshmërinë e kodit në fuqi në atë kohë, në anën tjetër ne shohim se në kodin e ri, dënimi në përputhje me rregullat e dënimit për një vepër penale në vazhdim të përcaktuar në nenin 81 të KPRK-së, është më i favorshëm se sa thjesht i pandehuri të dënohet në përputhje me rregullat për dënimin për bashkim të veprave penale, në të cilin së pari caktohet dënimi për secilën vepër penale individuale (neni 71, par. 1 dhe par. 2.2 të KPPK-së “Nëse për secilën prej veprave penale gjykata ka shpallur dënimin me burgim, dënimi unik duhet të jetë më i madh se çdo dënim i veçantë, por dënimi unik nuk mund ta arrijë shumën e të gjitha dënimeve të përcaktuara dhe as të tejkalojë periudhën prej njëzet vjetësh”).

Në këtë mënyrë, sa i përket A.Ç.-es, kodi i ri është më i favorshëm<sup>170</sup>, neni 3, par. 2, të KPRK-së, dhe do të dënohet në përputhje me nenin 170, paragrafët 1, 5, 6 dhe 8.1 dhe 8.2, të KPRK-së, lexuar së bashku me nenet 31, 41, 45, 46, 62, 71, 72, 73 dhe 81 të KPRK-së.

---

<sup>170</sup> Maksimumi i gjobës është i njëjtë, por në Kodin e Përkohshëm minimumi ishte më i vogël se në Kodin e Ri (50 euro, jo 100 euro, në përputhje me nenet 39, par. 1, dhe 46, par. 1, respektivisht) por kjo nuk e ndryshon

- Të pandehurit M.B., A.M., M.A., A.B. gjithashtu kanë kryer veprën penale (në bashkim, në kuptimin e shpjeguar më herët, pasi e kanë kryer atë më shumë se një herë), me rrethanën rënduese duke vepruar si anëtar të grupit, në pajtim me nenin 138 paragrafët 1, 6 dhe 7.1 dhe 7.2 të KPPK-së (aktualisht parashikuar sipas nenit 170, paragrafët 1, 6 dhe 8.1 dhe 8.2 të KPRK-së). Në këtë rast nevojitet shpjegim i mëtutjeshëm, edhe për shkak se në ligjin e mëparshëm (neni 138, par. 6, të KPPK-së) ishte padyshim një gabim, duke qenë se në rastin e kësaj rrethane rënduese dënimi ishte më i butë (2 deri në 10 vjet burgim) se sa për veprën penale të vetme të paragrafit 1 (2 deri në 12 vjet burgim). Përveç kësaj, paragrafi 6 i nenit të ri 170, përcakton minimumin e burgimit në 5 vjet, pa theksuar në mënyrë eksplicite se maksimumi është 10 vjet. Gjithashtu, më përpara nuk ishte parashikuar kurrfarë gjobe ndërsa tani ka. Në këtë rast, pavarësisht nga përfitimet e ofruara nga dënimi i veprave në vazhdim, gjykata është e mendimit se kodi i vjetër është më i favorshëm, sepse maksimumi është i njëjtë (10 vjet burgim - sepse pavarësisht se ishte një gabim në Kodin e Përkohshëm Penal, siç shpjegohet më lart, gjykata i detyrohet ligjit), por minimumi në atë kohë ishte më pak, 2 vjet burgim, në vend të 5 viteve, dhe në atë kohë gjoba nuk ishte e parashikuar.

M.B., A.M., M.A. dhe A.B. kanë kryer veprat penale në bashkim të kontrabandimit më migrantë (përshkruar më lart në mënyrë të veçantë për secilin prej tyre), pasi ata vepruan më shumë se një herë, kështu duke plotësuar të gjitha elementet përbërëse të veprës penale (në bazë të nenit 71 të KPPK-së ose nenit 80 - dhe nenit 81 në lidhje me veprat në vazhdim - të KPRK-së). Numri shumë i madh i rasteve në kohë të ndryshme kur ata kanë kryer veprat penale do të shqyrtohet me rastin e dënimit, ku edhe faktet e tjera do të merren parasysh po ashtu. Dënimi unik do të caktohet.

Prandaj, dënimi ndaj këtyre të pandehurve do të caktohet në përputhje me rregullat e kodit të vjetër, dhe, nenit 138, paragrafët 1, 6 dhe 7, të KPPK-së, lexuar së bashku me nenet 23, 34, 39, 54, 62, 63, 64 dhe 71 të KPPK-së.

- Të pandehurit I.P., T.Y. dhe A.G. janë përfshirë në kontrabandimin e migrantëve dhe kanë kryer veprën penale të thjeshtë, të vetme, sipas nenit 138 paragrafët 1 dhe 7.1 dhe 7.2 të KPPK-së (aktualisht parashikuar sipas nenit 170, paragrafët 1 dhe 8.1 dhe 8.2 të KPRK-së). Për këta të pandehur, ligji i ri është më i favorshëm, jo vetëm për shkak se kufiri maksimal është tani më i ulët (10 vjet, në vend të 12), por edhe për shkak se në rast se trupi gjykues vendos të pezullojë dënimin e të pandehurit, ligji i ri nuk e ndalon këtë, sepse maksimumi aktual ende është brenda pragut (burgim deri në 10 vjet) përcaktuar qoftë nga neni 44, par. 2, të KPPK-së ose me nenin 52, par. 2, të KPRK-së. Pasi T.Y. ka kryer veprën penale dy herë, ai mund të dënohet për veprën penale në vazhdim, në përputhje me nenin 81, të KPRK-së.

---

vendimin në lidhje me ligjin më të favorshëm për shkak se nuk ka të bëj me rastin në të cilin gjoba mund të jetë nën shumën 100 euro dhe për shkak se përparësia e dënimit të veprave në vijim tejkalon në mënyrë të qartë çfarëdo dyshimi.

Rrjedhimisht, këta të pandehur do të dënohen në përputhje me nenin 170, paragrafët 1 dhe 8.1 dhe 8.2 të KPRK-së, lexuar së bashku me nenin 3, 31, 41, 45, 46, 62, 71, 73 dhe 81 (i fundit vlen për T.Y.) të KPRK-së.

Shqiptimi i dënimeve për veprat penale të kryera siç sapo u shpjegua:

Duke pasur parasysh se:

- Të gjithë të pandehurit, përpos A.G.t (i cili ka vepruar me dashje eventuale<sup>171</sup>, sipas nenit 15, par. 3, të KPPK-së apo nenit 21, par. 3, të KPRK-së), kanë vepruar me dashje direkte (sipas nenit 15, par. 2, të KPPK-së apo nenit 21, par. 2, të KPRK-së.) dhe duke e ditur se veprimet e tyre ishin të ndaluara dhe të dënuara me ligj.

- Të gjithë të pandehurit kanë vepruar në bashkëkryerje në kuptimin e shpjeguar më herët (sipas nenit 23 të KPPK-së apo nenit 31 të KPRK-së).

- Kontrabandimi me migrantë në Ballkan është në numër të konsiderueshëm dhe një problem serioz<sup>172</sup>.

- Dhe duke pasur parasysh të gjitha faktet e vërtetuara më lartë, dënimet janë si më poshtë:

**A.Ç.** (pika e akuzës 5): Vepra penale është e dënueshme me gjobë prej 100 euro deri në 500.000 euro dhe burgim prej 7 deri 20 vjet.

Duke marrë parasysh nivelin shumë të lartë të përfshirjes, numrin shumë të madh të personave të kontrabanduar (79), dashjen shumë të fortë dhe direkte për një periudhë të konsiderueshme kohore siç tregohet tek faktet, e gjithë kjo për të arsyetuar se nuk ka asnjë argument për të caktuar dënimin e tij në minimumin e paraparë. Ky dënim është i domosdoshëm duke marrë parasysh personalitetin e tij siç tregohet me anë të fakteve (domethënë aftësitë organizative), për të parandaluar të tjerët nga kryerja e veprës penale dhe gjithashtu për shkak se ai nuk ka treguar kurrfarë keqardhje, e cila rrit rrezikun e përsëritjes së veprës penale dhe për këtë arsye një dënim më i lartë për ta parandaluar atë që ta bëjë një gjë të tillë, është i nevojshëm.

Duke pasur parasysh të lartpërmendurat: Për veprën penale të kontrabandimit me migrantë në formën renduese, duke vepruar jo vetëm si anëtar i grupit, por edhe duke organizuar dhe drejtuar të tjerët në veprimtarinë e kontrabandimit të migrantëve, në bashkëkryerje dhe në vazhdim, në përputhje me nenin 170, paragrafët 1, 5, 6 dhe 8.1 dhe 8.2, të KPRK-së, lexuar së bashku me nenet 3, 31, 41, 45, 46, 62, 71, 72, 73 dhe 81 të KPRK-së, dënohet me 7 vjet e 3 muaj burgim dhe me gjobë prej 1000 euro.

---

<sup>171</sup> Dashja eventuale, jo direkte, është pasojë e formulimit të përdorur për të përshkruar dashjen e tij në faktet e vërtetuara.

<sup>172</sup> Është fakt i njohur.

**M.B.** (pika e akuzës 5): Vepra penale është e dënueshme me burgim prej 2 deri 10 vjet.

Duke marrë parasysh nivelin e lartë të përfshirjes, numrin shumë të madh të personave të kontrabanduar (11), përsëritjen e veprës penale gjatë periudhës kohore (6 vepra penale në bashkim të kontrabandimit me migrantë) dashjen e fortë dhe direkte, përfshirjen në nivel familjar, referencat për migrantët e tij të cilat gjithashtu tregojnë aftësi organizative, e gjithë kjo për të arsyetuar se për secilën prej veprave penale gjykata nuk sheh asnjë argument për të caktuar dënimin e tij në minimumin e paraparë. Për këtë arsye, gjykata e shqipton dënimin me 2 vjet e 3 muaj burgim për secilën vepër penale në bashkim. Sipas rregullave për caktimin e dënimit unik, minimumi është 2 vjet dhe 3 muaj dhe maksimumi është 13 vjet e 6 muaj dhe gjykata vendos të shqiptoj dënimin unik ndaj tij prej 5 vjet e 3 muaj burgim.

Ky dënim është i domosdoshëm duke marrë parasysh personalitetin e tij siç tregohet me anë të fakteve (domethënë aftësitë organizative dhe përfshirja madje edhe në nivel familjar), për të parandaluar të tjerët nga kryerja e veprës penale dhe gjithashtu për shkak se ai nuk ka treguar kurrfarë keqardhje, e cila rrit rrezikun e përsëritjes së veprës penale dhe për këtë arsye një dënim më i lartë është i nevojshëm për të parandaluar atë që ta bëjë një gjë të tillë.

Për veprën penale të kontrabandimit me migrantë në formën renduese, duke vepruar si anëtar i grupit, në bashkëkryerje dhe në bashkim të 6 veprave penale të kontrabandimit me migrantë në formën e lartcekur, në përputhje me nenin 138, paragrafët 1, 6 dhe 7, lexuar së bashku me nenet 23, 34, 39, 54, 62, 63, 64 dhe 71 të KPPK-së, i shqiptohet dënimi unik prej 5 vjet e 3 muaj burgim.

**A.M.:** (pika e akuzës 5): Vepra penale është e dënueshme me burgim prej 2 deri 10 vjet.

Duke marrë parasysh nivelin e lartë të përfshirjes, numrin e konsiderueshëm të personave të kontrabanduar (11), përsëritjen e veprës penale gjatë periudhës kohore (7 vepra penale në bashkim të kontrabandimit të migrantëve, pavarësisht se 2 prej tyre kanë qenë në të njëjtën ditë) dashjen direkte, por më pak intensive sesa e M.B.t, përfshirjen kryesisht në nivelin e letrave të garancisë me përmbajtje të rreme dhe duke i marrë migrantët në aeroport (kur është fjala për marrjen e migrantëve në aeroport, e njëjta vlen edhe për M.B.n) dhe udhëtimin e mëtutjeshëm, e gjithë kjo për të justifikuar se për secilën prej veprave penale gjykata nuk sheh asnjë argument për të caktuar dënimin e tij në minimumin e paraparë. Për këtë arsye, gjykata e shqipton dënimin me 2 vjet e 3 muaj burgim për secilën vepër penale në bashkim. Sipas rregullave për caktimin e dënimit unik, minimumi është 2 vjet e 3 muaj dhe maksimumi është 15 vjet e 9 muaj dhe gjykata vendos ndaj tij të shqiptoj dënimin unik prej 5 vjet burgim (pasi, për arsyet e përmendura, përkundër faktit se ai ka një vepër penale më shumë se i mëhershmi, vlerësimi i përgjithshëm siç shpjegohet çon në nevojën e një dënimi më të ulët).

Ky dënim është i domosdoshëm duke marrë parasysh personalitetin e tij siç tregohet me anë të fakteve, për të parandaluar të tjerët nga kryerja e veprës penale dhe gjithashtu për shkak se



ai nuk ka treguar kurrfarë keqardhje, e cila rrit rrezikun e përsëritjes së veprës penale dhe për këtë arsye një dënim më i lartë është i nevojshëm për të parandaluar atë që ta bëjë një gjë të tillë.

Duke pasur parasysh të lartpërmendurat: Për veprën penale të kontrabandimit me migrantë në formën renduese, duke vepruar si anëtar i grupit, në bashkëkryerje dhe në bashkim të 7 veprave penale të kontrabandimit me migrantë në formën e lartcekur, në përputhje me nenin 138, paragrafët 1, 6 dhe 7, lexuar së bashku me nenet 23, 34, 39, 54, 62, 63, 64 dhe 71 të KPPK-së, i shqiptohet dënimi unik prej 5 vjet burgim.

**A.B.** (pika e akuzës 5): Vepra penale është e dënueshme me burgim prej 2 deri 10 vjet.

Duke marrë parasysh nivelin e lartë të përfshirjes, numrin e personave të kontrabanduar (3), përsëritjen e veprës penale gjatë periudhës kohore (3 vepra penale në bashkim të kontrabandimit të migrantëve), dashjen shumë intensive dhe direkte lidhur me operacionet përkatësisht në dëshirën e fortë për të marrë emrat e migrantëve nga A.Ç., për t'ia përcjellë pastaj zyrtarit policor të korruptuar, i cili në momentin e caktuar ishte me të, njohuritë praktike të treguara nga ai në lidhje me rrugët, kufijtë, organizimin e udhëtimeve të mëtejshme të migrantëve, e gjithë kjo për të arsyetuar se për secilën prej veprave penale gjykata nuk sheh asnjë argument për të caktuar dënimin e tij në minimumin e paraparë. Për këtë arsye, gjykata e shqipton dënimin me 2 vjet e 3 muaj burgim për secilën vepër penale në bashkim. Sipas rregullave për caktimin e dënimit unik, minimumi është 2 vjet dhe 3 muaj dhe maksimumi është 6 vjet e 9 muaj dhe gjykata vendos që ndaj tij të shqiptoj dënimin unik prej 4 vjet burgim.

Ky dënim është i domosdoshëm duke marrë parasysh personalitetin e tij siç tregohet me anë të fakteve, për të parandaluar të tjerët nga kryerja e veprës penale dhe gjithashtu për shkak se ai nuk ka treguar kurrfarë keqardhje, e cila rrit rrezikun e përsëritjes së veprës penale dhe për këtë arsye një dënim më i lartë është i nevojshëm për të parandaluar atë që ta bëjë një gjë të tillë.

Duke pasur parasysh të lartpërmendurat: Për veprën penale të kontrabandimit me migrantë në formën renduese, duke vepruar si anëtar i grupit, në bashkëkryerje dhe në bashkim të 7 veprave penale të kontrabandimit me migrantë në formën e lartcekur, në përputhje me nenin 138, paragrafët 1, 6 dhe 7, lexuar së bashku me nenet 23, 34, 39, 54, 62, 63, 64 dhe 71 të KPPK-së, i shqiptohet dënimi unik prej 4 vjet burgim.

**M.A.** (pika e akuzës 5): Vepra penale është e dënueshme me burgim prej 2 deri 10 vjet.

Duke marrë parasysh nivelin e përfshirjes, numrin e personave të kontrabanduar (2), përsëritjen e veprës penale (2 vepra penale në bashkim të kontrabandimit të migrantëve, 1 migrant secilën herë), dashjen shumë intensive dhe direkte lidhur me operacionet të cilat i rregullonte me A.Ç. konkretisht në lidhje me marrëveshjet me zyrtarin policor të korruptuar (në bashkëpunim edhe me “H.”in”) i cili në një moment të caktuar punonte edhe në aeroport dhe nevojën e kontrabandimit të migrantëve në ato raste të veçanta, e gjithë kjo për të arsyetuar se për secilën prej veprave penale gjykata nuk sheh asnjë argument për të caktuar dënimin e tij në

minimumin e paraparë. Për këtë arsye, gjykata e shqipton dënimin me 2 vjet e 3 muaj burgim për secilën veprë penale në bashkim. Sipas rregullave për caktimin e dënimit unik, minimumi është 2 vjet dhe 3 muaj dhe maksimumi është 4 vjet e 6 muaj dhe gjykata vendos që ndaj tij të shqiptoj dënimin unik prej 3 vjet e 6 muaj burgim.

Ky dënim është i domosdoshëm duke marrë parasysh personalitetin e tij siç tregohet me anë të fakteve, për të parandaluar të tjerët nga kryerja e veprës penale dhe gjithashtu për shkak se ai nuk ka treguar kurrfarë keqardhje, e cila rrit rrezikun e përsëritjes së veprës penale dhe për këtë arsye një dënim më i lartë është i nevojshëm për të parandaluar atë që ta bëjë një gjë të tillë.

Duke pasur parasysh të lartpërmendurat: Për veprën penale të kontrabandimit me migrantë në formën renduese, duke vepruar si anëtar i grupit, në bashkëkryerje dhe në bashkim të 2 veprave penale të kontrabandimit me migrantë në formën e lartcekur, në përputhje me nenin 138, paragrafët 1, 6 dhe 7, lexuar së bashku me nenet 23, 34, 39, 54, 62, 63, 64 dhe 71 të KPPK-së, i shqiptohet dënimi unik prej 3 vjet e 6 muaj burgim.

**I.P.** (pika e akuzës 5): Vepra penale është e dënueshme me burgim prej 2 deri 10 vjet.

Duke marrë parasysh nivelin e përfshirjes, numrin e personave të kontrabanduar në një rast (3), dashjen shumë intensive dhe direkte në kryerjen e veprës penale siç tregohet nga bisedat e shumta të kryera në atë rast me A.Ç., në lidhje me kufijtë, itineraret, çmimet, etj., e gjithë kjo për të arsyetuar se nuk ka asnjë argument për të përcaktuar dënimin e tij në minimumin e paraparë. Në rastin e këtij të pandehuri, vlen të theksohet se ai ka dosje penale, siç shpjegohet tek faktet e vërtetuara, që nënkupton se pavarësisht se nuk është konsideruar recedivist për shkak të mungesës së kërkesave të nevojshme, është rasti i një personi i cili, më shumë se një herë, ka shkelur ligjin, kjo nuk është hera e parë që ai është në kontakt me sistemin penal. Prej 9 fëmijëve, vetëm 3 janë nën 18 vjeç, ai tani është fermer në token e tij.

Ky dënim është i domosdoshëm duke marrë parasysh personalitetin e tij siç tregohet me anë të fakteve, për të parandaluar të tjerët nga kryerja e veprës penale dhe gjithashtu për shkak se ai nuk ka treguar kurrfarë keqardhje (pavarësisht nga fakti se gjatë 18 muajve ka qenë në paraburgim, ai ka pasur mundësinë për të menduar në lidhje me veprat e tij), e cila rrit rrezikun e përsëritjes së veprës penale dhe për këtë arsye një dënim më i lartë është i nevojshëm për të parandaluar atë që ta bëjë një gjë të tillë.

Duke pasur parasysh të lartpërmendurat: Për veprën penale të përfshirjes së kontrabandimit me migrantë, në bashkëkryerje, në përputhje me nenin 170, paragrafët 1 dhe 8.1 dhe 8.2, të KPRK-së, lexuar së bashku me nenet 3, 31, 41, 45, 46, 73 dhe të KPRK-së, i shqiptohet dënimi prej 2 vjet e 3 muaj burgim dhe gjoba prej 400 euro.

**A.G.** (pika e akuzës 6): Vepra penale është e dënueshme me burgim prej 2 deri 10 vjet.

Duke marrë parasysh nivelin e ulët të përfshirjes, pasi ai ka qenë i përfshirë në kontrabandimin e vetëm të një personi, faktin se ai ka qenë i vetmi i cili ka vepruar me dashje eventuale por gjithashtu i vetmi i cili ka hequr dorë në mënyrë vullnetare nga përfshirja e tij.

Kjo gjithashtu e bën gjykatën që të vendos se ekzistojnë rrethana të veçanta lehtësuese, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 75, para. 1 dhe 2.1, të KPRK-së, dhe për këtë arsye gjykata cakton dënimin nën kufirin e përcaktuar më sipër.

I pandehuri vazhdon të punoj si shofer taksie dhe është i gjendjes së varfër ekonomike dhe ka 3 fëmijë, ende të vegjël.

Duke pasur parasysh të lartpërmendurat: Për veprën penale të përfshirjes së kontrabandimit me migrantë, në bashkëkryerje, në përputhje me nenin 170, paragrafët 1 dhe 8.1 dhe 8.2, të KPRK-së, lexuar së bashku me nenet 3, 21, par. 3, 31, 41, 45, 46, 73 dhe 75 të KPRK-së, i shqiptohet dënimi me 1 vjet burgim dhe gjoba prej 200 euro.

**T.Y.** (pika e akuzës 8): Vepra penale është e dënueshme me burgim prej 2 deri 10 vjet.

Duke marrë parasysh nivelin e përfshirjes, numrin e personave të kontrabanduar (2), 1 në secilin nga 2 rastet e njëkohshme, dashjen direkte në kryerjen e veprave penale, dhe pavarësisht nga fakti se nuk është hera e parë që ai është në kontakt me sistemin penal, këtu nuk do të ketë ndonjë vlerë rënduese, pasi nuk ishte e mundur të vërtetohej nëse ai kishte qenë i dënuar më përpara ose pasi kishin ndodhur faktet në këtë rast.

Ai punon në një restorant me pagën prej 800 euro dhe ka 1 fëmijë. Ky dënim është i domosdoshëm duke marrë parasysh personalitetin e tij siç tregohet me anë të fakteve, për të parandaluar të tjerët nga kryerja e veprës penale dhe gjithashtu për shkak se ai nuk ka treguar kurrfarë keqardhje, e cila rrit rrezikun e përsëritjes së veprës penale dhe për këtë arsye një dënim më i lartë është i nevojshëm për të parandaluar atë që ta bëjë një gjë të tillë.

Për 2 veprat penale në bashkim të përfshirjes në kontrabandimin e migrantëve, të konsideruara si 1 në vazhdim, sipas nenit 81 të KPRK-së, gjykata cakton dënimin me burg prej 2 vjet dhe gjobën prej 400 euro.

Duke pasur parasysh të lartpërmendurat: Për 2 veprat penale në bashkim të përfshirjes në kontrabandimin e migrantëve, në bashkëkryerje dhe në vazhdim, në formën e lartcekur, në përputhje me nenin 170, paragrafët 1 dhe 8.1 dhe 8.2 të KPRK-së, lexuar së bashku me nenet 3, 31, 41, 45, 46, 73, dhe 81 të KPRK-së, i shqiptohet dënimi me 2 vjet burgim dhe gjoba prej 400 euro.

### **Llogaritja e kohës së kaluar në paraburgim**

Në pajtim me nenin 73, par. 1, të KPPK-së apo nenin 83, par. 1, të KPRK-së, koha e kaluar në paraburgim llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

### **Afati i pagesës së gjobës**

Në pajtim me nenin 365, par. 2, të KPPK-së dhe nenit 46, par. 2, të KPRK-së, i pandehuri A.G. duhet ta paguaj gjobën brenda 1 muaji dhe i pandehuri, T.Y. brenda 3 muajve. Në rast se gjobat duhet zëvendësuar, mënyra do të jetë në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 46, para. 3 deri 5, të KPRK-së.

### **Dënimi me kusht ndaj të pandehurve A.G. dhe T.Y.**

Gjykata, nëse qëndron rasti, mund të caktoj dënimin me kusht kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë kryesin nga kryerja e veprës penale.

Nga të gjithë të pandehurit, të vetmit që plotësojnë kërkesat janë A.G. dhe T.Y., pasi dënimet e tyre nuk janë më shumë se 2 vjet burgim dhe maksimumi i dënimit për veprat penale për të cilat dënohen është 10 vjet burgim. Pasi të dytë janë dënuar sipas KPRK-së, në përputhje me nenin 3, gjithashtu në kodin e tanishëm duhet të konfirmohen kërkesat në fjalë.

Në Kodin e tanishëm Penal të Republikës së Kosovës, dënimi me kusht mund të shqiptohet me nenet 50 deri 52 të KPRK-së; “Qëllimi i dënimit me kusht është që të mos zbatohet dënimi për veprën penale e cila nuk është e rëndë, kur tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e mjaftueshme për të parandaluar kryesin nga kryerja e veprës penale”. Kërkesat për shqiptimin e dënimit me kusht përcaktohen në nenet 51 dhe 52, “gjykata mund të shqiptojë dënimin me kusht kryerësit në pajtim me dispozitat e këtij Kodi”, domethënë, “Me dënimin me kusht, gjykata ia cakton kryesit të veprës penale dënimin dhe në të njëjtën kohë urdhëron që ky dënim të mos ekzekutohet nëse personi i dënuar nuk kryen vepër tjetër penale për kohën e verifikimit të cilën e cakton gjykata. Koha e verifikimit nuk mund të jetë më e shkurtër se një (1) vit dhe as më e gjatë se pesë (5) vjet” (neni 51, paragrafi 2, të KPRK-së) dhe “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet. Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në dhjetë (10) vjet, nëse zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimit” dhe “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni nëse gjykata shqipton dënimin me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet, qoftë për një vepër penale ose për disa vepra në bashkim (neni 52, para. 1 deri 3, të KPRK-së) dhe “Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht, gjykata merr posaçërisht parasysh qëllimin e dënimit me kusht, sjelljen e mëparshme të kryesit, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale” (neni 52, par. 4, të KPRK-së).

Siç e shohim, janë plotësuar të gjitha kushtet në lidhje me dy të pandehurit në fjalë. Gjykata gjithashtu vendos të shqiptoj dënimin me kusht vetëm lidhur me dënimin me burgim, e jo për dënimin me gjobë, në përputhje me nenet 51, par. 4 dhe 52, par. 5, të KPRK-së.

Gjykata, pra, vendos, në pajtim me nenet 3, 50, 51, para. 1, 2, 4 dhe 52, para. 2 (kjo lexohet së bashku me nenin 170. par. 1), 3 deri në 5, të KPRK-së, të mos ekzekutohet dënimi me burgim ndaj A.G.t nëse ai nuk kryen vepër tjetër penale gjatë kohës së verifikimit prej 2 vjet dhe ndaj T.Y. nëse ai nuk kryen vepër tjetër penale gjatë kohës së verifikimit prej 3 vjet. Lidhur me dënimet me gjobë nuk është shqiptuar dënimi me kusht.

Në mbështetje të neneve 52, par. 3, dhe 59 të KPRK-së, dënimi me kusht përfshin edhe detyrimin për mos ndërrimin e vendbanimit pa informuar shërbimin sprovues.

### **Mos zbatimi i nenit 82 të KPRK-së, nga ana e gjykatës**

Sipas nenit 82 të KPRK-së, “Nëse personi i dënuar gjykohet për vepër penale të kryer para se të ketë filluar mbajtjen e dënimit të shqiptuar me një dënim të mëparshëm (...), gjykata shqipton dënimin unik (neni 80 i këtij Kodi), duke marrë parasysh dënimin e shqiptuar më parë. Dënimi ose pjesa e dënimit të cilin personi i dënuar e ka mbajtur llogaritet në dënimin e shqiptuar unik”.

Gjykata vendos të mos aplikojë në këtë moment një dispozitë të tillë, pasi, në mesin e faktorëve të tjerë, nuk ka të dhëna të mjaftueshme në lidhje me fazën e ekzekutimit të dënimit me burgim të shqiptuar ndaj të pandehurit I.P., në procesin gjyqësor të Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR.nr. 56/2013 dhe Gjykatës së Apelit (PAKR 259/14), të datës 22 maj 2015, me të cilin ishte dënuar për “kontrabandim të migrantëve në tentativë”, në përputhje me nenin 170, paragrafin 1, nenin 28, paragrafi 3 dhe nenin 76, paragrafi 1, nën paragrafi 4, të KPRK-së, me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim dhe me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind euro).

### **Dënimet plotësuese**

Në lidhje me dënimin plotësues ndaj të pandehurve, gjykata vendos të shqiptoj ndaj shtetasve të huaj, të cilët nuk kanë lidhje direkte familjare në Kosovë (A.Ç. dhe A.B.), dënimin plotësues të “dëbimit nga territori i Republikës së Kosovës” të paraparë në nenin 62, par. 2.9, lexuar së bashku me nenet 3, 71, par. 1, të KPRK-së, në kohëzgjatje prej 7 vjet ndaj A.Ç.-es dhe 4 vjet ndaj A.B. duke filluar nga dita kur ky vendim gjyqësor merr formën e prerë (neni 71, par 4, të KPRK-së); në lidhje me A.B., duke u dënuar me kodin në fuqi në atë kohë, dispozitat e aplikueshme janë neni 54, par. 2.9 dhe neni 62 të KPRK-së. Gjithashtu, gjykata thekson në këtë aspekt se vendqëndrimi i përhershëm i A.Ç.-es në Kosovë nuk është në pajtim me ligjin në fuqi për të huajt.

Në rastin e dy shtetasve të tjerë të huaj, të pandehurit M.A. dhe T.Y., i pari është partner i një shtetaseje të Kosovës dhe ka një fëmijë të lindur në këtë shtet, i cili po ashtu është shtetas i

Kosovës, dhe i dyti (T.Y. ) po ashtu është bërë shtetas i Republikës së Kosovës në vitin 2010 (ai është bartës i pasaportës së Kosovës me numër K00701624), dhe faktet e tilla që kanë të bëjnë me këta 2 të pandehur shqyrtohen në përputhje me nenin 71, par. 2, të KPRK-së, “(...) lidhjen e kryesit me Republikën e Kosovës”) dhe, rrjedhimisht, këta të pandehur nuk i nënshtrohen dëbimit nga vendi (edhe për arsye se në rastin e të pandehurit T.Y., kjo nuk mund të zbatohet për shkak të shtetësisë së tij të dyfishtë, po ashtu kosovare).

### **Marrja e sendeve:**

Sendet e përmendura në aktakuzë të propozuara për t’u konfiskuar shpallen të konfiskuara<sup>173</sup> nëse ende nuk iu kanë nënshtuar vendimit të njëjtë në ndonjë tjetër proces gjyqësor<sup>174</sup> pasi ishin përdorur në kryerjen e veprimeve përbërëse të veprave penale, sipas nenit 60 të KPPK-së apo 69 të KPRK-së:

Nga **A.Ç.:**

- 1 - Telefoni mobil, Nokia, model 6300 IC: 661U-RM217 me SIM kartelë, IPKO, Nr. [Tel. Nr.];
- 2 - Telefoni mobil, Nokia, model 6230i, IMEI Nr. 353233/01421796/2 me SIM kartelë MTS, [Tel. Nr.];
- 3 - SIM kartela, IPKO Nr. 109011298946;
- 4 - SIM kartela, VALA, Nr. 8937701010020489791;
- 5 - SIM kartela, IPKO Nr. 109011301108;
- 6 - SIM kartela, djuice, Nr. 38269621088;
- 7 - Telefoni mobil, Nokia, model 2310, IMEI Nr. 354819/01/015797/7;
- 8 - SIM kartela, VIP, Nr. 8938105209070703180;
- 9 - SIM kartela, IPKO, Nr. 108010741091;
- 10 - Telefoni mobil, Nokia, model 6300 IC: 661U-RM217, IMEI: 358051012922556;
- 11 - SIM kartela, IPKO, Nr. 109011867774, [Tel. Nr.];
- 12 - SIM kartela, IPKO, 109011389055;

---

<sup>173</sup> Siç tashmë është thënë, për arsye se procedura gjyqësore ishte veçuar në lidhje me S.S.n, sendet që i referohen atij nuk do të përmendën këtu.

<sup>174</sup> Siç tashmë është thënë, duke pasur parasysh, për shembull, se në rastin e të pandehurit M.B., në këtë rast vetëm telefoni me [Tel. numër] ishte përdorur, por pjesa tjetër konfiskohet pas lëshimit të një urdhri në një tjetër proces gjyqësor.

13 - SIM kartela, Mobi, [Tel. Nr.];

14 - SIM kartela, Mobi, [Tel. Nr.];

**Nga M.B.:**

1 - Desktop kompjuter, HP COMPAQ, HP DC7600, MT, CEL 3066/512/40, numri serik nr. 1059262;

2 - Telefoni mobil, Vodafone, GSM 900/1800 Mhz, IMEI Nr. 868955000980611, me SIM kartelë [Tel. Nr.];

3 - SIM kartela, IPKO, Nr. 109011727207 [Tel. Nr.]

4 - Telefoni mobil, NOKIA, model 2310, lloji RM-189, IMEI Nr. 358960/01/546112/5 me [SIM kartelë Nr.] numër serik 0553626;

5 - SIM kartela, Z-mobile, Nr. 101005288898 [Tel. Nr.];

**Nga A.M.:**

1 - Telefoni mobil, SAMSUNG, model GT-E1170, IMEI Nr. 358688/03/348592/3, me SIM kartelë, IPKO, Nr. 109011732744 [Tel. Nr.];

2 - SIM kartela, VALA, Nr. 8937701010013414525;

3 - Telefoni mobil, NOKIA, model 1650, lloji RM 305, IMEI Nr. 359565/01/710615/3;

4 - Telefoni mobil, SIEMENS C35i, [Tel. Nr.];

5 - Telefoni mobil, SAMSUNG, model GT-E1080W, IMEI Nr. 359779/04/506133/6;

6 - DELL laptop, LBL P/N W1495 A00;

7 - Telefoni mobil, NOKIA, model N73-1, lloji RM-133, IMEI Nr. 359568019767451;

8 - Telefoni mobil, NOKIA, model 6230i, lloji RM-72, IMEI Nr. 357097/00/936104/4;

9 - San Disk Micro Chip, Micro SD;

**Nga M.A.:**

1 - SIM kartela, IPKO, Nr. 108010802656;

2 - Telefoni mobil Samsung, model SGH-C130, IMEI: 359345/00/290793/5;

**Nga A.B.:**

- 1 - Telefoni NOKIA 1112, nr serik IMEI 358067/01/197640/1;
- 2 - IPKO SIM kartelë me numër serik 109011863241;
- 3 - Telefon SAMSUNG SGH D900I, me IMEI nr. 354890/01/275088/7;
- 4 - T-Mobile SIM kartelë, nr. 893890109022551969732.GI;

**Nga I.P.:**

- 1 - Telefoni mobil, NOKIA, model 101, lloji RM-769, me dy SIM kartela dhe IMEI Nr. 359739/04/689510/8 dhe IMEI Nr. 359739/04/689511/8;
- 2 - SIM kartela, VALA, [Tel. Nr.];
- 3 - SIM kartela, IPKO, [Tel. Nr.];

**Nga A.G.:**

- 1 - Telefoni mobil, NOKIA, model 6300, IMEI Nr. 353933/01/340506/8;
- 2 - Telefoni mobil, Samsung, model SGH-E900, IMEI Nr. 356030/01/325515/0;
- 3 - Telefoni mobil, Samsung, model GT- C 3010, IMEI Nr. 353373/03/898337/9;
- 4 - Telefoni mobil, Samsung, model GT-E 1170, IMEI Nr. 355049/04/406513/2;
- 5 - Telefoni mobil, Samsung, model SGH-C 260, IMEI Nr. 358210/01/064416/2;
- 6 - Telefoni mobil, Samsung, model C 3050, IMEI Nr. 358553/03/840340/4;
- 7 - SIM kartela, VALA, Nr. 8937701010016818185;

**Nga T.Y.:**

- 1 - Telefoni mobil, NOKIA, model 6303ci, lloji RM-638, IMEI Nr. 352682/04/167543/9;
- 2 - SIM kartela, VALA, Nr. 8937701010016959260 [tel. nr.], pin kod:0000;
- 3 - SIM kartela, VALA, Nr. 8937701010007220789;
- 4 - Desktop kompjuter COMPAQ, 8110FR4Z1957.

**Kërkesa pasurore juridike:**

Nuk ka asnjë kërkesë pronësore juridike.



### **Shpenzimet e procedurës penale:**

Në përputhje me nenin të 450 të KPP-së, shpenzimet e procedurës penale paguhen nga të pandehurit. Në bazë të nenit 450, par. 2.6, shpenzimet paushallë janë 200 euro për secilin nga të pandehurit, në vlerë totale prej 1600 euro.

Në përputhje me nenin 450, paragrafët 5 deri 7 të KPP-së, nuk përfshihen shpenzimet e përkthimit në gjuhët e të pandehurve dhe shpërblimet dhe shpenzimet e nevojshme të mbrojtësve të caktuar.

### **Përfundim:**

Gjykata, *ex officio*, nuk e sheh të nevojshme shpalljen e këtij aktgjykimi (dispozitivit), në shtyp, në radio apo televizion, neni 365, par. 1.1.6, të KPP-së, për të mbrojtur vlerat e drejtësisë dhe interesin publik.

Deri në përfundim të procedurës, për çfarëdo ndryshimi të adresës të njoftohet gjykata, në përputhje me nenin 368, par. 3, të KPP-së.

Të procedohet në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 474, par. 3, dhe 369, para. 3 dhe 4 të KPP-së.

### **Këshillë juridike:**

Në përputhje me nenet 374, par. 1.1, dhe 380, par. 1, ndaj këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë brenda 15 ditëve, nga dita kur kopja e aktgjykimit i është dorëzuar palëve. Ankesa duhet t'i drejtohet Gjykatës së Apelit përmes Gjykatës Themelore në Prizren.

Përpiluar në gjuhen angleze (gjuhë e autorizuar), në Prizren më 14 prill 2016,

Kryetari i trupit gjykues

---

(Gjyqtari i EULEX-it Jorge Martins Ribeiro)

Venera Hadri – Mollakuqe

---

Procesmbajtëse